

FONDACIONI I KUR'ANIT

KUR'ANI DHE PSIKOLOGJIA

Titulli: **KUR'ANI DHE PSIKOLOGJIA**

Autori: **Muhamed Uthman NEXHATI**

E përktheu nga persishtja: **Redis SHEKO**

Radhitja kompjuterike: **Sonila QAZIMI**

E redaktoi: **Jerida KULLA**

Korrektura letrare: **Klodiana SMAJLAJ, Dorina BASHA**

Korrektura teknike: **Jetmir ÇELA**

Botoi: **FONDACIONI I KUR'ANIT**

Copyright: **FONDACIONI I KUR'ANIT**

Parathënia e përkthyesit

Njeriu është krijesa e vetme që është formuar nga dy përbërës: material dhe jomaterial. Kjo krijesë e veçantë, ashtu siç i vihet theksi edhe në Kur'anin Fisnik, e ka nisur zhvillimin e saj nga dheu dhe ka hedhur pas shpine faza të ndryshme të zhvillimit, deri aty sa shpirti hyjnor lulëzoi brenda tij dhe zuri të lëvizë njëkohësisht me trupin. Me përshkrimin e fazave të ndryshme, prej vetes ka shpënë në fazën e manifestimit dhe të lulëzimit cilësi të vetat, si: arsyja, dashuria dhe ndjenjat njerëzore.

Ajo që e ka tërhequr përherë mendjen njerëzore gjatë historisë dhe e ka detyruar atë të përshtatet, është njohja e vetvetes (*ma'rifetu'n-nefs*). Njeriu, teksa merret me njohjen e vetes, ndonjëherë e ka hedhur hapin në rrugën e drejtë dhe ndonjëherë në rrugën e shtrembër.

Në kohën që ai e ka kërkuar vetveten te Zoti dhe në këtë rrugë ka hedhur hapin drejt dritës me Profetët e Tij udhëzues, ka arritur në pozitën e shpirtit të bindur (*nefs mutmeinne*). Mirëpo, në kohën që ka qenë i pavëmendshëm nga vetvetja dhe e ka përshkruar këtë rrugë, duke i rënë pas shpirtit urdhëruar (*nefs emmare*), e ka humbur rrugën e drejtë dhe ka mbetur në konfuzion.

Kur'ani Fisnik, me synim arritjen e njohjes së vetvetes, zhvillimit të personalitetit dhe lartësimit të shpirtit njerëzor në shkallët e përsosjes njerëzore, i ka treguar atij rrugën më të përshtatshme dhe më të mirë, që mund të përgatisë terrenin e lumturisë së kësaj bote dhe të Botës Tjetër. Në Kur'anin Fisnik, ajete të shumta përmendin natyrën ekzistenciale të njeriut dhe gjendjet e ndryshme psikike të tij, shkaqet e largimit, sëmundjeve. Gjithashtu, janë treguar në mënyrë të përgjithshme udhët e përmirësimit, të disiplinimit dhe të shërimit të psikikës njerëzore.

Ne mundemi që me ndihmën e realiteteve që kanë

ardhur përreth njeriut, cilësive e gjendjeve të ndryshme psikike, të zhvillojmë personalitetin. Gjithashtu, të njohim motivet kryesore të nxitjes, sjelljes njerëzore dhe faktorëve, që kanë ndikim domethënës në harmonizimin e personalitetit, përsosjes e shkaktimit të mirëqenies psikike të tij.

Kur'ani është fjala e Krijuesit të njeriut. Është e qartë se Krijuesi është më i ditur mbi natyrën dhe sekretet e krijimit të krijesës së vet. Vallë ai Zot që krijoi krijesën, a nuk është i ditur (ndaj të fshehtave të tij), mbi të fshehtën dhe të dukshmet e të gjitha punimeve të universit?

“E si të mos dijë Ai që ka krijuar gjithçka, kur Ai njih çdo gjë me intësi dhe është i Gjithinformuari?!”¹

Pa dyshim që ne kemi nevojë për më shumë ambicie, lidhur me ringjalljen dhe analizimin e trashëgimisë sonë të pasur islame. Këto punë duhet të fillojnë nga Kur'ani Fisnik dhe thëniet e nderuara të të pamëkatëve dhe më pas të vazhdojmë rrugën e përsosmërisë, duke u bazuar në studimet psikike të filozofëve dhe mendimtarëve myslimanë, me qëllim që nëpërmjet kësaj rruge, të arrijnë në njohjen e saktë të koncepteve dhe të kuptimeve psikike islame.

Autori i nderuar është përpjekur të mbledhë realitetet dhe situatat psikike, të cilat kanë ardhur në Kur'an që me gjetjen e udhës nga ajetet kur'anore, të cilat janë të gjitha të sigurta dhe që e shtrembra nuk gjen dot shteg për tek ata, që të mund të arrijë në krijimin e personalitetit të drejtë dhe sjelljes së duhur njerëzore.

Në fund e shoh si detyrë që për mundimet e përkthyesit të nderuar Redis Sheko, i cili pati mbi supe punën e këtij përkthimi dhe gjithashtu të bashkëpunëtorëve të tjerë, që ndihmuan në realizimin e këtij libri, të shprehim falënderimet tona të përzemërta dhe e lusim të madhin Zot që t'u japë mbarësi atyre në këtë jetë dhe t'i bashkojë me Profetin, familjen e tij të pastër dhe shokët e tij të zgjedhur, në Jetën Tjetër.

O Zoti ynë, na i ndriço rrugët e jetës me dritën e Kur'anit të shenjtë!

Fondacioni i Kur'anit

1. Sure “El-Mulk”, ajeti 14.

Parathënia e autorit për botimin e dytë në arabisht

Botimi i parë i këtij libri, në mënyrë të përgjithshme, u mirëprit nga shumë të interesuar për trashëgiminë islame dhe, në mënyrë të veçantë, për psikologjinë islame. Unë, në këtë pikëpamje, e falënderoj shumë të madhin Zot. Kjo vëmendje publike dhe kjo mirëpritje më detyroi që t'i vijoj kërkimet në këtë fushë dhe të përpiqem në përmbushjen e argumentimit dhe të verifikimit, lidhur me parimet islame të psikologjisë në Kur'anin Fisnik, në hadithet e nderuara profetike dhe në mesin e mendimtarëve myslimanë.

I lutem të madhit Zot të më japë sukses në kryerjen e detyrës sime dhe të më ndihmojë në përmbushjen e saj.

Sigurisht, me dëshirën e Zotit, të më mbetet jetë me qëllim që të gjej mundësinë e angazhimit në këtë punë të rëndësishme.

Në botimin e dytë të këtij libri kanë marrë formë korrigjime dhe tema të shumta, si pjesë e ajeteve kur'anore, shënimeve, analizimeve dhe krahasimeve të reja, të cilat janë shtuar në me të shumtën e pjesëve të librit. Gjithashtu, shkrimtari, pas botimit të parë, gjeti rastin të lektorej nëpër seminare dhe konferenca të ndryshme, lidhur me disa nga tematikat, të cilat ishin objekt analizimi në këtë libër. Komentet, opinionet e dhëna dhe diskutimet që u paraqitën nga ana e të pranishmëve pas këtyre fjalimeve, ishin mjaft të dobishme për mua.

Dhe unë këtu ndihem mjaft i lumtur, që të bëj falënderimet e mia të singerta ndaj grupit të bashkëpunëtorëve më të nderuar, që qenë të pranishëm nëpër këto seminare dhe që paraqitën opinione dhe pika të dobishme. Në veçanti, falënderoj shumë mikun tim të shtrenjtë, profesor doktor Abdul Aziz Kamilin për opinionet e vlefshme që shprehu për disa prej pikave të këtij libri.

Gjithashtu, falënderoj Fondacionin "Takaddumu'l-Ilm" të Kuvajtit, që i kushtoi vëmendje këtij libri dhe librit tim të

mëparshëm *El-Idraku'l-Hissij 'inde Ibn Sina (Perceptimi shqisor tek Ibn Sina)*: Studimi i psikologjisë tek arabët, dhe, këtyre dy librave në vitin 1983, u dhuroi çmimin special të kërkimeve “El-Mirath”.

Si fjalë të fundit, shpresoj që të kem pasur sukses në plotësimin e disa mangësive të gjetura në botimin e parë të këtij libri, sado që ende e ndiej se libri ka nevojë për referim të vazhdueshëm dhe shumë shtesa. Unë shpresoj se do të mund t’i rregulloj në botimet e mëpasshme. E lus të madhin Zot, që ta bëjë këtë libër shkak të afrimit tim te Ai, në Ditën e Ringjalljes, në kohën e takimit tim me Të, ta rëndojë me dritën e tij pjatën e peshores së veprave të mia të mira.

Muhamed Uthman Nexhati

10 Sheval 1404 hixhri, 9 korrik 1984

Hyrja

Vëmendja dhe përpjekja ime për temën *Kur'ani dhe Psikologjia* filloi afro dyzet vjet më parë, kur përgatisja temën e mbrojtjes së diplomës së masterit: *Perceptimi në pikëpamjen e Avicenës (Ibn Sina)* përgjatë viteve 1939–1942. Që prej asaj kohe, besoja se për të kuptuar opinionet e Ibnu Sinas, veçanërisht të psikologjisë, nevojitet që fillimisht të shqyrtohen të tëra kontekstet, pikëpamjet dhe kërkimet e llojllojshme të psikologjisë përpara epokës së tij.

Prandaj, në parathënien e temës sime kam përmendur disa kontekste psikike, të gjendura në Kur'an dhe në hadithet e nderuara Profetike, si dy burime që kanë lënë gjurmë në krijimin e ideve të Ibn Sinas (Avicenës), veçanërisht në temat *perceptim shqisor* (ar. *idrak hissi*), *arritje e njohjes* (pers. *kesb shenakht*) - dhe në çështjen *gjumi dhe ëndrrat*. Por kohë më vonë, duke mbajtur fjalën në Asamblenë e Dijetarëve të Kajros, sërish e trajtova këtë temë.

Me sa mund të kujtoj, në njërën nga netët e muajit të Ramazanit, nga mesi i viteve gjashtëdhjetë, kisha mbajtur fjalimin e lartpërmendur "*Kur'ani dhe Psikologjia*". Gjithashtu, në festivalin kulturor të shkollës së mesme *Esh-Shujukh* të Kuvajtit në vitin 1967, mbajta një fjalim po rreth kësaj teme, përmbledhja e të cilit është botuar në librin *Universiteti dhe shoqëria*, që e ka botuar Universiteti i Kuvajtit në vitin akademik 1967–1968. Gjatë kësaj periudhe merresha me punë mësimore dhe kërkimore, si dhe shkruaja, mbikëqyrja temat që shkruanin studentët për të marrë dokumentin pasuniversitar dhe Doktoraturën e Psikologjisë. Kjo është arsyeja që unë nuk pata shumë kohë për të vëzhguar thellë dhe në mënyrë të gjithanshme kontekstet psikike, sipas pikëpamjes së Kur'anit.

Në kohën që po përfundonte shekulli i katërmëdhjetë i Hixhrit e bota islame po merrej me kryerjen e kërkimeve

islame, me mbajtjen e kongreseve dhe festave të shumta, duke i uruar mirëseardhjen shekullit të pesëmbëdhjetë, ndjeva se kishte ardhur momenti që duhet të caktoja kohë të mjaftueshme, si për shqyrtimin e konteksteve psikike nga pikëpamja kur'anore, ashtu edhe për shkrimin e një libri rreth kësaj teme. Kjo ishte mënyra ime e mirëseardhjes së shekullit të pesëmbëdhjetë.

Për këtë qëllim arrita të siguroj një leje nga Universiteti i Kuvajtit, për të ndjekur studimet në semestrin e parë, të vitit akademik 1980–1981 (sipas Krishtit). Gjatë kësaj kohe munda të grumbulloj një pjesë të madhe të temave të këtij libri.

Përfitoj nga rasti, të falënderoj nga zemra Universitetin e Kuvajtit, i cili më krijoi mundësinë që, më në fund, të përfundoj kërkimet për të cilat jam përpjekur gjatë viteve të shkuara dhe që më plotësoi dëshirën për t'i çuar deri në fund ato.

Gjithashtu, dëshiroj të falënderoj autorët e nderuar, librat e të cilëve i kam lexuar dhe kam përfituar nga mendimi i tyre. Emrat e tyre do të përmenden në shënimet dhe në listën e burimeve të librit. E falënderoj shumë Zotin e Pastër dhe Pozitëlartë, që më dhuroi mundësinë ta përfundoj këtë libër.

Shpresoj të jem i suksesshëm në fushën e konteksteve psikike të gjendura në Kur'an dhe në krahasimet e tyre me kontekstet e psikologjisë së re.

Muhamed Uthman Nexhati

13 Ramazan hixhri - 14 korrik 1981 miladi (sipas erës së Krishtit)

Parathënie

Kur'ani është libër i udhëzimit, udhëzim të cilin i madhi Zot ia ka zbritur profetit Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) për të ndihmuar njerëzimin. Zoti në Kur'an i drejtohet arsyes dhe ndërgjegjes njerëzore dhe i mëson njeriut besimin në Teuhid, në një Zot të vetëm e të pashokë.

Gjithashtu, e udhëzon në atë që është e hajrit dhe në interes të tij, si në jetën individuale, ashtu edhe shoqërore; i tregon rrugën më të përshtatshme për të arritur në njohjen e vetvetes, zhvillimit të personalitetit dhe ngritjes së vet shpirtërore në rangjet e përsosjes njerëzore, me qëllim që të mund të përgatisë terrenin e lumturisë së kësaj bote dhe të Botës Tjetër (Dynjasë dhe Ahiretit).

“Ky Kur'an është tregues i qartë, udhërrëfyes dhe mëshirë për njerëzit që kanë besim të patundur.”¹

“O njerëz, ju ka ardhur këshillë (Kur'ani) nga Zoti juaj, shërim për zemrat tuaja, udhëzim dhe mëshirë për besimtarët.”²

“Ditën kur do të sjellim kundër çdo populli dëshmitarë nga gjiri i tyre, Ne do të sjellim ty (Muhamed) dëshmitar kundër këtyre. Ne ta zbritëm ty Librin, si shpjegim për çdo çështje, si udhërrëfyes, si mëshirë dhe si lajm të mirë për myslimanët.”³

“Është Ai që u solli analfabetëve një të Dërguar nga gjiri i tyre, për t'u lexuar atyre shpalljet e Tij, për t'i pastruar e për t'u mësuar Librin dhe Urtësinë, ndonëse ata më parë ishin vërtet në humbje të plotë.”⁴

“Po kështu, (për të plotësuar mirësinë Time ndaj jush) ju kam sjellë një të dërguar, nga mesi juaj, i cili ju lexon

1. Sure “El-Xhathije”, ajeti 20.

2. Sure “Junus”, ajeti 57.

3. Sure “En- Nahl”, ajeti 89.

4. Sure “El-Xhumu'a”, ajeti 2.

Shpalljet Tona, ju pastron (nga gjynahet), ju mëson librin (Kur'anin) e Urtësinë (rregullat e fesë) dhe ju mëson ato gjëra që nuk i keni ditur.”¹

Kur'ani Fisnik i nxit njerëzit të shëtisin dhe të sodisin universin, qiejt, tokën dhe krijesat e Zotit, të cilat gjenden në qiej e në tokë. Arsyeja e kësaj shëtitjeje është meditimimi dhe kërkimi rreth tyre, që nëpërmjet soditjes së çudirave të krijimit, të mund të bien në gjurmë të ekzistencës së Zotit të Madhëruar.

Thuaje: “Udhëtoni nëpër Tokë dhe shikoni se si Ai e ka zënë fill krijimin. Pastaj do të jetë Allahu Ai që do të bëjë krijimin e dytë (ringjalljen). Me të vërtetë, Allahu është i Fuqishëm për çdo gjë.”²

“Thuaje (o Muhamed): “O njerëz, unë jam i Dërguari i Allahut për të gjithë ju, i Atij që i përket sundimi i qiejve dhe i Tokës. Nuk ka zot tjetër të vërtetë veç Atij; Ai jep jetë dhe vdekje, prandaj besoni në Allahun dhe në të Dërguarin e Tij, Profetin që nuk di shkrim e lexim e që beson në Allahun dhe Fjalët e Tij! Shkoni pas Tij, që të jeni në rrugën e drejtë!”³

“Vallë, a presin ata ndonjë gjë tjetër, veç diçkaje të ngjashme me dënimin e atyre që kanë jetuar më parë? Thuaj: “Pritni, se edhe unë po pres me ju!”⁴

Kur'ani Fisnik na nxit për kërkimin e dijes, për mësimin dhe nxënien e diturisë. Për këtë, nuk ka asnjë argument më të fortë se ajeti i parë i Kur'anit të nderuar, që e fton njerëzimin në leximin dhe në nxënien e diturisë, duke e nderuar, duke e lartësuar pozitën e kalemit (penës), me anë të së cilës Zoti i mësoi njeriut shkrimin dhe dijet që nuk i njihte:

“Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi (gjithçka); e krijoi njeriun nga një droçkë gjaku!; Lexo! Zoti yt është Bujari më i madh; i Cili, me anë të penës ia mësoi; ia mësoi njeriut ato që nuk i dinte.”⁵

1. Sure “El-Bekare”, ajeti 151.

2. Sure “En-Ankebut”, ajeti 20.

3. Sure “El-A’raf”, ajeti 185.

4. Sure “Junus”, ajeti 101.

5. Sure “El- Alak”, ajetet 1-5.

Në Kur'an, Zoti betohet në kalem (penën). Vetë ky është një tregues i pozitës së lartë të *kalemit* dhe *shkrimit* dhe tregon se ata kanë një ndikim përcaktues në punën e mësimin dhe të nxënies së dijes.

“Nûn. Betohem për penën dhe për atë që shkruajnë.”¹

Kur'ani Fisnik e lavdëron virtytin e diturisë, i çmon dijetarët, e lartëson pozitën e tyre dhe e vendos diturinë në rang të lartë, ashtu si rangun e Islamit (Besimit).

“O besimtarë! Kur ju thuhet t'u hapni vend të tjerëve në tubim, atëherë bëni vend, se Allahu do t'ju bëjë vend (në Xhenet)! E kur ju thuhet të ngriheni, atëherë bëni kështu, se Allahu do t'i ngrejë në shkallë të lartë ata midis jush që besojnë dhe që u është dhënë dija. Allahu di çdo gjë që punoni.”²

“Ata, të cilëve u është dhënë dituria dhe besimi, do të thonë: “Ju, me të vërtetë, keni qëndruar aq sa ju ka caktuar Allahu në Libër - deri në Ditën e ringjalljes, e ja kjo është Dita e ringjalljes, por ju nuk e keni ditur.”³

Kur'ani e lavdëron diturinë dhe dijetarët. Ky është një argument i fortë. Këtë e tregon edhe ajeti i mësipërm, duke i përmendur ata para besimtarëve. Ndërsa në ajetin e mëposhtëm dijetarët janë përmendur pas engjëjve.

“Allahu dëshmon, e po ashtu edhe engjëjt, edhe njerëzit e dijes, se nuk ka zot tjetër që meriton të adhurohet përveç Tij, duke mbajtur drejtësinë. S'ka zot tjetër përveç Atij, të Plotfuqishmit, të Urtit.”⁴

Një argument tjetër, që është kallëzues i vlerësimit që i bën Zoti dijes dhe lavdërimit ndaj mirësisë dhe virtytit të saj, është se e ka urdhëruar Profetin që, kur t'i lutet Atij, t'i kërkojë shtimin e diturisë së vet.

“I Lartësuar qoftë Allahu, Sunduesi i Vërtetë! Mos nxito për ta lexuar Kur'anin para se të përfundojë shpallja e tij dhe thuaj: “O Zoti im, shtoma dijeninë!”⁵

1. Sure “El-Kalem”, ajeti 1.

2. Sure “El-Muxhadile”, ajeti 11.

3. Sure “Er-Rum”, ajeti 56.

4. Sure “Ali Imran”, ajeti 18.

5. Sure “Ta ha”, ajeti 114.

Dituria dhe urtësia janë dy nga begatitë më të mëdha që Zoti i bën njeriut dhe ia dhuron ato çdo robi, besimtari e të merituari që Ai dëshiron.

“Ai ia jep urtësinë (të kuptuarit e Kur’anit) kujt të dojë. Cilitdo që i është dhënë urtësia, vërtet që i është dhënë një mirësi e madhe. Por këtë nuk e kupton tjetërkush, përveç njerëzve të mençur.”¹

Dituria dhe urtësia janë dy nga begatitë më të rëndësishme që Zoti u ka dhuruar profetëve dhe të dërguarve të Tij të zgjedhur. Për këtë temë është vënë theksi në shumë ajete.² Gjithashtu, Kur’ani e nxit njeriun të thellohet në njohjen e vetes dhe të krijimit të tij, kujdesit që është përdorur për krijimin e tij. Në këtë mënyrë, Kur’ani e nxit njeriun për të eksploruar në qenësinë e vet, për të njohur sekretet dhe misteret e tij, sepse njohja e vetvetes përfundon me njohjen e Zotit.

“Në Tokë ka shenja për ata që besojnë me bindje, po edhe në vetet tuaja - a nuk e shihni vallë?”³

“Vallë, a nuk mendojnë ata në vetvete? Allahu ka krijuar qiejt dhe Tokën dhe ato që gjenden në mes tyre - vetëm me qëllim dhe afat të caktuar. E, me të vërtetë, shumica e njerëzve nuk besojnë në takimin me Zotin e tyre.”⁴

“Ne do t’u tregojmë atyre shenjat Tona në hapësirat tokësore e qiellore, si dhe në vetvete, derisa t’u bëhet plotësisht e qartë se ai (Kur’ani) është e vërteta. Vallë, a nuk të mjafton ty që, Zoti yt është Dëshmues i çdo gjëje?”⁵

“Le të meditojë njeriu se prej çfarë është krijuar: është krijuar prej një lëngu që hidhet e që del ndërmjet shtyllës kurrizore dhe brinjëve.”⁶

Profeti i nderuar (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) po përreth kësaj, ka thënë: “Men arefe nefsehu,

1. Sure “El-Bekare”, ajeti 269.

2. Referohu tek suret: “El-Bekare”, 247; “Jusuf”, 22-68; “El-Enbija”, 74; “En-Neml”, 15.

3. Sure “Edh-Dharijat”, ajetet 20-21.

4. Sure “Er-Rum”, ajeti 8.

5. Sure “Fussilet”, ajeti 53.

6. Sure “Et-Tarik”, ajetet 5-7.

fekad arefe Rabbehu." - *Kush njeh veten, do të njohë Zotin.*)

Dhe në një vend tjetër thotë: "A'refukum binefsihi a'refukum bi Rabbihi." - *Ai që e njeh më mirë veten, e njeh më mirë Zotin e tij.*¹

Përveç kësaj, njohja që njeriu i bën vetes, e ndihmon atë të kontrollojë epshin e vet dhe të imunizohet nga humbja e rrugës së drejtë. Gjithashtu, njohja e vetvetes e udhëheq njeriun në udhën e besimit, punëve të mira dhe sjelljes normale.

Këto e përgatisin njeriun për terrenin e një jete të qetë dhe të sigurt, për lumturinë e kësaj bote dhe të Botës Tjetër. Në Kur'anin Fisnik gjenden ajete të shumta që përmendin natyrën e ekzistencës së njeriut dhe gjendjet e ndryshme psikike të tij, shkaqet dhe faktorët e largimit dhe të sëmundjes. Gjithashtu, tregojnë edhe rrugët e përmirësimit, disiplinimit dhe kurimit të njeriut.

Sigurisht që pritet një premtim në çështje të këtilla, nga ana e një Libri, që ka zbritur me qëllim udhëzimin, disiplinimin dhe mësimin e njeriut. Ajetet që gjenden në Kur'anin Fisnik, në këtë aspekt (të psikikës së njeriut), janë në vend të shenjave, prej të cilave njeriu mund të kërkojë orientimin për njohjen e vet, duke u udhëzuar nëpërmjet ajeteve të lartpërmendura, me synim përmirësimin dhe disiplinimin e vetes. Ne mundemi, që me ndihmën e ajeteve që kanë ardhur në Kur'an, lidhur me njeriun, me cilësitë dhe me gjendjet psikike të tij, të udhëzohemi, të shikojmë drejt personalitetit tonë dhe të njohim motivet kryesore të sjelljes njerëzore dhe faktorët që ndihmojnë ndjeshëm në harmonizimin e personalitetit, të përkryerjes dhe saktësimit të mirëqenies psikike.

Ky mund të jetë "shtruesi" i rrugës së ardhjes në ekzistencë të një lloji diturie, "Psikologjisë", rezultatet dhe faktet e së cilës janë në harmoni me faktet, diturinë e të drejtat tona rreth njeriut, që janë nxjerrë nga Kur'ani, i cili është fjala e Krijuesit të njeriut. Është e qartë se Ai është më i ditur se kushdo, për sa i përket krijimit të krijesës së Vet.

1. Marrë nga Ebu Hamid Muhamed ibn Muhamed El Gazalij: *Me'arixhu'l-kuds fi medarixh ma'rifeti'n-nefs*, f. 6, botimi i dytë, Bejrut, Daru'l-Afaki'l-Xhedideh, 1975.

“E si të mos dijë Ai që ka krijuar gjithçka, kur Ai njeh çdo gjë me imtësi dhe është i Gjithinformuari?”¹

Libri që ndodhet tani përpara syve të lexuesit, është një përpyetje me synim grumbullimin e fakteve dhe koncepteve psikike, të cilat kanë ardhur në Kur'an. Madje, ne, nëpërmjet ajeteve kur'anore, mund të arrijmë rrugën në krijimin e personalitetit dhe të sjelljes së njeriut, në mënyrë të qartë dhe larg pështjellimit.

Në të vërtetë, kjo punë do të shtrojë rrugën e zhvillimit dhe të përsosjes së kërkimeve të reja, që, për nga pikëpamjet e trajtuara rreth “personalitetit”, përpiqen të miratojnë ligje themelore (kushtetuta), ligje që realitetet dhe konceptet rreth njeriut të kenë harmoni me ligjet dhe konceptet e gjendura në Kur'an.

Psikologët e rinj, për shkak se në kërkimet e tyre përdorin dijet eksperimentale, e ngulojnë veten në kornizën e kontrollit të asaj pjese të dukurive psikike, për të cilat ekziston mundësia e shikimit dhe e shqyrtimit subjektiv, duke u larguar nga vërtetimi dhe kërkimi ndaj shumë dukurive të rëndësishme psikike, që nuk përfshihen në kufijtë e shikimit dhe të testimit eksperimental.

Kjo është arsyeja se pse e kanë flakur mënjane nga puna e tyre kërkimore, çështjen e ekzaminimit të *nefsit - shpirtit*, sepse *revan-shpirti*, nuk është diçka që mund ta shohësh apo ta vësh për eksperiment. Për këtë arsye, ata i kufizojnë kërkimet e tyre vetëm në atë pjesë të sjelljes së njeriut që është e shikueshme dhe e vlerësueshme. Madje, disa psikologë bashkëkohorë kanë sugjeruar që emri i kësaj shkence të shndërrohet nga “Psikologji” në “Sjelljelogji”.

Argumenti i tyre është se Psikologjia e re merret me studimin dhe saktësimin e sjelljes (dhe jo psikikës apo shpirtit) së njeriut. Njëra nga rrjedhojat e prirjes në kërkimin e shkencave eksperimentale mbi kërkimet psikologjike, ishte që, në këto kërkime, të mbizotërojnë prirjet materialiste, që vijnë nga aktivitetet filozofike, nga të gjitha dukuritë psikike.

1. Sure “El-Mulk”, ajeti 14.

Parimisht, materialistët e shikojnë njeriun si një kafshë dhe kanë ecur aq përpara në këtë proces, saqë kërkimet e tyre rreth sjelljes së kafshës, i quajnë si një portë e natyrshme për futjen në rezervatin e studimit dhe të kontrollit të sjelljes njerëzore. Ata janë indiferentë ndaj anës shpirtërore dhe këtë çështje të rëndësishme e kanë lënë në harresë në kërkimet e tyre. Pikërisht kjo çështje u bë shkak i shtimit të kërkimeve psikologjike.

Por, kjo shkencë përfshin tipat e sjelljeve sipërfaqësore e të parëndësishme njerëzore. Ndërsa indiferenca në ekzaminimin e shumë dukurive të sjelljes njerëzore, që përbëhen nga aspekte fetare, shpirtërore dhe vlera të larta njerëzore është hap vendimtar në kërkimin e çështjes së dashurisë (*'ashk*) në më të mirën e formës njerëzore (larg nga aspektet seksuale, që për rastësi të kërkimeve të reja psikologjike, më së shpeshti përfshijnë po këtë aspekt dashurie). Gjithashtu, ajo nuk mund të ekzaminojë ndikimin e adhurimeve (ndaj Zotit) në sjelljen njerëzore apo në çështjen e konfliktit psikik midis motiveve trupore dhe atyre shpirtërore të tij, si dhe studimin rreth mënyrës së harmonizimit në personalitetin e njeriut, të rrugës së gjetjes së ekuilibrit midis aspekteve materiale dhe shpirtërore të tij, si dhe tema të tjera, me studimin e të cilave do të merremi në këtë libër.

Sigurisht që disa nga psikologët bashkëkohorë e kanë vënë në qendër të vëmendjes këtë çështje, që është e shkruar nga dora e Psikologjisë së re, në eksplorimin dhe në studimin e aspekteve shpirtërore të njeriut. Për shembull, psikanalisti i njohur bashkëkohor Erik From¹, në lidhje me këtë, thotë: *"Psikologjia e re, në vend që të krijojë metoda të reja për shqyrtimin e problemeve të rëndësishme të njeriut, më së shumti u kushton vëmendje çështjeve të parëndësishme, zgjidhja e të cilave bashkërendon me mënyrën shkencore iluzive."*²

Në këtë mënyrë, sërish psikologjia u bë nevojtare ndaj çështjes së saj themelore, domethënë psikikës. Vëmendja dhe

1. Erich Fromm.

2. Erich Fromm, *Ed-dijn ue tahlilu'n-nefs*, përkthim i Fuad Kamilit, Kajro, Mektebetu'l-Garijb, 1977, f. 11.

përpyjekja e psikologjisë deri tani ka qenë e përqendruar te mekanizmat dhe faktorët që shkaktuan reagimet dhe instinktet njerëzore dhe jo te dukuritë kryesore psikike, si: dashuria, arsyeja, ndjenjat, vetëdija dhe vlerat, të cilat e dallojnë plotësisht njeriun nga krijesat e tjera. Në vitet e fundit, një numër shumë i paktë psikologësh i kanë kushtuar vëmendje rëndësisë së ekzaminimit të aspekteve shpirtërore dhe kanë filluar përpjekjet për eksplorimin e disa dukurive psikike, si telepatia¹ dhe parandjenja.²

Mirëpo, prapëseprapë, këto përpjekje janë në fillim të udhës dhe ende nuk kanë arritur në rezultate të sakta, që me bindje të mund t'i shtoheshin koleksionit të informacioneve të studimeve për njeriun. Pa dyshim, ne kemi nevojë për më shumë ambicie dhe përpjekje në fushën e ekzaminimit të trashëgimisë sonë islame. Këtë punë duhet ta nisim nga Kur'ani Fisnik, hadithet e nderuara profetike dhe pastaj të ndjekim zhvillimin e mendimit në kërkimet psikologjike në mesin e filozofisë dhe të mendimtarëve myslimanë. Nga kjo udhë, të arrijmë në njohjen e saktë të konteksteve psikike islame, që orientojnë dhe ndihmojnë kërkimet psikologjike, krijimit dhe gjetjes së pikëpamjeve tona të veçanta rreth personalitetit të njeriut.

Ne, në këtë punë duhet të ecim përpara, duke i kushtuar vëmendje të mjaftueshme, jo vetëm si një kërkim shkencor, por edhe të shpjegojmë më së miri të vërtetat që kanë ardhur në Kur'an rreth njeriut, sepse, meqë ato kanë zbritur nga ana e Zotit, Krijuesit të njeriut, të gjitha janë të prera dhe absolute.

“Atij nuk mund t'i afrohet gënjeshtria nga asnjëra anë. Kjo është shpallje prej një të Urti që meriton të gjitha lavdet.”³

1. Telepatia është shkëmbimi i mendimeve dhe i kujtimeve me një person tjetër, që ndonjëherë jeton larg njeriut në fjalë.

2. *Tauahhum* (parandjenja): është perceptimi dhe ndjesia ndaj gjërave larg dhe jashtë hapësirës së shqisave.

3. Sure “Fussilet”, ajeti 42.

KREU I PARË

Motivet e sjelljes në Kur'an

Motivet janë forca lëvizëse, të cilat nxisin gjendje hareje dhe aktivizimi tek krijesa e gjallë, që nxjerrin në pah sjelljen e saj dhe e udhëheqin atë drejt qëllimit apo qëllimeve të përcaktuara. Motivet kryejnë detyra të rëndësishme për krijesën e gjallë. Në të vërtetë, janë këto motive që e detyrojnë njeriun për kryerjen e nevojave bazë dhe të domosdoshme për vazhdimin e jetës. Gjithashtu, e ngacmojnë atë edhe në kryerjen e shumë punëve të tjera të rëndësishme, të cilat janë të dobishme në harmonizimin e njeriut me mjedisin ku jeton. Psikologët bashkëkohorë i ndajnë motivet në dy lloje:

Motivet fiziologjike:¹

Këto motive janë të lindura (*fitri*) dhe lidhen me nevojat fiziologjike trupore, me mangësinë dhe mosekuilibrimin që ndodh në indet e trupit. Këto motive e udhëheqin sjelljen e individit në drejtim të objektivave që lypin nevojat fiziologjike të trupit të tij ose kompensojnë mangësinë dhe pamjaftueshmërinë, që nganjëherë krijohet në indet e trupit, dhe, nga pikëpamja e baraspeshës, e rikthejnë atë në pozitën e mëparshme.

Motivet psikike:

Këto motive përfitohen nëpërmjet mësimimit në rrjedhën e zhvillimit shoqëror të individit.²

1. Këto lloj motivesh mund të cilësohen si motive parësore.

2. Kësaj kategorie motivesh u thuhet *motive dytësore*, të fituara ose motive të mësuara ose sociale (shoqërore).

A – Motivët fiziologjike

Urtësia e arrirë e Zotit, që u dhuroi krijesave të Tij mirësinë e ekzistencës, e kërkon që tek ata të depozitohet veçori dhe cilësi të veçanta dhe t'i bëjë të denjë për kryerjen e detyrave, për të cilat janë krijuar.

(Musai) tha: **“Zoti ynë është Ai që çdo gjëje i ka dhënë trajtën e vet e pastaj e ka udhëzuar.”**¹

“Lavdëro emrin e Zotit tënd, më të Lartit, që ka krijuar gjithçka dhe e ka përpjesëtuar drejt; që ka caktuar fatin e çdo gjëje dhe ia ka rrëfyer rrugën;”²

Motivët fiziologjike janë prej veçorive më të rëndësishme që Zoti i ka depozituar në natyrën e ekzistencës së kafshës dhe njeriut. Këto motive janë dy llojesh: njëri nga ata është për mbijetesën e individit dhe tjetri për vazhdimësinë e llojit të domosdoshëm.

Punët fiziologjike të kafsha dhe njeriu, në fund, rezultojnë me kryerjen e këtyre detyrave të rëndësishme. Këto aktivizime dhe mosaktivizime fiziologjike sigurojnë nevojat e trupit dhe merren me ndërlikime, si defekte gjymtyrore, apo pamjaftueshmërinë e lëndës kimike, që nganjëherë ndodhin në trup dhe rezistojnë përballë çdo lloji çrregullimi apo ankthi dhe mosbaraspeshimi.

Rrënjësisht, motivët fiziologjike ruajnë gjithnjë në një masë të përcaktuar³ baraspeshën jetike, e cila është e nevojshme për ruajtjen dhe vazhdimësinë e racës njerëzore. Për shembull, si pasojë e pamjaftueshmërisë së gjatë të ushqimit apo mungesës së ujit në indet e trupit, krijohet ndonjë çrregullim në ekuilibrin e tij, ose nxehtësia dhe ftohtësia e trupit shkon përtej gradës së përcaktuar.

Gjithashtu, kur lidhja e kalon masën e përcaktuar, menjëherë aktivizohen faktorët e përcaktuar për rikthimin e gjendjes së mëparshme në trup dhe e shtrëngojnë njeriun për

1. Sure “Ta ha”, ajeti 50.

2. Sure “El-A’la”, ajetet 1-3.

3. Këto kërkime i kreu fiziologjist amerikan Valter Kanon dhe i botoi në librin *Urtësia e trupit* Cannon W.B *The Wisdom of the Body*, New York: Norton, 1932.

kryerjen e veprimtarive të duhura. Kërkimet e reja fiziologjike kanë nxjerrë në pah se në trupin e njeriut dhe të kafshës ekziston një lloj prirjeje e natyrshme, lidhur me ruajtjen e ekuilibrit në gradën bazë. Nëse çrregullohet ky ekuilibër, tek ai zgjohet një faktor, i cili e detyron atë në kryerjen e aktivitetit harmonizues, për rikthimin e trupit në gjendjen e ekuilibrit të mëparshëm.

Ky aktivitet harmonizues nganjëherë merr formë vetëm mbi bazën e një veprimi fiziologjik dhe pa ndërhyrjen e vullnetit të njeriut. Si për shembull, dalja e djersës nga trupi kur ngrihet temperatura. Kjo punë vjen vetvetiu, për shkak të avullimit të djersës dhe e ul temperaturën e trupit; apo kur diçka e huaj hyn në sy dhe nën qerpikët e tij, lotët zënë të rrjedhin në mënyrë të pavullnetshme dhe janë po këto lot, që e ruajnë syrin nga dëmet e jashtme.

Ndonjëherë ky aktivitet bën “marrëveshje” me kryerjen e një përpjekjeje të vullnetshme, të përcaktuar nga ana e individit, si ngrënia e ushqimit në kohën e urisë apo pirja e ujit kur ka etje. Vetë idenë e “ekuilibrit” jetik, e cila është zbuluar së fundi nga ana e shkencëtarëve, Kur’ani Fisnik e ka shpjeguar që para katërmbëdhjetë shekujsh:

“Dhe Tokën e kemi shtrirë e nëpër të kemi shpërndarë male të patundura. Ne kemi bërë që në tokë të rritet çdo gjë në përpjesëtim.”¹

Thuj: “A është më i mirë ky apo Xheneti i amshuar, i cili u është premtuar të devotshmëve? Ai do të jetë për ta shpërblim dhe vend kthimi.”²

“Allahu e di se ç’mbart çdo femër dhe e di sa shkurtohet e sa zgjatet (koha e lindjes). Çdo gjë tek Ai është me masë. Ai i di gjërat e dukshme dhe të padukshme. Ai është i Madhi, i Larti.”³

“Vërtet, Ne çdo gjë e kemi krijuar me masë të paracaktuar.”⁴

1. Sure “El-Hixhr”, ajeti 19.

2. Sure “El-Furkan”, ajeti 2.

3. Sure “Er-Ra’d”, ajeti 8.

4. Sure “El-Kamer”, ajeti 49.

Prandaj njeriu, po ashtu edhe kafsha, janë krijuar me një stil të përcaktuar, të llogaritur dhe në një masë të fiksuar. Në këtë mënyrë, që, nga pikëpamja e baraspeshës dhe e harmonisë, të gjendet në një masë të fiksuar dhe, kurdo që kjo baraspeshë të çrregullohet, menjëherë aktivizohen motivet fiziologjike, që e shtrëngojnë si njeriun, ashtu edhe kafshën, në kryerjen e llojeve të aktiviteteve harmonizuese, të cilat janë të nevojshme për rikthimin në trup të gjendjes së mëparshme të ekuilibruar.

Kur'ani vë theksin në këto motive të rëndësishme fiziologjike. Më poshtë do të paraqesim ajetet që lidhen me këto motive:

1. Motivet e ruajtjes së qenies

I madhi Zot, në disa nga ajetet e Kur'anit, ka përmendur motivet më të rëndësishme fiziologjike, të cilat kanë për detyrë ruajtjen e vetes (*nefsit*) dhe mbijetesën e individit, si: uria, etja, lodhja, i nxehti, i ftohti, dhembja dhe frymëmarrja. Zoti i Madhëruar iu drejtua Hazretit Adem (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe i përkujtoi atij begatitë që gëzonte. Kjo ishte në kohën kur Ademi jetonte në Parajsë. Në Parajsë nuk e mundonte gjë: ndjesia e urisë apo e lodhjes, vendi ku nuk jetonte i zhveshur e ta mbulonte turpi e atë të mund ta dëmtonin tekat e motit, vendi ku nuk e ndiente të nxehtin përvëlues të diellit, sepse parimisht në Parajsë nuk ekzistonte dielli.

Allahu (*xh.sh*) e paralajmëroi që të mos binte në grackën e djallit, që donte ta nxirrte jashtë Parajsës dhe të binte në jetën tokësore bashkë me bijtë, të mundoheshin për të shuar urinë nëpërmjet punës së lodhshme dhe përpjekjes së vazhdueshme, si: gjuetia, plugimi i tokës dhe bujqësia. Gjithashtu, për të shuar etjen, duhet të gërmonin puse, ta kërkonin ujin në tokë; për t'u mbrojtur nga ndryshimet e motit, duhet të endnin pëlhura; për t'u ruajtur nga nxehtësia e diellit dhe i ftohti i natës, duhet të strukeshin nën hijet e pemëve dhe brenda shpellave, ose të ndërtonin shtëpi. I madhi Zot, në lidhje me këtë, thotë:

Pastaj thamë: “O Adem, me të vërtetë që ky është armiku yt dhe i gruas sate, prandaj mos e lini t’ju nxjerrë kurrësi nga Xheneti, se pastaj do të vuani në mjerim! Këtu nuk do të mbetesh kurrë as i uritur e as i zhveshur, dhe nuk do të kesh as etje, as vapë.” Por djalli e cyti: “O Adem, a do të të tregoj pemën e përjetësisë dhe të një mbretërimi që nuk zhduket?”¹

Në këto ajete tregohet për tri prej motiveve më të rëndësishme të ruajtjes së qenësisë: urinë, etjen dhe mbrojtjen nga vapa, nga i ftohti i madh. Këto ajete, gjithashtu, vënë theksin në motivet e dashurisë për qëndrim dhe të pronësisë. Parimisht, motivet e ruajtjes së qenësisë veprojnë në shërbim të motivit të dashurisë për qëndrim dhe funksionojnë për plotësimin e nevojave fiziologjike. Në të vërtetë, punojnë për qëndrimin e njeriut dhe për vazhdimësinë e jetës së tij.

Ndërsa, për sa i përket motivit të pronësisë që llogaritet prej motiveve psikike, do ta trajtojmë në të ardhmen. Motivët e “dëshirës për të mbijetuar” dhe të “pronësisë”, në të vërtetë, ishin një portë hyrëse e djallit për te shpirti i Hazretit Adem (*Paqja qoftë mbi të!*). Djalli e pyeti Ademin: “A të të prij ty për te pema e përjetësisë dhe e pronësisë, që nuk vjetrohët kurrë?” Këtu, Ademi i la në harresë paralajmërimet e të madhit Zot, iu rebelua urdhrit të Tij dhe hëngri frytin e asaj peme. Në ajetet e mëposhtme të sures “En-Nahl” shohim se si është vënë theksi në disa nga motivet e ruajtjes së qenësisë, si: i nxehti, i ftohti, lodhja dhe dhembja. Zoti thotë:

“Sigurisht që ti (Muhamed), nuk mund t’i bësh të vdekurit të dëgjojnë, as nuk mund t’i bësh të shurdhrit të dëgjojnë thirrjen tënde, kur të kthejnë shpinën! Ti nuk mundesh t’i nxjerrësh as të verbrit nga humbja e tyre! Ty të dëgjojnë vetëm ata që besojnë Shpalljet Tona dhe na nënshtrohen Ne (si myslimanë).”²

Prandaj njeriu gjen strehë nëpër shpella, nën çadra dhe brenda shtëpive, duke u ruajtur nga kafshët e egra, nga armiqtë

1. Sure “Ta ha”, ajetet 117-120.

2. Sure “En-Neml”, ajetet 80-81.

e nga ndryshimet e motit. Po ashtu, aty gjen vend rehatia dhe siguria për veten. Ai mund të pushojë pas lodhjes që i vjen nga puna e përditshme.

Gjithashtu, njeriu gjen strehë nën hijen e pemëve, në kodra e male, që e ruajnë nga dëmi i të nxehtit të diellit. Ai, me anë të rrobave që përgatit, e ruan veten nga i nxehti dhe i ftohti dhe, në luftëra, me mjetet e blinduara që krijon nga hekuri (si këmishët e çeliktë), e ruan trupin e tij nga dëmi i armiqve dhe nga dhimbja e plagëve. Njëri nga argumentet që tregon se motivet e urisë, e etjes dhe të lodhjes janë nga motivet që zakonisht njeriu mund t'i durojë për një kohë të gjatë, për shkak të vuajtjes dhe dhembjes dhe sjelljes së dëmit, është premtimi për shpërblim që Zoti u ka dhënë besimtarëve, në këmbim të durimit të vuajtjes nga uria, etja dhe lodhja në rrugën e Zotit.

“Banorëve të Medinës dhe beduinëve që janë rreth saj, nuk u lejohet të mos ndjekin të Dërguarin e Allahut, as të kursejnë jetën e tyre para jetës së tij. Kjo është kështu, sepse ata që janë në rrugën e Allahut, sa herë që t'i godasë etja, lodhja e uria dhe sa herë që të shkelin në ndonjë vend ku do t'i zemërojnë mohuesit apo t'i gjejë gjë nga ana e armikut, atyre do t'u shkruhet si vepër e mirë. Me të vërtetë, Allahu nuk do t'ua humbë shpërblimin punëmireve.”¹

Motivet e ruajtjes së qenësisë ekzistojnë si të kafshët, ashtu edhe te njeriu. Ajeti i mëposhtëm i sures “En-Neml” vë theksin në motivet e ruajtjes së qenësisë të milingonat, që u bë shkak që milingona të zgjedhë largimin nga gjërat që e dëmtojnë dhe e asgjësojnë atë.

“Para Sulejmanit u tubua ushtria e Tij e përbërë prej xhindeve, njerëzve dhe shpendëve, të gjithë të radhitur në çeta të gatshme. Kur arritën në Luginën e Milingonave, një milingonë tha: ‘O milingona, hyni në banesat tuaja, që të mos ju shkelë Sulejmani dhe ushtria e tij, duke mos ju parë!’”²

1. Sure “Et-Teube”, ajeti 120.

2. Sure “En-Neml”, ajetet 17-18.

Shohim se në këto dy ajete është theksuar motivi i ruajtjes së qenësisë të milingonat, duke e detyruar njërën prej tyre, ndoshta kryetarin ose rojtarin, që t'i vërë në gatishmëri milingonat e tjera për rrezikun që u kanoset, me qëllim që, për t'u ruajtur nga ky rrezik, të hyjnë në foletë e tyre.

Disa nga ajetet kur'anore vënë theksin në rëndësinë e veçantë të çdonjërit prej motiveve të urisë dhe të gjendjes së reagimit nga frika në jetën njerëzore. Secila nga gjendjet e urisë dhe frikës kanë ndikim të madh në jetën e njeriut, sepse zakonisht njeriu duron vuajtje të shumta, për të shtënë në dorë një copë bukë për vete dhe për familjen e tij, ashtu sikurse frika nga vdekja, e ardhmja e paditur, nga armiq të tij të tjerë dhe siklete të kohës, që më së shpeshti bëhen shkak i fatkeqësisë së njeriut. Po për këtë arsye, në disa nga ajetet kur'anore, gjendjet e urisë dhe frikës janë përmendur si dy faktorë që kanë ndikim të madh në jetën e njeriut.¹

Zoti thotë:

“Të cilët kur i godet ndonjë fatkeqësi thonë: “të Allahut jemi dhe tek ai do të kthehemi!”²

“Allahu e ka bërë shembull qytetin (e Mekës), i cili ishte i sigurt dhe i qetë. Atij i arrinin ushqime të bollshme nga të gjitha anët, por pastaj banorët e tij i mohuan dhuntitë e Allahut dhe Ai i bëri të shijojnë urinë dhe frikën, si ndëshkim për atë që bënë.”³

“Prandaj le të adhurojnë Zotin e kësaj shtëpie (Qabesë); i Cili i ushqen ata në ditë urie dhe i siguron në ditë frike.”⁴

Një rast tjetër, që sqaron rëndësinë e kënaqësisë së motivit të urisë në jetën e njeriut, si dhe rëndësinë e ruajtjes së trupit të tij nga ndryshimet e motit, vapa e madhe dhe i ftohti, është ky që, i Madhi Zot e ka caktuar shlyerjen e mosveprimit pas betimit, me ushqyerjen e dhjetë të varfërve të pastrehë ose me veshjen e tyre.

1. Çështjen e frikës do ta trajtojmë më hollësisht në kapitullin e dytë, i cili u trajtohet posaçërisht gjendjeve reaguese.

2. Sure “El-Bekare”, ajeti 156.

3. Sure “En-Nahl”, ajeti 112.

4. Sure “Kurejsh”, ajetet 3- 4.

“Allahu nuk ju ndëshkon për betimin që e bëni pa qëllim, por ju ndëshkon për betimin e bërë me qëllim. Larja e gjynahut për thyerjen e betimit është: ushqyerja e dhjetë të varfërve me mesataren e ushqimit të familjes suaj ose t’i vishni ata, ose të lironi një skllav. Ai që nuk gjen mundësi për këto, le të agjërojë tri ditë. Kjo është shlyerja për thyerjen e betimeve tuaja, nëse betoheni. Mbani betimet tuaja! Kështu jua shpjegon Allahu Fjalët dhe ligjet e Veta, që të jeni mirënjohës.”¹

Gjithashtu, Kur’ani vë theksin në motivin e të nxehtit dhe të ftohtit.

“dhe, për durimin e tyre, Ai do t’i shpërblejë me Xhenet dhe petka të mëndafshta. Të mbështetur në divane, ata nuk do të kenë as vapë dhe as të ftohtë.”²

Parimisht, në Parajsë nuk ekziston dielli, që të bëhet shkak për nxehtësi, ashtu siç nuk ekziston edhe i ftohti i ashpër. Gjithashtu, Kur’ani vë theksin në motivin e lodhjes. I Madhi Zot thotë ato që do të thonë besimtarët në Parajsë.

“Pastaj do të thonë: “Lavdi Allahut, i Cili e ka larguar hidhërimin nga ne. Vërtet, Zoti ynë është Falës dhe Falënderues. Është Ai që me mirësinë e Tij na ka pranuar në shtëpinë e banimit të përhershëm, në të cilën nuk do të lodhemi e nuk do të rraskapitemi.”³

Në Parajsë, njeriu, duke mos pasur detyra, nuk ndien lodhje. Zoti, duke përshkruar banorët e Parajsës, sikur thotë: “Ndërsa, në jetën e kësaj bote, ku njeriu heq mundime për të fituar bukën e përditshme dhe kryerjen e detyrës e të përgjegjësi të shumëllojshme, është e natyrshme që ndien lodhje. Për të rifituar freskinë dhe gjallërinë e jetës së vet, ka nevojë për pushim dhe gjumë.”

“Të tjera shenja të Tij janë gjumi juaj natën e ditën dhe kërkesa e juaj nga dhuntitë e Tij. Vërtet, në këtë ka shenja për njerëzit që dëgjojnë.”⁴

1. Sure “El-Maide”, ajeti 89.

2. Sure “El-Insan”, ajetet 12-13.

3. Sure “Fatir”, ajetet 34-35.

4. Sure “Er-Rum”, ajeti 23.

Prandaj, njëri nga treguesit e fuqisë së Zotit është se njeriu fle natën për të qetësuar trupin e tij nga lodhja e punës së përditshme, në kërkim të bukës nga mirësia e pamasë e Zotit. Rreth kësaj, Zoti thotë:

“Ai jua krijoi natën për të pushuar në të, kurse ditën për të parë dhe këtu, vërtet, ka shenja (argumente) për njerëzit që ua vënë veshin.”¹

“Allahu e ka bërë natën që ju të pushoni, ndërsa ditën e ka bërë të ndritshme për të parë. Vërtet, Allahu është Dhurues i madh ndaj njerëzve, por shumica e tyre nuk janë mirënjohës.”²

“Vallë, a nuk shohin ata, që Ne e kemi bërë natën për pushim, ndërsa ditën për të parë?! Njëmend, këto janë shenja për besimtarët.”³

“dhe gjumin jua kemi bërë për prehje. Natën jua kemi bërë mbulesë, ndërsa ditën e kemi caktuar për të punuar.”⁴

“Dhe është Ai që jua ka bërë natën mbulesë dhe gjumin pushim, kurse ditën jua ka bërë për të lëvizur.”⁵

Ajetet e mësipërme vënë theksin mbi këtë çështje, që i madhi Zot krijoi perden e zezë të natës, me qëllim që njerëzit të flenë nën strehën e saj me qetësi, pas një dite të lodhshme, pas lëvizjeve dhe aktivitetit të shumtë. Ditën e ka bërë të ndriçuar, me qëllim që njerëzit të përpiqen për fitimin e bukës së përditshme dhe të plotësojnë nevojat e jetës.

Për motivin e lodhjes dhe kërkimin e qetësisë, Zoti thotë:

“Ai jua merr shpirtrat (ju vë në gjumë) natën, duke e ditur ç’keni bërë ditën, pastaj ju zgjon që të plotësoni kohën tuaj të caktuar për të jetuar. Në fund, tek Ai do të ktheheni dhe Ai do t’ju tregojë gjithçka që keni bërë.”⁶

“Prej mëshirës së Vet, Ai ka bërë për ju natën dhe ditën, që të qetësoheni, të kërkoni nga mirësia e Tij dhe të jeni mirënjohës.”⁷

1. Sure “Junus”, ajeti 67.

2. Sure “Gafir”, ajeti 61.

3. Sure “En-Neml”, ajeti 86.

4. Sure “En-Nebe’”; ajeti 9-11

5. Sure “El-Furkan”, ajeti 47.

6. Sure “El-En’am”, ajeti 60.

7. Sure “El-Kasas”, ajeti 73.

Lodhja është një motiv i rëndësishëm, i cili e detyron njeriun të çlodhet dhe të flejë pas mundimit të punës së përditshme, me qëllim që qelizat e trupit të tij të rifitojnë freskinë dhe fuqinë e jetës. Kur njeriu zgjohet nga gjumi, është i fuqishëm e i hareshëm dhe ka aftësi ta vazhdojë me dëshirë punën e vet. Gjumi i redukton njeriut tensionin trupor (ose konvulsionin dhe dridhjen trupore) të ardhur nga frika, e cila e kaplon atë nga problemet dhe vështirësitë e shumta të jetës së përditshme. Kjo çështje del në pah nga përsëkrimi i gjendjes së myslimanëve në Kur'an gjatë Luftës së Bedrit, në kohën kur disa prej tyre u pushtuan nga frika. Zoti thotë:

“Ai bëri që ju të koteni në gjumë të lehtë si shenjë sigurie nga ana e Tij dhe lëshoi nga qielli shi, për t’ju pastruar nëpërmjet atij, për të larguar nga ju ndyrësinë e djallit dhe për t’i forcuar zemrat tuaja dhe këmbët.”¹

Ky gjumë rehatie u bë shkak i zhdukjes së frikës së tyre dhe, si përfundim, i rikthimit të gjendjes së sigurisë dhe të qetësisë tek ata. I Madhi Zot, në ajetin e mëparshëm e ka vënë theksin mbi rëndësinë e gjumit në jetën e njeriut.

“Thuaju (o Muhamed): “Pa mendoni, nëse Allahu jua bën ditën të përhershme deri në Ditën e Kiametit, cili zot, përveç Tij, do t’jua sillte natën, në të cilën qetësoheni? Vallë, a nuk shihni?”²

Nëse dita do të vazhdonte pa mbarim dhe nuk do të ekzistonte nata, që njeriu të gjejë qetësinë nën strehën e saj dhe të largojë nga vetja mundimin e lodhjes, vallë a do të mund të kishte një jetesë të rehatshme dhe pa mundime e fatkeqësi? Kjo veti është argument mbi mëshirën dhe mirësinë e Zotit ndaj njeriut, i Cili e ka bërë natën dhe ditën, në mënyrë që të vijë njëra pas tjetrës dhe depozitoi te njeriu motivin e lodhjes, që ta detyrojë atë të çlodhet, me qëllim që të rifitojë harenë dhe jetën e re. Dhimbja konsiderohet prej motiveve të lindura (*fitri*) fiziologjike, e cila e detyron njeriun të largohet nga gjërat që bëhen shkak i mundimit, i vuajtjes dhe i torturimit të tij. Më

1. Sure “El-Enfal”, ajeti 11.

2. Sure “El-Kasas”, ajeti 72.

parë vumë theksin në motivin e dhimbjes në dy ajetet, ajetet 80-81, që sollëm nga surja "En-Neml".

Shembuj të shumtë tregojnë se dhembja është një motiv i fuqishëm, që i detyron njerëzit të largohen dhe të ruhen nga gjërat mundimsjellëse. Kjo çështje është trajtuar në shumë ajete kur'anore, që nga paralajmërimi që u bëhet mohuesve dhe hipokritëve, që, nëse nuk do të pendohen dhe nuk do të besojnë në Zot, një dënim i dhembshëm do t'i kapë ata, si në këtë botë (dynja), ashtu edhe në Ahiret. Nëse dhembja nuk do të ishte një motiv i fuqishëm, i lindur (*fitri*) dhe i përgjithshëm, nuk kishte pse të përdorte këtë mënyrë për të frikësuar njerëzit që mohojnë Zotin dhe nuk pranojnë mesazhin e Muhamedit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), që rezultat i saj ishte kapja nga dënimi i dhembshëm. Në Kur'an ka ajete të shumta që i paralajmërojnë mohuesit për dënimin e Xhehenemit (Ferrit). Do të përmendim disa shembuj:

"Me të vërtetë, sikur të kenë jobesimtarët tërë pasurinë që gjendet në tokë, madje edhe një herë aq, e ta sakrifikojnë për të shpëtuar nga dënimi i Ditës së Kiametit, nuk do të pranohet prej tyre dhe për ata do të ketë dënim pikëllues. Ata do të dëshirojnë të dalin nga zjarri, por s'do të mund të dalin dot. Ata i pret dënimi i përhershëm."¹

"Hipokritët betohen për Allahun se nuk thanë asgjë (të keqe). Por, në të vërtetë, ata thanë fjalën e mosbesimit, mohuan pas (pranimin të) Islamit dhe synuan të bënin gjëra të paarritshme. Ata u bënë keqdashës, vetëm sepse Allahu dhe i Dërguari i Tij u kishin dhënë (besimtarëve) nga të mirat e Tij. Nëse pendohen, do të jetë më mirë për ta; por, nëse kthejnë shpinën, Allahu do t'i ndëshkojë me dënim të rëndë në këtë jetë dhe në tjetrën dhe ata nuk do të kenë kurrfarë mbrojtësi apo ndihmësi në Tokë."²

"O populli ynë, përgjigjuni thirrësit të Allahut dhe besojni Atij! Ai do t'jua falë gjynahet tuaja dhe do t'ju shpëtojë prej dënimit të dhembshëm."³

1. Sure "El-Maide", ajetet 36-37.

2. Sure "Et-Teube", ajeti 74.

3. Sure "El-Ahkaf", ajeti 31.

2. Motivi i frymëmarrjes

Motivi i frymëmarrjes është një nga motivet e domosdoshme fiziologjike të jetës, sepse njeriu, po ashtu edhe kafsha, për të jetuar ka nevojë të thithë oksigjenin. Kur pakësohet oksigjeni, njeriu ndien te vetja një motiv që e detyron atë të thithë oksigjen. Nëse nuk ka oksigjen, njeriu vdes. Zoti, në ajetin e mëposhtëm, vë theksin mbi rëndësinë e frymëmarrjes në jetën njerëzore.

“Një shenjë tjetër për ata është që paraardhësit e tyre Ne i ngarkuam në anijen e mbushur plot (të Nuhut) dhe për ata Ne krijuam mjete të ngjashme me atë anije, në të cilat hipin. Po të duam, Ne i fundosim ata e atëherë as nuk do të mund t’i ndihmojë kush, as nuk do të mund të shpëtojnë...”¹

“Ne të gjithë i dënuam për gjynahun e vet: disave u dërguam furtunë, disa syresh i goditi një zë i tmerrshëm, disa prej tyre i gëlltiti toka dhe të tjerët i përmyti uji. Allahu nuk u bëri atyre padrejtësi, por ata i bënë padrejtësi vetvetes.”²

Rëndësia e motivit të frymëmarrjes, si një motiv fiziologjik i lindur, që ka një detyrë të rëndësishme në ruajtjen e ekzistencës së njeriut dhe të mbijetesës së tij, aktivizohet në kohën kur njeriu ndien frikë ose kur rrezikon të mbytet.

Zoti e vë kështu theksin mbi gjendjen e trishtuar dhe frikën e njeriut, kur gjendet në anije në mes të detit të paanë, përballë stuhisë së fuqishme dhe dallgëve që vijnë nga çdo anë, duke ndier rrezikun e mbytjes, që pason me zhdukjen e tij.

“Ai ua mundëson (njerëzve) udhëtimin nëpër tokë dhe det. E, kur gjenden në anije që lundron me ta me erën e përshtatshme e ata i gëzohen kësaj, arrin një stuhi dhe i sulmojnë valët nga të gjitha anët e mendojnë se do t’i vënë poshtë, (atëherë) i luten Allahut sinqerisht, duke i premtuar besimin: “Nëse na shpëton nga kjo, me të vërtetë, do të jemi mirënjohës.”³

1. Sure “Jasin”, ajetet 41-43.

2. Sure “El-Ankebut”, ajeti 40.

3. Sure “Junus”, ajeti 22.

3. Dy motive të mbijetesës së species

Urtësia e të madhit Zot ka vendosur në natyrën e njeriut dhe të kafshës, motive fiziologjike të lindura, që t'i detyrojnë ata të zgjedhin sjellje të domosdoshme, të shumëllojshme, për të ruajtur qenësinë. Dy prej këtyre instinkteve janë: instinkti seksual dhe instinkti amësor (që i përket nënës).

3.1. Instinkti seksual

Puna e rëndësishme e këtij instinkti është prodhimi i kopjes, që bëhet shkak për formimin e familjeve, të shoqërive, të kombeve dhe të racës njerëzore. Ndërtimi i sipërfaqes së tokës, njohja e popujve, zgjerimi i qytetërimeve, analizimi i shkencës dhe i industrisë, janë produkte të këtyre instinkteve.¹

“O njerëz! Në të vërtetë, Ne ju krijuam ju prej një mashkulli dhe një femre dhe ju bëmë popuj e fise, për ta njohur njëri-tjetrin. Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij. Vërtet, Allahu është i Gjithëdhijshëm dhe për Atë asgjë nuk është e fshehtë.”²

“ O njerëz! Frikësojuni Zotit tuaj, i Cili ju krijoi prej një njeriu, ndërsa prej atij krijoi bashkëshorten e tij, kurse prej këtyre të dyve krijoi shumë meshkuj e femra. Dhe frikësojuni Allahut, me emrin e të Cilit ju kërkon të drejtat e ndërsjella dhe ruani lidhjet farefisnore. Se vërtet, Allahu është përherë Mbikëqyrës mbi ju. ”³

“Allahu i ka krijuar për ju gratë nga lloji juaj e nga gratë tuaja ju jep djemtë e nipat dhe ju furnizon me ushqime të mira. A mos vallë, ata besojnë në gënjeshtër dhe mohojnë dhuntitë e Allahut.”⁴

1. Sure “Esh-Shura”, ajeti 11. Në tefsirin e Ibn Kethirit, në fund të këtij ajeti, lexojmë: *jedhreukum* d.m.th., “Ju krijon në atë”; përmiri *atë* kthehet në krijimin në këtë formë dhe me këtë cilësi, d.m.th., Zoti ju krijon në mashkull dhe femër, ashtu njëri pas tjetrit dhe brez pas brezi. (Vëllimi 4, f. 108.)

2. Sure “El-Huxhurat”, ajeti 13.

3. Sure “En-Nisa”, ajeti 1.

4. Sure “En-Nahl”, ajeti 72.

Dëshmia e Zotit është e atillë, që edhe te bimët të gjendet detyra e shtimit të llojit. Dëshira e Tij është që çdo gjë në gjithësi të ketë çiftin e vet.¹

“Është Ai që e ka shtrirë tokën, duke krijuar në të male dhe lumenj. Dhe për çdo lloj fryti, Ai ka krijuar nga një çift. Ai ka bërë që nata ta mbulojë ditën. Me të vërtetë, në këto ka shenja për njerëzit që mendojnë.”²

“Dhe nga çdo gjë, Ne kemi krijuar dy palë, në mënyrë që ju të vini veshin!”³

“Qoftë lavdëruar Ai që i ka krijuar çift të gjitha llojet: çka mbin prej tokës, ata vetë dhe ato që nuk i dinë!”⁴

Instinkti seksual, në të vërtetë, është themeli i formimit të familjes, sepse secili nga bashkëshortët, tek gjendet në krah të partnerit të vet ndien prehje, siguri, qetësi dhe midis tyre lind ndjenja e dashurisë, e miqësisë dhe e dhembshurisë.

Këta janë faktorët e vazhdimësisë së jetës martesore në një situatë harmonizimi, bashkëpunimi. Kjo lloj jetese, sipas radhës së vet, përgatit një atmosferë të shëndetshme për zhvillim, për edukimin e fëmijëve dhe për formimin e drejtë të personalitetit të tyre.

“Dhe një prej shenjave të Tij është që prej jush krijoi për ju bashkëshortet tuaja, që të qetësoheni pranë tyre, duke vënë ndërmjet jush dashuri dhe mëshirë. Me të vërtetë, në këtë ka shenja, për njerëzit që mendojnë.”⁵

“A nuk e shohin ata mbretërinë e qiejve e të Tokës dhe gjithçka që ka krijuar Allahu, duke menduar se mund t’u jetë afruar fundi?! Në çfarë Shpallje tjetër do të besojnë pas kësaj?!”⁶

1. Sure “Jasin”, ajeti 36. Në lidhje me këtë, referoju *Dirasat fi’n-nefsi’l-insani-je*, të autorit Muhamed Kutub, Bejrut, Daru’sh-Shuruk (Shtëpia botuese “Shuruk”), 1979, f. 195-196.

2. Sure “Er-Ra’d”, ajeti 3.

3. Sure “Edh-Dharijat”, ajeti 49.

4. Sure “Jasin”, ajeti 36.

5. Sure “Er-Rum”, ajeti 21.

6. Sure “El-A’raf”, ajeti 185.

3.2. Instinkti amësor

Urtësia dhe e mira e të madhit Zot është e tillë, që në natyrën e nënës të krijojë një instinkt të lindur (*fitrah*), që ta përgatisë atë për kryerjen e një misioni të rëndësishëm të vetin, me synim vazhdimësinë e llojit. Nëna e duron vështirësinë e shtatzënisë dhe të lindjes, nga dëshira, edhe pas lindjes së fëmijës. Gjithashtu, kryen detyrën e gjidhënies, ruajtjes e mëshirimit, deri sa i vogli të rritet dhe të mund t'i kryejë vetë punët. Kur'ani e vë theksin kështu mbi durimin e vuajtjeve, shtatzënisë dhe lindjes së nënës:

“Njeriun e kemi porositur të jetë i sjellshëm ndaj prindërve të vet. Nëna e mbart atë me mund dhe me mund e lind. Ai mbartet dhe ushqehet me gji për tridhjetë muaj dhe, kur arrin në moshën e burrërisë e i mbush dyzet vjet, ai thotë: “O Zoti im! Më frymëzo që të të falënderoj për begatitë që Ti më ke dhënë mua dhe prindërve të mi dhe që të bëj vepra të mira, me të cilat Ti do të jesh i kënaqur! Më dhuro pasardhës të mirë! Tek Ty kthehem i penduar dhe Ty të dorëzohem!”¹

“Ne e kemi urdhëruar njeriun që t'i nderojë prindërit e vet. Nëna e ka mbartur atë, duke duruar mundim pas mundimi, e ndarja e tij (nga gjiri) është brenda dy vitesh. Ne i thamë atij: “Bëhu falënderues ndaj Meje dhe prindërve të tu! Tek Unë do të ktheheni të gjithë”.²

Kur'ani sqaron ndjesitë e nënës, dashurinë, dhembshurinë e saj për fëmijët; frikën e pikëllimin e saj në kohën kur gjendet larg tyre; gëzimin e saj kur i ka pranë vetes. Ky përshkrim i bukur ka ardhur përgjatë rrëfimit të historisë së Musait (*Paqja qoftë mbi të!*):

“Ndërkohë, zemra e nënës së Musait u bë si të ishte e zbrazët. Edhe pak dhe çdo gjë do të zbulohet, sikur të mos ia kishim forcuar Ne zemrën, që të bëhej besimtare e vërtetë.”³

1. Sure “El-Ahkaf”, ajeti 15. Thënia **“Nëna e ka mbartur atë, duke duruar mundim pas mundimi”** do të thotë se nëna hoqi mundime e vështirësi, si në periudhën e shtatzënisë, ashtu edhe në kohën e lindjes. Fjala *fisal* do të thotë “heqje e qumështit”.

2. Sure “Lukman”, ajeti 14.

3. Sure “El-Kasas”, ajeti 10.

“Ne e kemi urdhëruar njeriun që t’i nderojë prindërit e vet. Nëna e ka mbartur atë, duke duruar mundim pas mundimi, e ndarja e tij (nga gjiri) është brenda dy vitesh. Ne i thamë atij: “Bëhu falënderues ndaj Meje dhe prindërve të tu! Tek Unë do të ktheheni të gjithë.”¹

Domethënë, zemra e nënës së Musait nuk kishte merak për asgjë tjetër vetëm se për të birin e saj. Nëse Zoti nuk do t’ia forconte zemrën dhe nuk do të zbriste qetësi dhe siguri në shpirtin e saj, do t’i zbulohesh sekreti nga sasia e frikës dhe e pikëllimit, që e kishte kapluar atë, si pasojë e ndarjes nga i biri. Ndërsa në kohën që u rikthye i biri, pikëllimi ia mori të ligat asaj dhe iu kthye sërish lumturia.

“Kështu, Ne e kthyem atë te nëna e vet, që ajo të gëzohej e të mos pikëllonte dhe që ta dinte se premtimi i Allahut është i vërtetë; por, shumica e njerëzve nuk e dinë.”²

B. Motivet psikike

Motivet psikike janë motive që nuk mund t’ua referosh drejtpërdrejt gjendjeve fiziologjike të trupit, që janë rezultat i nevojave trupore. Mirëpo kjo kategori është e shkrirë me motivet fiziologjike, si: urinë, etjen dhe lodhjen. Pjesa dërrmuese e psikologëve besojnë se shumica e motiveve psikike janë të fituara mbi bazën e atyre fiziologjike. Me fjalë të tjera, motivet psikike, ata i njohin si degë të motiveve fiziologjike, të cilat anashkalohen si rezultat i ndikimit të zhdërvjelltësive dhe faktorëve të zhvillimit shoqëror të individit.

Prandaj, ata nuk i mohojnë elementet e lindura (*fitra*) në motivet psikike. Madje disa nga ata, si Erik Fromi, besojnë që disa nga motivet psikike që ai i quan “nevoja psikike”, në të vërtetë janë nevoja të lindura dhe themelore në natyrën e njeriut.

1. Sure “Lukman”, ajeti 14. Fjala *uehnun* do të thotë “dobësi” dhe **“duke duruar mundim pas mundimi”**, mund pas mendi, dobësi në periudhën e shtatzënisë dhe lindjes.

2. Sure “El-Kasas”, ajeti 13.

Nevoja e bashkimit me të tjerët, nevoja për urdhërim dhe vlerësim, nevoja për identitet dhe, gjithashtu, nevoja për kornizimin në drejtim të udhëheqjes së sjelljes vetjake, nuk mësohen, por fitohen në mjedisin shoqëror.¹

Abraham Masloui (Maslow) ka bërë një propozim të ri për klasifikimin e motiveve, që përfshin edhe motivet shpirtërore. Ai beson në dy lloj nevojash: 1- **nevojat themelore**; 2- **nevojat shpirtërore**.

1- Nevojat themelore

Nevojat themelore përbëhen nga po ato gjëra që shumica e psikologëve i marrin në studim në kërkimet e tyre, si: uria, etja, instinkti seksual, siguria dhe të ardhurat dhe motive të tjera nga kjo kategori.

2- Nevojat shpirtërore

Nevojat shpirtërore janë përfshirëse të aspekteve shpirtërore, të nevojave të njeriut, si: kërkimi i drejtësisë, bamirësia, bukuria, disiplina e unitetit dhe e rregullit.

Abraham Masloui beson se nevojat shpirtërore të njeriut janë një lloj nevojash të lindura (*fitri*), me plotësimin e së cilave ka lidhje zhvillimi i personalitetit të individit.

Ne, në këtë libër, jemi të prirur që të gjitha motivet psikike dhe shpirtërore, që janë shkak i dallimit të njeriut nga kafsha, t'i sjellim nën titullin "Motive psikike".

Ndërkaq besojmë që shumë nga këto motive psikike, nuk janë të fituara në mjedisin shoqëror. Madje, në mes tyre, gjithashtu, gjenden elemente të lindura (*fitri*). Vlen të përmendet që psikologët bashkëkohorë, i kanë kushtuar shumë vëmendje kërkimit rreth nevojave fiziologjike të njeriut, ashtu sikurse kërkimet e tyre përreth motiveve psikike, më shumë janë përfshirëse të atij grupi nevojash të ndryshme të njeriut, që lidhen me harmonizimin individual dhe shoqëror të tij, me kërkesat kulturore dhe shoqërore të

1. Lindsey, G. Hall, C. Sand and Thompson, R.F., New York: Worth Publishers, Inc., 1976, f. 360.

posaçme të mjedisit, të edukimit dhe të zhvillimit të tij.

Psikologët bashkëkohorë nuk i kanë kushtuar vëmendje shqyrtimit të aspektit shpirtëror të njeriut dhe nevojave bazë e të larta njerëzore, që burojnë prej tij. Ndërkohë që realisht, vetë kjo anë shpirtërore, është nevoja më e rëndësishme dhe më e lartë njerëzore dhe dallimi më i rëndësishëm i tij me kafshët e tjera.

Vendosmëria e psikologëve bashkëkohorë mbi zbatimin e mënyrës shkencore të shkencave natyrore në studimet kërkimore rreth njeriut, i ka detyruar ata që t'i kushtojnë vëmendje formave të sjelljeve njerëzore, që janë të studiuara vetëm nëpërmjet kërkimeve eksperimentale dhe të rebelohen prej shumë aspekteve të rëndësishme të sjelljes njerëzore, të cilat lidhen me çështjet shpirtërore. Ata, në vend të përpjekjes për përmirësimin e metodave të reja, që janë të denja për kërkimin dhe për studimin e aspekteve shpirtërore të njeriut, e kanë flakur kërkimin dhe studimin mbi to.

Kohët e fundit janë bërë kritika mbi prirjet materialiste që mbizotërojnë në kërkimet psikologjike njerëzore dhe, gjithashtu, mbi mënjanimin e aspekteve shpirtërore të sjelljes njerëzore. Për shembull, Erik From e ka kritikuar Psikologjinë bashkëkohore, sepse shpesh merret me studimin e aspekteve të vogla dhe sipërfaqësore të sjelljes njerëzore dhe nuk studion problemet e rëndësishme, vlerat e larta dhe aspektet shpirtërore të saj. Sipas tij, vetë këto veçori janë karakteristikat më të rëndësishme të njeriut.¹ Ishin këto kritika që e detyruan Maslow-in, t'i ndajë nevojat e njeriut në nevoja themelore dhe nevoja shpirtërore, të cilat ne vumë theksin.

1. Motivi i pronësisë (i zotërimit)

Motivi i pronësisë i përket atij grupi të motivimeve psikike, që njeriu e mëson në rrjedhën e zhvillimit të tij shoqëror, sepse ai, nëpërmjet kulturës së mjedisit ku rritet, si dhe përmes shkathtësive dhe informimeve personale, mëson dashurinë për zotërimin e parasë, arave, tokave dhe pasurive

1. Po aty, f. 361.

të ndryshme. Sipas tij, këto elemente bëhen shkak që të ndihet i sigurt përballë varfërisë. Kur'ani Fisnik, në shumë ajete, vë theksin mbi motivin e pronësisë (zotërimit).

“Burrave u është hijeshuar dashuria për gjërat e dëshiruara: për gratë, fëmijët, arin dhe argjendin e grumbulluar, kuajt e bukur, bagëtitë dhe arat e lëruara. Këto janë kënaqësitë e kësaj jete, por shumë më i mirë është kthimi tek Allahu.”¹

“Dhe e doni pasurinë me një dëshirë të pakufishme.”²

“Pasuria dhe djemtë janë stoli e jetës së kësaj bote. Por veprat e mira që mbeten përherë, janë më të mira te Zoti yt sa i përket shpërblimit dhe, janë më të mira sa i përket shpresës (për shpëtim).”³

“Ta dini, se jeta në këtë botë, nuk është tjetër veçse lojë, dëfrim e zbukurim, si dhe mburrje ndërmjet jush e rivalitet për më shumë pasuri dhe fëmijë! Ajo i shëmbëllen bimës, e cila pas shiut rritet dhe i gëzon bujqit, por më vonë zverdhet, thahet dhe mbetet pa vlerë. Në Botën Tjetër ju presin vuajtje të mëdha ose falja e Allahut dhe kënaqësia e Tij; jeta në këtë botë është vetëm kënaqësi e rreme.”⁴

Vetë motiv i zotërimit (pronësisë) ishte njëri nga dy motivet e rëndësishme që djalli zgjoi në shpirtin e Ademit (*Paqja qoftë mbi të!*), i cili u bë shkak që ai, duke ngrënë frytin e pemës që Zoti e pati ndalur për t'iu afruar, t'i rebelohej urdhrit të Zotit.

Por djalli e cyti: “O Adem, a do të të tregoj pemën e përjetësisë dhe të një mbretërimi që nuk zhduket?”⁵

Një pjesë e psikologëve, si Mehdugal, e konsideron zotërimin (pronësinë) si një lloj instinkti. Mirëpo kërkimet e kryera në antropologji dhe në psikologjinë bashkëkohore, nuk e miratojnë zotërimin (pronësinë) si instinkt dhe e konsiderojnë atë një motiv të fituar psikik.⁶

1. Sure “Ali Imran”, ajeti 14.

2. Sure “El-Fexhr”, ajeti 20.

3. Sure “El-Kehf”, ajeti 46.

4. Sure “El-Hadid”, ajeti 20.

5. Sure “Ta ha”, ajeti 120.

6. Për më shumë, referohu tek *Ilmu'n-nefs fi hayatina'l-jeumije* të Muhamed

Prandaj, nuk duhet të dilet në një përfundim të tillë, që motivi i zotërimit tek Ademi dhe bijtë e tij është i lindur apo instiktiv, kur djalli e udhëheq Ademin drejt “sundimit të pazhdukshëm”. Ka mundësi që nga çështja e mësipërme të arrijmë në këtë përfundim: Djalli u përpoq të shkaktojë një motiv në shpirtin e Ademit, që në atë kohë, faktikisht, nuk ekzistonte tek ai. Në këtë mënyrë, mund të themi që Ademi e mësoi motivin e zotërimit me anë të tregimit të djallit dhe nën ndikimin e tij.

2. Motivi i grindjes (i agresionit)

Motivi i grindjes shfaqet në sjelljen agresive të njeriut përballë të tjerëve, me qëllim dëmtimin e tyre, si në formën e agresionit fizik, ashtu edhe në formën e agresionit me fjalë. Kur'ani Fisnik e vë theksin mbi rrjedhën e rrëfimit të historisë së Ademit dhe Havasë, mashtrimit të tyre nga ana e djallit dhe dëbimit të tyre nga Parajsa.

Por djalli e cyti: “O Adem, a do të të tregoj pemën e përjetësisë dhe të një mbretërimi që nuk zhduket?”¹

“Shejtani i shtyu të gabojnë e i nxori nga lumturia ku ishin. “Zbritni – u thamë Ne – do të jemi armiq të njëri-tjetrit. Në Tokë do të qëndroni, do të keni furnizim e do të jetoni deri në një kohë të caktuar.”²

Dhe tha: “Zbritni prej Xhenetit që të dy!”³

Dy ajetet e mësipërme vënë theksin mbi padrejtësinë dhe dhunimin që bëjnë disa njerëz kundrejt të tjerëve, për shkak të konkurrencës dhe të dëshirave epshore, duke rënë pre e mashtrimit nga djalli. Gjithashtu, Kur'ani, në ajetin e mëposhtëm të sures “El-Bekare” e vë theksin mbi motivin e agresionit (dhunimit).

Kur Zoti yt u tha engjëjve: “Unë do të krijoj një mëkëmbës (që do të zbatojë lidhjet e Zotit) në Tokë”, ata

Uthman Nexhati, botimi 11, Kuvajt, Daru'l-Kalem, 1984.

1. Sure “Ta ha”, ajeti 120.

2. Sure “El-Bekare”, ajeti 36.

3. Sure “Ta ha”, ajeti 123.

thanë: **“A do të vësh atje dikë që do të bëjë çrregullime e do të derdhë gjak në të, ndërkohë që Ne të madhërojmë, të lavdërojmë dhe të lartësojmë ashtu siç të takon Ty?!”** Ai tha: **“Unë di atë që ju nuk dini.”**¹

Iman Fakhru Razi, duke e komentuar këtë ajet, thotë: “Kur Zoti u shpalli engjëjve ajetin: “Unë në tokë do të caktoj një mëkëmbës”, ata thanë: “Vallë do të caktosh dikë që do të mbjellë shthurje (*fesad*)?” Shpjegimi i çështjes është ky: Sa herë epshi dhe zemërimi nga njëra anë dhe arsyeja, nga ana tjetër, vendosen në krah të njëri-tjetrit, në një situatë të tillë do të mbizotërojnë epshi dhe do të marrë formë zemërimi. Kjo do të bëhet shkak i manifestimit të shthurjes nga ana e epshit.

Thënia e Zotit nga goja e engjëjve *jesfiku'd-dima*, domethënë një mëkëmbës i këtillë do të derdhë gjak mbi tokë, duke sjellë përdorim të forcës së zemërimit. Ndërsa Zoti u tha engjëjve: “inni a’lemu ma la ta’lemune”, d.m.th., “Unë di atë që ju nuk e dini.”²

Agresioni i parë në historinë e njerëzimit ishte ai i Kabilit, djalit të Ademit (*Paqja qoftë mbi të!*) ndaj vëllait të tij Habilit. Kur Zoti pranoi kurbanin (flijimin) e të vëllait dhe refuzoi kurbanin e tij, atë e pushtoi xhelozia dhe vrau të vëllanë.

“Lexoju (o Muhamed) saktësisht ngjarjen e dy bijve të Ademit, kur ata bënë nga një kurban, njërit iu pranua, kurse tjetrit jo. Njëri i tha tjetrit: “Ty gjithsesi do të të vras”. Tjetri tha: “Allahu pranon vetëm prej të devotshmit. Nëse ti ngre dorë të më vrasësh mua, unë nuk do ta ngre dorën që të të vras, sepse, në të vërtetë, unë i frikësohem Allahut, Zotit të gjithësisë. Unë parapëlqej të marrësh barrën e gjynahut tim dhe të gjynahut tënd e kështu të bëhesh ndër banorët e zjarrit. Ky është ndëshkimi i keqbërësve”. Vetja e tij e nxiti në vrasjen e të vëllait dhe e vrau. Kështu, ai u bë nga të humburit.”³

1. Sure “El-Bekare”, ajeti 30.

2. Imam Fakhrudin Umer Er-Rrazi: *En-nefsu ue'r-ruh ue sherhu kiuahuma* sipas studimit të Muhamed Sagijr Hasan El-Ma'sumij, nga publikimet e Ma'hadu'l-Ebhatti'l-Islamiye, Karaçi, pa datë, f. 4.

3. Sure “El-Maide”, ajetet 27-30.

Gjithashtu, Kur'ani vë theksin mbi sjelljen grindavece, që nganjëherë shfaqet në interpretimet gjuhësore të llojit të përfoljes, akuzës, ofendimit dhe talljes së të tjerëve. Ajetet e mëposhtme janë një shembull ideal për këtë çështje.

“O ju që keni besuar! Mos zgjidhni për miq dhe këshilltarë të afërt njerëz të tjerë jashtë gjirit tuaj; ata nuk ngurrojnë që t’ju bëjnë dëm. Ata dëshirojnë që të vuani. Urrejtja shfaqet në gjithçka që del prej gojës së tyre, kurse ajo që fshehin në zemrën e tyre, është edhe më e madhe. Ne jua kemi shpjeguar vargjet (e Kur’anit), nëse jeni njerëz që kuptoni.”¹

“Nëse ju mposhtin, ata do të jenë armiq të tuaj e do t’i zgjasin duart dhe gjuhën e tyre për t’ju lënduar ju, sepse dëshirojnë që ju të bëheni jobesimtarë.”²

Psikologët dhe psikanalistët nuk janë të një mendimi për çështjen e grindjes, nëse është motiv i lindur apo i fituar. Disa nga ata, si Frojdi dhe Lorenci, besojnë se agresioni është një motiv i lindur. Ka psikologë të tjerë që nuk e pranojnë këtë çështje. Sipas tyre, pranimi i kësaj çështjeje ka të bëjë me pasjen e një vështrimi negativ dhe një mendimi pesimist, lidhur me natyrën dhe qenien e njeriut. Nga ky shikim, dhunimi i të tjerëve, përshkruhet si punë e shëmtuar dhe mundim.

Për vetë këtë arsye, psikologët From dhe Mazolo vënë theksin mbi aspektet pozitive dhe unanimitetin e mirëdashjes pozitive që ekziston te natyra njerëzore. Kërkimet e reja eksperimentale kanë nxjerrë në dritë përfundime se sjellja grindavece zë të shfaqet te foshnjat që kur lëvizja trupore e tyre kufizohet.

“Ata që nuk besojnë, janë të joshur nga jeta e kësaj bote, prandaj tallen me besimtarët. Por njerëzit që i frikësohen Allahut, do të jenë mbi ata – në Ditën e Kiametit. Allahu begaton pa kufi kë të dojë.”³

“Sa për ata (hipokritë) që përqeshin besimtarët që japin lëmoshë me vullnet dhe tallen me ata që nuk janë në gjendje

1. Sure “Ali Imran”, ajeti 118.

2. Sure “El-Mumtehine”, ajeti 2.

3. Sure “El-Bekare”, ajeti 212.

të japin gjë përveç (fryteve të) punës së tyre, Allahu do të tallet me ta. Ata do të kenë dënim të dhembshëm.”¹

Ky kufizim i lëvizjes bëhet shkak i shfaqjes së gjendjes zhgënjyese, si rezultat, del në pah sjellja agresive e tyre. Prandaj, në rrjedhën e zhvillimit të fëmijës zënë të shtohen llojet e pengesave: shoqërore, ligjore, ekonomike, politike dhe psikike, që bëhen shkak për lindjen e zhgënjimit. Përfundimet e disa kërkimeve të tjera tregojnë se gjendja zhgënjyese nuk rezulton patjetër me sjelljen agresive, madje nganjëherë bëhet shkak i shfaqjes së llojeve të tjera të sjelljes, si: kërkimi i ndihmës nga të tjerët, izolimi, mbështetja te pijet alkoolike dhe përdorimi i lëndëve narkotike. Këtu mund të përmendim faktorë të shumtë që janë të lidhur me edukimin e fëmijës, raportin e tij me prindërit dhe personale, që i mësojnë atij të reagojë përballë zhgënjimeve me sjellje agresive. Për këtë arsye, shumë nga psikologët bashkëkohorë, sjelljen agresive, të paktën në një pjesë të saj, e quajnë sjellje të fituar.²

Kjo ide, tek e cila besojnë shumë nga psikologët bashkëkohorë, përputhet me atë që ka ardhur në Kur'an për gatishmërinë dhe aftësinë e pritjes të së mirës dhe të së keqes te njeriu.

“dhe ia kemi bërë të qarta të dyja rrugët.”³

Domethënë, ne i treguam atij rrugën e së mirës dhe të së keqes dhe e lamë të lirë të zgjidhte. Shumë faktorë, si mënyra e edukimit, kushtet e zhvillimit shoqëror dhe kulturor, mësimet e fituara dhe përvoja personale, bëhen shkak që ai të zgjedhë njërin nga dy rrugët: bamirësinë dhe sjelljen e hijshme me njerëzit, ose keqbërjen, padrejtësinë e agresionin. Për shembull, nganjëherë njeriu mëson që ta kompensojë zhgënjimin me sjellje agresive, me izolim dhe mbyllje në vetvete.

Nganjëherë, po ashtu, na mëson të bëjmë qëndresë përballë zhgënjimeve që pësojmë, duke e vrarë mendjen për zgjidhjen e problemeve dhe duke u përpjekur që për

1. Sure “Et-Teube”, ajeti 79.

2. Morris, Charles, G. *Psychology, An introduction*, 3rd. Englewood Chiffs. New Jersey, 1979, f. 368-370.

3. Sure “El-Beled”, ajeti 10.

kompensimin e zhgënjimeve, të gjejmë rrugëzgjdhje të reja, të cilat funksionojnë më mirë për mposhtjen e problemeve.

3. Motivi i garimit (konkurrimit)

Garimi është nga ajo kategori e motiveve psikike, që njeriu e mëson nga mjedisi i zhvillimit kulturor dhe e udhëheq edukimin individual të tij në kah të aspekteve pozitive, në drejtim të lartësimit dhe të përparimit, mbi bazën e vlerave që ka shoqëria. Për shembull, ndonjëherë individi mëson nga kultura e shoqërisë së vet garimin ekonomik, politik, shkencor ose të llojeve të tjera që qarkullojnë në kulturat e ndryshme njerëzore.

Kur'ani i nxit njerëzit për të garuar në çështjen e devotshmërisë ndaj Zotit, në punët e mira, në përmbajtjen ndaj vlerave të larta njerëzore dhe për të ndjekur udhën e treguar prej Zotit në jetë; si në raport me të madhin Zot apo familjen, apo shoqërinë, që të përfitojnë faljen dhe kënaqësinë e Tij, si përfundim, të hyjnë në Parajsë dhe të përfitojnë nga begatitë e Zotit.

Zoti thotë: **“Me të vërtetë, punëdrejtët do të gjenden në Xhenet, duke shikuar nga divanet. Në fytyrat e tyre do të njohësh shkëlqimin e lumturisë. Atyre do t’u jepet të pinë musht të pastër, të ruajtur mirë, fundi i të cilit është myshku. Për këtë, le të përpiqen ata që përpiqen.”**¹

“Çdokush ka një drejtim nga i cili kthehet. Pra, bëni garë më njëri-tjetrin për punë të mira. Kudo që të gjendeni, Allahu do t’ju mbledhë të gjithëve; Ai është i Fuqishëm për çdo gjë.”²

“Prandaj rrekuni me njëri-tjetrin, duke kërkuar falje prej Zotit tuaj dhe një kopsht të gjerë sa qielli dhe Toka, që është e përgatitur për ata që i kanë besuar Allahut dhe të dërguarve të Tij. Ajo është mirësia e Allahut, që Ai ia jep kujt të dojë; e Allahu ka mirësi të pafund.”³

“Ne të kemi zbritur ty (o Muhamed) Librin me të vërtetën,

1. Sure “El-Mutaffifin”, ajetet 22-26.

2. Sure “El-Bekare”, ajeti 148.

3. Sure “El-Hadid”, ajeti 21.

si përmbushës të shkrimeve të mëparshme dhe mbrojtës të tyre. Prandaj gjykoji ata sipas asaj që të ka zbritur Allahu dhe mos ndiq dëshirat e tyre, duke u shmangur kështu nga e Vërteta që të është shpallur. Ne për secilin nga ju kemi sjellë një ligj dhe një rrugë të qartë. Sikur të donte Allahu, do t'ju kishte bërë një popull të vetëm, por Ai kërkon që t'ju provojë në atë që ju ka dhënë, andaj bëni gara për punë të mira! Të gjithë do të ktheheni te Allahu e Ai do t'ju lajmërojë për çështjet, rreth të cilave kishit kundërshti.”¹

4. Motivi i fesë

Feja është një motiv psikik i lindur (*fitrah*) në natyrën e njeriut, sepse, thellë në ekzistencën e tij, ai ndien një motiv që e shtrëngon për të kërkuar rreth Krijuesit të vet, universit, adhurimeve, kërkimit të rrugëzgjdhjeve prej Tij dhe strehimit tek Ai në kohën e shtrëngatës nga vështirësitë e jetës.

Parimisht, njeriu e gjen sigurinë dhe qetësinë e vet në përkrahjen dhe kujdesin që Zoti i bën atij. Nëse do të vërejmë sjelljen e njeriut në të gjitha ciklet e historisë në shoqëritë e ndryshme njerëzore, do ta zbulojmë fare qartë këtë gjë.

Përfytyrimet e njerëzve në shoqëritë e ndryshme përgjatë shekujve të historisë, rreth Zotit dhe mënyrës se si e kanë adhuruar, kanë dallime me njëra-tjetrën, nga pikëpamja e nivelit të mendimit dhe e shkallës së zhvillimit kulturor. Mirëpo, të gjitha këto dallime që vihen re në përfytyrimet e njerëzve për Zotin dhe mënyrën e adhurimit të Tij, janë vetëm në mënyrën e interpretimit dhe të shpjegimit të po atij motivi të lindur të fesë, i cili gjendet thellë në shpirtin njerëzor.

Disa nga ajetet e Kur'anit Fisnik e zbardhin këtë çështje, që motivi i fesë është një motiv i lindur (*fitri*). Zoti thotë: **“Drejtohu me përkushtim në fenë e pastër monoteiste, natyrën fillestare, në të cilën Allahu i ka krijuar njerëzit. S'ka ndryshim të krijimit të Allahut. Kjo është feja e drejtë, por shumica e njerëzve nuk e dinë.”**²

1. Sure “El-Maide”, ajeti 48.

2. Sure “Er-Rrum”, ajeti 30.

Zoti, në këtë ajet, përkujton që feja, besimi, domethënë në krijimin dhe në natyrën njerëzore ekziston një lloj dhuntie e lindur, që mund të perceptojë çuditë e krijimit të Zotit dhe nëpërmjet tyre të argumentojë mbi ekzistencën dhe njëshmërinë e Tij.¹ Gjithashtu, Zoti thotë:

“Drejtohu me përkushtim në fenë e pastër monoteiste, natyrën fillestare, në të cilën Allahu i ka krijuar njerëzit. S’ka ndryshim të krijimit të Allahut. Kjo është feja e drejtë, por shumica e njerëzve nuk e dinë.”²

Në këtë ajet, Zoti sqaron se krijimi i Ademit, i fëmijëve dhe i gjeneratës së tyre, ka qenë brez pas brezi në botën e atomit, pra ekzistenca e tyre ka qenë përpara krijimit të tyre në këtë botë. Dhe u kërkoi atyre dëshmi: “A nuk jam Unë Zoti juaj?” Ata u përgjigjën “Posi, dëshmojmë për këtë gjë.” Kjo është arsyeja pse Zoti e kërkon dëshminë e tyre mbi të qenët e Tij, që në Ditën e Kiametit të mos thonë se ne ishim të pavëmendshëm lidhur me Teuhidin (njëshmërinë e Zotit) apo nuk kishim dijeni për të.³

Tema e mësipërme qartëson se, në natyrën e krijuar të njeriut, ekziston një dhunti e lindur ndaj njohjes së Zotit dhe adhurimit të Tij. Prandaj, pranimi i zotësisë së Zotit i ka rrënjët në natyrën e lindur njerëzore dhe ka ekzistuar që në thellësinë e shpirtit të tij.

Mirëpo, përzierja e shpirtit me trupin dhe interesi i njeriut për dëshirat e ndryshme trupore, të cilat janë domosdoshmëri e jetës së kësaj bote tokësore dhe shkak njohjeje dhe informimi lidhur me Zotin dhe dhuntinë e lindur për adhurimin e një Zotit, bëjnë që njeriu të përballet me rrezikun e pavetëdijes dhe të harresës, si dhe të flaket mënjane nëpërmjet ndjenjave të pavetëdijshme të tij. Prandaj njeriu ka nevojë për diçka që t’ia zgjojë këtë dhunti të lindur, t’ia fshijë pluhurin e harresës nga faqja e saj dhe ta zgjojë atë në thellësinë e pavetëdijshme të tij, deri sa të perceptohet dhe të ndihet në mënyrë të qartë e të hapur. Kjo gjë realizohet nëpërmjet bashkëpunimit të njeriut

1. *Tefsiru'l-Kurtubij*, vëllimi 14, f. 29; *Tefsiru'l-Xhelalejn*, f. 340- 341.

2. Sure “Er-Rrum”, ajeti 30.

3. *Tefsir Ibn Kethir*, vëllimi 2, f. 262; *Tefsiru'l-Xhelalejn*, f. 114.

me universin dhe vështrimin të tij të çudirave që Zoti ka krijuar në ekzistencën e tij dhe të krijesave të tjera.

“Kur Zoti yt nxori nga kurrizi i bijve të Ademit pasardhësit e tyre dhe i bëri të dëshmojnë kundër vetes së tyre, u tha: “A nuk jam Unë Zoti juaj?” Ata u përgjigjën: “Po, dëshmojmë se Ti je.” Kështu bëri Ai, në mënyrë që ju (o njerëz) të mos thoni në Ditën e Kiametit: “Këtë nuk e kishim ditur.”¹

Ndër faktorët që e ndihmojnë njeriun në zgjimin dhe aktivizimin e motivit të fesë është ekzistenca e rreziqeve, që e kërcënojnë atë në disa nga momentet e jetës dhe që ia mbyllin atij të gjitha rrugët e shpëtimit, në atë mënyrë, sa që nuk gjendet asnjë shteg-arratisje, përveçse strehimit te Zoti. Si rrjedhim, njeriu tërhiqet kah Zoti me vetë motivin e lindur dhe i kërkon Atij ndihmë për asgjësimin e rrezikut.²

Lidhur me këtë, Zoti thotë: **“Ai ua mundëson (njerëzve) udhëtimin nëpër tokë dhe det. E, kur gjenden në anije që lundron me ta me erën e përshtatshme e ata i gëzohen kësaj, arrin një stuhi dhe i sulmojnë valët nga të gjitha anët e mendojnë se do t'i vënë poshtë, (atëherë) i luten Allahut sinqerisht, duke i premtuar besimin: “Nëse na shpëton nga kjo, me të vërtetë, do të jemi mirënjohës.”³**

Thua ju: **“Kush ju shpëton nga errësira e tokës dhe e detit, kur i luteni Atij haptazi dhe fshehurazi (duke thënë): “Nëse Ai na shpëton prej këtyre (rreziqeve), vërtet do të bëhemi mirënjohës.”⁴**

5. Motivet e pavetëdijshme

Nganjëherë njeriu ndien prirje të dëshiruara ose shqetësuese dhe përpiqet t'i largojë ato nga “rezervati” i ndjesive të veta. Në fund, kjo rezulton me zhdukjen dhe

1. Sure “El-A’raf”, ajeti 172.

2. El-Beha El-Khaulij: *Adem (a) - Felsefetu takuimi'l-insan ue khilafetihi*. Botimi i tretë, Kajro: Mektebetu Uehbeh, 1974. f. 174.

3. Sure “Junus”, ajeti 22.

4. Sure “El-En’am”, ajeti 63.

arkivimin e tyre në të pandërgjegjshmen e tij. Mirëpo shpesh qëllon që njeriu i nxjerr në pah vetë këto prirje dhe motive në mënyrë të pavetëdijshme, në formën e shkarjeve të gjuhës dhe të gabimeve në fjalë.

Kur'ani e vë theksin mbi disa nga motivet e pavetëdijshme, që gjenden brenda njeriut dhe që ai përpiqet t'i mbulojë e t'i fshehë ato. Gjithsesi, i nxjerr ato nëpërmjet shkarjeve të gjuhës: **"Vallë, a mendojnë ata që kanë sëmundje në zemrat e tyre, se Allahu nuk do t'ua nxirrte në shesh urrejtjen e tyre (ndaj Islamit)? Sikur të donim, Ne do të t'i tregonim ty ata dhe ti, me siguri, do t'i njihje sipas shenjave të tyre. Por, ti do t'i njohësh ata sipas mënyrës së shprehjes së tyre. Allahu i di veprat tuaja."**¹

Në këtë fushë, Osman ibn Afani ka transmetuar këto fjalë: *Askush nuk fsheh diçka, që Zoti të mos e bëjë të duket atë nga fytyra e tij dhe nga shkarja e gojës së tij.*²

"Vallë, a mendojnë ata që kanë sëmundje në zemrat e tyre, se Allahu nuk do t'ua nxirrte në shesh urrejtjen e tyre (ndaj Islamit)? Sikur të donim, Ne do të t'i tregonim ty ata dhe ti, me siguri, do t'i njihje sipas shenjave të tyre. Por, ti do t'i njohësh ata sipas mënyrës së shprehjes së tyre. Allahu i di veprat tuaja." D.m.th., hipokritët. Pra, hipokritët që kanë sëmundjen e dyshimit dhe të dyfytërsisë.³

Askush nuk fsheh dot një sekret, që Zoti të mos ia veshë "rrobën" sipas sekretit. Nëse ai sekret është për të mirë, i vesh atij rrobën e së mirës dhe, nëse ai sekret është për sherr (të keqe), i vesh atij rrobën e së keqes.⁴

Në kapitullin e nëntë, gjatë diskutimit rreth "Personalitetit", do të vëmë re se Kur'ani ka vënë theksin mbi disa nga truket e pavetëdijshme të arsyes, si: justifikimi, lënia e fajit jetim ose ngecja dikujt tjetër dhe shfaqja e reagimit. Kjo temë nxjerr në dritë se Kur'ani i ka trajtuar këto çështje katërmbëdhjetë shekuj më parë se kërkimet e Frojdit, themeluesit të idesë së psikanalizës.

1. Sure "Muhamed", ajetet 29-30.

2. *Tefsir Ibn Kethir*, vëll. 4, f. 180.

3. Sure "Muhamed", ajetet 29-30.

4. Burimi i mësipërm, f. 180.

Ndeshja e motiveve

Sa herë që te njeriu, disa motive ndeshen me njëri-tjetrin (për shembull, kur një motiv e tërheq njeriun në njërin anë dhe një motiv tjetër e tërheq në anën e kundërt), atë e pushton një gjendje turbullire, hezitimi. Ai bëhet i paafte në vendimmarrje, nuk e di se nga duhet të shkojë. Një gjendje të tillë e quajmë "Ndeshje (ose konflikt) psikike".

Kur'ani e paraqet bukur këtë konflikt psikik, nga i cili vuajnë individët që kanë pozicion të dyshimtë dhe ngurrues përballë besimit. Këta individë janë persona që as nuk hyjnë plotësisht në besim dhe as nuk dalin plotësisht në mohim (*kufri*), mirëpo janë mëdyshas (ngurrues, të lëkundur) në zgjedhjen e besimit dhe mohimit (*imanit* dhe *kufrit*) dhe nuk mund të marrin vendim të prerë rreth kësaj.

"Thuaj: "A të adhurojmë në vend të Allahut çfarë nuk na sjell as dobi, as dëm?! A të kthehemi mbrapsht, pasi Allahu na udhëzoi, duke u bërë si i magjepsuri nga djajtë, që sillet i çoroditur nëpër tokë, ndonëse shokët e thërrasin në rrugë të drejtë: "Eja tek ne!" Thuaj: "Udhëzimi i Allahut është i vetmi udhëzim i drejtë! Ne jemi të urdhëruar t'i nënshtrohemi Zotit të botëve"¹

Në këtë ajet është përshkruar me kujdes gjendja e konfliktit psikik, si dhe hutimi e hezitimi që burojnë prej saj. Nga njëra anë, djajtë e pyesin, i bëjnë vesvese njeriut dhe e tërheqin drejt humbjes e mohimit (*kufrit*) dhe nga ana tjetër, miqtë e tij besimtarë e thërrasin atë kah udhëzimi dhe besimi. Por, ai ndodhet në gjendje hutimi dhe shpërqendrimi mendor midis këtyre dy përpjekjeve dhe joshjeve. Kur'ani, gjithashtu, e përshkruan kështu gjendjen e dyshimit, hutimit, mëdyshjes dhe lëkundjes që buron nga konflikti psikik midis mohimit dhe besimit (*kufrit* dhe *imanit*).

"Ty do të kërkojnë leje vetëm ata që nuk besojnë në Allahun dhe Ditën e Kiametit dhe që zemrat e tyre dyshojnë.

Ata luhaten në dyshimin e vet."²

1. Sure "El-En'am", ajeti 71.

2. Sure "Et-Teube", ajeti 45.

“Ata përgjojnë se çfarë do të bëhet me ju. Kështu, nëse ju vjen fitorja nga Allahu, ata thonë: “A nuk ishim vallë ne me ju?” E, nëse mohuesit arrijnë fitore, hipokritët u thonë: “A thua nuk ju ndihmuam deri në fitore dhe ju mbrojtëm prej besimtarëve të vërtetë?” Allahu do të gjykojë ndërmjet jush në Ditën e Kiametit. Allahu nuk do t’iu japë kurrë rast mohuesve që t’i shkatërrojnë besimtarët. Në të vërtetë, hipokritët përpiqen të mashtrojnë Allahun, por është Ai që i mashton ata. Kur ata ngrihen për namaz, ngrihen me përtesë, vetëm sa për t’u dukur para botës dhe Allahun e përmendin fare pak.”¹

Gjithashtu, Kur’ani e përshkruan kështu gjendjen e konfliktit psikik të disa individëve të hutuar dhe të lëkundur, të cilët nuk dinin a të luftonin me myslimanët apo me njerëzit e tyre të afërm idhujtarë. Ky konflikt psikik kishte shkaktuar tek ata një gjendje lëmshi dhe hutimi.

“...përveç atyre që janë strehuar te një popull me të cilin ju keni marrëveshje ose atyre që kanë ardhur te ju, e u vjen rëndë që të luftojnë kundër jush ose të luftojnë kundër popullit të vet. Sikur të kishte dashur Allahu, do t’u kishte dhënë pushtet mbi ju dhe ata do të luftonin kundër jush. Në qoftë se ata tërhiqen prej jush, nuk hyjnë në luftë kundër jush dhe ju ofrojnë paqe, atëherë për ju Allahu nuk lë shteg që të luftoni kundër tyre.”²

Triumfi mbi motivet

Nga tërë temat e trajtuara del në pah çështja se dëshira e të madhit Zot është që, në natyrën e lindur dhe në esencën e njeriut dhe të kafshës, të vendosen njëherësh motive fiziologjike, me qëllim që të realizohen objektivat e Zotit, që janë ruajtja e ekzistencës dhe vazhdimësia e llojit. Prandaj është e dukshme që kënaqja e këtyre motiveve është diçka e natyrshme, të cilën e kërkon natyra dhe ekzistenca e njeriut dhe e kafshës, sepse vazhdimësia e jetës dhe mbijetesa e llojit ka lidhje tërësisht me

1. Sure “En-Nisa”, ajetet 142–143.

2. Sure “En-Nisa”, ajeti 90.

të. Për këtë arsye, rregullat dhe urdhëresat e Kur'anit rreth këtyre motiveve kanë harmoni me natyrën e njeriut, sepse Kur'ani i pranon këto motive dhe kërkon që njeriu të jetë i kënaqur me to, aq sa e lejon sheriatu (legjislacioni) i shenjtë.

As në Kur'an dhe as në Sunet (tradita profetike) nuk ekziston ndonjë temë që të tregojë përçmimin apo mohimin, apo që të ftojë në përmbysjen e këtyre motiveve. Kur'ani, së bashku me Sunetin, i ftojnë njerëzit vetëm në vënien nën kontroll të këtyre motiveve dhe u kërkojnë atyre që t'i ngopin motivet e veta, vetëm me aq sa e lejon feja, pa e tepruar dhe pa e tejkaluar këtë kufi. Kjo çështje është si në interes të individit, ashtu edhe në atë të shoqërisë. Këtu është e nevojshme të sqarojmë dallimin midis dy fjalëve: kontrollit dhe përmbysjes në raport me motivet.

Kontrolli është në kuptimin e frenimit të dëshirës së një motivi apo prirjeje dhe rezistencës përballë përmbushjes (ngopjes) së saj në kushte të papërshtatshme. Mirëpo, në përgjithësi, nuk mund të ketë kuptimin e mospranimit të dëshirës, sepse ka mundësi që në një situatë tjetër të përshatshme, të lejohet përmbushja e saj dhe veprimi sipas saj.

Ndërsa përmbysja e një motivi është në kuptimin e mohimit, e mospranimit, e përçmimit apo e frikës nga Zoti. Njeriu përpiqet ta largojë tërësisht atë nga "rezervati" i informacionit dhe i ndjesisë së vet, me qëllim që të çlirohet nga rëndesa e mëkatit dhe e trishtimit, që buron nga ai motiv. Domethënia e përmbysjes së një motivi është kjo: për pak kohë është larguar nga rrethi i informacionit, i ndjesisë dhe është gruposur në thellësinë e të pandërgjegjshmes së njeriut. Mirëpo aty nuk është asgjësuar plotësisht, madje, me anë të hileve të pavarëdijshme përpiqet gjithnjë ta trajtojë veten në një formë a në një tjetër. Kjo çështje bëhet shkak i gjetjes së ndërlikimeve të shumta, të cilat burojnë nga shqetësimi dhe nga lëkundja e sjelljes së njeriut.

Kur'ani nuk thotë që t'i përmbysim motivet e lindura në atë kuptim që përmendëm më sipër, por na kërkon t'i kontrollojmë, t'i studiojmë dhe t'i udhëheqim ato, sa të ruhet

e të respektohet në mënyrë të merituar, si interesi i individit, ashtu edhe interesi i shoqërisë. Domethënë, të jetë në atë mënyrë që individi t'i fusë nën kontroll motivet e veta dhe t'i udhëheqë ato, që këto motive të mos e vënë përfund dhe ta udhëheqin atë në punët e tij. Kjo mund të vihet re fare mirë në ajetet e mëposhtme të Kur'anit, aty ku pranohet lejimi i ngopjes së motiveve fiziologjike:

“O njerëz! Ushqehuni me të gjithë ato gjëra të lejuara e të mira që gjenden në Tokë dhe mos ndiqni gjurmët e djallit, sepse ai është njëmend armiku juaj i hapur.”¹

“O besimtarë! Hani nga ushqimet e lejuara që ju kemi dhënë dhe, nëse jeni adhures të Allahut, falënderojeni Atë!”²

“O besimtarë! Mos ia ndaloni vetes gjërat e mira, të cilat Allahu jua ka lejuar dhe mos e kaloni kufirin! Vërtet, Allahu nuk i do ata që e kapërcejnë kufirin. Hani nga ato gjëra të lejuara e të mira që ju ka dhënë Allahu! Frikësojuni Allahut, të Cilit ju i keni besuar!”³

“Kur Musai kërkoi ujë për popullin e tij, Ne i thamë: “Bjeri gurit me shkopin tënd!” Atëherë, nga ai shpërthyen dymbëdhjetë burime dhe çdo fis dinte burimin e vet. Ne thamë: “Hani e pini prej begative të Allahut dhe mos bëni të këqija e mbrapshti në Tokë!”⁴

“O bijtë e Ademit, vishuni përshtatshëm kudo dhe kurdo që të faleni! Hani e pini, por mos e teproni, se Ai nuk i do ata që e teprojnë. Thuaj: “Kush i ka penguar stolitë dhe ushqimet e këndshme, të cilat Ai i ka krijuar për robërit e Vet?” Thuaj: “Ato janë për besimtarë (dhe të tjerët) në këtë botë, ndërsa në Botën Tjetër do të jenë vetëm për besimtarët. Kështu ua shpjegojmë shpalljet njerëzve që dinë. Thuaj: “Me të vërtetë, Zoti im ka ndaluar vetëm punët e pahijshme, qofshin të hapëta ose të fshehta dhe gjynahet, dhunimin pa të drejtë, t'i shoqërohet Allahut (në adhurim) diçka, për

1. Sure “E-Bekare”, ajeti 168.

2. Sure “El-Bekare”, ajeti 172.

3. Sure “El-Maide”, ajeti 87, 88.

4. Sure “El-Bekare”, ajeti 60.

të cilën nuk ju ka dhënë kurrfarë të drejte dhe të thoni për Allahun atë që nuk e dini.”¹

“I martoni të pamartuarit dhe të pamartuarat ndër ju, si dhe skllëvërit dhe skllavet tuaja që janë besimtarë të ndershëm! Nëse janë të varfër, Allahu, do t’i begatojë ata me dhuntinë e Tij; Allahu është i Gjerë në mirësi dhe i Gjithëdijshtëm.”²

“Nëse keni frikë se nuk bëni drejtësi ndaj jetimeve, atëherë, martohuni me ato gra që ju pëlqejnë: me dy, me tri apo me katër; e, nëse frikësoheni se nuk do të jeni të drejtë ndaj të gjithave njësoj, atëherë mjaftohuni me një grua, ose me atë që e keni në pushtetin tuaj. Në këtë mënyrë do t’i ruheni padrejtësisë më lehtë.”³

“Gratë tuaja janë “ara” për ju, prandaj iu afroni “arave” tuaja si të doni. Por bëni diçka (të mirë) për veten tuaj (duke përmendur emrin e Allahut para kontaktit). Kijeni frikë Allahun dhe dijeni se do të takoheni me Atë. Jepu lajm të mirë besimtarëve (se do të fitojnë Xhenetin).”⁴

Ajetet e mësipërme sqarojnë këtë çështje: Kur’ani jo vetëm që nuk e fton njeriun në mospranimin dhe përmbysjen e motiveve të tij të lindura, por e paralajmëron atë për konfliktin psikik, që është rezultat i mospranimit të motivit seksual dhe i mposhtjes së tij, një konflikt që bëhet shkak i shfaqjes së ndërlikimeve shqetësuese në sjelljen e njeriut. Por, megjithatë Kur’ani nuk e lë njeriun frelëshuar, që t’i ngopë pa kufi e pa llogari motivet e tij të lindura. Ai e fton atë në organizimin e ngopjes së motiveve dhe marrjes në dorë të kohës së tyre.⁵

Parimisht nuk ka asnjë problem që njeriu të shijojë motivet e veta të lindura sipas rrugës së lejuar e të ligjshme. Në çështjet e lidhura me kënaqjen e motiveve të lindura,

1. Sure “El-A’raf”, ajetet 31, 33.

2. Sure “En-Nur”, ajeti 32.

3. Sure “En-Nisa”, ajeti 3.

4. Sure “El-Bekare”, ajeti 223.

5. Referohu tek: *El-Insan bejne’l-Maddijeti ue’l-Islam* i Muhamed Kutub, botimi i tretë, Kajro: Isa El-Babij El-Halebij dhe bashkëpuntorët e tij, 1960, f. 84-91. Muhamed Kutub, *Menhexhu’t-terbijeti’l-islamijeh*, botimi i dytë, Beirut: Daru’sh-Shuruk (pa datë), f. 128, 129, 145.

Kur'ani e fton njeriun në dy lloj organizimesh: së pari, në kënaqjen e motiveve nga rruga e lejuar, që sheriati i shenjtë e ka legjitimuar dhe e ka porositur dhe, së dyti, në mosshpërdorimin në kënaqjen e tyre. Lidhur me organizimin e parë për kënaqjen e motiveve fiziologjike, që është vetë kënaqja nga rruga e lejuar, po japim këtë ajet:

“Nëse keni frikë se nuk bëni drejtësi ndaj jetimeve, atëherë, martohuni me ato gra që ju pëlqejnë: me dy, me tri apo me katër; e, nëse frikësoheni se nuk do të jeni të drejtë ndaj të gjithave njësoj, atëherë mjaftohuni me një grua ose me atë që e keni në pushtetin tuaj. Në këtë mënyrë do t'i ruheni padrejtësisë më lehtë.”¹

Kur'ani ndalon nga kënaqja e motivit të urisë nëpërmjet një rruge të ndaluar, nga ngrënia e disa lloje ushqimesh, për shkak të dëmit që sjellin në shëndetin e njeriut, apo nga pirja e alkooleve, të cilat janë të dëmshme për shëndetin trupor dhe mendor. Gjithashtu, Kur'ani e ndalon njeriun nga kënaqja e instinktit seksual në rrugë të paligjshme, për shkak të dëmeve të shumta shëndetësore dhe shoqërore. Zoti, me krijimin e seksit mashkull dhe femër, e ka rregulluar “programin” e kënaqjes së instinktit seksual për njeriun, me jetën e përbashkët të burrit dhe gruas në familje, sepse jetesa familjare shoqërohet me dashuri, pasion, bashkëpunim dhe sakrificë.

“Dhe një prej shenjave të Tij është që prej jush krijoi për ju bashkëshortet tuaja, që të qetësoheni pranë tyre, duke vënë ndërmjet jush dashuri dhe mëshirë. Me të vërtetë, në këtë ka shenja, për njerëzit që mendojnë.”²

“Tani është e lejuar për ju që, gjatë netëve të agjërimit, të shkoni me bashkëshorten tuaj. Ato janë petk për ju e ju petk për ato. Allahu e di mirë se ju keni mashtruar veten (duke shkuar me gratë para se të zbriste lejimi), por Allahu e ka pranuar pendimin tuaj dhe jua ka falur gabimin. Prandaj, ju lejohet bashkimi me bashkëshortet tuaja dhe tani kërkoni atë që ka caktuar Allahu për ju. Dhe hani e pini deri sa të

1. Sure “En-Nisa”, ajeti 3.

2. Sure “Er-Rrum”, ajeti 21.

dallohet fija e bardhë (bardhësia) e agimit nga fija e zezë (errësira e natës), pastaj plotësojeni agjërimin deri sa të bjerë mbrëmja. Mos iu afroni atyre (bashkëshorteve) gjatë kohës kur mbylleni për adhurimin në xhami! Këta janë kufijtë e Allahut, prandaj mos iu afroni atyre! Kështu, pra, Allahu ua shpjegon njerëzve urdhëresat e veta, që ata të ruhen nga të këqijat.”¹

Mirëpo, nëse nuk janë gati kushtet për martesën e njeriut, duhet të ruhet pastërtia e moralit, e ndershmërisë; duhet të sundohet instinkti seksual dhe të mposhtet deri në rezultatin e kushteve të dëshiruara.²

Kur'ani i nxit të rinjtë myslimanë të jetojnë në një shoqëri dhe mjedis që i ndihmon ata për të mposhtur instinktin

1. Sure “El-Bekare”, ajeti 187.

2. Vlentëpërmendet sepjesa dërmueset e të sëmurdëve psikikë (psikoneuroza) me studimin e të cilëve merrej Zigmund Frojdi, jetonin në shoqëritë e krishtera evropiane. Në atë kohë, në shoqëritë e përmendura, instinkti seksual interpretohej si një motiv i papëlqyer, i cili duhet zhdukur. Prandaj nuk ishte për t'u çuditur që Frojdi të vendoste raport midis mposhtjes së instinktit seksual dhe shfaqjes së sëmundjeve psikike, megjithëse disa nga nxënësit e Frojdit, si Adleri, Jungu dhe psikanalistë të tjerë, si Karen Horney dhe Erik Fromi, për sa i përket instinktit seksual dhe këmbënguljes së tij të shumtë mbi këtë temë, mendonin se sëmundjet psikike, në të vërtetë, burojnë nga mposhtja e instinktit seksual. Mirëpo vlen të përmendet edhe kjo pikë: edhe nëse janë të drejta disa nga rezultatet e përfituara nga Frojdi, lidhur me disa nga gjendjet në shoqërinë e tij, nuk mund të themi që ato janë të drejta për shoqëritë e tjera, të cilat dallojnë nga pikëpamja kulturore me shoqërinë e Frojdit. Nga temat që ne thamë, lidhur me pikëpamjet e Islamit rreth instinktit seksual, pranimi të tij dhe mosinterpretimi të tij si një dukuri e padëshiruar që duhet zhdukur, del në pah se shoqëria islame i edukon bijtë e saj sipas rregullave të drejta islame dhe i nxit të martohen në kohë, duke e çliruar veten nga zinxhirët e rregullave dhe zakoneve, që bëhen pengesë e realizimit të këtyre objektivave. Ashtu sikurse nuk mendojmë se, nëse i edukojmë të rinjtë në një mënyrë që të sundojnë instinktin e tyre seksual dhe ta ndalojnë atë nga kënaqja deri në mbërritjen e kohës së përshtatshme për martesë, shëndetit psikik të tyre do t'i kanoset ndonjë dëm. Sigurisht, kjo temë është e drejtë deri në kohën që të rinjtë t'u drejtohen çështjeve të adhurimit, veçanërisht agjërimit, si një mjet që i ndihmon ata që të fusin nën kontroll forcën instinktive dhe ta shtypin atë. Gjithashtu, për ata, duhen përgatitur mundësi të tjera, të reja për shtypjen e instikteve, siç janë ushtrimet trupore, pjesëmarrja në llojet e aktiviteve shoqërore dhe marrja me studimin e dijes, letërsisë dhe artit.

seksual dhe nuk i ekspozon kundrejt gjërave që bëhen shkak i zgjimit dhe i eksitimit të instinktit seksual. Në këtë drejtim, Kur'ani u kërkon burrave myslimanë që të vetëpërmbahen nga shikimi i paligjshëm, ashtu sikurse u kërkon grave që të mbulojnë stolitë dhe bukuritë trupore të tyre.

“Ata që nuk kanë mundësi për martesë, le të përmbajnë veten, deri sa Allahu t'i begatojë me dhuntinë e Tij.”¹

Thuaju besimtarëve që të ulin shikimet e tyre (nga e ndaluara) dhe ta ruajnë nderin e tyre (nga marrëdhëniet e jashtëligjshme)! Kjo është më mirë për ta! Me të vërtetë, Allahu është i Dijshëm për atë që bëjnë ata. Thuaju besimtarëve që të ulin shikimet e tyre (nga e ndaluara), ta ruajnë nderin e tyre (nga marrëdhëniet e jashtëligjshme) dhe të mos i shfaqin stolitë e tyre, përveç atyre që janë të dukshme. Le t'i mbulojnë kraharorët me mbulesat e tyre (të kokës) dhe të mos ua shfaqin stolitë e tyre, përveçse bashkëshortëve të tyre ose baballarëve të tyre, ose vjehërrve të tyre, ose bijve të tyre, ose djemve të bashkëshortëve të tyre, ose vëllezërve apo djemve të vëllezërve të tyre, ose djemve të motrave a grave të tyre, ose atyre që i kanë nën zotërim (si skllave), ose shërbëtorëve që nuk kanë epsh ndaj femrave apo fëmijëve që nuk i dinë ngacmimet e femrave. Dhe të mos i rrahin këmbët (përtokë), në mënyrë që të mos duken stolitë e tyre të fshehta. Të gjithë ju, o besimtarë, kthehuni tek Allahu të penduar, që të arrini shpëtimin!”²

Profeti i nderuar e ka kundërshtuar të ndenjurin vetëm të gruas dhe burrit (të huaj), sepse të qenët e tyre vetëm krijon vetvetiu një mjedis të përshtatshëm për zgjimin e instinktit seksual, duke e shtuar mundësinë e shkuarjes drejt së gabuarës. Gjithashtu, Kur'ani vë theksin mbi një pikë, që duhen njoftuar shërbyesit e shtëpisë dhe të vegjlit, të cilët nuk e kanë arritur moshën e pubertetit, që të mos futen pa leje në dhomën ku rrinë bashkëshortët në tri periudha të natës e ditës. Këto tri kohë janë:

1. Sure “En-Nur”, ajeti 33.

2. Sure “En-Nur”, ajetet 30-31.

para faljes së namazit të sabahut (agimit), në kohën e pushimit në drekë dhe mbas faljes së namazit të darkës (jacisë) në kohën që njeriu përgatitet për t'u rehatuar e për të fjetur.

“O besimtarë! Skllevërit dhe fëmijët tuaj që s’kanë arritur pubertetin, le t’ju kërkojnë leje (për të hyrë) në tri kohë: para namazit të mëngjesit, kur i zhvishni rrobat në mesditë dhe pas namazit të jacisë. Këto janë tri kohë kur hiqni rrobat. Nuk ka gjynah as për ju e as për ata që, pas këtyre rasteve, të vizitoni njëri-tjetrin (pa kërkuar leje për të hyrë). Kështu jua shpjegon Allahu shpalljet juve! Allahu është i Urtë dhe i Gjithëdijsëm. Kur fëmijët tuaj të arrijnë moshën e pubertetit, le të kërkojnë leje, ashtu siç kanë kërkuar leje ata para këtyre. Kështu jua shpjegon Allahu juve shpalljet e Tij! Allahu është i Urtë dhe i Gjithëdijsëm.”¹

Meqenëse, në tri kohët e lartpërmendura, njeriu shpeshherë i zhvesh rrobat me të cilat zakonisht shfaqet në publik dhe vesh rrobat e gjumit e të pushimit, mund të rritet mundësia për shikimin e pjesëve të trupit që nuk duhet të shihen. Argument pse Kur’ani e ka ndaluar hyrjen pa leje të shërbëtorëve dhe të fëmijëve në dhomën e bashkëshortëve në këto kohë, është parandalimi i marrjes së informacionit “të gabuar” të tyre, sepse kjo gjë, jo vetëm i turpëron bashkëshortët, por cenon nderin e tyre. Nganjëherë rezulton edhe me zgjimin e instinktit seksual të shërbëtorëve dhe gjithashtu rrit mundësinë që fëmijët të shikojnë te prindërit gjëra që nuk duhet t’i shohin, të cilat lidhen drejtpërdrejt me çështjet seksuale.

Kërkimet e psikanalizës kanë nxjerrë përfundime dhe kanë zbardhur ndikimin e keq që lë në psikikën e fëmijëve shikimi i këtyre gjërave.² Përveç kësaj, ndonjëherë nëpër gazeta lexojmë lajme të pakëndshme, të cilat ndodhin si pasojë e shoqërimit dhe e lidhjes së shfrenuar të shërbyesve me vajza dhe gra të reja të familjes, moskontrollit të tyre. Si rrjedhim, familjen e pllakos tragjedia.

1. Sure “En-Nur”, ajetet 58-59.

2. Ahmed Muhamed Xhemal, *Nahue terbijetin islamijeh*, Xheddah: Tuhome, 1980, f. 78- 79.

Për sa i përket fushës së organizimit të dytë të motiveve fiziologjike, domethënë veprimit në kënaqjen e tyre, duhet thënë se si nëpërmjet përvojave personale, ashtu edhe nga kërkimet shkencore, ka dalë në pah se shpërdorimi dhe abuzimi në të ngrënë i shkakton dëm shëndetit të njeriut, sepse i krijon atij parehati në stomak dhe të tjera sëmundje në aparatin tretës, duke u bërë shkak i dhjamosjes së individit. Gjithashtu, abuzimi në konsumimin e të pirit dhe teprimit me gjumë, të gjitha, janë të dëmshme për shëndetin e njeriut. Për këtë arsye, i madhi Zot e ka ndaluar konsumimin pa masë të ushqimit dhe pijes.

“O bijtë e Ademit, vishuni përshtatshëm kudo dhe kurdo që të faleni! Hani e pini, por mos e teproni, se Ai nuk i do ata që e teprojnë.”¹

Është e dukshme se ndalimi që i bëhet shpërdorimit, në ajetin e mësipërm, nuk i takon vetëm dy motiveve të urisë dhe të etjes, por përfshin edhe motive të tjera fiziologjike. Qëllimi i Kur'anit nuk përkufizohet me ndalimin e këtyre dy motiveve, por te dhënia e shembullit dhe theksimi mbi dëmin që pëson njeriu nga kënaqja e motiveve të veta të lindura. Parimisht, një nga veçoritë e Kur'anit është shpjegimi i temave me lakonizëm.

Përveç kësaj, argument tjetër pse përmendet uria dhe etja në ajet, në vazhden e ndalimit nga shpërdorimi në kënaqjen e motiveve të lindura, është se dy motivet e lartpërmendura kanë rëndësi të veçantë në ruajtjen e gjeneratës dhe në mbijetesën e njeriut, sepse njeriu, zakonisht, ka prirjen ta teprojë në kënaqjen e këtyre motiveve. Kur'ani, jo vetëm që e udhëheq njeriun në sundimin e motiveve fiziologjike, por edhe e përqendron atë në sundimin dhe në mposhtjen e motiveve psikike.

Gjithashtu, në shumë raste e nxit njeriun drejt mposhtjes së motiveve të agresionit dhe zotërimit. Për shembull, nga pikëpamja e Kur'anit, cilësia e vetëpërmbajtjes dhe e sundimit të dëshirave dhe prirjeve epshore, si trupore dhe psikike, është prej cilësive me të cilat duhet të stoliset çdo besimtar që ka personalitet të palëkundur dhe të fortë.

1. Sure “El-A’raf”, ajeti 31.

Rreth motivit të agresionit, duhet thënë se Kur'ani i ndalon njerëzit nga dhunimi dhe agresioni i të tjerëve, si nëpërmjet fizikut, ashtu edhe fjalëve, dhe i urdhëron ata të sillen mirë e me butësi me të tjerët.

“Ata që i lëndojnë besimtarët dhe besimtare, duke i akuzuar për diçka që nuk e kanë bërë, në të vërtetë, i kanë ngarkuar vetes fajin për shpifje dhe një gjynah të qartë.”¹

“O besimtarë! Kur të bisedoni fshehtas mes jush, mos flisni për gjynahe, armiqësi dhe mosbindje ndaj të Dërguarit; por bisedoni për mirësi dhe drejtësi. Kijeni frikë Allahun, para të Cilit do të tuboheni.”²

“O besimtarë! Mos e cenoni shenjtërinë e simboleve të Allahut, as të muajve të mëdhenj, as të kurbanit të Qabesë, as të kurbaneve të shënuar me gjerdan, as (mos i pengoni) ata që janë nisur të vizitojnë Shtëpinë e Shenjtë, duke kërkuar mirësinë dhe kënaqësinë e Zotit të vet. Pas heqjes së Ihramit, gjuani. Dhe, të mos ju nxisë urrejtja ndaj disa njerëzve, që ju penguan të vizitoni Qabenë, pra, kurrësi të mos ju nxisë që t'i sulmoni! Ndiemojeni njëri-tjetrin në punë të mira dhe në të ruajturit nga të këqijat dhe jo në gjynahe dhe armiqësi! Frikësojuni Allahut, sepse Ai dënon ashpër.”³

Thuaju: “Ejani t’ju lexoj çfarë ju ka urdhëruar Allahu: që të mos i shoqëroni Atij asgjë (në adhurim); që të silleni mirë me prindërit; që të mos vrisni fëmijët tuaj për shkak të varfërisë, sepse Ne ju ushqejmë ju dhe ata; që të mos i afroheni veprave të turpshme, qofshin ato të hapëta apo të fshehta dhe që të mos ia merrni tjetrit jetën, të cilën Allahu e ka shenjtëruar, përveçse kur e kërkon drejtësia (e ligji). Këto ju porosit Ai, me qëllim që të kuptoni.”⁴

“Nëse dy palë besimtarësh bëjnë luftë midis tyre, pajtojini ata. Por, nëse njëra palë sulmon tjetrën, atëherë luftoni kundër sulmuesit, derisa të kthehet në urdhrat e Allahut. E, nëse kthehet, atëherë pajtojini ata midis tyre, me drejtësi dhe

1. Sure “El-Ahzab”, ajeti 58.

2. Sure “El-Muxhadile”, ajeti 9.

3. Sure “El-Maide”, ajeti 2.

4. Sure “El-En’am”, ajeti 151.

paanësi, sepse Allahu i do ata që veprojnë me drejtësi. Në të vërtetë, besimtarët janë vëllezër, andaj pajtojini vëllezërit tuaj midis tyre dhe kijeni frikë Allahun, në mënyrë që ju të mëshiroheni. O ju që keni besuar! Asnjë burrë prej jush të mos tallet me burra të tjerë, se këta mund të jenë më të mirë se ai. Gjithashtu, asnjë grua të mos tallet me gra të tjera, se këto mund të jenë më të mira se ajo. Mos e nënçmoni dhe mos e qesëndisni njëri-tjetrin me nofka (të këqija)! Sa e shëmtuar është të thirresh me emër të keq pas (pranimi të) besimit! Ata që nuk pendohen, janë vërtet keqbërës.”¹

Kur'ani i fton njerëzit për të frenuar motivin e zotërimit dhe i ndalon ata nga smira, babëzia pas pasurisë, marrjes së kamatës, ngrënies së pasurisë së popullit dhe vjedhjes. Në të kundërt, urdhëroni për bamirësi në rrugën e Zotit, dhënien e lëmoshës ndaj të varfërve, mjeranëve dhe për pagimin e zekatit.

“Përrjashtim bëjnë ata idhujtarë, me të cilët keni lidhur marrëveshje e që nuk ju kanë shkelur asgjë prej saj dhe që nuk kanë ndihmuar askënd kundër jush. Respektojeni marrëveshjen me ta deri në fund. Me të vërtetë, Allahu i do ata që (i) frikësohen (Atij)... Do të vijë dita, kur (thesaret e mbledhura) do të digjen në zjarrin e Xhehenemit dhe me to do të damkoset balli, anët dhe shpina e tyre e do t’u thuhet: “Kjo është ajo që keni grumbulluar për veten; pra, shijoni atë që grumbulluat!”²

“Ata që bëhen koprracë me të mirat që ua ka dhënë Allahu, kurrsesi të mos mendojnë se kështu është më mirë për ta! Jo, kjo është më keq për ata! Ajo që kanë grumbulluar do t’u ngarkohet atyre në qafë Ditën e Kiametit. E Allahut është trashëgimia e qiejve dhe e Tokës dhe Allahu e di mirë ç’punoni ju.”³

“Prandaj frikësojuni Allahut sa të mundeni, dëgjoni e binduni dhe shpenzoni për bamirësi në të mirën tuaj. Ata që e ruajnë veten nga lakmia e saj, pikërisht ata janë të fituarit.”⁴

1. Sure “El-Huxhurat”, ajetet 9–11.

2. Sure “Et-Teube”, ajetet 4–35.

3. Sure “Ali Imran”, ajeti 180.

4. Sure “Et-Tegabun”, ajeti 16.

“Prandaj jepni prej atyre mirësive që ju kam dhënë Unë, para se t’i vijë vdekja ndonjërit, e ai të thotë: “O Zoti im, sikur të më kishe lënë edhe një kohë të shkurtër në jetë, do të kisha dhënë lëmoshë dhe do të bëhesha ndër të mirët!”¹

“Besoni Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe shpenzoni nga ato që Ai jua ka lënë trashëgim, se për ata midis jush që besojnë dhe shpenzojnë (për bamirësi), do të ketë shpërblim të madh!”²

“Ata që japin lëmoshë e që i japin Allahut një hua të mirë, qofshin burra ose gra, do t’u shumëfishohet përfitimi dhe do të kenë një shpërblim fisnik.”³

“Thuaju robërve të Mi, të cilët besojnë: Le të falin namazin dhe le të japin fshehurazi dhe haptazi nga ajo që ua kemi dhënë Ne, para se të arrijë dita në të cilën s’ka as tregti, as miqësi.”⁴

Kur’ani e fton njeriun në frenimin e motiveve dhe në sundimin e tyre dhe i kërkon atij t’i ruajë ato në kuadrin e normave dhe rregullave fetare dhe të mos bëhet skllav i dëshirave dhe i prirjeve të tij; t’i vërë nën kontroll ato dhe t’i drejtojë në çdo anë që ai vetë dëshiron.

“Atëherë, ai që ka shkelur gjithçka; dhe ka parapëlqyer jetën e kësaj bote, sigurisht që do të ketë për strehë Xhehenemin. Kurse ai që i është frikësuar madhërisë së Zotit të tij dhe e ka frenuar veten nga dëshirat, pa dyshim që do të ketë për strehë Xhenetin.”⁵

Kuptimi i mosndjekjes së epshit, në të vërtetë, është po frenim i motiveve të parandalimit të tekave dhe ndalimi i tyre nga prirjet e palogjikshme, me fjalë të tjera, është sundimi i tyre. Kur’ani i kërkon njeriut që të bëjë harmonizimin midis kërkesave të përditshme trupore, që me këmbëngulje i kërkojnë atij kënaqjen e vet dhe atyre shpirtërore dhe psikike, të cilat janë të drejtuara nga Zoti, dhe që të hedhë shikimin në

1. Sure “El-Munafikun”, ajeti 10.

2. Sure “El-Hadid”, ajeti 7.

3. Sure “El-Hadid”, ajeti 18.

4. Sure “Ibrahim”, ajeti 31.

5. Sure “En-Nazi’at”, ajetet 37–41.

begatitë e Jetës së Përtejme (Ahiretit). Prandaj, njeriu duhet t'i përgjigjet pozitivisht nevojave të tij trupore dhe t'i kënaqë motivet e tij të lindura në kuadrin e rregullave, që të mund të vijojë jetën dhe ta çojë në fund mësimin që ka marrë përsipër nga Zoti. Por, gjithashtu duhet të plotësojë edhe nevojat e veta psikike, si: pranimin e ekzistencës së Zotit, adhurimin e Tij dhe pasimin e rrugës së ndritur, të cilën e ka përcaktuar Zoti, në mënyrë që fitohet kënaqësia e Tij.

Njeriut i është kërkuar që të përpiket për krijimin e harmonisë midis kërkesave trupore dhe atyre shpirtërore, kërkesave të kësaj jete dhe të Jetës Tjetër, sepse kjo përpjekje bëhet shkak që njeriu të çlirohet nga konfliktet psikike, të cilat i fusin ankth dhe shqetësim atij, duke e larguar nga begatia e sigurisë, e qetësisë dhe e lumturisë.

“Por përpiku me atë që të ka dhënë Allahu të fitosh jetën e botës së ardhshme, duke mos harruar pjesën tënde në këtë botë. Bëju mirë të tjerëve, ashtu si të ka bërë mirë ty Allahu. Mos kërko ngatërresa në Tokë, sepse Allahu nuk i do ngatërrestarët.”¹

“O ju që keni besuar, mos lejoni që pasuria dhe fëmijët tuaj t'ju largojnë nga të përmendurit e Allahut. Ata që e bëjnë këtë, do të humbin.”²

Ftesa e Kur'anit drejtuar njeriut për frenimin dhe kontrollimin e motiveve ka si qëllim zhvillimin dhe drejtimin e tyre kah kënaqësia e Zotit dhe kah e mira e individit, e shoqërisë dhe e njerëzimit. Kjo duket më së qarti po të shohim në suren “Ali Imran”. Ajeti i mëposhtëm, pas përmendjes së disa motiveve që njerëzit zakonisht përpiqen t'i kënaqin në jetën e tyre të kësaj bote, drejtpërsëdrejti, menjëherë, përkujton se devotshmëria ndaj Zotit është më e mirë për njeriun se sigurimi dhe kënaqja e këtyre motiveve në jetën e kësaj bote, sepse ajo do të faktojë për njerëzit kënaqësinë e përfitimit të Parajsës dhe të begative të sotme.

“Burrave u është hijeshuar dashuria për gjërat e dëshiru-

1. Sure “El-Kasas”, ajeti 77.

2. Sure “El-Munafikun”, ajeti 9.

ara: për gratë, fëmijët, arin dhe argjendin e grumbulluar, kua-
jt e bukur, bagëtitë dhe arat e lëruara. Këto janë kënaqësitë
e kësaj jete, por shumë më i mirë është kthimi tek Allahu.
Thuaj (o Muhamed!): “A doni t’ju tregoj për gjëra më të mira
se ato? Për ata që janë të devotshëm, te Zoti i tyre do të ketë
kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe ku do të bano-
jnë përgjithmonë. Aty do të kenë bashkëshorte të pastra dhe
kënaqësi nga Allahu”. Allahu i vrojton robërit e Vet.”¹

Në këto dy ajete është kërkuar fare qartë nga njerëzit që
të frenojnë motivet e tyre (të ndaluarat), t’i zhvillojnë dhe
t’i lartësojnë ato (të lejuarat) nëpërmjet devotshmërisë dhe
kërkimit të kënaqësisë së Zotit. Gjithashtu, në lidhje me këtë,
në Kur’an është thënë:

“Pasuria dhe fëmijët janë stoli e jetës së kësaj bote. Por
veprat e mira që mbeten përherë, janë më të mira te Zoti
yt sa i përket shpërblimit dhe, janë më të mira sa i përket
shpresës (për shpëtim).”²

“Ta dini, se jeta në këtë botë, nuk është tjetër veçse lojë,
dëfrim e zbukurim, si dhe mburrje ndërmjet jush e rivalitet
për më shumë pasuri dhe fëmijë! Ajo i shëmbëllen bimës, e
cila pas shiut rritet dhe i gëzon bujqit, por më vonë zverdhet,
thahet dhe mbetet pa vlerë. Në Botën Tjetër ju presin vuajtje
të mëdha, ose falja e Allahut dhe kënaqësia e Tij; jeta në
këtë botë është vetëm kënaqësi e rreme.”³

Ajetet e mësipërme e paralajmërojnë njeriun se është drejt
zhdukjes fati i asaj që ekziston në këtë botë prej endjeve e qejfeve,
zbukurimeve, krenimit për bollëk pasurie. Njësoj si fati i bimëve
të gjelbëruara dhe me freski, që veniten e thahen dhe që era i
shpërndan ato. Ajo që mbetet është vetëm vepra e njeriut.

Personat që pëlqejnë jetën e kësaj bote përmbi Jetën e
Përtejme, dhe që, të gjitha përpjekjet e tyre në këtë botë janë
të përqendruara te kënaqja e motiveve, e prirjeve personale,
arritja e shijeve të përkohshme dhe që rebelohen ndaj bindjes
dhe adhurimit të Zotit, në Botën Tjetër do të kapen nga një

1. Sure “Ali Imran”, ajetet 14-15.

2. Sure “El-Kehf”, ajeti 46.

3. Sure “El-Hadid”, ajeti 20.

dënim i fortë. Ndërsa shpërblimi i personave që nuk janë të pakujdesshëm nga bindja dhe udhëzimi i Zotit dhe nga veprat e mira në jetën e kësaj bote dhe që kanë nën kontroll epshet dhe pasionet e tyre, është falja dhe kënaqësia e Zotit. Në lidhje me këtë, në Kur'an është thënë:

“Jeta e kësaj bote është vetëm lojë e argëtim, kurse Bota Tjetër, pa dyshim që është më e mirë për ata që i frikësohen Allahut. Pra, a nuk po mendoni?”¹

Shmangia e motiveve

Nëse njeriu nuk arrin të frenojë motivet, sundimin e tyre, e tepron në kënaqjen e tyre, duke u mbytur në shijim, këto motive do të largohen nga pikësynimet e tyre bazë. Ato do të shndërrohen vetvetiu në qëllim dhe jo vetëm që do të dalin jashtë kontrollit dhe sundimit të njeriut, por do ta vënë nën kontroll e do ta sundojnë atë.

Çështja e shmangies së motiveve dhe e sundimit të tyre mbi njeriun, nganjëherë ndodh në mënyrë të njëlojtë në të gjitha motivet, si në ato fiziologjike, ashtu edhe në ato psikike. Njëri nga motivet më të rëndësishme fiziologjike, që pasqyron shmangien, është instinkti seksual. Në Kur'an është përmendur njëra nga mënyrat e përhapura të shmangies seksuale, pëlqimi drejt të njëjtit seks. Nga shpjegimi i Kur'anit për këtë shmangie seksuale kuptojmë se kjo praktikë, për herë të parë në historinë njerëzore, është shfaqur te kombi i Zotit.

“Ju u qaseni meshkujve me epsh - në vend të femrave. Me të vërtetë, ju jeni popull që e teproni me të këqija!” Përgjigjja e popullit të tij ishte: “Dëbojini ata nga vendbanimi juaj! Ata janë njerëz që duan të mbahen të dëlirë.”²

“Vallë, ju, nga e gjitha bota, iu qaseni meshkujve e i lini mënjanë gratë tuaja, të cilat Zoti juaj i ka krijuar bashkëshorte për ju?! Njëmend, ju jeni popull që kaloni çdo kufi të së keqes.”³

Njëra nga shmangiet e përhapura të motiveve psikike të

1. Sure “El-En’am” ajeti 3.

2. Sure “El-A’raf”, ajetet 80- 81.

3. Sure “Esh-Shuara”, ajetet 165-166.

njeriut është dashuria e tepruar dhe dëshira e papërshkueshme që vihet re te një pjesë e njerëzve, për paratë dhe grumbullimin e pasurive, ndërkohë që zotërimet dhe pasuritë, në thelb, i takojnë Zotit. Ai na ka bërë ne përfaqësues të Tij, që ta shpenzojmë pasurinë në rrugën e kënaqësisë së Tij, gjithashtu në ndërtimin e tokës dhe në përparimin e racës njerëzore. Mirëpo, një pjesë e njerëzve e kanë bërë qëllim në vetvete zotërimin e parave dhe të pasurisë dhe interesohen më shumë në kursimin dhe depozitimin e tyre, sesa në shfrytëzimin dhe ruajtjen për në rrugën e Zotit, për interesat e popullit dhe për të ndihmuar në përparimin e njerëzimit.

Përgjithësisht, shpërdorimi apo teprimi në kënaqje dhe pafuqia e njeriut për t'i frenuar dhe për t'i sunduar ato, rezulton me shmangien e tyre prej qëllimeve reale, domethënë qëndrueshmërisë së jetës së individit, mbijetesës së llojit dhe realizimit të harmonisë së njeriut me mjedisin. Për shembull, teprimi në armiqësim i njeriut, në raportet e tij me njerëzit e tjerë, duke pasur prirje për armiqësim dhe agresion, llogaritet një lloj shmangieje; apo teprimi në konkurrencë, në mënyrë që qëllimi kryesor i njeriut të jetë pushteti fizik, ekonomik, politik apo ushtarak mbi të tjerët, gjithashtu, është një lloj tjetër shmangieje; po ashtu, edhe teprimi në rehati dhe përfitim nga begatitë e Zotit dhe shikimet e jetës, në mënyrë që qëllimi bazë i njeriut të jetë jetesa luksoze, ku të mos ketë kurrfarë përgjegjësie përballë individëve e shoqërisë. Mungesa e bashkëpunimit me ata dhe moszgjatja e dorës së ndihmesës drejt tyre, gjithashtu është një lloj shmangieje. Ndërsa ekuilibrimi dhe rruga e mesme në kënaqjen e motiveve, e pengon njeriun nga fundosja në vorbullën e shmangies. Prandaj, mund të thuhet se puna më e mirë është ecja në rrugën e mesme:

“dhe ata që, kur shpenzojnë, nuk janë as dorëshpuar, as dorështrënguar, por i përmbahen të mesmes;”¹

“Mos e shtrëngo dorën, as mos u bëj dorëshpuar e të mbetesh i qortuar dhe i mjerë.”²

1. Sure “El-Furkan”, ajeti 67.

2. Sure “El-Isra”, ajeti 29.

KREU I DYTË

Reagimet në Kur'an

Vullneti i urtë i Allahut (*xh.sh*) kërkon të shkaktojë një seri gjendjesh dhe reagimesh te njeriu dhe te kafsha. Këto ndjenja (motive) ndihmojnë në ruajtjen dhe në mbijetesën e racës së njerëzve dhe të kafshëve. Për shembull, frika është një gjendje reaguese dhe bëhet shkak që të largohemi nga rreziqet që na kanosen. Gjendja reaguese e zemërimit, që na detyron për të mbajtur veten dhe për t'u përballur, që të mbijetojmë ndaj gjendjes reaguese të dashurisë, është baza dhe themeli i bashkimit të dy sekseve, mashkull e femër (te njeriu dhe te kafsha) dhe joshjes së cilitdo kundrejt tjetrit për vazhdimësinë e llojit.

Midis motiveve (ndjenjave aktive) dhe reagimeve ekziston një raport i fortë, sepse çdo motiv është zakonisht i shoqëruar me një gjendje reaguese. Për shembull, sa herë që një motiv arrin kulmin e vet te njeriu, për njëfarë kohe aktivizohet parandalimi për kënaqjen e tij, njeriun e kaplon një gjendje tensioni dhe kjo gjendje zakonisht shoqërohet me një gjendje ndërgjegjeje dhe reagimi pikëllues dhe brengosës.

Ndërsa kënaqja e motiveve të përmendura, shoqërohet nga një gjendje gëzimi dhe lumturie. Përveç kësaj, ndjenjat reaguese kryejnë gjithashtu detyrën e udhëzimit të sjelljes njerëzore, njëlloj si motivet.

Marrim si shembull gjendjen reaguese të frikës, që e shtrëngon njeriun për t'ia mbathur dhe për t'u larguar nga rreziku; gjendja reaguese e zemërimit e shtrëngon njeriun për të mbrojtur veten dhe nganjëherë e shtyn për agresion; ose gjendja reaguese e dashurisë bëhet shkak i afrimit të njeriut me atë që do. Në Kur'anin Fisnik janë përshkruar me kujdes shumë nga ndjenjat reaguese, si: frika, zemërimi, turpi dhe poshtërimi që njeriu ndien. Në këtë kapitull do të përqendrohemi në kërkimin e gjendjeve reaguese të përmendura në Kur'an.

A- Frika

Frika është një nga ndjenjat e rëndësishme reaguese në jetën e njeriut. Sepse kjo gjendje, siç thamë më lart, e ndihmon njeriun në largimin prej rreziqeve që i kanosen. Kjo, gjithashtu, nga ana e vet, e ndihmon njeriun në ruajtjen e jetës dhe në vazhdimësinë e gjeneratës.

Në kapitullin e mëparshëm, kur folëm për motivin e urisë, theksuam se Kur'ani gjatë disa ajeteve, ka përmendur çështjen e sigurisë përballë frikës, shoqëruar me kënaqjen e motivit të urisë. Kjo tregon se motivi i urisë dhe gjendja reaguese e frikës kanë rëndësi të veçantë në jetën e njeriut. Ne i përcollëm tekstet e ajeteve të lartpërmendura, ndërsa diskutonim përreth motivit të urisë.¹

Dobia e frikës nuk përkufizohet vetëm në ruajtjen e njeriut nga rreziqet që i kanosen atij në jetën e kësaj bote. Përveç kësaj, njëra nga dobitë më të rëndësishme të frikës, është se e shtrëngon besimtarin në ruajtjen e vetes përballë dënimit të Zotit në Botën Tjetër, sepse frika nga ndëshkimi i Zotit e shtrëngon besimtarin të mënjanohet nga mëkatet dhe të kapet fort pas devotshmërisë dhe vendosmërisë në adhurim dhe punës për kënaqjen e Zotit.

“Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata, zemrat e të cilëve, kur përmendet Allahu, fërgëllojnë dhe, kur u lexohen shpalljet e Tij, u forcohet besimi dhe vetëm te Zoti i tyre mbështeten,”²

“Ata ngrihen nga shtrati, i luten Zotit të tyre me frikë e shpresë dhe japin nga ajo që iu kemi dhënë Ne.”³

“O njerëz, frikësojuni Zotit tuaj, sepse dridhja e Orës (së Kiametit), është vërtet një ngjarje e madhe! Ditën, që do të shihni atë, çdo grua me fëmijë në gji do ta harrojë fëmijën e saj dhe çdo grua shtatzënë do ta hedhë barrën e vet. Njerëzit do t'i shihni si të dehur, ndonëse ata nuk do të jenë të dehur, por dënimi i Allahut është i ashpër.”⁴

1. Referohu tek: “En-Nahl”, ajeti 112 dhe “Kurejsh”, ajetet 3-4, tema e motiveve.

2. Sure “En-Enfal”, ajeti 2.

3. Sure “Es-Sexhde”, ajeti 16.

4. Sure “El-Haxh”, ajetet 1-2.

Gjendja reaguese e frikës është një lloj ankthi akut, i cili përfshin të gjithë ekzistencën e individit. Kur'ani, këtë lloj ankthi e ka përshkruar si një lloj dridhjeje të fortë, e cila e trondit pa masë njeriun dhe ia heq atij fuqinë për të menduar dhe për të kontrolluar veten.

“Ata ju sulmuan nga lart dhe nga poshtë, kështu që sytë tuaj u errësuan, zemrat ju erdhën në fyt dhe besimi juaj tek Allahu u lëkund. Aty besimtarët u vunë në provë dhe u tronditën si nga një tronditje e fuqishme.”¹

Nëse frika do jetë e fortë, njeriun e pushton për njëfarë kohe një gjendje shtangieje e turbullimi dhe ai e humbet aftësinë për të lëvizur dhe për të menduar. Kur'ani, ndërsa përshkruan Ditën e Kiametit, e vë theksin mbi një gjendje të tillë, që rrjedh nga frika e fortë dhe e beftë.

“Por atyre (Kiameti) do t'u vijë papritmas e do t'i trullosë, kështu që nuk do të mund ta shmangin atë e as nuk do t'u jepet afat!”²

Në kohën që njeriun e rrethon një rrezik i madh dhe e pushton frika, i përqendron të gjitha përpjekjet e tij që ta shpëtojë veten nga ajo greminë e rrezikshme. Në këtë situatë, ai nuk e ka mendjen tek asgjë tjetër.

“Por, kur të vijë Ushtima, atë Ditë njeriu do të ikë nga i vëllai, nga e ëma dhe nga i ati, nga e shoqja dhe nga fëmijët e vet. Atë Ditë, secili prej tyre do të ketë aq shqetësim për veten, sa do t'i mjaftojë.”³

“Ata ju sulmuan nga lart dhe nga poshtë, kështu që sytë tuaj u errësuan, zemrat ju erdhën në fyt dhe besimi juaj tek Allahu u lëkund. Aty besimtarët u vunë në provë dhe u tronditën si nga një tronditje e fuqishme.”⁴

“Por atyre (Kiameti) do t'u vijë papritmas e do t'i trullosë, kështu që nuk do të mund ta shmangin atë e as nuk do t'u jepet afat!”⁵

1. Sure “El-Ahzab”, ajetet 10-11.

2. Sure “El-Enbija”, ajeti 40.

3. Sure “Abese”, ajetet 33-37

4. Sure “El-Ahzab”, ajetet 10, 11. Këto ajete janë zbritur në kohën e Luftës së Hendekut (Ahzabit).

5. Sure “El-Enbija”, ajeti 40.

“Por, kur të vijë Ushtima, atë Ditë njeriu do të ikë nga i vëllai, nga e ëma dhe nga i ati, nga e shoqja dhe nga fëmijët e vet. Atë Ditë, secili prej tyre do të ketë aq shqetësim për veten, sa do t’i mjaftojë.”¹

Së bashku me gjendjen reaguese të frikës, shkaktohen transformime të shumta në detyrat fiziologjike të organeve të brendshme të trupit të njeriut, në vijat e fytyrës (rrudhat), kordat e zërit, forma e trupit. Ne, në kapitullin e ardhshëm do të bëjmë objekt diskutimi tjetërsimet fizike të trupit, që vijnë si rezultat i gjendjeve reaguese. Zakonisht te njeriu, me largimin dhe ikjen nga vendet dhe situatat e rrezikshme, të cilat i kanosen dhe që zgjojnë tek ai gjendjen reaguese të frikës, ngrihet si mburojë edhe përballja.

Allahu (*xh.sh*) e përshkroi kështu ballafaqimin e njeriut me frikën, që realizohet me ikjen e tij nga të mundë prej vendeve ku i kanoset rreziku dhe që të kallin datën. Në rrjedhën e përshkrimit të frikës së kombeve mohuese (qafirëve), ndëshkimi i Zotit u zbriti atyre për shkak të përgënjeshtimit që u bënë Profetëve dhe këmbënguljes në mohim (*kufr*), në atë mënyrë sa tmerri i pushtoi ata dhe garonin me njëri-tjetrin për t’ia mbathur nga ky ndëshkim.

“Sa e sa vendbanime, banorët e të cilëve kanë qenë mohues, i kemi shkatërruar; e pas tyre kemi ngritur popuj të tjerë! Kur e ndienin dënimin Tonë, ata iknin me të shpejtë.”²

Kur’ani e ka përmendur kështu frikën e hipokritëve (munafikëve) dhe pritjen e tyre për të ikur nga besimtarët.

“Ata betohen për Allahun se janë në fenë tuaj, ndërkohë që nuk janë prej jush, por janë njerëz frikacakë (për të treguar si janë në të vërtetë). Sikur ata të gjenin ndonjë strehim, shpellë apo vend mbrojtjeje, do të niseshin atje me nxitim.”³

Në sqarimin e frikës së Musait (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe arratisë së tij prej Faraonit, në Kur’an thuhet kështu:

“Pastaj ika prej jush, kur u frikësova prej jush...”⁴

1. Sure “Abese”, ajetet 33–37.

2. Sure “El-Enbija”, ajetet 11-12.

3. Sure “Et-Teube”, ajetet 56-57.

4. Sure “Esh-Shuara”, ajeti 21.

“Musai doli prej qytetit i frikësuar, duke pritur se ç’do të ndodhte dhe tha: “O Zoti im, më shpëto prej popullit të padrejtë!”¹

Gjithashtu, Kur’ani, frikësimin e Musait (*Paqja qoftë mbi të!*), kur vuri re se bastuni i tij u shndërrua në gjarpër dhe u kthye prapa t’ia mbathte, e përshkruan kështu: **“Hidhe shkopin tënd!” Kur e pa shkopin që po lëvizte si gjarpër, ai iku me vrap e nuk u kthye prapa. “O Musa, mos u frikëso! Në të vërtetë, të dërguarit e Mi nuk frikësohen në praninë Time.”²**

Llojet e frikës

Janë të shumta gjërat që shkaktojnë frikësimin e njeriut. Kur’ani ka përmendur disa prej tyre, si: frika nga Zoti, nga vdekja dhe nga varfëria. Frika nga Zoti ka një rëndësi të veçantë në jetën e njeriut, sepse e shtrëngon gjithnjë atë për në devotshmëri dhe për arritjen e kënaqësisë së Zotit, ndjekjen e rrugës dhe ligjit të Tij, braktisjen e të ndaluarave dhe zbatimin e urdhëresave të Tij. Në të vërtetë, frika nga Allahu (*xh.sh*) është njëra nga shtyllat e besimit dhe hapi i rëndësishëm në formimin e personalitetit të besimtarit.³

“Pa dyshim, ata që besojnë dhe punojnë vepra të mira pikërisht ata janë krijesat më të mira. Shpërblimi i tyre është te Zoti i tyre: kopshtet e Adnit, nëpër të cilat rrjedhin lumenj e ku do të banojnë përherë. Allahu është i kënaqur me ata, por dhe ata janë të kënaqur me Atë. Kjo është dhurata për ata që e kanë frikë Zotin e vet.”⁴

“Hidhe shkopin tënd!” Kur e pa shkopin që po lëvizte si gjarpër, ai iku me vrap e nuk u kthye prapa. “O Musa, mos u frikëso! Në të vërtetë, të dërguarit e Mi nuk frikësohen në

1. Sure “El-Kasas”, ajeti 21.

2. Sure “En-Neml”, ajeti 10.

3. Muhammed El-Gazali, *El-Xhanibu'l-‘atijf mine’l-Islam (Bahthun fi’l-khuluki ue’s-suluki ue’t-tesavuf)*, Kajro, Daru’l-Kutubi’l-Hadithe, aditheHadithe (pa datë), f. 252-255.

4. Sure “El-Bejjine”, ajetet 7-8.

praninë Time.”¹

“Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata, zemrat e të cilëve, kur përmendet Allahu, fërgëllojnë dhe, kur u lexohen shpalljet e Tij, u forcohet besimi dhe vetëm te Zoti i tyre mbështeten.”²

Thuaj: “Unë i trembem vërtetë dënimit të Ditës së madhe, nëse nuk i bindem Zotit tim”.³

“...të cilët kanë frikë nga Dita (e Kiametit), kur zemrat dhe shikimet do të jenë të shqetësuara.”⁴

“Ne i frikësohemi Zotit tonë në një Ditë të ashpër, që do t’i bëjë fytyrat të jenë të vrenjtura.”⁵

Një lloj frike, që më së shumti vihet re te njerëzit, është frika nga vdekja. Kur’ani e thekson kështu frikën e njerëzve nga vdekja:

“Dhe, kur të përfundojë namazi, atëherë shpërndahuni nëpër tokë, kërkoni nga mirësitë e Allahut dhe përmendeni shumë Allahun, në mënyrë që të shpëtoni.”⁶

Kjo lloj frike, shihet qartë në kohën e luftës. Në veçanti, në mesin e ushtarëve, të cilët dërgohen në arenën e luftës. Në Kur’an është thënë kështu lidhur me frikën e hipokritëve (munafikëve) në luftë: “A nuk i ke parë (o Muhamed) ata që janë porositur: “Tërhiqni duart tuaja nga lufta, falni namazin dhe jepni zekatin!”?! Por kur, pas kësaj, u urdhëruan që të luftojnë, një grup prej tyre u frikësua nga njerëzit, ashtu si i frikësohen Allahut, madje edhe më tepër dhe thirrën: “O Zoti ynë! Pse na caktove të luftojmë? Ah, sikur të na kishte kursyer lufta edhe për një kohë të shkurtër!” Thuaju: “Kënaqësitë e kësaj jete janë të vogla. Jeta Tjetër është më e mirë për ata që e kanë frikë Allahun e s’bëjnë gjynahe. Juve nuk do t’ju bëhet asnjë fije padrejtësi.”⁷

“Besimtarët thonë: “Sikur të ishte shpallur një sure!”

1. Sure “En-Neml”, ajeti 10.

2. Sure “El-Enfal”, ajeti 2.

3. Sure “Ez-Zumer”, ajeti 13.

4. Sure “En-Nur”, ajeti 37.

5. Sure “El-Insan”, ajeti 10.

6. Sure “El-Xhumu’a”, ajeti 8.

7. Sure “En-Nisa”, ajeti 77.

Por, kur shpallet një sure e qartë dhe në të përmendet lufta, i sheh ata me zemra të sëmura, si të vështrojnë ty me shikim si të agonisë së vdekjes! Ndërkohë, më e përshtatshme do të ishte për ata.”¹

Frika nga vdekja ka të atillë përhapje midis njerëzve, saqë, madje, nga ajo nuk mbeti i imunizuar as një profet si Musai (*Paqja qoftë mbi të!*).

Hazreti Musa (*Paqja qoftë mbi të!*), ashtu siç edhe na e komunikon Kur’ani nga fjalët e atij vetë, po frikësohej se mos e vriste Faraoni.

“Unë jam edhe përgjegjës ndaj tyre për një krim, andaj kam frikë se do të më vrasin.”²

Musai tha: “O Zoti im, unë kam vrarë një njeri të tyre, prandaj kam frikë se do të më vrasin.”³

E vetmja rrugë e shpëtimit nga kjo lloj frike është besimi i vërtetë në Zot. Besimtarët e dinë se, me të vdekur, do të transferohen në një Jetë Tjetër të përjetshme.

Aty do të përfitojmë nga mëshira dhe kënaqësia e Zotit dhe, nëse ndien frikë nga vdekja, në të vërtetë është sepse frikësohet se mos nuk përfiton nga falja e Zotit dhe nuk fut në dorë dot mëshirën dhe kënaqësinë e Tij.

Nuk ka dyshim se frika nga vdekja, është e fortë për ata mëkatarë që frikësohen se mos vdekja u arrin atyre përpara pendimit.

Prandaj, frika nga vdekja i kthehet kësaj çështjeje, që vdekja është pengesë e pendimit⁴ e për këtë arsye, frika nga vdekja është një raport mjaft i afërt me frikën nga Zoti, për të cilën folëm më përpara.

“Prandaj jepni prej atyre mirësive që ju kam dhënë Unë, para se t’i vijë vdekja ndonjërit, e ai të thotë: “O Zoti im, sikur të më kishe lënë edhe një kohë të shkurtër në jetë, do

1. Sure “Muhamed”, ajeti 20.

2. Sure “Esh-Shuara”, ajeti 14.

3. Sure “El-Kasas”, ajeti 33.

4. Muhamed Ali Taskhirij, *Et-Teuazun fi’l-Islam*, Bejrut, Ed-Daru’l-Islamiye, 1979, f. 59-60.

të kisha dhënë lëmoshë dhe do të bëhesha ndër të mirët!”¹

Thuaju hebrenjve: “Në qoftë se ju pretendoni se jeni të vetmit miq të Allahut nga të gjithë njerëzit, atëherë dëshirojeni vdekjen, po të jeni të singertë!” Por ata kurrë nuk do ta dëshirojnë vdekjen, për shkak të veprave që kanë bërë duart e tyre. Allahu i njeh mirë keqbërësit.”²

Ateistët, të cilët nuk besojnë në ringjallje dhe në Jetën Tjetër, i tmerrohen vdekjes, sepse besojnë që ajo është në kuptimin e asgjësimit dhe zhdukjes së tyre. Prandaj, ata janë të tmerruar me idenë e largimit nga jeta, me mbarimin e saj.³

Gjithashtu, disa, ngaqë nuk e dinë se me çfarë të panjohure do të përballen kur t’u vijë vdekja, i tremben asaj. Në të vërtetë, injoranca e tyre, lidhur me fatin dhe fundin e punës, bëhet shkak i frikësimit dhe i tmerrit të tyre.

“Prandaj jepni prej atyre mirësive që ju kam dhënë Unë, para se t’i vijë vdekja ndonjërit, e ai të thotë: “O Zoti im, sikur të më kishe lënë edhe një kohë të shkurtër në jetë, do të kisha dhënë lëmoshë dhe do të bëhesha ndër të mirët!”⁴

Thuaju hebrenjve: “Në qoftë se ju pretendoni se jeni të vetmit miq të Allahut nga të gjithë njerëzit, atëherë dëshirojeni vdekjen, po të jeni të singertë!” Por ata kurrë nuk do ta dëshirojnë vdekjen, për shkak të veprave që kanë bërë duart e tyre. Allahu i njeh mirë keqbërësit.”⁵

Frika nga varfëria është një frikë e përhapur midis njerëzve. Njeriu në jetë përpiqet përherë të fitojë gjërat e përditshme dhe të sigurojë një jetë të qetë dhe të këndshme për vete dhe për familjen e tij. Ai zakonisht duron vuajtje dhe lodhje të shumta për të fituar qetësinë. Çdo rrezik, që mundësisht i kërcënon bazën e të ardhurave, bëhet shkak për frikësim dhe panik. Arabët, para Islamit, i vrisnin fëmijët e tyre nga frika e varfërisë.

1. Sure “El-Munafikun”, ajeti 10.

2. Sure “El-Xhumu’a”, ajetet 6-7.

3. Jusuf El-Kardai, *El-Iman ue'l-Hajat*, botimi 6, Kajro, Libraria Uehbeh, 1978, f. 146, 167.

4. Sure “El-Munafikun”, ajeti 10.

5. Sure “El-Xhumu’a”, ajetet 6-7.

Mirëpo, Kur'ani e ndaloi këtë veprim, atëherë kur i informoi se rrësku i tyre dhe i fëmijëve të tyre është në dorën e Zotit.

“Paralajmëroji (me Kur'an) ata që i frikësohen daljes para Zotit të tyre, se atëherë nuk do të kenë as mbrojtës, as ndihmës tjetër përveç Tij, me qëllim që të ruhen nga gjynahet.”¹

“Mos i vrisni fëmijët tuaj nga frika e varfërisë! Ne u sigurojmë ushqim atyre dhe juve. Vërtet, vrasja e tyre është gjynah i madh.”²

Një nga veçoritë e besimit në Zot është se e zhduk frikën nga varfëria te njeriu, sepse besimtari, që beson në Zot, ka bindjen se rrësku është në dorën e Zotit dhe për këtë arsye nuk ka më shkak për t'u frikësuar nga varfëria.

“Vërtet, Allahu është Furnizuesi i vetëm, i Fuqishmi, i Plotpushtetshmi.”³

“Në qiell është furnizimi juaj dhe gjithçka që ju është premtuar.”⁴

Prandaj, frika e vërtetë që ndien besimtari është vetë frika nga Zoti,⁵ sepse besimi në Zot bëhet shkak që besimtari të mos frikësohet nga vdekja apo varfëria, nga njerëzit dhe çdo gjë tjetër në këtë botë dhe të trembet vetëm nga zemërimi dhe dënimi i Zotit. Frika nga Zoti kryen një detyrë të rëndësishme dhe të dobishme në jetën e besimtarit, pasi e mban atë larg nga kryerja e krimeve dhe, si rezultat, e ruan nga kapja e zemërimit dhe e dënimit të Zotit.

Përveç kësaj, ajo e nxit atë për kryerjen e adhurimeve dhe punëve të merituara për fitimin e kënaqësisë së Zotit. Frika nga Zoti, në fund të fundit, e bën besimtarin të ndiejë një lloj sigurie psikike, sepse në një gjendje të këtillë, ekzistencën e tij e rrethon një aureolë shprese, do të përfitojë faljen dhe kënaqësinë e Zotit.

1. Sure “El-En'am”, ajeti 151.

2. Sure “El-Isra”, ajeti 31.

3. Sure “Edh-Dharijat”, ajeti 58.

4. Sure “Edh-Dharijat”, ajeti 22.

5. Muhamed Ali Taskhirij, *Et-Teuazun fi'l-Islam*, f. 61.

“Me të vërtetë, atyre që thonë: “Zoti ynë është Allahu”, e pastaj vazhdojnë të vendosur në rrugën e drejtë, do t’u zbresin engjëjt (para vdekjes) e do t’u thonë: “Mos u frikësoni dhe mos u pikëlloni! Dhe gëzojuni Xhenetit që ju është premtuar.”¹

B- Zemërimi

Zemërimi është një nga ndjenjat e rëndësishme reaguese, e cila kryen punë domethënëse te njeriu, e ndihmon atë në mbrojtjen dhe ruajtjen e vetes, sepse, kur njeriu zemërohet, atij i shtohet fuqia për kryerjen e punëve të rëndësishme muskulore.² Kjo gjendje e forcon atë për të mbrojtur veten apo për ta frymëzuar mbi vështirësitë, të cilat e pengojnë në realizimin e qëllimeve të tij të rëndësishme. Kur’ani përkujton të silleni me zemërim dhe ashpërsi kundrejt mohuesve (qafirëve) që bëjnë qëndresë ndaj përhapjes së Islamit. Kjo është vetë rreptësia që buron nga forca e zemërimit në rrugën e Zotit dhe përhapjes së ftesës së Zotit. Kur’ani thotë kështu në përshkrimin e Profetit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ithtarëve dhe shoqëruesve të tij:

“Për të t’i falur ty Allahu gabimet e mëparshme dhe të ardhshme, për ta plotësuar dhuntinë e Vet ndaj teje dhe për të të udhëzuar në rrugën e drejtë.”³

O besimtarë! “Luftoni kundër mohuesve që gjenden afër jush dhe le ta ndiejnë ata ashpërsinë tuaj. Dhe, ta dini se Allahu është me ata që ruhen nga gjynahet.”⁴

“O Profet! Luftoji të pafetë dhe hipokritët dhe bëhu i

1. Sure “Fussilet”, ajeti 30.

2. Në kohën që njeriun e pushton gjendja e zemërimit, apo përgjithësisht ndjenja të tjera reaguese, në trup i shkaktohen transformime të shumta fiziologjike. Njëra nga ato është çlirimi i hormoneve të adrenalinës, të cilat ndikojnë te mëlcia dhe bëhen shkak që ajo të sekretojë një sasi të madhe të lëndëve sheqerore dhe kjo, nga ana e vet, bëhet shkak i shtimit të fuqisë trupore dhe e përgatit njeriun për aktivitete të rënda, për të cilat ka nevojë kur mbron veten në gjendje zemërimi, apo kur ikën në situatat e frikës.

3. Sure “El-Fet’h”, ajeti 29.

4. Sure “Et-Teube”, ajeti 123.

ashpër ndaj tyre! Vendbanimi i tyre do të jetë Xhehenemi. Eh, sa i shëmtuar është ai vendbanim!”¹

Në Kur'an është përshkruar gjendja reaguese e zemërimit dhe ndikimi i tij në sjelljen e njeriut. Këtë temë e hasim kur flitet për Musain (*Paqja qoftë mbi të!*). Kur ai po kthehej nga mali Tur, pa se izraelitët po adhuronin një viç të artë, të punuar nga duart e Samerriut. Ai i flaku përtokë pllakat, e kapu për koke të vëllanë, e tërhoqi nga vetja dhe zuri ta qortoje atë.

“Kur Musai u kthye te populli i tij, i zemëruar dhe i pikëlluar, thirri: “Shumë e keqe është ajo që keni bërë pas ikjes sime! A mos vallë donit të shpejtonit ndëshkimin e Zotit tuaj?” Pastaj i hodhi pllakat dhe, duke e kapur vëllanë për koke, e tërhoqi drejt vetes. Haruni i tha: “O djali i nënës sime! Në të vërtetë, këta njerëz më quajtën për të dobët dhe gati më mbytën. Mos më turpëro para armiqve dhe mos më llogarit ndër keqbërësit!” Musai u lut: “O Zot! Më fal mua dhe vëllanë tim dhe na prano në mëshirën Tënde! Ti je më i Mëshirshmi i mëshiruesve”.²

Ata u përgjigjën: “Ne do t’i lutemi atij, derisa të na kthehet Musai.” (Musai) tha: “O Harun, ç’të pengoi ty, kur i pe ata se kishin humbur.”³

Njeriu ka prirjen që, duke sulmuar pengesat e kënaqjes së motiveve apo realizimit të qëllimeve të tij, të reflektojë përballë gjendjes reaguese të zemërimit, qofshin këto pengesa të lartpërmendura, persona apo individë, qofshin kufizime materiale apo shoqërore. Mirëpo më së shpeshti qëllon që njeriu e transmeton te personat e tjerë zemërimin e vet, që në të vërtetë, ata nuk janë pengesë e realizimit të qëllimeve të tij, apo arsyeja e vërtetë e zgjimit të gjendjes reaguese të zemërimit tek ai. Për shembull, nganjëherë ndonjë fëmijë zemërohet nga i ati, mirëpo kundërveprimin e zemërimit të tij e transferon tek i vëllai më i vogël dhe e rreh atë, duke dhënë pretekst të kotë. Kjo gjë quhet zhvendosje.⁴

1. Sure “Et-Tahrim”, ajeti 9.

2. Sure “El-A’raf”, ajeti 150.

3. Sure “Ta ha”, ajetet 92-94.

4. *Displacement* (ang.).

Edhe në Kur'an ka ardhur një shembull për transferimin e zemërimit në sjelljen e Hazretit Musa (*Paqja qoftë mbi të!*), atëherë kur ai u zemërua nga kombi i vet për shkak të adhurimit që ata i bënëin vëçit. Mirëpo në fillim, zemërimit e vet ia nxjerr të vëllait, Harunit (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe e kap për koke e mjekre dhe e tërheq me zemërim drejt vetes.

“Kur Musai u kthye te populli i tij, i zemëruar dhe i pikëlluar, thirri: “Shumë e keqe është ajo që keni bërë pas ikjes sime! A mos vallë donit të shpejtonit ndëshkimin e Zotit tuaj?” Pastaj i hodhi pllakat dhe, duke e kapur vëllanë për koke, e tërhoqi drejt vetes. Haruni i tha: “O djali i nënës sime! Në të vërtetë, këta njerëz më quajtën për të dobët dhe gati më mbytën. Mos më turpëro para armiqve dhe mos më llogarit ndër keqbërësit!” Musai u lut: “O Zot! Më fal mua dhe vëllanë tim dhe na prano në mëshirën Tënde! Ti je më i Mëshirshmi i mëshiruesve.”¹

Ata u përgjigjën: “Ne do t’i lutemi atij, derisa të na kthehet Musai.” (Musai) tha: “O Harun, ç’të pengoi ty, kur i pe ata se kishin humbur.”²

Rastis ndonjëherë që njeriu zemërohet nga dikush, por meqenëse deklarimi i zemërimit ndaj atij personi mund të ketë pasojë të pakëndshme, nuk ia shfaq hapur atij zemërimit. Në këtë situatë, njeriu e kthen zemërimit e tij ndaj individëve të tjerë, zë të thyejë apo të thërrmojë sende të tjera materiale. Nganjëherë e kthen zemërimit edhe nga vetja e vet dhe sillet padrejtësisht me veten.

Kur'ani sjell një shembull real, duke shpjeguar çështjen e transferimit të sjelljes agresive te vetja. Kur përshkruan hipokritët, Kur'ani përmend se ata kafshojnë gishtat e tyre nga zemërimi i madh që u zien përbrenda për besimtarët. Dhe në të vërtetë, në vend që të shfaqin sjellje agresive ndaj të tjerëve, këtë akt e kryejnë ndaj vetes së tyre dhe zënë ta mundojnë veten qoftë edhe në formë simbolike.

“Ja, ju i doni ata, por ata nuk ju duan juve dhe ju i besoni

1. Sure “El-A’raf”, ajeti 150.

2. Sure “Ta ha”, ajetet 92-94.

të gjitha librave (ndërsa ata jo). Kur ata ju takojnë, thonë: **“Edhe ne besojmë” e, kur mbeten vetëm, nga mllefi ndaj jush, ata i kafshojnë majat e gishtave me dhëmbë. Thuaju: “Plasni me mllefin tuaj.” Vërtet, Allahu e di mirë ç’kanë në gjokset e tyre.”**¹

Kur te njeriu mbizotëron forca e zemërimit, ai e humbet aftësinë e të menduarit drejt dhe nganjëherë shfaq sjellje anormale apo thotë fjalë për të cilat pendohet, pasi i bie zemërimi. Në ajetet ku është treguar zemërimi i Hazretit Musa (*Paqja qoftë mbi të!*), që përmendëm më parë, vumë re se Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) i flaku përdhe pllakat, e kapi për flokësh e për mjekre vëllanë e vet, e tërhoqi nga vetja dhe zuri ta qortojë atë. Ai pandehu se Haruni (*Paqja qoftë mbi të!*) e ka neglizhuar punën e tij, i ka lejuar Beni Israilët të adhurojnë viçin. Mirëpo, kur i ra zemërimi dhe rifitoi qetësinë e tij të mëparshme, vuri re se Haruni (*Paqja qoftë mbi të!*) i kishte ndaluar ata nga ky veprim dhe ishin ata që e kishin shpërfillur dhe kishin qenë gati ta vrisnin. Ai i kërkoi Zotit falje për atë që kishte kryer ndaj të vëllait përpara se të njihej me realitetin e ngjarjes.

“Musai u lut: “O Zot! Më fal mua dhe vëllanë tim dhe na prano në mëshirën Tënde! Ti je më i Mëshirshmi i mëshiruesve.”²

Kur njeriu e humbet aftësinë e të menduarit drejt, në kohën e zgjimit të zemërimit dhe përgjithësisht ndjenjave të forta reaguese, është mirë që në një situatë të këtillë, të përmbahet nga kryerja e veprimeve, për të cilat do të pendohet më vonë. Përveç kësaj, është e nevojshme që të mësojë mënyrën e mposhtjes së zemërimit. Që këtu del në dritë arsyeja se pse Zoti i ka këshilluar njerëzit për të mposhtur, për të sunduar reagimin e zemërimit dhe për ta shuar atë. Ne do ta trajtojmë këtë çështje në kohën e diskutimit të çështjes “Frenimi i ndjenjave reaguese”.

1. Sure “Ali Imran”, ajeti 119. Në “El-Mu’xhemu’l-Uesijt” është thënë se fraza *gadebehu gajdhan* domethënë se e ka nxehur (zemëruar) fort atë duke i shkaktuar mllef”; vëll. 2, f. 668.

2. Sure “El-A’raf”, ajeti 151.

C- Dashuria

Dashuria ka rëndësi të madhe në jetën e njeriut, sepse është themeli i jetesës bashkëshortore, i formimit të familjes, i kujdestarisë për fëmijët; është rrënja e lidhjes dhe e solidaritetit mes njerëzve dhe formimi i raporteve të ngrohta njerëzore.

Dashuria dhe miqësia janë një litar i fortë, i cili e lidh njeriun me Zotin dhe bëhet motiv i sinqeritetit në adhurim dhe ndjekjes së rrugës së Zotit, kapjes fort në fe dhe në sheriat. Dashuria shkakton probleme të shumta në jetën e njeriut. Njeriu nganjëherë do veten, herë njerëzit, herë gruan dhe fëmijën, ndonjëherë paratë e pasurinë; ka raste edhe Zotin e Profetin (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Ne mund të gjejmë shembuj të këtyre dashurive në Kur'an.¹

1. Dashuria ndaj vetvetes

Dashuria ndaj vetes është në një raport mjaft të afërt me motivin e ruajtjes së vetvetes. Njeriu është i interesuar të mbetet gjallë, t'i zgjerojë mundësitë e jetesës e të realizojë identitetin e tij. Përgjithësisht, dëshiron çdo gjë që atij i sjell të mira, siguri dhe lumturi dhe urren çdo gjë që i bëhet pengesë për jetën, zhvillimin dhe realizimin e personalitetit të tij.

Kur'ani ka folur për këtë dashuri të lindur të qenies për gjërat e dobishme a tërheqjes së interesave (*xhelbu'l-menafi'*) dhe largimit nga gjërat e këqija (*def'u'l-mederreh*), të cilat i sjellin dëm, aty kur flet nëpërmjet gojës së Profetit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Thuaj: “Unë nuk mund t'i sjell vetes as dobi, as dëm, përveçse aq sa dëshiron Allahu. Sikur ta dija të padukshmen, do t'i shumoja të mirat dhe nuk do të më prekte asnjë e keqe. Unë jam vetëm paralajmërues dhe sjellës i lajmeve të mira

1. Dashuria për këtë botë është burim i të gjitha llojeve të trazirave dhe çoroditjeve, ndërsa për kënaqësinë e Zotit dhe fitimeve të Ahiretit (Botës Tjetër) është burimi i të gjitha të mirave. Referohu tek suret: “Et-Teube”, ajeti 38; “Fatir”, ajeti 5; “El-Hadid”, ajeti 20; “El-Kijame”, ajeti 20; “El-Humeze”, ajetet 1-4, “En-Naziat”, ajetet 37-39.

për njerëzit që besojnë.”¹

Një nga dukuritë e dashurisë ndaj vetes te njeriu, është interesimi i fortë për grumbullimin e pasurisë, me anë të së cilës mund të arrijë të gjitha dëshirat dhe të sigurojë të tëra mjetet e rehatisë dhe jetës luksoze. Kur’ani e shpjegon kështu dashurinë e fortë të njeriut për pasuri: **“Vërtet, ai është i babëzitur për pasuri.”²**

Një nga dukuritë e tjera të dashurisë së vetes te njeriu është se ai do përherë për vete mirësi të llojit të pasurisë dhe shëndetit dhe gjëra të mira e begati të tjera. Nëse atij i vjen ndonjë e keqe, fatkeqësi apo varfëri, atë e kaplon një ndjenjë e fortë pasigurie dhe pandeh se pas kësaj kurrë nuk do t’ia shohë më faqen të mirës.

“Njeriu nuk lodhet kurrë duke kërkuar të mirën, por, nëse e godet e keqja, ai menjëherë bie në dëshpërim dhe humb shpresën.”³

Gjithashtu, një tjetër prej shembujve të dashurisë së vetes te njeriu, është se, sa herë e zë ndonjë bela, apo i vjen ndonjë dëm, atë e pushton gjendja e frikës dhe e mospërballimit. Nga ana tjetër, nëse fut në dorë ndonjë pasuri, tregon lakmi të fortë ndaj saj, saqë ngurron për të dhënë lëmoshë për nevojtarët, qoftë edhe nga një pjesë e pasurisë së vet.

“Vërtet që njeriu është krijuar i paqëndrueshëm: kur atë e godet e keqja, ai ligështohet fort.”⁴

Vlen të përmendet se dashuria ndaj vetes te njeriu është e pranueshme deri aty ku nuk kalon përtej kufirit të përcaktuar, por doemos duhet të jetë e shoqëruar me dashjen dhe mirëdashjen e njerëzve, me qëllim që të vendoset rregulli.

2. Altruizmi

Njeriu, me qëllim që të mund të përshtatet me të tjerët dhe të jetojë në paqe e qetësi, duhet të kufizojë shtratin e dashurisë ndaj

1. Sure “El-A’raf”, ajeti 188.

2. Sure “El-Adijat”, ajeti 8.

3. Sure “Fussilet”, ajeti 49.

4. Sure “El-Mearixh”, ajetet 19-20.

vetvetes dhe të përpiqet në krijimin e ekuilibrit midis vetëdashjes dhe dashjes së njerëzve (filantropisë), të bashkëpunimit me njerëzit dhe zgjatjen e dorës së ndihmës drejt tyre.

Prandaj, i madhi Zot, kur thekson dashurinë ndaj vetes te njeriu, që del në pah në trajtën e frikës dhe të mospërballimit të fatkeqësisë dhe të lakmisë, për të shtënë në dorë të mira materiale apo koprracisë në dhurimin e tyre ndaj të tjerëve, i lavdëron drejtpërsëdrejti personat që rezistojnë përballë tepërimit të dashurisë ndaj vetvetes. Këta të fundit, në kohën që i zënë fatkeqësitë, nuk shfaqin frikë dhe pamundësi. Kur begatohen, nuk janë dorështrënguar dhe kapen fort pas besimit, falin namaz dhe paguajnë zekat, u japin sadaka (lëmoshë) të varfërve, të pastrehëve dhe përmbahen nga punët që shkaktojnë zemërimin e Zotit. Në këtë mënyrë, tipari i këtij lloj besimi, është krijimi i ekuilibrit midis vetëdashjes dhe dashjes së të tjerëve, në mënyrë që të ruajë si interesat e individit, ashtu edhe të shoqërisë.

“Vërtet që njeriu është krijuar i paqëndrueshëm: kur atë e godet e keqja, ai ligështohet fort, por, kur i bie e mira, ai bëhet koprrac. Përrjashtim bëjnë ata që falen, e që janë të vazhdueshëm në faljet e tyre; e që caktojnë një pjesë të pasurisë së tyre për lypësin dhe për nevojtarin; e që besojnë në Ditën e Llogarisë (Gjykimit); e që frikësohen nga dënimi i Zotit të tyre.”¹

Kur’ani i nxit njerëzit për dashuri, solidaritet mes tyre, bashkëpunim dhe ruajtjen e njëri-tjetrit. **“ Të gjithë mbahuni fort për litarin e Allahut (Kur’anin) dhe mos u përçani! Kujtoni dhuntinë e Allahut për ju, sepse, kur ishit në armiqësi, Ai i pajtoi zemrat tuaja e, në sajë të dhuntisë së Tij, u bëtë vëllezër. Dhe ju ishit buzë greminës së zjarrit, ndërsa Ai ju shpëtoi prej saj. Kështu, Allahu jua shpjegon shpalljet e Veta, që ju të drejtoheni në udhën e drejtë. ”²**

“Por, nëse ata synojnë të të mashtrojnë, të mjafton Allahu (si mbrojtës). Ai të ka forcuar me ndihmën e Tij dhe

1. Sure “El-Mearixh”, ajetet 19-27.

2. Sure “Ali Imran”, ajeti 103.

me besimtarët, duke i bashkuar zemrat e tyre (si një zemër e vetme). Sikur të shpenzoje tërë pasurinë që gjendet në Tokë, nuk do të mund t'i bashkoje zemrat e tyre, por Allahu i bashkoi ato. Ai është vërtet i Plotfuqishëm dhe i Urtë.”¹

Kur'ani i ka lavdëruar ensarët (medinasit) për shkak të shfaqjes së dashurisë së sinqertë ndaj myslimanëve muhaxhirë (mekasve) dhe ndihmës së dhënë atyre, sepse ensarët u dhanë strehë muhaxhirëve dhe i bënë ata partnerë në shtëpitë dhe pasuritë.

“Ndërsa ata që banojnë në Medinë dhe që e kanë pranuar besimin qysh më parë, i duan mërgimtarët që vijnë në Medinë dhe në zemrat e tyre nuk ndiejnë kurrfarë rëndimi, për atë, që u është dhënë atyre, por duan t'u bëjnë më mirë mërgimtarëve sesa vetes, edhe pse vetë janë nevojtarë. Kushdo që ruhet nga lakmia e vetvetes, me siguri që do të jetë fitues.”²

Kur'ani u kërkon besimtarëve që ta duan njëri-tjetrin, ashtu siç do vëllai vëllanë, duke i mundësuar atyre që të mos e zmadhojnë dashurinë për veten, sepse dashja e të tjerëve bëhet shkak i ekuilibrit të vetëdashjes dhe pengesës së zgjerimit të shtratis të saj.

“Në të vërtetë, besimtarët janë vëllezër, andaj pajtojini vëllezërit tuaj midis tyre dhe kijeni frikë Allahun, në mënyrë që ju të mëshiroheni.”³

“Besimtarët dhe besimtare janë miq për njëri-tjetrin. Ata urdhërojnë që të bëhen vepra të mira dhe i ndalojnë të këqijat; falin namazin, japin zekatin dhe i binden Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Këta janë ata që do t'i mëshirojë Allahu. Se, Allahu me të vërtetë, është i Plotfuqishëm dhe i Urtë.”⁴

Është rrëfyer nga Profeti (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*): *“Nuk do të hyni në Xhenet vetëm pasi të besoni. Nuk do të besoni derisa ta doni njëri-tjetrin. A t'ju tregoj*

1. Sure “El-Enfal”, ajetet 62-63.

2. Sure “El-Hashr”, ajeti 9.

3. Sure “El-Huxhurat”, ajeti 10.

4. Sure “Et-Teube”, ajeti 71.

*për një punë që, nëse e kryeni atë, do ta doni njëri-tjetrin? Përhapeni selamin mes jush (përshëndetuni, jepini selam njëri-tjetrit)."*¹

"O ju që keni besuar! Mos nxitoni para (urdhrit të) Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe kijeni frikë Allahun! Vërtet, Allahu dëgjon gjithçka dhe është i Gjithëdijsëm."²

"Besimtarët dhe besimtare janë miq për njëri-tjetrin. Ata urdhërojnë që të bëhen vepra të mira dhe i ndalojnë të këqijat; falin namazin, japin zekatin dhe i binden Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Këta janë ata që do t'i mëshirojë Allahu. Se, Allahu me të vërtetë, është i Plotfuqishëm dhe i Urtë."³

3. Dashuria seksuale

Çështja e dashurisë ka një lidhje të ngushtë me instinktin seksual. Në të vërtetë, dashuria bëhet shkak i vazhdimit të lidhjes, harmonisë dhe bashkëpunimit mes gruas dhe burrit, duke mundësuar vazhdimësinë e jetës familjare.

"Dhe një prej shenjave të Tij është që prej jush krijoj për ju bashkëshortet tuaja, që të qetësoheni pranë tyre, duke vënë ndërmjet jush dashuri dhe mëshirë. Me të vërtetë, në këtë ka shenja, për njerëzit që mendojnë."⁴

"Burrave u është hijeshuar dashuria për gjërat e dëshiruara: për gratë, fëmijët, arin dhe argjendin e grumbulluar, kuajt e bukur, bagëtitë dhe arat e lëruara. Këto janë kënaqësitë e kësaj jete, por shumë më i mirë është kthimi tek Allahu."⁵

"Disa gra (të parisë) në qytet po thoshin: "Gruaja e Azizit (ministrit) deshi ta joshte shërbëtorin e vet. Asaj i ka rënë vërtet

1. Hadithi nr. 42 nga "Përmbledhja e Sahih Muslimit" i Hafidh El-Mundhiriut, me saktësime e verifikime të Nasirudin Albanit, botimi i tretë, Bejrut, El-Mektebu'l-Islami, 1977. Dhe, në një vend tjetër thotë: *"Beto hem për Atë që më ka shpirtin në dorë, se rob i nuk ka besuar derisa të dëshirojë për fqinjin e vet (ose vëllanë e vet) atë që dëshiron për veten..."*

2. Sure "El-Huxhurat", ajeti 1.

3. Sure "Et-Teube", ajeti 71.

4. Sure "Er-Rum", ajeti 21.

5. Sure "Ali Imran", ajeti 14.

në kokë dashuria për të. Ne besojmë se ajo e ka humbur fare.”¹

“Ajo tha: “Ja, ky është ai për të cilin ju më qortuat. Jam përpjekur ta josh, por ai është ruajtur nga gjynahu. Por, nëse ai nuk bën atë që e urdhëroj unë, me siguri që do të burgoset dhe do të poshtërohet”. Ai tha: “O Zoti im, më shumë e dua burgun se atë ku më shtyjnë ato. Nëse Ti nuk e largon prej meje dredhinë e tyre, unë do të prirem drejt atyre dhe do të bëhem nga ata që nuk (i) dinë (ligjet e Tua).”²

Në kapitullin e shkuar, që ishte për kërkimin e motiveve të sjelljes në Kur'an, në vazhden e diskutimit mbi instinktin seksual, ne sqaruam se Islami është njohës i ekzistencës së motivit seksual dhe nuk është mohues i tij. Natyrisht, e pranon dashurinë seksuale, që shoqëron instinktin seksual, sepse ajo është një gjendje reaguese, e lindur në ekzistencën e njeriut. Përballë saj nuk jep shenja rezistence nga vetja dhe, gjithashtu, nuk e shtyp atë, por i fton njerëzit për të fituar dhe për ta vënë nën kontroll atë. Është e pranueshme kënaqja e këtij motivi në mënyrë legjitime, me martesë.

4. Dashuria atërore

Në kapitullin e parë të këtij libri folëm për motivin amësor, si një nga motivet fiziologjike, sepse ai është i qëndrueshëm mbi bazën e shndërrimeve fiziologjike, d.m.th., të po atyre shndërrimeve trupore që shkaktohen përgjatë shtatzënisë, lindjes dhe gjdhënies te nëna. Këto shndërrime trupore (fiziologjike) e lidhin aq fort nënën me fëmijën, saqë efektet e saj kristalizohen në motivin amësor. Nga shembujt e dukshëm të tyre janë dashuria ndaj fëmijëve, dhembshuria dhe përkujdesja ndaj tyre. Më përpara vumë theksin mbi subjektin e motivit amësor.

Babai nuk ka me fëmijët e tij ato raporte fiziologjike që e bashkojnë nënën me fëmijët. Psikologët bashkëkohorë nuk e trajtojnë motivin atëror si një motiv fiziologjik, ashtu si motivin amësor, por e vlerësojnë dashurinë e tij për fëmijët. Kjo vjen

1. Sure “Jusuf”, ajeti 30.

2. Sure “Jusuf”, ajetet 32-33.

pasi fëmijët për baballarët janë shkak i kënaqësisë, i gëzimit, burim i fuqisë dhe i pozitës. Ata janë faktor i rëndësishëm në vijimësinë e rolit të tyre në jetë dhe kujtim i tyre pas vdekjes. Kjo çështje del në pah në lutjen e Zekirjas (*Paqja qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), që i kërkoi Zotit t'i falë atij një djalë, i cili të jetë trashëgimtar i tij dhe i familjes së Jakubit (*Paqja qoftë mbi të!*), “(duke thënë): **“O Zoti im! Eshtrat tashmë më janë dobësuar, koka më ndriçon nga thinjat dhe asnjëherë nuk kam mbetur i zhgënjyer nga lutja ime për Ty, o Zoti im! Unë u frikësohem (sjelljeve të) të afërmve të mi pas meje, ndërsa bashkëshortja ime është beronjë; andaj, më dhuro nga ana Jote një pasardhës, që të më trashëgojë mua dhe familjen e Jakubit. O Zoti im, bëje atë të pëlqyeshëm (për Ty)!”**¹

Duke bërë kujdes në ajetet e Kur'anit, do të vëmë re se shumë ajete që flasin për dashurinë për fëmijët, kanë ardhur krahas dashurisë për pasuri.

“Pasuria dhe fëmijët janë stoli e jetës së kësaj bote. Por veprat e mira që mbeten përherë, janë më të mira te Zoti yt sa i përket shpërblimit dhe, janë më të mira sa i përket shpresës (për shpëtim).”²

“Pastaj jua kthyer juve sërish fitoren kundër tyre, ju ndihmuam me pasuri e djem dhe jua shtuam numrin e ushtarëve.”³

“T’ju shtojë pasurinë dhe fëmijët tuaj dhe të bëjë për ju kopshte e lumenj!”⁴

“Më lër Vetëm (të merrem) me atë që e krijova dhe i dhashë pasuri të pamasë e djem pranë vetes!”⁵

Kur'ani, përgjatë rrëfimit të historisë së Hazretit Nuh (*Paqja qoftë mbi të!*) e vë theksin mbi dashurinë atërore dhe dashurinë që i fshihej në zemër Nuhut (*Paqja qoftë mbi të!*) lidhur me të birin. Kjo dashuri doli në pah në kohën që Nuhu (*Paqja qoftë mbi të!*) e thirri atë me mëshirë, dashuri e dhembshuri dhe i

1. Sure “Merjem”, ajetet 4-6.

2. Sure “El-Kehf”, ajeti 46.

3. Sure “El-Isra”, ajeti 6.

4. Sure “Nuh”, ajeti 12.

5. Sure “El-Muddeth’thir”, ajeti 11-13.

kërkoi atij që të hipte në anije për të shpëtuar nga mbytja.

“Dhe ajo lundronte me ata nëpër valët e mëdha e të larta sa malet, ndërsa Nuhu thërriste birin e vet, i cili ishte ndarë veç: “O biri im, hip me ne e mos u bëj me mohuesit!”¹

Kjo dashuri, shfaqet aty ku Nuhu (*Paqja qoftë mbi të!*) i kërkon Zotit që t’ia shpëtojë të birin.

“Pastaj Nuhu iu lut Zotit dhe i tha: “O Zoti im, biri im është nga familja ime, premtimi Yt është i vërtetë dhe Ti je Gjykatësi më i drejtë!”²

Gjithashtu, dashuria atërore shfaqet në dashurinë e Hazretit Jakub për Jusufin dhe vëllanë e tij më të vogël. Kjo dashuri bëhet shkak që vëllezërit e Jusufit të kenë xhelozi për të dhe t’u futet në zemër armiqësia ndaj tij.

“Vëllezërit e tij thanë: “Jusufi dhe vëllai i tij, janë më të dashur se ne për babanë tonë, ndërkohë që ne jemi një grup i tërë. Babai ynë, me të vërtetë, po gabon.”³

Dashuria atërore e Jakubit, frika e shqetësimi i tij për Jusufin (*Paqja qoftë mbi të!*) shfaqet në kohën që ai zë të kundërshtojë shkuarjen e Jusufit (*Paqja qoftë mbi të!*) me të vëllezërit.

(Babai) **tha: “Unë brengosem po ta merrni dhe kam frikë se mos do ta hajë ujku, ndërkohë që ju s’do ta keni mendjen tek ai.”⁴**

Gjithashtu, dashuria atërore kristalizohet në qarjen pikëlluese të Jakubit për ndarjen nga i biri, e cila vazhdoi deri me humbjen e shikimit të tij.

“U largua prej tyre dhe tha: “O i mjeri unë për Jusufin!” Sytë i ishin zbardhur prej pikëllimit dhe ishte plot zemërim.”⁵

Zakonisht, dashuria atërore manifestohet në formën e përpjekjes së babait për fëmijët dhe kujdestarisë, këshillimit dhe udhëheqjes së tyre në punët ku gjendet e mira dhe dobia e tyre. Kur’ani, nëpërmjet gjuhës së Lukmanit dhe këshillave të tij atërore ndaj të birit, paraqet një shembull të një babai të urtë, i cili e këshillon dhe e prin të birin.

1. Sure “Hud”, ajeti 42.

2. Sure “Hud”, ajeti 45.

3. Sure “Jusuf”, ajeti 8.

4. Sure “Jusuf”, ajeti 13.

5. Sure “Jusuf”, ajeti 84.

5. Dashuria e Zotit

Kulmi i dashurisë dhe lloji më i lartë i saj, në aspektin e paqes së brendshme dhe shpirtërore të njeriut, është dashuria ndaj të madhit Zot dhe malli i fortë i tij për t'iu afruar Zotit. Kjo dashuri manifestohet jo vetëm në namaz, lutje dhe përmendjen e Zotit (në *dhikër*), por në çdo punë që kryen njeriu dhe në çdo sjellje që zë fill prej tij. Në këtë situatë, njeriu, për të gjitha veprimet dhe sjelljet e tij, është përqendruar kah Zoti dhe shpreson që Ai t'ia pranojë veprat dhe të jetë kënaqur me të.

“U largua prej tyre dhe tha: “O i mjeri unë për Jusufin!” Sytë i ishin zbardhur prej pikëllimit dhe ishte plot zemërim.”¹

“(Kujtoje) kur Lukmani i tha të birit, duke e këshilluar: “O djali im, mos i shoqëro Allahut asgjë (në adhurim)! Pa dyshim, idhujtaria është një padrejtësi shumë e madhe”.... Ec me kujdes e i përmbajtur dhe fol me zë të ulët; se zëri më i vrazhdë është zëri i gomarit!”²

Thuaju (o Muhamed): “Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu do t'ju dojë dhe do t'jua falë gjynahet! Allahu është Falës i Madh dhe Mëshirëplotë.”³

O besimtarë! “Nëse ndokush prej jush braktis besimin e vet, dijeni se Allahu do të sjellë njerëz, që i do dhe që e duan; të përlulur me besimtarët dhe të ashpër me femohuesit; që luftojnë në rrugën e Allahut dhe nuk i tremben qortimit të asnjë qortuesi. Kjo është mirësia e Allahut, të cilën Ai ia jep kujt të dojë. Allahu është Bujar i madh dhe i Gjithëditur.”⁴

Dashuria ndaj Zotit në jetën e besimtarit qëndron më lart se çdo dashuri tjetër, që nga dashja e vetvetes e deri te dashuria për fëmijën, gruan, babanë, nënën, familjen dhe pasurinë.

Thuaj: “Nëse etërit tuaj, bijtë tuaj, vëllezërit tuaj, gratë tuaja, farefisi juaj, pasuria juaj që e keni fituar, tregtia për të cilën keni frikë se nuk do të shkojë mirë dhe shtëpitë ku e ndieni veten rehat, janë më të dashura për ju sesa Allahu, i

1. Sure “Jusuf”, ajeti 84.

2. Sure “Lukman”, ajetet 13-19.

3. Sure “Ali Imran”, ajeti 31.

4. Sure “El-Maide”, ajeti 54.

Dërguari i Tij dhe lufta në rrugën e Tij, atëherë pritni derisa Allahu të sjellë vendimin (dënimin) e Tij. Allahu nuk e udhëzon në rrugën e drejtë popullin e pabindur.”¹

“E megjithatë, disa njerëz zgjedhin (për të adhuruar) në vend të Allahut (zota) të tjerë, (duke i konsideruar) si të barabartë me Atë dhe duke i dashur siç duhet Allahu. Por ata që besojnë, e duan shumë më tepër Allahun (se sa ç’i duan idhujtarët idhujt e tyre). Sikurse keqbërësit të shihnin që tani çastin kur të përballen ne ndëshkimin, do ta kuptonin se e tërë fuqia e Allahut dhe se dënimi i Tij është shumë i ashpër.”²

Në kohën që njeriu do të ketë sinqeritet (*ihlas*) në dashurinë ndaj Zotit, vetë kjo dashuri në jetën e tij do të bëhet shtysëdhënëse dhe udhëheqëse dhe të gjitha dashuritë e tjera do të përulen përballë dashurisë së Zotit. Në këtë mënyrë, ekzistenca e njeriut do të vërshojë nga dashuria për njerëzit, kafshët dhe të gjitha krijesat e Zotit anembanë universit. Krijesat që e rrethojnë vënë re gjurmët e fuqisë së Zotit, që lidhen me të me një entuziazëm shpirtëror dhe ndriçim zemre.³

6. Dashuria ndaj Profetit

Pas dashurisë së të madhit Zot, në drejtim të lartësisë, pastërtisë dhe shpirtërores, renditet dashuria ndaj Profetit të nderuar (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), të cilin Zoti e dërgoi si mëshirë për njerëzimin, me qëllim që t’i udhëzojë dhe t’i pastrojë ata dhe t’u mësojë Librin dhe urtësinë. Është profeti i fundit i të gjithëve profetëve të Tij, të dërguar për njerëzit, që ia zbriti Kur’anin Fisnik, librin më të

1. Sure “Et-Teube”, ajeti 24.

2. Sure “El-Bekare”, ajeti 165.

3. Në kërkimet e tyre për dashurinë, psikologët bashkëkohorë mjaftohen vetëm me përmbajtjen e dashurisë së vetes, dashurisë seksuale e dashurisë së familjes. Ata nuk ndërhyjnë në çështjen e dashurisë së njeriut për Zotin dhe dashurisë për profetët; po ashtu, as në atë të dashurisë ndaj shembujve të moralit të lartë të njeriut, si: drejtësia, drejtfolësia e të tjera, ndërkohë që këto të fundit janë nga llojet më të larta të dashurive njerëzore dhe, se vetëm nëpërmjet këtyre, dallohet njeriu nga kafsha.

lartë se të gjithë librat e tjerë qiellorë.

Profeti i nderuar (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ishte shembulli i një njeriu të përkryer, nga pikëpamja e moralit dhe e sjelljes. Në këtë prizëm, ç'argument do të ishte më i fortë sesa vetë Kur'ani, i cili e ka përshkruar atë, si njeriun me moralin më të lartë!

“se ti je me virtyte madhore.”¹

Një besimtar që beson në Zot, e do fort Profetin (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), i cili i duroi vështirësitë e thirrjes në Islam dhe luftoi heroikisht për përhapjen e Islamit në të katër anët e botës. Ai e udhëhoqi njerëzimin nga errësira e humbjes drejt dritës së udhëzimit. Kur'ani na këshillon që ta duam fort Profetin (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Në ajetin e njëzetekatërtë të sures “Et-Teube”, që ne më përpara e përmendëm në vazhdën e diskutimit mbi *hubbullah*, dashurinë ndaj Zotit, dashuria ndaj Profetit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) është sjellë së bashku me dashurinë ndaj Zotit. Besimtari i vërtetë merr për shembull të shkëlqyer Profetin (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) në moral e sjellje dhe e hedh hapin aty ku e ka hedhur ai. Në jetën e tij kërkon udhëzim prej jetëshkrimit dhe mënyrës së tij të pastër.

“Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë, që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun.”²

Ç- Gëzimi

Njeriu, sa herë që e arrin dëshirën e vet dhe ia del mbanë me gjërat që i interesojnë, si: pasuria, pushteti, ndikimi, suksesi, dituria apo besimi dhe devotshmëria, në vetvete ndien gëzim dhe lumturi. Prandaj, gëzimi është diçka relative dhe bazohet te qëllimet e njeriut në jetë. Për shembull, nëse qëllimi i dikujt në jetë do të ishte grumbullimi i pasurisë, i shtënies në dorë

1. Sure “El-Kalem”, ajeti 4.

2. Sure “El-Ahzab”, ajeti 21.

të pushtetit dhe pozitive të tjera të kësaj bote, sukcesi i tij në këto objektiva do të bëhej shkak i gëzimit dhe i lumturisë së tij. Ndërsa, për atë person që qëllimi i jetës së tij do të ishte forcimi i besimit, përmbajtja dhe puna e mirë për të shtënë në dorë lumturinë e Botës Tjetër, po këto çështje do të bëheshin shkak dhe burim për qetësinë dhe për t'u ndier i sigurt dhe i gëzuar. Kur'an i ka përmendur që të dyja këto lloj gëzimesh. Për shembull, e përshkruan kështu gëzimin e mohuesve kur arrijnë begatitë e kësaj bote:

“Allahu ia shton furnizimin kujt të dojë dhe ia pakëson kujt të dojë. Jobesimtarët i gëzohen jetës së kësaj bote, por jeta e kësaj bote në krahasim me Botën Tjetër është vetëm kënaqësi kalimtare.”¹

Gjithashtu, ka përmendur gëzimin e besimtarëve kur u këndohen ajetet kur'anore, të cilat i udhëheqin nga e vërteta, në atë që është shërimi i dhembjeve të tyre, udhëzim dhe mëshirë.

“Ndërsa shpërblimi i Jetës Tjetër është më i mirë për ata që besojnë dhe e kanë frikë Allahun. Dhe erdhën vëllezërit e Jusufit e hynë tek ai. Ai i njohu, por ata nuk e njohën.”²

Në formën kur burim i gëzimit dhe i lumturisë së dikujt do të ishte rehatia në këtë botë, ndërkohë që shumica e njerëzve janë të tillë, e ky person, në të vërtetë, nuk është i tillë, ky person nuk është përfitues i një jete të qetë dhe të qëndrueshme, sepse, në kohën që Zoti i dhuron atij mirësinë e shëndetit të mirë dhe zgjerimit të rrizkut dhe të pasurisë, ndien gëzim dhe lumturi për këto begati.

Kënaqësitë e kësaj bote e pengojnë atë ta kujtojë dhe ta falënderojë Zotin. Sa herë që atë e godet ndonjë dëm apo fatkeqësi dhe humbet një pjesë të begative që përfitonte, mbi të mbizotëron dëshpërimi, dhembja, dhe zë e i mohon begatitë e tjera prej të cilave po përfitonte.

Në këtë mënyrë, një person i tillë e kalon jetën gjithnjë në ankth dhe luhatje midis ndjesisë së lumturisë dhe të trishtimit.

1. Sure “Er-Ra’d”, ajeti 26.

2. Sure “Jusuf”, ajetet 57-58.

“Kur Ne i japim njeriut të shijojë mëshirën Tonë e pastaj ia heqim atë, ai atëherë bëhet shpresëhumbur dhe mohues. E, kur pas fatkeqësisë që e ka goditur atë, Ne i japim atij dhunti, ai me siguri do të thotë: “Gjynahet e mia janë larguar nga unë!” atëherë bëhet i gëzuar dhe mendjemadh.”¹

Mirëpo, nëse burimi i gëzimit dhe i lumturisë së dikujt do të jetë besimi në Zot, devotshmëria, punët e mira dhe ecja në vijën që ka urdhëruar Zoti në jetë, ky person ndien lumturinë e vërtetë dhe të përhershme. Është e vërtetë fjala e të madhit Zot rreth tij:

“Cilindo mashkull apo femër që kryen vepra të mira, duke qenë besimtar, Ne do ta bëjmë që të kalojë jetë të bukur dhe do ta shpërblejmë sipas veprave më të mira, që ka bërë.”²

Gjithashtu, Kur'ani e përshkruan kështu lumturinë e besimtarit në Ditën e Kiametit, atëherë kur i madhi Zot e shpëton nga e keqja e asaj dite dhe me mëshirën e Vet, e fut në Parajsën e bekuar.

“Por Allahu do t’i ruajë ata nga tmerret e asaj Dite e do t’u japë shkëlqim dhe gëzim”³

D- Urrejtja

Urrejtja është një lloj gjendjeje reaguese kundër dashurisë. Përbëhet nga ndjesia e antipatisë dhe e mospranimi, e neverisë dhe e mospëlqimit dhe e prirjeve për largim nga gjërat që e nxisin këtë ndjesi, qofshin faktorë, persona, sende, punë dhe sjellje.

Megjithëse dashuria është themeli i jetës bashkëshortore, prapëseprapë, nganjëherë midis gruas dhe burrit ndodhin keqkuptime, mosmarrëveshje dhe grindje, që mund të rezultojnë me krijimin e gjendjes së urrejtjes kundrejt njëritjetrit. Kur'ani e vë theksin mbi disa çështje të pakëndshme që hasin nganjëherë bashkëshortët dhe kërkon që ata të përpiqen për të triumfuar mbi këto lloj çështjesh, pasi, në këtë mënyrë, përgatisin mundësinë e vazhdimi të jetës bashkëshortore.

1. Sure “Hud”, ajetet 9-10.

2. Sure “En-Nahl”, ajeti 97.

3. Sure “El-Insan”, ajeti 11.

“O besimtarë! - nuk ju lejohet të bëheni përdhunisht trashëgimtarë të grave dhe mos i pengoni ato me qëllim që t’ua merrni një pjesë nga dhuratat që ua keni dhënë, përveç nëse bëjnë gabime sheshazi.”¹

Nganjëherë njeriu e urren dikë apo disa persona për arsye të mospërputhjes së mendimit me të. Kjo urrejtje del në pah për shkak të provokimit të xhelozisë, smirës, që buron prej përparësisë së të tjerëve në raport me të. Nga kjo, ata parapërgatitin shkaqet e privimit të tij ose nga faktorë të tjerë që zgjojnë tek ta një lloj urrejtjeje. Për shembull, mohuesit dhe hipokritët nuk i duronin dot besimtarët dhe në zemrat e tyre ushqenin armiqësi për ta.

“O besimtarë! Mos zgjidhni për miq dhe këshilltarë të afërt njerëz të tjerë jashtë gjirit tuaj; ata nuk ngurrojnë që t’ju bëjnë dëm. Ata dëshirojnë që të vuani. Urrejtja shfaqet në gjithçka që del prej gojës së tyre, kurse ajo që fshehin në zemrën e tyre, është edhe më e madhe. Ne jua kemi shpjeguar vargjet (e Kur’anit), nëse jeni njerëz që kuptoni..... Nëse ju vjen ndonjë e mirë, ata i brengos e, nëse ju gjen ndonjë e keqe, ata gëzohen, por nëse ju duroni dhe ruheni nga gjynahet, dinakëritë e tyre nuk mund t’ju dëmtojnë aspak. Vërtet Allahu ka dijeni për çdo gjë që punojnë ata.”²

Siç theksuam më parë në temën e dashurisë ndaj vetes, njeriu e do veten e tij dhe kërkon më të mirën për të. Për shembull, e urren vdekjen apo gjërat që e mundojnë. Kjo është arsyeja se pse njeriu nuk e ka qejf luftën, sepse ekziston mundësia e vdekjes, e gjymtimit dhe e dëmtimit të tij. Kur’ani e përshkruan kështu urrejtjen që ndien njeriu ndaj luftës:

“Lufta është bërë detyrim për ju, ndonëse e urreni. Por mund ta urreni një gjë, ndërkohë që ajo është e mirë për ju e mund ta doni një gjë, ndërkohë që ajo është e dëmshme për ju.”³

Veprimi i njeriut për të sakrifikuar në rrugën e *akides* (besimit) së tij, argumenton këtë: që fuqia e bindjes tek ai ka

1. Sure “En-Nisa”, ajeti 19.

2. Sure “Ali Imran”, ajetet 118-120.

3. Sure “El-Bekare”, ajeti 216.

arritur në atë fazë të lartë, saqë është edhe më e vlefshme se shpirti i tij (jeta e tij) dhe më e fuqishme sesa dashuria ndaj vetvetes. Ishte kjo arsyeja që besimtarët garonin me njëri-tjetrin për të rënë dëshmorë në rrugën e Zotit, ndërsa në zemrat e hipokritëve nuk kishte vend besimi. Ata urrenin të ndihmonin me pasuritë e tyre apo të sakrifikonin jetët e tyre në luftë për hirin e Zotit. Ata parapëlqenin të mos dilnin nga Medineja për *xhihad* përkrah Profetit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Gjithashtu, i ndalonin edhe të tjerët nga kjo punë dhe i nxitnin që të mos dilnin jashtë Medinës, me pretekstin e vapës dhe të nxehtit të madh.

“Ata që mbetën në shtëpitë e tyre, pas (daljes për luftë të) të Dërguarit të Allahut, u gëzuan; nuk u pëlqente të luftonin në rrugën e Allahut me pasurinë dhe jetën e tyre dhe thanë: “Mos shkoni në luftë, nëpër vapë!” Thuaju: “Zjarri i Xhehenemit është edhe më i nxehtë!” Veç sikur të kuptonin!”¹

“Ndihmesat e tyre nuk do të pranohen, ngase ata janë njerëz që nuk besojnë në Allahun dhe të Dërguarin e Tij, namazit i afrohen vetëm në mënyrë të ngathët dhe nuk shpenzojnë (nga pasuria), veçse në mënyrë përbuzëse.”²

Besimi ndikon në zemrën e besimtarit, që ai të mos i urrejë vëllezërit e tij besimtarë. Kur'ani i lavdëron besimtarët që erdhën pas ensarëve dhe muhaxhirëve (domethënë *tabiinët*), për shkak se kërkuan nga Zoti që të falë mëkatet e besimtarëve para tyre dhe të mos lënë vend për urrejtje në zemrat e tyre për ata.

“Edhe ata që erdhën pas tyre, thonë: “O Zoti ynë, falna neve dhe vëllezërit tanë, të cilët kanë besuar para nesh dhe mos lejo që në zemrat tona të ketë asnjë të keqe ndaj besimtarëve! O Zoti ynë, Ti je vërtet i Butë dhe Mëshirëplotë!”³

E- Xhelozia

Xhelozia është një reagim i shoqëruar me inat, mëri dhe

1. Sure “Et-Teube”, ajeti 81.

2. Sure “Et-Teube”, ajeti 54.

3. Sure “El-Hashr”, ajeti 10.

zymtësi zemre, të cilën njeriu zakonisht e ndien në kohën kur personi i dashur i tij e ka hedhur vëmendjen apo dashurinë e tij te një tjetër. Një prej llojeve më të përhapura të xhelozisë është ajo që haset ndërmjet vëllezërve, kur ndonjëri nga ata ndien se babai dhe nëna apo njëri nga ata të dy, do më shumë njërin nga vëllezërit. Kur'ani e ka përshkruar këtë xhelozë në rrëfimin e historisë së vëllezërve të Jusufit (*Paqja qoftë mbi të!*), kur ata patën xhelozë ndaj tij.

Vëllezërit e tij thanë: "Jusufi dhe vëllai i tij, janë më të dashur se ne për babanë tonë, ndërkohë që ne jemi një grup i tërë. Babai ynë, me të vërtetë, po gabon. Vriteni Jusufin ose braktiseni në ndonjë vend të largët, se pastaj babai juaj do të kthehet nga ju dhe, pas kësaj, do të bëheni njerëz të mirë."¹

Sigurisht që reagimi i xhelozisë është një reagim i përbërë, ku gjenden elemente nga disa reagime të tjera, në veçanti nga reagimi i urrejtjes. Prandaj, kjo gjendje shpesh shoqërohet me urrejtje, mëri dhe prirje për ta ngacmuar individin që e provokon atë. Gjithashtu, Kur'ani, në rrjedhën e historisë së Jusufit (*Paqja qoftë mbi të!*), ka përshkruar prirjen e vëllezërve të Jusufit për ta vrarë atë dhe si rezultat për t'u çliruar prej tij. Njëkohësisht ka përmendur veprimin e tyre, duke e flakur Jusufin në gropën e pusit.

7. Smira

Smira është një lloj gjendjeje reaguese, që njeriu ndien për të zënë vendin e personit tjetër që ka begati dhe dëshiron që ajo mirëqenie t'i asgjësohet, me qëllim që të bëhet vetë zotëruar i saj. Për shembull, nganjëherë njeriu xhelozon ndaj dikujt që ka pasuri të shumta dhe dëshiron që një pasuri e tillë t'i përkasë atij.

Kur'ani, teksa rrëfen ndodhinë e Karunit, e përshkruan këtë lloj xhelozie. Kur Karuni u shfaq në popull më i fortë dhe me luks të madh, disa njerëz xhelozuan ndaj tij dhe dëshiruan që t'i zotëronin vetë ato të mira. Ai thotë:

1. Sure "Jusuf", ajeti 8-9.

Kur ai dilte para popullit të vet me stolitë e tij, ata që lakmonin jetën e kësaj bote thanë: “Ah! Sikur të na ishte dhënë edhe neve si Karunit! Vërtet që ai është njeri me fat.”¹

Kjo lloj xhelozie është e përhapur te shumë njerëz dhe shumë nga ata xhelozojnë për pasurinë, fëmijët, shëndetin trupor dhe suksesin e individëve të tjerë, që ua ka dhuruar Zoti. Karuni e ka përshkruar xhelozinë e çifutëve (jehuditëve) dhe idhujtarëve në lidhje me Profetin e Nderuar (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe përparësinë e profetësisë, të cilën Zoti e ka dhënë për Profetin (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe po ashtu xhelozinë e tyre për besimtarët, që janë të pajisur me virtytin e besimit dhe të udhëzimit, që gjithashtu është i posaçëm për ata nga ana e Zotit.

“Ata që mohojnë, si ithtarët e Librit, ashtu edhe paganët, nuk dëshirojnë që t’ju zbresë ndonjë e mirë nga Zoti juaj. Por Allahu ia dhuron mëshirën e Vet kujt të dojë. Allahu zotëron mirësi të madhe”²

“A mos i kanë zili njerëzit për çfarë u ka dhuruar Allahu nga të mirat e Veta? Ne u dhamë pasardhësve të Ibrahimit Librin e urtësinë, si dhe një pushtet të madh.”³

“Shumë nga ithtarët e Librit, prej zilisë që kanë në vete, dëshirojnë që t’ju kthejnë nga besimi në mosbesim, tani që e vërteta është e qartë për ta. Por ju falini ata dhe lërinin, derisa të arrijë urdhri i Allahut. Vërtet Allahu është i Fuqishëm për çdo gjë.”⁴

Ndonjëherë, ndërmjet vëllezërve shfaqet edhe çështja e smirës. Për shembull, një vëlla ka smirë për dhuntitë e ndryshme që Zoti i ka dhuruar vëllait të tij. Për këtë arsye, Jakubi (*Paqja qoftë mbi të!*) e paralajmëroi Jusufin (*Paqja qoftë mbi të!*) që të mos ia ritregojë të vëllezërve ndodhinë e ëndrrës së tij, sepse ishte i alarmuar për smirën e tyre ndaj Jusufit, se mos ndoshta e zinin dhe e mundonin atë.

1. Sure “El-Kasas”, ajeti 79.

2. Sure “El-Bekare”, ajeti 105.

3. Sure “En-Nisa”, ajeti 54.

4. Sure “El-Bekare”, ajeti 109.

Ai i tha: "O biri im! Mos ua trego ëndrrën tënde vëllezërve të tu, që të mos kurdisin ndonjë gjë kundër teje, sepse, vërtet, djalli është armik i hapët i njeriut."¹

Smira e parë që ndodhi mbi faqen e dheut, ishte smira që pati Kabili ndaj vëllait, Habilit, atëherë kur Zoti pranoi flijimin (*kurbanin*) e Habilit, ndërsa nuk pranoi kurbanin e bërë nga Kabili. Kjo çështje u bë motiv që Kabili të vriste të vëllanë.

"Lexoju (o Muhamed) saktësisht ngjarjen e dy bijve të Ademit, kur ata bënë nga një kurban, njërit iu pranua, kurse tjetrit jo. Njëri i tha tjetrit: "Ty gjithsesi do të të vras." Tjetri tha: "Allahu pranon vetëm prej të devotshmit."²

Edhe smira, ashtu si xhelozia, ngjall mëri dhe urrejtje te njeriu dhe e shtyn atë që të dëshirojë dëmtimin e personit që ka begati. Ndonjëherë e shtrëngon njeriun për ta dhunuar dhe për ta torturuar atë, ashtu sikurse Kabili vrau të vëllanë Habin apo ashtu siç bënë vëllezërit e Jusufit (*Paqja qoftë mbi të!*), kur e hodhën atë në pus.³

Kjo smirë ndaj Jusufit (*Paqja qoftë mbi të!*) rezulton me urrejtje, me mundimin e tij e njëkohësisht me agresion mbi të. Nisur nga kjo ngjarje, Zoti na kërkon që të kërkojmë mbrojtjen e Tij prej personave smirëzinj.

"dhe nga sherri i smirëziut, kur vepron me smirë."⁴

F- Pikëllimi

Pikëllimi është një gjendje reaguese (reflektuese) kundër gëzimit dhe lumturisë. Kjo gjendje ndodh kur njeriu humb personin e dashur, diçka të shtrenjtë, kur atij i ndodh ndonjë incident apo pëson disfatë në kryerjen e një pune të rëndësishme.

Baballarët dhe nënat, zakonisht ndihen të pikëlluar kur

1. Sure "Jusuf", ajeti 5.

2. Sure "El-Maide", ajeti 27.

3. Gjithashtu, armiqësia e djallit ndaj Ademit (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte rezultat i smirës së tij ndaj atij Hazreti, që u bë shkak i përzënies së tij nga Xheneti.

4. Sure "El-Felek", ajeti 5.

bijtë e tyre nuk gjenden pranë tyre, kur atyre u shkaktohet ndonjë dëm apo kur u ndodh diçka e pakëndshme. Kur'ani e vë kështu theksin mbi pikëllimin e nënës së Musait (*Paqja qoftë mbi të!*), kur ajo e futi atë në arkë dhe e lëshoi në lumë dhe kur vala e ujit e largoi Musain (*Paqja qoftë mbi të!*) nga ajo.

“Kështu, Ne e kthyem atë te nëna e vet, që ajo të gëzohej e të mos pikëllonte dhe që ta dinte se premtimi i Allahut është i vërtetë; por, shumica e njerëzve nuk e dinë.”¹

“Kur shkoi motra jote e tha: “A doni t’ju tregoj dikë që do të kujdeset për atë?”

Ne të kthyem te nëna jote, që ajo të gëzohej dhe të mos pikëllonte më. Pastaj ti vrave një njeri, por Ne të shpëtuan nga brenga dhe të vumë në sprova të shumta. Ti qëndrove me vite të tëra midis banorëve të Medjenit, pastaj erdhe sipas porosisë së caktuar, o Musa!”²

Kur'ani e përshkruan kështu pikëllimin e Jakubit (*Paqja qoftë mbi të!*), kur humbi të birin, Jusufin.

U largua prej tyre dhe tha: “O i mjeri unë për Jusufin!” Sytë i ishin zbardhur prej pikëllimit dhe ishte plot zemërim. Ata thanë: “Për Allahun, ti po e përmend Jusufin pa pushim, saqë do të sëmuresh rëndë ose do të vdesësh!” (Jakubi) tha: “Unë dhimbjen time dhe pikëllimin tim ia paraqes vetëm Allahut e nga Allahu di atë që nuk e dini ju”.³

Kur'ani, gjithashtu, e përshkruan në këtë mënyrë gjendjen e pikëllimit të besimtarëve të varfër, që erdhën pranë Profetit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe kërkuan që, së bashku me të, të dilnin nga Medina për të luftuar në rrugë të Zotit. Mirëpo, Profeti i nderuar (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u tha atyre se nuk kishte ndonjë lajm që t’ua jepte dhe, si përfundim, ata u kthyen nga Profeti me lot në sy e të pikëlluar.

Thuaj: “Çfarë prisni për ne, përveçse njërës prej dy të mirave (fitores ose martirizimit)? Ndërsa ne po presim që Allahu t’ju godasë me dënim nga ana e Tij ose me duart

1. Sure “El-Kasas”, ajeti 13.

2. Sure “Ta ha”, ajeti 40.

3. Sure “Jusuf”, ajetet 84–86.

tona. Pra, pritni se edhe ne me ju do të presim.”¹

Kur'ani ka përmendur pikëllimin e Ebu Bekrit në kohën që ishte në shpellë, së bashku me Profetin (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), kur jobesimtarët kurejshë po i ndiqnin, me qëllim që të vrisnin Profetin e tij.

“Nëse ju nuk e ndihmoni atë (Muhamedin), Allahu tashmë e ka ndihmuar ditën kur atë e dëbuan mohuesit vetë të dytin, kur ishin në shpellë e ai i thoshte shokut të vet: “Mos u mërzit, se Allahu është vërtet me ne!” Atëherë, Allahu zbriti qetësinë e Vet mbi të, e ndihmoi me një ushtri të padukshme (engjëjsh) dhe bëri që fjala e jobesimtarëve të jetë më e poshtëruara, kurse Fjala e Allahut të jetë më e lartësuar. Vërtet, Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë.”²

Profeti i nderuar (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) në kohën që pa se jobesimtarët e Mekës nuk po e pranonin ftesën e tij për të besuar në Zot dhe në Kur'anin që i ishte zbritur atij, ndjeu hidhërim dhe pikëllim.

“Ti (o Muhamed) mos u brengos nga ata që nxitojnë në mohim, sepse, në të vërtetë ata nuk mund ta dëmtojnë Allahun aspak. Allahu dëshiron që të mos i shpërblejë me kurrfarë dhurate në Botën Tjetër; dhe për ata ka ndëshkim të madh.”³

“Sa për ata që nuk besojnë, ti (o Muhamed), mos u brengos nga mohimi i tyre. Ata do të kthehen te Ne, e Ne do t'i njoftojmë për atë që kanë bërë. Me të vërtetë, Allahu di ç'ka në zemrat e njerëzve.”⁴

Ai, gjithashtu, u pikëllua kur dëgjoi fjalët e jobesimtarëve për Zotin dhe përgënjeshttrimin e vet.

“Mos u dëshpëro nga fjalët e tyre! Ne e dimë çfarë fshehin dhe çfarë shpallin.”⁵

“Ne e dimë se ty të zemëron ajo që thonë ata. Në të vërtetë, nuk je ti ai që po mohojnë ata, por keqbërësit po

1. Sure “Et-Teube”, ajeti 52.

2. Sure “Et-Teube”, ajeti 40.

3. Sure “Ali Imran”, ajeti 176.

4. Sure “Lukman”, ajeti 23.

5. Sure “Jasin”, ajeti 76.

mohojnë shpalljet e Allahut.”¹

Në shumë ajete, Kur’ani e ka përmendur pikëllimin përkrah frikës. Kjo tregon se pikëllimi dhe frika janë dy gjendje reaguese (reflektuese) të zymta, të cilat po t’i rastisin njeriut, ia errësojnë paqen e jetës.

Ajetet e përmendura, gjithashtu, janë tregues të kësaj çështjeje se, në besimin në Zot, në devotshmëri dhe në punë të mira, ekziston një fuqi që e imunizon njeriun nga frika dhe nga pikëllimi. Dhe, kur ata gjenden në këtë gjendje, angazhohet në shërimin e tyre. Ajetet e mëposhtme janë një shembull i kësaj:

Ne u thamë: “Zbritni të gjithë prej Xhenetit! Kur t’ju vijë udhërrëfimi Ynë, ato që do t’i mbahen atij, nuk do të kenë frikë dhe nuk do të dëshpërohen.”²

“O bijtë e Ademit, kur nga gjiri juaj të vijnë të dërguar që ju shpjegojnë shpalljet e Mia, atëherë ata që ruhen nga të këqijat dhe kryejnë vepra të mira, nuk do të frikësohen e as do të pikëllohen.”³

“Ne i çojmë të dërguarit vetëm si sjellës të lajmeve të mira dhe qortues. Pra kushdo që i beson ata dhe bën mirë, nuk do të frikësohet e as nuk do të pikëllohet.”⁴

“Vërtet, ata që i përuken Allahut dhe bëjnë vepra të mira, do ta kenë shpërblimin te Zoti i tyre, nuk do të frikësohen e as do të pikëllohen.”⁵

G- Pendesa

Pendesa është një gjendje reaguese (reflektuese), e cila rrjedh nga ndjesia e mëkatit dhe e keqardhjes për kryerjen e tij. Ajo ka të bëjë me qortimin e vetvetes për atë që njeriu ka kryer dhe me dëshirën që të mos e kishte kryer atë punë. Qortimi i vetvetes dhe pendesa për punën e shëmtuar, është prej faktorëve të rëndësishëm të perimetrit të personazhit njerëzor

1. Sure “El-En’am”, ajeti 33.

2. Sure “El-Bekare”, ajeti 38.

3. Sure “El-A’raf”, ajeti 35.

4. Sure “El-En’am”, ajeti 48.

5. Sure “El-Bekare”, ajeti 112.

dhe nxitjes së tij për t'u larguar nga punët e papëlqyera dhe kryerjes së mëkateve. Kaq shumë vlerë ka pendesa, sa Zoti betohet për rëndësinë e qortimit të vetes (*nefs levvame* – shpirt qortues).

“Betohem në Ditën e Kiametit! Betohem në shpirtin qortues!”¹

Nefs Levvame është ajo gjë, të cilën ne e quajmë ndërgjegje dhe psikanalistët e quajnë “vetja më e përsosur” ose “vetja ideale”. Ajo është pjesë e vetes, e cila e nxit njeriun të bëjë llogari për punët e veta, duke e qortuar veten për kryerjen e gabimeve dhe e detyron atë të ndiejë pendesë për to.

Hera e parë që njeriu ndjeu pendesë është historia e babait dhe nënës sonë, Ademit dhe Havasë (*Paqja qoftë mbi ta!*), përpara se të zbrisnin në Tokë, në kohën kur ishin në Parajsë. Ata nuk iu bindën urdhrit të Zotit të tyre dhe hëngrën nga fryti i pemës, që Ai ua kishte ndaluar për t'iu afruar dhe, si përfundim, atyre iu shfaqën organet gjenitale. Ata u penduan për veprimin e tyre dhe iu drejtuan Zotit, i kërkuan Atij falje.

Ne thamë: “O Adem, jeto ti dhe gruaja jote në Xhenet dhe aty hani sa të doni e kur të doni, por mos iu afroni kësaj peme, se ndryshe do bëheni të padrejtë. Shejtani i shtyu të gabojnë e i nxori nga lumturia ku ishin. “Zbritni – u thamë Ne – do të jeni armiq të njëri-tjetrit. Në tokë do të qëndroni, do të keni furnizim e do të jetoni deri në një kohë të caktuar. Ademi mësoi disa fjalë (se si të kërkonte falje) nga Zoti i tij, kështu që Ai ia pranoi pendimet, Ai është Mëshirëploti.”²

Mbas ndodhisë së Ademit (*Paqja qoftë mbi të!*), hera e dytë që njeriu ndieua pendesë në këtë botë, ishte në kohën që Habili u vra nga dora e të vëllait, Kabilit. Më pas, Kabili u pendua për këtë punë.³

“Vetja e tij e nxiti në vrasjen e të vëllait dhe e vrau. Kështu, ai u bë nga të humburit. Allahu dërgoi një sorrë që rrëmihte në tokë, për t'i treguar se si ta mbulonte kufomën

1. Sure “El-Kijame”, ajetet 1-2.

2. Sure “El-Bekare”, ajetet 35-37.

3. Mahmud Shelebi, *Hajatu Adem*, botimi i dytë, Bejrut. Daru'l-Xhijl, (pa datë), f. 101.

e të vëllait. (Kabili) tha: “Mjeri unë, a nuk qenkam i zoti të bëhem si kjo sorrë e ta mbuloj trupin e tim vëllai?!” E u bë nga të penduarit.”¹

Kur'ani e përshkruan kështu ndodhinë e pendesës së disa jobesimtarëve në Ditën e Kiametit, që do të pendohen për mosbesimin në Zot dhe për mospranimin e Profetit.

“Atë Ditë keqbërësi do të hajë gishtat e duarve të veta, duke thënë: “Ah, sikur ta kisha marrë rrugën (e drejtë) me të Dërguarin! Ah, sikur të mos e kisha bërë filanin mik!”²

H- Reagime të tjera

Kur'ani vë theksin edhe në disa gjendje të tjera reaguese, përveç atyre që përmendëm deri tani, si: druajtja, turpi, fodullëku dhe mburrja. Druajtja është një reagim i përzier, në të cilin gjenden elemente të turpit dhe frikës. Druajtja e pushton njeriun kur frikësohet se mos njerëzit i vënë re atij sjellje, të cilat janë të kritikueshme dhe të qortueshme.

Kjo gjendje është prej veçorive të pëlqyera të njeriut, sepse e detyron njeriun të ruhet nga punët e shëmtuara e të ndyra. Kur'ani e përshkruan këtë ndjenjë në historinë e arratisjes së Musait (*Paqja qoftë mbi të!*) nga lufta e faraonit. Kur u arratis nga faraoni, u strehua në territorin e Medjenit. Ai i dha ujë deleve të vajzave që kishin qëndruar në anë të pusit. Kur'ani vë theksin në gjendjen reaguese të turpit, kur njëra nga dy vajzat, pas dhënies së ujit, kthehet te Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe me ndrojtje i flet atij, që të takojë babanë e tyre.

“Më vonë, njëra nga ato dyja, erdhi me ndrojtje dhe i tha: “Babai im të fton për të të shpërblyer, se i dhe ujë (tufës sonë)”. Kur Musai shkoi tek ai dhe i tregoi çfarë kishte përjetuar, ai tha: “Mos u frikëso, sepse ke shpëtuar prej një populli keqbërës!”³

Ndjenja e druajtjes, në të vërtetë, është vetë turpi i shoqëruar me ndjenjën e uljes, të poshtërimit, të fëlliqjes e të çnderimit. Në

1. Sure “El-Maide”, ajetet 30-31.

2. Sure “El-Furkan”, ajetet 27-28.

3. Sure “El-Kasas”, ajeti 25.

Kur'an ekzistojnë ajete të shumta, që e përshkruajnë gjendjen e turpit që ndiejnë idhujtarët (*mushrikinët*) dhe hipokritët në këtë botë dhe në Botën Tjetër.

“Kush është më fajtor se ai që pengon të përmendet nëpër xhamitë e Allahut Emri i tij dhe përpiqet për shkatërrimin e tyre?! Ato nuk duhet të hyjnë në to, përveçse të frikësuar. Për ata, në këtë jetë ka poshtërim, kurse në Jetën Tjetër dënim të madh.”¹

“Për shkak se ata e thyen besëlidhjen e tyre, Ne i mallkuam ata dhe ua bëmë zemrat të ashpra. Ata i kanë shtrembëruar fjalët e Shkrimeve të shenjta dhe kanë harruar një pjesë të mirë nga ato këshilla. Ti (Muhamed) përherë do ta vëresh tradhtinë e tyre, përveç një pakice të tyre; pra, falua fajet dhe mos i qorto! Se, Allahu i do bamirësit.”²

“Dhe, Ne u dërguam atyre në ditët e fatkeqësisë erë të acartë, për ta shijuar dënimin poshtërues që në këtë jetë; ndërsa dënimi në Jetën Tjetër do të jetë edhe më poshtërues dhe askush nuk do t'i ndihmojë.”³

Pëlqimi i vetes është një gjendje reaguese komplekse, e cila vihet re te një pjesë e njerëzve. Kjo gjendje është vetëpëlqimi i vetes, fodullëku dhe mburrja. Nganjëherë, tek disa njerëz, pëlqimi i vetes shndërrohet në një lloj treguesi sjelljeje, me të cilin shquhen personalitetet e tyre. Kur'ani e quan të shëmtuar pëlqimin e vetes, mendjemadhësinë.

“Mos ec nëpër tokë me mendjemadhësi, se ti, në të vërtetë, nuk mund ta çash tokën e as të arrish lartësinë e maleve.”⁴

“Mos i trajto njerëzit me nënçmim dhe mos ec në tokë me mendjemadhësi, se Allahu nuk i do mendjemëdhenjtë e mburracakët!”⁵

Vetëpëlqimi dhe admirimi i vetvetes, në fund të fundit, do

1. Sure “El-Bekare”, ajeti 114.

2. Sure “El-Maide”, ajeti 13.

3. Sure “Fussilet”, ajeti 16.

4. Sure “El-Isra”, ajeti 37.

5. Sure “Lukman”, ajeti 18, *“la tusa’ir khaddeke lin-nasi”* - “mos ua kthe fytyrën njerëzve prej kryelartësisë”.

të përfundojë me kryelartësi dhe kërkimin e të qenët më lart se të tjerët, me sjellje poshtëruese dhe arrogante në lidhje me ata. Kur'ani, në shumë ajete, e ka qortuar gjendjen e kërkimit të përparësisë dhe kokëfortësinë fodulle të politeistëve dhe të hipokritëve.

Ajetet e mëposhtme janë shembuj për këtë:

“Kur u thuhet atyre: “Ejani, se i Dërguari i Allahut do të kërkojë falje për ju”, ata tundin kokat e tyre dhe i sheh ata të kthehen me mendjemadhësi.”¹

“Mjerë gjynahqari gënjeshtar! Ai i dëgjon shpalljet e Allahut që i lexohen e përsëri ngulmon në mendjemadhësi, sikur nuk i ka dëgjuar ato; jepi lajmin për dënim të dhembshëm!”²

Kur'ani, në rrëfimin e historisë së faraonit, na paraqet shembull personalitetesh që kërkonin me arrogancë përparësisë mbi të tjerët dhe që u pëlqente vetja.

“dhe tuboi njerëzit e u deklaroi: “Unë jam zoti juaj më i lartë!”³

Dhe Faraoni tha: “O pari! Unë nuk di që për ju ka tjetër zot përveç meje! O Haman, më ndez një zjarr për të pjekur qerpiçë dhe më ndërto një kullë të lartë që të ngjitem te Zoti i Musait. Jam i bindur se ai (Musai) gënjen!”⁴

I- Ndryshimet trupore, shoqëruar me reagim

Në kohën që njeriu kaplohet nga një gjendje reaguese, nga pikëpamja fiziologjike, në trupin e tij ndodhin shumë ndryshime, sa tjetërsimet i vihen re në pamjen e jashtme të trupit dhe në vijat e fytyrës së tij (te rrudhat). Ndërmjet këtyre tjetërsimeve, që ngjajnë në kohën e reagimit, mund të përmendim intensitetin e rrahjeve të zemrës, tkurjen e kapilarëve të gjakut në organet e brendshme dhe zgjerimin e tyre në sipërfaqen e trupit. Zgjerimi i këtyre kapilarëve është

1. Sure “El-Munafikun”, ajeti 5.

2. Sure “El-Xhathije”, ajetet 7-8.

3. Sure “En-Naziat”, ajetet 23-24.

4. Sure “El-Kasas”, ajeti 38.

vetë shkaku i futjes së një sasive të madhe gjaku në zemër.

Mbushja plot e zemrës me gjak shkakton rritjen e volumit të saj dhe bashkimin me laringun, sepse, nga pikëpamja fiziologjike, anatomia e zemrës ndodhet përafërsisht një centimetër e gjysmë nën njërën bronke.¹

Kur'ani e ka përshkruar kështu ankthin: rrahje të forta zemre, shtrëngimi i saj shton futjen e gjakut në zemër dhe shkakton rritjen e volumit të saj dhe si rezultat, jep afrimin e saj me laringun.

Dhe Faraoni i thërriste popullit të vet: "O populli im! Vallë, a nuk më përket mua sundimi i Egjiptit dhe i këtyre lumenjve që rrjedhin pranë meje? A nuk shihni? Vallë, a nuk jam unë më i mirë se ky i mjerë, i cili mezi mund të shprehet?"²

"Ata ju sulmuan nga lart dhe nga poshtë, kështu që sytë tuaj u errësuan, zemrat ju erdhën në fyt dhe besimi juaj tek Allahu u lëkund. Aty besimtarët u vunë në provë dhe u tronditën si nga një tronditje e fuqishme."³

Kur'ani, gjithashtu, e shpjegon kështu frikën e fortë, e cila do t'i pushtojë njerëzit në Ditën e Kiametit.

"Paralajmëroji ata për Ditën e afërt të Gjykimit, kur zemrat do t'u vijnë deri në fyt prej pikëllimit. Për njerëzit e këqij nuk ka asnjë mik të afërt dhe as ndërmjetësues të pranueshëm."⁴

Shembuj të tjerë tjetërsimesh trupore që ndodhin krahas reagimit, janë ndryshimet e vijave të fytyrës (rrudhat në fytyrë) në atë mënyrë, sa njeriu mund ta vërë re gjendjen reaguese nga rrudhat që i krijohen në fytyrë personit që reagon. Kur'ani e vë theksin mbi këtë dukuri në shumë ajete. Ajetet e mëposhtme janë shembuj të këtij lloji.

Këto dy ajete përshkruajnë gjendjen e frikës që i pushtoi

1. Xhemal Madi Ebu'l-'Azaim, *El-Kur'an ue ilmu'n-nefs ue'l-Islam*, (Simpozi-umi "Ilmu'n-nefs ue'l-Islam"), vëllimi i parë. Nga botimet e Fakultetit të Shkencave Edukative të Universitetit të Rijadit (në formë broshure), viti 1978 sipas Krishtit, f. 21.

2. Sure "Ez-Zuhruf", ajeti 51-52.

3. Sure "El-Ahzab", ajetet 10-11.

4. Sure "El-Gafir", ajeti 18.

myslimanët në vijim të Luftës së Hendekut (*Ahzabit*).

“Kur atyre iu lexohen vargjet Tona të qarta, ti do të vëresh në fytyrat e jobesimtarëve marazin; ata duan t’u vërsulen atyre që iu lexojnë shpalljet Tona. Thuaj: “A doni t’ju tregoj se çfarë është më e keqe se kjo? - Zjarri i Xhehenemit, të cilin Allahu ua ka premtuar atyre që nuk besojnë! Eh, sa vendbanim i shëmtuar që është ai!”¹

“Kur ndonjëri nga ata merr lajmin e mirë për lindjen e asaj, që ia veshin të Gjithëmëshirshmit (si pjesë e Tij), atij i nxihet fytyra dhe pikëllohet.”²

Në Kur’an ekzistojnë shumë ajete që përshkruajnë gjendjet e pikëllimit e të depresionit, të gëzimit e lumturisë që do të ndiejnë njerëzit në Ditën e Kiametit. Gjithashtu, ndryshimet që shfaqen në fytyrat e tyre janë pasqyrimi i gjendjes reaguese të tyre. I madhi Zot thotë kështu, teksa përshkruan gjendjen e depresionit dhe të pikëllimit që i kaplon mohuesit (*qafirët*) në Ditën e Kiametit, për shkak se janë në pritje të arritjes së dënimit të Zotit dhe, kur nën efektin e hidhërimit dhe të pikëllimit, fytyrat e tyre janë të ngrysur dhe të nxira:

“Në Ditën e Kiametit do t’i shihni ata që kanë trilluar gënjeshtër për Allahun, me fytyra të nxira. Vallë, a nuk është Xhehenemi vend për ata që janë mendjemëdhenj?”³

Kur’ani e përshkruan kështu gjendjen e gëzueshme dhe të lumtur të besimtarëve në Ditën e Kiametit: Ata, me fytyra të qeshura e të hareshme, presin të futen në Parajsë.

“Kurse disa fytyra, atë ditë, do të jenë të zymta, duke e ditur se do të pësojnë një fatkeqësi, që të thyen në mes.”⁴

“Atë Ditë do të ketë (edhe) fytyra të pluhurosura, që do t’i mbulojë errësira. Këta janë jobesimtarët, gjynahqarët.”⁵

1. Sure “El-Haxh”, ajeti 72.

2. Sure “Ez-Zuhruf”, ajeti 17.

3. Sure “Ez-Zumer”, ajeti 60.

4. Sure “El-Kijame”, ajetet 24-25, Fjala “*basireh*” që ndodhet në ajet në origjinal, domethënë “i ngrysur” dhe “i vrenjtur”. Dhe fraza “*juf’ale biha fakireh*” domethënë “do të pësojnë një fatkeqësi, që të thyen në mes (shtyllën kurrizore)”.

5. Sure “Abese”, ajetet 40-42. Fjala “*gabereh*” do të thotë “pluhur”, “*katereh*” do të thotë “zymtësi” dhe “turbullimë”. Me kuptimin që fytyrat e

“Atë Ditë do të ketë fytyra rrëzëllore, të qeshura e të gëzuara.”¹

“Me të vërtetë, punëdrejtët do të gjenden në Xhenet, duke shikuar nga divanet. Në fytyrat e tyre do të njohësh shkëlqimin e Lumturisë.”²

“Atë Ditë, fytyrat e disave do të jenë të gëzuara, të kënaqura për punët e bëra. Ata do të jenë në kopshtin e lartë.”³

“Atë ditë, disa fytyra do të shkëlqejnë dhe Zotin e tyre do të shohin.”⁴

Një nga ndryshimet trupore, që shoqërohet me gjendje reaguese, në veçanti me reagimin e frikës, është zmadhimi i bebes së syrit dhe mosfunksionimi i të menduarit.

“Mos mendo kurrësi që Allahu nuk e vëren atë që bëjnë keqbërësit! Ai vetëm ua shtyn (dënimin) deri në Ditën, kur sytë e tyre do të zgurdullohen (nga tmerret që do të shohin), dhe, duke vrapuar me kokë lart, nuk do të mund t’i lëvizin sytë, ndërsa zemrat e tyre do të jenë të zbrazëta (nga tmerri).”⁵

“Çdo lartësie, dhe të afrohet premtimi i vërtetë (Kiameti), atëherë sytë e atyre që nuk kanë besuar, do të zgurdullohen, (e thonë): “Mjerë për ne! Ne kemi qenë të pavëmendshëm ndaj kësaj dhe e kemi ngarkuar veten me gjynahe.”⁶

Kjo fjalë e të madhit Zot *“tushakh’khasu fijhi’l ebsar”* “... kur sytë e tyre do të zgurdullohen...” dhe *“la jerteddu ilejhim tarfuhum”*, “...nuk do të mund t’i lëvizin sytë...” është një përshkrim i përpiktë për shtimin e vëllimit të bebes së syrit, shtangies së madhe, mosçeljes dhe mbylljes së tyre për shkak të frikës së madhe nga gjërat që shikon.

Në kohën e pushtimit nga gjendja reaguese, në mënyrë të përgjithshme, ndryshon e gjithë forma e trupit. Për shembull,

tyre i mbulon një vello turpi dhe poshtërimi.

1. Sure “Abese”, ajetet 38-39. Fjala *“musfireh”* do të thotë “i shndritshëm” dhe “shkëlqyes”.

2. Sure “El-Mutaffifin”, ajetet 22-24.

3. Sure “El-Gashije”, ajeti 8-10.

4. Sure “El-Kijame”, ajetet 22-23.

5. Sure “Ibrahim” ajetet 42-43.

6. Sure “El-Enbija”, ajeti 97.

në gjendje gëzimi dhe lumturie, njeriu duket i hareshëm, e mban trupin drejt, kryet lart dhe e fryn gjoksin, ndërsa në gjendje turpërimi dhe kur ndien mëkatim dhe pendim, ai duket si inferior, kokulur dhe i kërrusur në vete, a thua se do ta fshehë veten e tij nga sytë e njerëzve. Ne mund ta gjejmë në Kur'an përshkrimin e këtyre ndryshimeve trupore, të cilat vijnë së bashku me gjendjen reaguese.

“Sikur t’i shohësh keqbërësit se si para Zotit të tyre kokulur do të thonë: “O Zoti ynë, pamë dhe dëgjuam, andaj, kthena (në atë botë) që të bëjmë vepra të mira! Ne tashmë besojmë me bindje!”¹

“Ti do t’i shohësh se si do të përballen me zjarrin të përulur nga poshtërimi dhe duke parë tinëzisht me bisht të syrit...”²

“Të ulura do të jenë shikimet e tyre dhe do t’i mbulojë poshtërimi...”³

Një nga ndryshimet e tjera trupore që ndodh në kohën e gjendjes reaguese të frikës, është ngritja përtpjetë e qimeve të kokës (flokëve) dhe e të gjitha qimeve të trupit mbi sipërfaqen e lëkurës. Kjo çështje vihet re fare qartë edhe te disa kafshë, sikurse macet, që në gjendjen reaguese të frikës, u ngrihen përtpjetë qimet në trup. Po kjo gjendje shkaktohet edhe për njerëzit, por nuk dallohet aq qartë sa te kafshët. Po kjo ngritje përtpjetë e qimeve në sipërfaqen e lëkurës së trupit, në kohën e shfaqjes së gjendjes reaguese, bëhet shkak që në kohën e frikësimit në trup të ndihet një lloj drithërime. Kur'ani e ka përmendur kështu ndjesinë e të dridhurit të trupit, e cila vjen nën shoqërinë e gjendjes reaguese të frikës.

“Allahu ka shpallur Fjalën më të bukur (Kur'anin) në formën e një libri, pjesët e të cilit i ngjasojnë njëra-tjetrës dhe përsëriten. Prej tij u rrëqethet lëkura atyre që i frikësohen Zotit të tyre e, mandej qetësohen lëkura dhe zemrat e tyre, kur përmendet Allahu. Ky Libër është udhëzim i Allahut. Nëpërmjet tij Allahu udhëzon kë të dojë. Ndërsa atë që

1. Sure “Es-Sexhde”, ajeti 12.

2. Sure “Esh-Shura”, ajeti 45.

3. Sure “El-Kalem, ajeti 43

Allahu e shpie në humbje, s'mund ta udhëzojë kush.”¹

Kjo thënie e të madhit Zot në ajetin e sipërm **“...mandej qetësohen lëkura dhe zemrat e tyre, kur përmendet Allahu...”**, është shenjë e vënë për gjendjen e qetësisë dhe të rehatisë që shkakton në shpirtin e njeriut përmendja e Zotit dhe përqendrimi tek Ai. Kjo fitohet me adhurim ndaj Zotit dhe duke i atribuuar Atij pacenueshmëri.

Nganjëherë njeriu i shfaq gjendjet e tij reaguese me lëvizjen e dorës. Kur'ani e përshkruan kështu rrahjen e shuplakave të njeriu, kur ai bie në pendim.

“Dhe pasuria e tij (e mohuesit) u shkatërrua, kurse ai i rrihte duart për gjithçka që kishte shpenzuar në të (pronën e vet) – e që tashmë ishte shkretuar nga rrënjët dhe thërriste: “Ah! Sikur të mos i kisha shoqëruar Zotit tim askënd!”²

Nganjëherë njeriu e vendos dorën mbi gojë për të manifestuar hutinë dhe urrejtjen e vet. Zoti thotë: **“A nuk ju ka ardhur lajmi për ata që kanë qenë para jush: për popullin e Nuhut, fiset Ad e Themud dhe për ata pas tyre? Vetëm Allahu i di ata! Të dërguarit e tyre u sollën shenja të qarta, por ata vinin duart në gojë (me tallje) dhe thoshin: “Ne nuk besojmë në mesazhin tuaj. Ne kemi dyshim të madh ndaj asaj që na thërrisni ju!”³**

Gjithashtu, në kohën e reagimit, nganjëherë ndalon procesi i të menduarit dhe njeriu nuk mund të mendojë në mënyrë të rregullt për problemet me të cilat përballet, ashtu siç mendon zakonisht në kohë dhe në situatat joreaguese. Kur'ani, në ajetin 43 të sures “Ibrahim”, të cilën e përmendim më parë, e vë theksin mbi ndalimin e procesit të të menduarit në kohën e reagimit: **“dhe, nuk do të mund t'i lëvizin sytë, ndërsa zemrat e tyre do të jenë të zbrazëta (nga tmerri).”⁴**

Shprehja (*ef'idetuhum haua*), **“...ndërsa zemrat e tyre do të jenë të zbrazëta”**, vë theksin mbi mosfunksionimin e rrjedhës mendore në kohën e frikës, sepse në këtë formë truri i

1. Sure “Ez-Zumer”, ajeti 23.

2. Sure “El-Kehf”, ajeti 42.

3. Sure “Ibrahim”, ajeti 9.

4. Sure “Ibrahim”, ajeti 43.

zullumqarëve zbrazet nga të menduarit dhe nga të arsyetuarit.¹

J- Vënia nën kontroll e reagimeve

Gjithsesi, ndjenjat reaguese kanë detyra të rëndësishme në jetën e njeriut dhe, ashtu siç theksuam më parë, ato e ndihmojnë njeriun në ruajtjen dhe mbijetesën e vetes së tij. Por me gjithë këtë, teprimi në to sjell dëm për shëndetin trupor dhe mendor. Për shembull, reagimi i frikës është i dobishëm për njeriun, sepse e bën atë të përmbahet dhe të largohet nga rreziqet që i kanosen jetës së tij. Mirëpo, nëse njeriu e tepron në frikë dhe frikësohet nga shumë gjëra, që në të vërtetë nuk janë të rrezikshme, në këtë formë frika është dëmprurëse për njeriun.

Këto lloje frike janë të shumta. Zakonisht janë shkak për çrregullimin dhe për luhatjen e personalitetit njerëzor. Kërkimet e reja në mjekësinë psikosomatike (sëmundje psikike që prodhon ndërlikime trupore) e kanë qartësuar këtë çështje, që çrregullimi në aspektet reaguese të njeriut është një nga faktorët e zhvillimit të shumë ndërlikimeve të sëmundjeve trupore. Një pjesë e statistikave tregon se një përqindje e madhe e të sëmurëve, që shpesh u drejtohen klinikave mjekësore, pikësëpari, ankohen për çrregullime të prejardhura nga problemet psikike. Këta të sëmurë nuk kanë nevojë për trajtim mjekësor, por për kurim psikik. Tashmë nëpër ambientet mjekësore është e famshme thënia: “Këshilla më e mirë për këta tipa të sëmurësh është çlirimi i vetes nga gjendja shqetësuese dhe e ankthshme.

Kur'ani, me vëmendje dhe me përpjekje, në udhëzimin e njerëzve në çështjen e frenimit të gjendjeve psikike dhe vënien e tyre nën kontroll, u ka paraprirë shkencave të reja mjekësore dhe psikike, sepse në këtë punë ekzistojnë dobi të shumta shëndetësore, që deri tani ishin të panjohura në mënyrë shkencore. Në kohën tonë, atyre u janë mësuar dobitë.

1- Mposhtja e frikës nga vdekja

Kur'ani këmbëngul që njeriu nuk duhet të trembet nga
1. *Tefsiru'l-Kurtubij*, vëllimi 9, f. 377- 378; *Tefsiru'l-Xhelalejn*, f. 215.

gjërat që zakonisht sjellin gjendje frike, siç është vdekja dhe varfëria. Lidhur me frikën nga vdekja, Kur'ani ka shpjeguar se jeta e kësaj bote është një jetë kalimtare dhe e zhdukshme dhe se begatitë e saj janë të asgjësueshme. Vetëm jeta në Botën Tjetër është e përhershme dhe ka begati të përjetshme dhe të qëndrueshme. Vdekja nuk është gjë tjetër vetëm një fazë që na transferon nga kjo jetë e asgjësueshme, në një jetë të paasgjësueshme e të përhershme. Për këtë arsye, besimtari i vërtetë nuk trembet nga vdekja, sepse ka bindjen se vdekja do ta çojë atë te begatitë e jetës së qëndrueshme dhe të pafund, të cilën Zoti ia ka premtuar robërve të Tij të devotshëm.

“Jeta e kësaj bote nuk është gjë tjetër, veçse argëtim dhe lojë. Ndërsa jeta e Botës Tjetër, pikërisht ajo është jeta e vërtetë. Veç sikur ta dinin!”¹

Jeta e kësaj bote është vetëm lojë e argëtim, kurse Bota Tjetër, pa dyshim që është më e mirë për ata që i frikësohen Allahut. Pra, a nuk po mendoni?²

“O populli im, në të vërtetë, jeta e kësaj bote është vetëm kënaqësi e përkohshme, ndërsa Jeta Tjetër është Shtëpi e përhershme.”³

Po ky, besimi në jetën e përhershme të Botës Tjetër (Ahiretit) dhe njëkohësisht në begatitë e përjetshme që Zoti ua ka premtuar besimtarëve, ishte një nga elementet kyçe që u bënë shkak që myslimanët e fillesave të Islamit t'i hidhnin hapat me guxim dhe pa pasur frikë nga vdekja, në luftë në rrugën e Zotit, të vërsuleshin heroikisht dhe me guxim të paparë e të padëgjuar në rreshtat e qafirëve, ndërkohë që, si dëshirë, kishin rënien dëshmor në rrugën e Zotit dhe arritjen e begative të Parajsës.

“Kursesi mos i quani të vdekur ata që janë vrarë në rrugën e Allahut. Jo, janë të gjallë, duke u ushqyer te Zoti i tyre. Janë të gëzuar për çfarë u ka dhënë Allahu nga dhuntitë e Tij dhe gëzohen edhe për ata që ende nuk u janë bashkuar e që kanë ngelur pas tyre (dhe ende nuk kanë rënë martirë),

1. Sure “El-Ankebut”, ajeti 64.

2. Sure “El-En’am”, ajeti 32.

3. Sure “Gafir”, ajeti 39.

sepse nuk do të frikësohen (për çfarë i pret) dhe nuk do të pikëllohen (për çfarë kanë lënë pas)."¹

"Edhe nëse ju vriteni ose vdisni në udhë të Allahut, falja dhe mëshira e Allahut, me të vërtetë, janë më të mira nga ato që kanë grumbulluar ata. Edhe po vdiqët apo u vratë, me siguri do të tuboheni tek Allahu."²

"Le të luftojnë në rrugën e Allahut ata që nuk e kursejnë jetën e kësaj bote për jetën e ardhshme. Atij që lufton në rrugën e Allahut, e vritet ose fiton, Ne, me siguri, do t'i japim shpërblim të madh."³

"Në të vërtetë, Allahu ka blerë nga besimtarët jetën dhe pasurinë e tyre, në këmbim të Xhenetit. Ata luftojnë në rrugën e Allahut, vrasin dhe vriten. (Ky është) premtimi i Tij i vërtetë në Teurat, Ungjill dhe Kur'an. E kush i përmbahet besëlidhjes më fort se Allahu? Andaj, gëzojuni kësaj shitjeje! Kjo është fitorja madhështore."⁴

Besimtarët e vërtetë e dinin me bindje se vdekja është hak dhe se nga ajo nuk ka asnjë shteg se nga t'ia mbathësh. Prandaj atë e pranuan si një realitet të patjetërsueshëm, pa frikë dhe pa shfaqur shqetësim, sepse e dinin se, sado që të zgjaste jeta e tyre në këtë botë (në Dynja), prapëseprapë do të ishte duke shkuar drejt mbarimit dhe se më në fund vdekja do t'i shpinte ata drejt jetës pa mbarim e të përhershme.

"Çdo shpirt do ta shijojë vdekjen. Shpërblimet do t'u plotësohen vetëm në Ditën e Kiametit; kushdo që shpëton nga zjarri i Xhehenemit dhe hyn në Xhenet, ai ka fituar (gjithçka që mund të dëshirohet). Ndërsa jeta e kësaj bote është vetëm kënaqësi mashtruese."⁵

"Çdo njeri do ta shijojë vdekjen! Ne ju vëmë në provë me të keqe dhe me të mirë dhe te Ne do të ktheheni."⁶

"Çdo shpirt do ta shijojë vdekjen dhe pastaj të gjithë do

1. Sure "Ali Imran", ajetet 169-170.

2. Sure "Ali Imran", ajeti 157-158.

3. Sure "En-Nisa", ajeti 74.

4. Sure "Et-Teube", ajeti 111.

5. Sure "Ali Imran", ajeti 185.

6. Sure "El-Enbija", ajeti 35.

të ktheheni tek Ne.”¹

“Kudo që të gjendeni, do t’ju arrijë vdekja, madje, qofshi edhe në kështjellat më të forta!” Sa herë që u vjen ndonjë e mirë, ata thonë: “Kjo është nga ana e Allahut”. Por, nëse i godet ndonjë e ligë, ata thonë: “Kjo është prej teje (o Muhamed)!” Thuaju: “Të gjitha janë prej Allahut.” Ç’është kështu me këtë popull, që nuk kupton asgjë?”²

Thuaju: “Nuk do t’ju bëjë dobi të ikurit, nëse ikni prej vdekjes apo vrasjes. Edhe atëherë, ju do të kënaqeni vetëm për pak kohë!”³

Mosfrikësimi i besimtarëve nga vdekja dhe dëshira e ethshme e tyre për t’u martirizuar gjatë xhihazit në rrugën e Zotit ishte një nga faktorët kryesorë ndihmues të tyre, për të fituar nëpër luftëra dhe, si rrjedhojë, për përhapjen e shpejtë të Islamit nëpër botë.

2- Mposhtja e frikës nga varfëria

Kur’ani na ka këshilluar që të mos frikësohemi nga varfëria, sepse buka jonë e përditshme është në dorën e Zotit dhe se vetëm Ai është Rrëskdhënësi i Plotfuqishëm.

“Vërtet, Allahu është Furnizuesi i vetëm, i Fuqishmi, i Plotpushtetshmi.”⁴

“Në qiell është furnizimi juaj dhe gjithçka që ju është premtuar.”⁵

“S’ka asnjë gjallesë në Tokë që të mos i ketë mjetet e jetesës prej Tij. Ai di vendbanimin e saj dhe vendin e vdekjes. Të gjitha këto janë (të shënuara) në Librin e qartë.”⁶

“Sa krijesa ka që nuk e mbajnë dot veten me ushqim! Allahu u jep atyre dhe juve! Ai dëgjon dhe di gjithçka.”⁷

1. Sure “El-Ankebut”, ajeti 57.

2. Sure “En-Nisa”, ajeti 78.

3. Sure “El-Ahzab”, ajeti 16.

4. Sure “Edh-Dharijat”, ajeti 58.

5. Sure “Edh-Dharijat”, ajeti 22.

6. Sure “Hud”, ajeti 6.

7. Sure “El-Ankebut”, ajeti 60.

“Allahu, ia zgjeron furnizimin kujt të dojë nga robërit e Tij, e dikujt ia zvogëlon. Allahu është vërtet i Dijshëm për çdo gjë.”¹

“Bëgatitë, që Allahu ua jep njerëzve nga mëshira e Tij, nuk mund t’i pengojë askush, ndërsa atë, që Ai e pengon, askush nuk mund ta japë veç Tij; Ai është i Plotfuqishmi dhe i Urti. O njerëz! Kujtoni dhuntinë e Allahut për ju! A ka ndonjë krijues, veç Allahut, i cili ju furnizon nga qielli dhe Toka? S’ka zot tjetër të vërtetë përveç Tij. Atëherë, si po largoheni ju?”²

3- Mposhtja e zemërimit

Kur’ani na ka këshilluar për kontrollimin e zemërimit, sepse kur njeriu zemërohet, e humbet logjikën, nuk di se ç’bën dhe e humb aftësinë për të dhënë urdhra të drejtë. Gjithashtu, përgjatë zemërimit dhe përgjithësisht, ashtu siç edhe thamë më parë në kohën e frikës dhe të reagimeve të tjera, gjëndrat dhjamore mbi veshkë sekretojnë hormone adrenaline. Këto hormone ndikojnë mbi mëlçinë, duke bërë që mëlçia të sekretojë një sasi të madhe të substancave sheqerore.

Ky akt shkakton shtimin e fuqisë fizike të njeriut dhe e bën atë të aftë që, për të mbrojtur veten, të vërë në funksion fuqinë e nevojshme muskulore. Shtimi i fuqisë trupore në kohën e reagimit të zemërimit, bëhet shkak i gatishmërisë së njeriut në drejtim të agresionit fizik ndaj atij personi që e ka provokuar zemërimin. Prandaj, ja disa nga arsyet pse është i dobishëm kontrollimi i vetes në gjendje të zemëruar:

1. nëse e ruan fuqinë e vet mbi logjikimin e shëndoshë dhe mbi lëshimin e urdhrave të drejtë, njeriu nuk kryen ndonjë punë dhe nuk thotë ndonjë fjalë, që më pas të pendohet për të;
2. nëse e ruan ekuilibrin e tij trupor, njeriu nuk kaplohet nga dridhjet trupore që rrjedhin nga shtimi i fuqisë, e cila vjen si rezultat i shtimit të sekrecionit të lëndës sheqerore

1. Sure “El-Ankebut”, ajeti 62.

2. Sure “Fatir”, ajetet 2-3.

nëpërmjet mëlçisë dhe, në këtë mënyrë, distancohet nga veprimet zemërake, si agresioni fizik ndaj armikut, që ngjet shpesh në kohën e zemërimit;

3. njeriu ka në dorë kontrollin e gjendjes reaguese të zemërimit dhe të mosdhunimit, qoftë trupor apo me fjalë ndaj të tjerëve dhe vazhdimësinë e sjelljes së mirë, së bashku me qetësi ndaj të tjerëve. Rregullisht, ai bëhet shkak i krijimit të qetësisë tek të dyja palët dhe njëkohësisht e detyron atë të vijë në vete dhe të rifitojë qetësinë. Kjo çështje, padyshim rezulton me lindjen e dashamirësisë dhe miqësisë së njerëzve dhe përgjithësisht, ndihmon për marrëdhënie të mira tek ta;

“Nuk barazohet e mira me të keqen! Të keqen ktheje me të mirë e atëherë armiku yt do të të bëhet menjëherë mik i ngushtë.”¹

4. kontrolli i zemërimit është i dobishëm edhe në aspektin shëndetësor, sepse kjo punë, ashtu siç e theksuam më parë, e mban larg njeriun prej shumë sëmundjesh trupore, që zakonisht dalin në pah si rezultat i reagimeve të vazhdueshme.

Nga temat e mësipërme të kësaj çështjeje del në pah se pse i madhi Zot u kërkon njerëzve që të kenë nën kontroll fuqinë e tyre të zemërimit dhe të bëjnë lëshime ndaj gabimeve të të tjerëve. Zoti u ka premtuar shpërblim të madh personave që mposhtin zemërimin e tyre.

“Nxitoni drejt faljes së gjynaheve nga Zoti juaj dhe Xhenetit, hapësira e të cilit është sa qiejt e Toka dhe që është përgatitur për të devotshmit, të cilët japin lëmoshë edhe kur janë në mirëqenie, edhe kur janë në vështirësi, e mposhtin zemërimin dhe ua falin fajet njerëzve. Allahu i do bamirësit”²

“Çdo gjë që ju është dhënë juve, është vetëm kënaqësi në jetën e kësaj bote. Por shpërblimi i Allahut është më i mirë dhe më i përhershëm për ata që besojnë dhe mbështeten te Zoti i tyre; për ata që ruhen prej gjynaheve të mëdha e

1. Sure “Fussilet”, ajeti 34.

2. Sure “Ali Imran”, ajeti 133-134.

mbrapshtive dhe që, kur i zemëron dikush, falin.”¹

“Kushdo që duron dhe fal, ta dijë se, në të vërtetë, këto janë nga veprimet më të virtytshme.”²

“Shpërblimi për të keqen është i njëjtë me atë të keqe. Por, atë që fal dhe pajton, e pret shpërblimi i Allahut. Ai, në të vërtetë, nuk i do të padrejtët.”³

“Ne i kemi krijuar qiejt, Tokën dhe gjithçka që gjendet midis.”⁴

“Njerëzit e ndershëm dhe të pasur ndër ju të mos betohen se nuk do t’u japin të afërmve, të varfërve dhe të mërguarve në rrugën e Allahut; le t’i falin ata dhe të mos ua marrin për keq! Vallë, a nuk doni ju që t’ju falë Allahu? Allahu është Falës e Mëshirëplotë.”⁵

“Për shkak se ata e thyen besëlidhjen e tyre, Ne i mallkuam ata dhe ua bëmë zemrat të ashpra. Ata i kanë shtrembëruar fjalët e Shkrimeve të shenjta dhe kanë harruar një pjesë të mirë nga ato këshilla. Ti (Muhamed) përherë do ta vëresh tradhtinë e tyre, përveç një pakice të tyre; pra, falua fajet dhe mos i qorto! Se, Allahu i do bamirësit.”⁶

Fitimi që Kur’ani bën për “gëlltitjen” e zemërimit dhe faljen e njerëzve ka lënë gjurmë të pashlyeshme te myslimanët dhe ka përhapur tek ata moralin e bujarisë dhe të faljes. Këtu, si shembull, po rrëfejmë ndodhinë e Umer ibn Hatabit, kur një burrë i tha atij: “Ti nuk gjykon me drejtësi dhe nuk fal shumë.” Umeri, me t’i dëgjuar këto fjalë, u shndërrua dhe ky shndërrim iu shfaq plotësisht në fytyrë. Njëri nga të pranishmit i tha: “O prijës i besimtarëve, vallë a nuk e ke dëgjuar fjalën e të madhit Zot që thotë: **“Zgjidh udhën e faljes dhe bujarinë, urdhëro për punë të mira dhe ktheju shpinën njerëzve të paditur.”**” Umeri tha: “The të drejtën. Ky zemërim ishte si një zjarr që

1. Sure “Esh-Shura”, ajetet 36-37.

2. Sure “Esh-Shura”, ajeti 43.

3. Sure “Esh-Shura”, ajeti 40.

4. Sure “El-Hixhr”, ajeti 85.

5. Sure “En-Nur”, ajeti 22.

6. Sure “El-Maide”, ajeti 13.

7. Sure “El-A’raf”, ajeti 199.

tashmë është shuar.”¹

4- Vënia nën kontroll e reagimit të dashurisë

Kur'ani na këshillon që ta kemi nën kontroll dashurinë ndaj individëve të familjes, sikurse babai dhe bashkëshortja e fëmijët apo dashurinë ndaj miqve dhe njerëzve, atdheut, pasurisë dhe punës, që të mos na e heqin nga mendja dashurinë ndaj Zotit dhe të mos na pengojnë nga nënshtrimi ndaj Tij dhe xhihadi në rrugën e Tij.

“O besimtarë! Në të vërtetë, ju keni armiq në radhët e grave tuaja dhe të fëmijëve tuaj, andaj ruajuni prej tyre! Por, nëse nuk i vini re fyerjet e tyre dhe ua falni, ta dini se Allahu është vërtet Falës dhe Mëshirëplotë. Pasuria dhe fëmijët tuaj janë vetëm sprovë për ju. Allahu ka shpërblim të madh.”²

Thuaj: “Nëse etërit tuaj, bijtë tuaj, vëllezërit tuaj, gratë tuaja, farefisi juaj, pasuria juaj që e keni fituar, tregtia për të cilën keni frikë se nuk do të shkojë mirë dhe shtëpitë ku e ndieni veten rehat, janë më të dashura për ju sesa Allahu, i Dërguari i Tij dhe lufta në rrugën e Tij, atëherë pritni deri sa Allahu të sjellë vendimin (dënimin) e Tij. Allahu nuk e udhëzon në rrugën e drejtë popullin e pabindur.”³

Kur'ani thekson se dashuria e besimtarit për të madhin Zot është më e lartë se dashuria e tij ndaj njerëzve, madje edhe e personave të tij më të afërt, si babai dhe fëmija dhe të afërmit e miqtë. Sa herë që dashuria e besimtarit ndaj Zotit bie në konflikt me dashurinë e tij ndaj të gjithë këtyre individëve, besimtari padyshim do të zgjedhë dashurinë ndaj Zotit.

“Nuk gjen njerëz, që besojnë në Allahun dhe në Ditën e Fundit, që të ushqejnë dashuri ndaj atyre, të cilët

1. Muhamed Sadik Afifi, *El-Fikru'l-islamiji, mebadiuhu, menhexhuhu, kijmetuhu, akhlakijatuhu*, Kajro: Biblioteka El-Khanexhij, pa datë, f. 256.

2. Sure “Et-Tegabun”, ajetet 14-15. Kuptimi i thënies: “...Në të vërtetë, ju keni armiq në radhët e grave tuaja dhe të fëmijëve tuaj, andaj ruajuni prej tyre!...” është ky: Ju i doni ata dhe përpigjeni për plotësimin e kërkesave dhe dëshirave të tyre. Kjo mund t’ju pengojë t’i bindeni Zotit, prandaj jini të matur në sjelljet tuaja ndaj tyre.

3. Sure “Et-Teube”, ajeti 24.

kundërshtojnë Allahun dhe të Dërguarin e tij, edhe në qofshin ata etërit e tyre ose bijtë e tyre, ose vëllezërit e tyre, ose farefisi i tyre. Allahu ka skalitur besimin në zemrat e tyre dhe i ka fuqizuar ata me shpalljen e Vet. Ai do t'i shpjerë ata në kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj e ku do të qëndrojnë përgjithmonë. Allahu është i kënaqur me ata, por edhe ata do të jenë të kënaqur me Të. Ata janë Pala e Allahut dhe, vërtet që Pala e Allahut do të jetë fituese.”¹

Kur'ani, përreth mposhtjes që njeriu i bën dashurisë ndaj familjes dhe parapëlqimit të pjetës së peshores së dashurisë së Zotit kundrejt dashurisë ndaj familjes, ka sjellë si shembull historinë e Hazretit Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe të afërmeve të tij besimtarë.

“Shembull i mrekullueshëm për ju është Ibrahimimi dhe ata që kanë qenë me të, kur i thanë popullit të vet: “Ne shkëputemi nga ju dhe nga ato që ju i adhuron në vend të Allahut; ne ju mohojmë dhe armiqësia e urrejtja midis nesh është e përhershme, derisa të besoni tek Allahu Një dhe i Vetëm”. Përfundim (nga ky shembull) bën fjala e Ibrahimit për të atin: “Unë do të kërkoj falje për ty, por nuk kam kurrfarë mundësie për të të mbrojtur para Allahut. O Zoti ynë, tek Ti mbështetemi, Ty të drejtohem dhe tek Ti do të kthehem.”²

5- Mposhtja e reagimeve të tjera

Kur'ani na ka rekomanduar që të mos na pëlqejë vetja e të mos mbahemi me të madh. Më parë, teksa diskutonim rreth gjendjes reaguese të mendjemadhësisë dhe pëlqimit të vetes, përmendëm disa nga ajetet që flasin për pëlqimin e vetes, mendjemadhësinë dhe për dëshirën për të qenë në qendër të vëmendjes. Gjithashtu, Kur'ani na ka rekomanduar që të kontrollojmë secilin nga reagimet e pikëllimit dhe të gëzimit.

Ne nuk duhet të shfaqim pikëllim më shumë se masa, lidhur me fatkeqësitë dhe ngjarjet hidhëruese që ndodhin

1. Sure “El-Muxhadile”, ajeti 22.

2. Sure “El-Mumtehine”, ajeti 4.

në jetë, për vetë ne apo bijtë, zotërimet apo pasuritë tona, ashtu siç nuk duhet ta zmadhojmë me shfaqjen e gëzimit për mirësinë dhe begatinë që na vjen apo suksesin, përparësinë, famën apo pozitën që fitojmë dhe të hidhemi kah pëlqimi i vetes, mendjemadhësia dhe mburrja. Sepse, si bezdisja dhe fatkeqësia, apo si mirësia dhe begatia, të cilat na vijnë, janë shkruar në Tabelën e Ruajtur (*Leuhi Mahfûdh*).

Para se ato të na ndodhnin, kanë qenë të fiksuara në dijen e Zotit dhe se pikëllimi ynë nuk ka kurrfarë dobie dhe ndikimi në ndryshimin e ngjarjes apo tjetërsimin e rezultateve të tij. Ashtu sikurse lumturia dhe mburrja jonë, gjithashtu, nuk e shtojnë gjë mirësinë dhe begatinë apo nuk e ruajnë dot atë nga venitja dhe shkatërrimi, sepse gjëra të këtij lloji, janë vetëm në dijen e të madhit Zot dhe varen nga vullneti dhe dashja e Tij.

“S’ka fatkeqësi që godet tokën dhe ju, që të mos jetë e shënuar në Libër (Leuhi Mahfûdh) më parë se ta krijojmë atë. Kjo për Allahun është vërtet e lehtë! (Këtë paracaktim e kemi bërë) që ju të mos dëshpëroheni për atë që ju ka kaluar, por edhe për të mos u gëzuar së tepërmi për atë që Ai ju ka dhënë. Allahu nuk i do kryelartët mburravecë.”¹

Në mënyrë tërësore, Zoti na rekomandon për të kontrolluar gjendjet reaguese dhe për t’i pasur nën sundim ato. Besimi i vërtetë në Zot dhe ndjekja e ligjit të Tij, që është shkruar në Kur’an dhe që Profeti i nderuar (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e ka sqaruar atë për ne, na jep vullnet dhe vendosmëri, që të mund t’i vëmë nën kontroll reagimet tona.

Parimisht, besimtari i vërtetë, përveçse nga Zoti, nuk trembet nga asgjë tjetër, sikurse vdekja, varfëria, njerëzit apo çdo gjë tjetër në gjithësi. Ai e “gëlltit” zemërimin, nuk nxehet e nuk zemërohet për hiçgjë. Ai zemërohet në kuadrin e zemërimit për Zotin. Gjithashtu, besimtari e ka nën kontroll pikëllimin, sepse e di që atij nuk i vjen kurrë ndonjë fatkeqësi, përveç asaj që ka caktuar Zoti. Ai është i përlur, sepse e njeh nivelin e vlerës së tij të vërtetë dhe, për këtë arsye, nuk mburret

1. Sure “El-Hadid”, ajetet 22-23.

dhe nuk shfaq mendjemadhësi.

Në Kur'an kanë ardhur shumë ajete që nxjerrin në pah se besimi te Zoti është si një mburojë kundër frikës dhe e shëron atë. Ne, në kapitullin e dhjetë, që lidhet me studimin e **“Psikoterapisë nga pikëpamja kur'anore”**, do t'i kthehemi kësaj çështjeje dhe do ta trajtojmë atë.

KREU I TRETË

Perceptimet shqisore në Kur'an

I madhi Zot ka dëshiruar që t'i vërë në shërbim të njeriut dhe të kafshës të gjitha mundësitë dhe mjetet e domosdoshme jetike dhe të mbijetesës. Në këtë drejtim, përveç motiveve dhe reagimeve, i ka pajisur ata me disa mjete, që me to të perceptojnë botën e jashtme, ngjarjet e ndryshme, si dhe botën e tyre të brendshme dhe ndryshimet e përfutuara në të. Perceptimet shqisore kryejnë një detyrë të rëndësishme në jetë, sepse krijesa e gjallë, nëpërmjet tyre, njeh gjërat që mund ta dëmtojnë dhe largohet prej tyre, duke u përpjekur të shtjerë në dorë atë që e quan të dobishme.

Ne e perceptojmë botën e jashtme me shqisa të dukshme. Ato janë: të dëgjuarit, të shikuarit, të nuhaturit, të shijuarit dhe të prekurit. Nëpërmjet ndjesisë së brendshme zbulojmë kontradiktat që ndodhin në balancën organike dhe kimike të trupit, si uria dhe etja. Këto perceptime bëhen shkak që njeriu të ndërmarrë një sjellje në përpjesëtim me kushtet e mjedisit të jashtëm apo për të parandaluar mosfunksionimin e indeve trupore dhe rikthimin e tyre në gjendjen e mëparshme të ekuilibrit organik dhe kimik.

Perceptimet shqisore janë të përbashkëta te kafsha dhe njeriu. Mirëpo i madhi Zot ka dhënë për njeriun një tjetër fuqi të rëndësishme perceptuese, që nëpërmjet saj dallohet nga qeniet e tjera. Kjo fuqi është arsyeja me të cilën njeriu mund të shkojë përtej cakut të perceptimit të gjërave të ndjeshme dhe të mendojë për kuptime abstrakte, si: e mira, e keqja, virtyti, e vërteta, e kota etj., si dhe, me vëzhgimet dhe eksperimentet e veta, të argumentojë për konstatimin e parimeve të përgjithshme; për shembull, njeriu, me ndihmën e arsyes mund të argumentojë për krijimin mahnitës të të gjithë universit ose për krijimin e vetes dhe për ekzistencën e të madhit Zot.

“Ne do t’u tregojmë atyre shenjat Tona në hapësirat

tokësore e qiellore, si dhe në vetvete, derisa t'u bëhet plotësisht e qartë se ai (Kur'ani) është e vërteta. Vallë, a nuk të mjafton ty, që Zoti yt është Dëshmues i çdo gjëje?!¹

Mirëpo, me gjithë këtë fuqi mendore, prapëseprapë njeriu është i kufizuar në fushën e perceptimeve dhe të njohjes. Nga ana tjetër, mendimi i tij gjendet gjithnjë i eksploruar ndaj gabimeve, sepse nganjëherë dalin disa kushte të veçanta, të cilat e pengojnë njeriun të mendojë drejt. Në këtë situatë, ai ka nevojë që ta mësojë dhe ta udhëheqë përpara dikush. Prandaj i madhi Zot ka dërguar lajmëtarë dhe Profetin e fundit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe i ka zbritur njerëzimit libra të shenjtë qiellorë, me qëllim që ta udhëzojë në atë që është në të mirë dhe në interes të tij.

“Çdo populli Ne i çuam një të dërguar (që u thoshte): “Adhuroni Allahun dhe shmangni idhujt!” Disa prej tyre Allahu i shpuri në rrugë të drejtë e disa e merituan të mbeten në humbje. Andaj, udhëtoni nëpër botë të shihni se si ishte fundi i përgënjeshtresve!”²

“Ne të kemi dërguar ty me të Vërtetën, për të sjellë lajme të mira dhe për të paralajmëruar; nuk ka pasur asnjë popull që të mos i ketë ardhur paralajmërues.”³

“Po kështu, (për të plotësuar mirësinë Time ndaj jush) ju kam sjellë një të dërguar, nga mesi juaj, i cili ju lexon shpalljet Tona, ju pastron (nga gjynahet), ju mëson Librin (Kur'anin) e Urtësinë (rregullat e fesë) dhe ju mëson ato gjëra që ju nuk i keni ditur.”⁴

Prandaj, pesë shqisat dhe arsyeja janë mjetet prej të cilave njeriu ndihmohet prej tyre në fushën e perceptimeve dhe të njohjes. Mirëpo, në shumë çështje, ato nuk janë të mjaftueshme për të arritur në njohjen e vërtetë. Për shembull, ato nuk ka se si të jenë të afta për njohjen e çështjeve të fshehta (që i përkasin *gajbit*), që njeriu nuk mund t'i perceptojë me shqisa dhe arsye. Për këtë arsye, është e domosdoshme që njeriu të përfitojë

1. Sure “Fussilet”, ajeti 53.

2. Sure “En-Nahl”, ajeti 36.

3. Sure “El-Fatir”, ajeti 24.

4. Sure “El-Bekare”, ajeti 151.

njohjen nga Zoti, që ta rregullojë jetën e tij tokësore në mënyrë të atillë, që të jetë garantuese e realizimit të lumturisë së tij në këtë botë dhe në Botën Tjetër.

Njeriu e merr këtë njohje të Zotit përmes Profetëve apo nëpërmjet frymëzimit hyjnor, që Zoti e ka bërë të veçantë ndaj disa prej shenjtorëve të Tij. Ne, në këtë kapitull, do të përpiqemi që të trajtojmë temën “Perceptimet shqisore në Kur'an”, ndërsa në kapitujt e tjerë do të trajtojmë fjalën rreth të menduarit dhe njohjes hyjnore, të cilën njeriu e përfiton nëpërmjet shpalljes dhe frymëzimit nga Zoti.

A- Perceptimet në Kur'an

Foshnja kur lind nuk di asgjë. Nuk kalon shumë dhe shqisat e saj zënë të kryejnë detyrat, sepse foshnja ndien efektin e faktorëve të jashtëm, të cilët e prekin atë. Këta faktorë shkaktojnë ndjesi të ndryshme tek ai, që më pas formojnë bazën dhe themelin e perceptimeve dhe të njohjes së botës së jashtme. Kur'ani Fisnik ka vënë theksin ndaj këtij realiteti në shumë prej ajeteve të tij. Si shembull po përmendim ajetet e mëposhtme:

“Allahu ju ka nxjerrë nga barku i nënave tuaja e ju nuk dinit asgjë dhe ju dha të dëgjuarit, të parët dhe zemrat, që të jeni falënderues.”¹

“A po kërkon shpërblim prej tyre? Shpërblimi i Zotit tënd është më i mirë. Ai është më i miri i furnizuesve.”²

Thuaju: “Është Ai që ju ka krijuar dhe ju ka dhënë dëgjimin, shikimin dhe zemrat, e megjithatë ju pak e falënderoni!”³

“Së cilës pastaj i dha trajtë dhe i fryu shpirtin e krijuar prej Tij. Ai ju ka dhënë dëgjimin, shikimin dhe zemrën, por pak prej jush janë mirënjohës.”⁴

Kur'ani është mjaftuar me përmendjen e veshit dhe të syrit,

1. Sure “En-Nahl”, ajeti 78.

2. Sure “El-Mu'minun”, ajeti 78.

3. Sure “El-Mulk”, ajeti 23.

4. Sure “Es-Sexhde”, ajeti 9.

si dy instrumente shqisore, sepse, pikë së pari, këto dy shqisa kanë rëndësi të madhe në rrjedhën e punës së perceptimeve shqisore. Së dyti, në përmendjen e tyre ekzistojnë çështje që janë të mjaftueshme për tregimin e rëndësisë së të gjitha shqisave në funksionimin e perceptimeve shqisore. Kjo gjë është një nga veçoritë e metodës kur'anore dhe tipari dallues i saj është lakonizmi elokuent.

Gjatë tij, Kur'ani mjaftohet me përmendjen e të vërtetave të përgjithshme bazë dhe nuk përmend detajet, sepse Kur'ani nuk është libër shkencor, por libër udhëzimi për njerëzit. Në këtë drejtim provohet se Zoti, duke i dhuruar njeriut instrumente të perceptimit shqisor, i ka favorizuar ata. Këtu, pra, është e mjaftueshme të theksojmë vetëm syrin dhe veshin. Në shumë prej ajeteve kur'anore, veshi është përmendur para syrit. Ja disa prej argumenteve:

1- Veshi është më i rëndësishëm se syri në funksionin e perceptimeve shqisore, në çështjen e nxënies dhe të studimit të dijeve. Mësimi i gjuhës dhe studimi i dijeve është i mundshëm për njeriun, edhe në rast të humbjes së shikimit. Mirëpo, nëse e humbet dëgjimin, mësimi i gjuhës dhe studimi i dijes do të ishte një punë e vështirë për të.

Një nga argumentet për rëndësinë e shqisës së të dëgjuarit për mësimin e gjuhës, është se edhe gjuha është një nga instrumentet më të rëndësishme të të menduarit dhe të mësimin të diturisë. Kur'ani e ka përmendur atë vetëm përkrah mendjes (arsyes), që lë të kuptosh se midis veshit dhe mendjes ekziston një lidhje e ngushtë.

Ata do të thonë: "Sikur të kishim dëgjuar ose menduar, nuk do të ishim midis banorëve të Zjarrit Flakërues!"¹

Gjithashtu, në shumë prej ajeteve kur'anore, *sem'un* – dëgjimi, përmendet me domethënien e kuptimit, e planifikimit dhe e meditimit.

"O Zoti Ynë! Ne dëgjuam një thirrës që na ftonte në besim: "Besoni Zotin tuaj!" Dhe kështu besuam. O Zoti Ynë! Na i fal gjynahet tona, na i shlyej gabimet dhe bëna që të

1. Sure "El-Mulk", ajeti 10.

vdesim me të mirët!”¹

“Ndërsa përgjigja e vetme e besimtarëve, kur thirren tek Allahu dhe i Dërguari i Tij, që ai të gjykojë midis tyre, është: “Dëgjojmë dhe bindemi.” Pikërisht këta janë të shpëtuarit.”²

“Posa dëgjuam udhëzimin (Kur'anin), Ne besuam në të; e kush beson në Zotin e vet, nuk ka përse të frikësohet se mos dëmtohet, as se mos i bëhet padrejtësi.”³

“Kur dëgjojnë për atë (Kur'anin) që i është zbritur të Dërguarit, i sheh se si u rrjedhin lotët nga sytë, për shkak të së vërtetës që kuptuan. Ata thonë: “O Zoti ynë! Ne besojmë, prandaj na llogarit ndër dëshmitarët e Tu!”⁴

“A nuk është e qartë për ata që trashëguan tokën e banorëve të mëparshëm të saj, se, nëse Ne dëshirojmë, i dënojmë për gjynahet e tyre dhe ua vulosim zemrat, që të mos dëgjojnë?!”⁵

2- Shqisa e të dëgjuarit merr funksion menjëherë pasi lind, sepse foshnja, sapo lind, mund të dëgjojë zëra, ndërkohë, që për të shikuar sendet ka nevojë për njëfarë periudhe.⁶

3- Shqisa e të dëgjuarit e kryen detyrën e vet gjithnjë e pa ndalim, ndërkohë që shqisa e të parit nganjëherë ndalet nga të kryerit e detyrës, si për shembull, në kohën kur njeriu i mbyll sytë apo kur fle gjumë. Mirëpo, një zë i fortë mund ta zgjojë njeriun nga gjumi. Për këtë arsye, i madhi Zot, në tregimin e As'habi Kehfit, ka përmendur se atyre ua vulosën veshët që të zhyteshin në gjumë të thellë dhe të mos mund t'i zgjojë dot asnjë zë.

1. Sure “Ali Imran”, ajeti 193.

2. Sure “En-Nur”, ajeti 51.

3. Sure “El-Xhin”, ajeti 13.

4. Sure “El-Maide”, ajeti 83.

5. Sure “El-A'raf”, ajeti 100.

6. Kërkimet e reja fiziologjike kanë provuar se foshnja reagon ndaj zërave të lartë, ndërsa qëndron indiferent ndaj zërave të ulët e të dobët. Këto kërkime kanë vërtetuar gjithashtu se deri në muajin e gjashtë të lindjes, format e sendeve nuk shfaqen të qarta te sytë e foshnjave, sepse zhvillimi i ndërtimit të rrjetit të syrit, bëhet plotësisht vetëm në fundin e gjashtë muajve të parë të lindjes. Ne, në vijim, do të flasim rreth kësaj çështjeje, kur të trajtojmë temën “Zhvillimi në Kur'an”, në kapitullin e nëntë, që lidhet me temën e “Personalitetit”.

“Ne ua mbyllëm veshët atyre (duke i lënë të flinin) në shpellë për shumë vjet.”¹

4- Shqisa e dëgjimit (veshi) dëgjon në çdo kohë, si në dritë e në errësirë, ndërsa shqisa e të parit (syrit) sheh vetëm në dritë.² Këtu nuk është e pavend përmendja e një pike: Kur'ani e përmend veshin në numrin njëjës, ndërsa syrin (të shikuarit) në pjesën më të madhe të ajeteve e përmend në numrin shumës *ebsaar*- të shikuarit. Vetë kjo është një nga treguesit e mrekullisë së metodës kur'anore. Por shqisa e të dëgjuarit i percepton zërat ngado që vijnë, ndërkohë që syri mund të shikojë vetëm në kohën kur njeriu dëshiron t'i hedhë sytë drejt asaj që kërkon të shikojë.³

Nëse në një vend do të jenë mbledhur individë dhe dëgjohej ndonjë zë, pothuajse të gjithë e dëgjojnë atë zë në të njëjtën kohë, ndërkohë që po ky numër individësh e shikon një gjë në kënde të ndryshme. Ashtu siç ka mundësi që ata, në atë moment, teksa përqendrohen drejt asaj që duan të shohin, vërejnë edhe gjëra të tjera të ndryshme.

Përveç kësaj, sa herë që nga ndonjë vend vjen drejt nesh ndonjë zë, valët zanore të tij arrijnë në të njëjtën kohë te të dy veshët dhe intensiteti i efektit të tij është i njëjtë mbi cipën e daulles së të dy veshëve.

Por, nëse do të vështrojmë diçka që gjendet përballë nesh, forma që projektohet prej saj në rrjetën e syrit të djathtë është e ndryshme nga forma e asaj gjëje që projektohet në rrjetin e syrit të majtë, sepse syri i djathtë i sheh gjërat nga ana e djathtë e tyre, ndërkohë që syri i majtë i sheh gjërat nga ana e majtë.⁴

1. Sure “El-Kehf”, ajeti 11.

2. Muhamed Muteuel’li Esh-Sha’raui, *Mu’xhizetu’l-Kur’an*, vëll. 1, Kajro: “Kitabu’l-Jeum”, 1980, f. 95-98.

3. Muhamed Ismail Ibrahim, *El-Kur’an ue i’xhazuhu’l-ilmi*, Kajro: Daru’l-Fikri’l-Arabi: 1977, f. 108-111, Muhamed Muteuel’li Esh-Sha’raui, *Mu’xhizetu’l-Kur’an*, f. 95-98.

4. Muhamed Uthman Nexhati, *Ilmu’n-nefs fi hajatina’l-jeumijeh*, f. 300-302. Sa herë që shihni gjërat që keni përballë, ju do mund të vini re dallimin midis (shikimit) të dy syve tuaj. Fillimisht, vini duart tuaja mbi syrin e djathtë e pastaj mbi syrin e majtë. Në këtë mënyrë do të vini re se sendet që gjenden përpara jush lëvizin sa në të djathtë, në të majtë. Kjo ndodh sepse

Shqisa e të prekurit

Kërkimet e reja fiziologjike kanë provuar se në lëkurën e njeriut gjenden qeliza të shumta ndjesore në forma të ndryshme, ku çdo grup përgjigjet për lloje të përcaktuara ndjesish. Për shembull, disa nga ato ndiejnë të nxehtin, ndërsa disa të ftohtin, një pjesë e tyre janë për prekjen e sendeve dhe për ndjenjën e trysnisë mbi lëkurë, disa gjithashtu ndiejnë dhembjen. Kur'ani, në ajetin e mëposhtëm, thekson ekzistencën e organeve ndjesore, që janë të veçanta për ndjenjën e dhembjes mbi lëkurën e trupit: **“Ata që s’besojnë në shenjat Tona, Ne padyshim, do t’i djegim në zjarr. Sapo t’u digjet lëkura, Ne do t’ua ndërrojmë atë me lëkurë tjetër, për të përjetuar dënimin. Me të vërtetë, Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë.”**¹

Ky ajet, ashtu siç kanë provuar kërkimet e reja fiziologjike, e vë theksin mbi ekzistencën e qelizave ndjesore në lëkurë, që janë të posaçme për ndjenjën e dhembjes. Nëse digjet lëkura e trupit, këto qeliza asgjësohen, njeriu nuk do të ndiejë më dhembje dhe, për këtë arsye, i madhi Zot krijon qeliza të reja ndjesore në lëkurën e djegur, me qëllim që të ndiejnë gjithnjë dhembje në zjarrin e Xhehenemit.

Kur'ani, gjithashtu, vë theksin në shqisën e të prekurit, si një instrument me të cilin njeriu ndihmohet në njohjen e sendeve. **“Sikur Ne të të zbritnim ty një Libër të shkruar në letër e ata ta preknin me duart e tyre, jobesimtarët me siguri që do të thoshin: “Kjo s’është gjë tjetër, veçse një magji e hapur.”**²

B- Perceptimet shqisore jashtë kornizës së shqisave

në kohën që i vendosni duart mbi syrin tuaj të djathtë, shikoni vetëm anën e majtë të asaj gjëje dhe pastaj, kur vini duart mbi syrin e majtë, fshihet ana e majtë e atij sendi dhe ju shihni anën e djathtë. Prandaj, të duket sikur ai send lëviz sa në të djathtë në të majtë. Kurse, për sa i përket zërit që ju vjen drejtpërsëdrejti përballë jush, ndikon njëkohësisht dhe në mënyrë të barabartë mbi të dy veshët tuaj. Nëse zëri vjen nga ana juaj e djathtë apo e majtë, valët e zërit arrijnë më shpejt në veshin që gjendet në anën e origjinës së zërit sesa në veshin tjetër. Mirëpo kjo diferencë kohore është tepër e papërfillshme.

1. Sure “En-Nisa”, ajeti 56.

2. Sure “El-En’am”, ajeti 7.

(Perceptimet mbishqisore)

Gjithashtu, ekzistojnë edhe lloje të tjera perceptimesh shqisore të jashtëzakonshme, të cilat psikologët i kanë quajtur “Perceptimet mbishqisore”, sikurse “zbulimi dhe shquarja”. Këto shqisa përbëhen nga shikimi i sendeve apo i ngjarjeve të largëta, që ngjajnë jashtë kufirit të shqisës së të shikuarit.

Telepatia përbëhet nga perceptimi i mendimeve që i kalojnë nëpër kokë individit tjetër dhe që shpesh është në një vend të largët, ose ndjenja e të dëgjuarit, që përbëhet nga dëgjimi i zërit apo e diçkaje tjetër, nga një vend i largët, i cili është larg kufirit të shqisës së të dëgjuarit. Disa nga psikologët bashkëkohorë që janë përpjekur t’i studiojnë këto dukuri, kanë kryer eksperimente të shumta për to, por nuk kanë arritur rezultate aq të sakta dhe të qëndrueshme, që të mund të na ndihmojnë në konceptimin pa mëdyshje të tyre.

Këto lloj perceptimesh mbishqisore nuk i kanë të gjithë njerëzit; vetëm disa individë e gëzojnë këtë dhunti të veçantë. Kjo dhunti përbëhet nga një lloj transparence dhe paqeje shpirtërore që lidhet me një fuqi perceptuese të jashtëzakonshme, që njeriu mund të kapërcejë kufijtë e vendit dhe të perceptojë sendet dhe ngjarjet larg vetes ose ngjarjet që janë fokusuar diku por që nuk mund të perceptohen menjëherë për shkak të pengesave.

Kur’ani, si shembull për këto lloj perceptimesh shqisore të mbinatyrshme, ka përmendur ngjarjen e Hazretit Jakub (*Paqja qoftë mbi të!*). Ai ndien aromën e të birit, Jusufit (*Paqja qoftë mbi të!*), në kohën që karvani mbante këmishën e Jusufit, kur u nis nga territori i Egjiptit dhe kur kishte edhe disa ditë rrugë deri te banesa e tij.

“Kur karvani u largua nga vendi (Egjipti), babai i tyre tha: “Unë, me të vërtetë, po ndiej erën e Jusufit, ndonëse ju mund të më quani matuf.”¹

Nuhatja e aromës së Jusufit (*Paqja qoftë mbi të!*) nga ana e Jakubit (*Paqja qoftë mbi të!*) nga një largësi kaq e madhe, e vë

1. Sure “Jusuf”, ajeti 94.

theksin mbi dukurinë e perceptimit shqisor jashtë kornizës së shqisave. Njëra nga mrekullitë e Hazretit Isa (*Paqja qoftë mbi të!*), për të cilën na ka lajmëruar Kur'ani, është kur u thoshte njerëzve se ç'lloj gjellësh hanë nëpër shtëpitë e tyre dhe se ç'gjëra po ruanin:

"...ju tregoj çfarë hani dhe çfarë ruani në shtëpitë tuaja..."¹

Ka mundësi që kjo lloj mrekullie të jetë një lloj zbulimi dhe shquarjeje, që Zoti e bëri vetëm për Profetin e Vet, Isain (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe i fali atij aftësinë e perceptimit të gjërave të pashikueshme dhe që janë jashtë kufirit të shqisës së të parit.

Gjithashtu, ka mundësi që kjo gjë të jetë një lloj frymëzimi nga Zoti. Nëpër librat e hadithet e historisë së jetës së sahabëve (shokëve) të Profetit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe gjithashtu, historisë së Tasavufit (Gnosticizmit) hasen shembuj të perceptimeve shqisore jashtë kufirit të shqisave, të cilin sufijtë e quajnë "zbulim".

Muslimi transmeton nga Profeti i Nderuar (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*): Kryejini në mënyrë të plotë rukutë (përkuljet) dhe sexhdet (rëniet me ballë në tokë) tuaja. Pasha Zotin, që unë ju shikoj nga prapa kur ju bini në ruku dhe sexhde.²

Gjithashtu, Buhariu transmeton se Profeti i nderuar (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: Vallë, a shikoni se si unë këtu kam marrë drejtim nga kibla? Edhe ju veproni kështu, sepse, pasha Zotin, mua nuk më mbeten të fshehura as mirësjellja dhe as prania e zemrës tuaj; as rukuja juaj në namaz (përkulja juaj në falje), sepse unë ju shikoj, megjithëse jeni mbrapa meje.³

E kjo që Profeti i nderuar (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), sheh shokët duke qenë prapa shpinës së tij, është një shembull mbi gjendjen e zbulimit, sepse Profeti mund t'i

1. Sure "Ali Imran", ajeti 49.

2. Kitabu's-Salat, vëll. 3, f. 150. *Sahih Muslim* me komentim të Neveviut, Kajro, El-Matbaatu'l-Misrijetu ue mektebetuha, pa datë.

3. Kitabu's-Salat, hadithi nr. 418. *Fet'hu'l-Barij fi sherhi Sahih'i'l-Buharij*, vëll. 3, f. 74, Kajro, Mektebetu'l-kulijjati'l-ez'herije, 1978.

shquante gjërat që nuk janë në kufijtë e shqisës së të parit, në saje të paqes së zemrës dhe transparencës së shpirtit të tij.

Një ditë, teksa Profeti i nderuar (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ishte në shoqërinë e disa shokëve, i ra të kalojë anash dy varreve në varrezën Baki, ku sapo ishin varrosur dy vetë. Ai qëndroi dhe tha: “Cilët persona keni varrosur sot këtu?” Shoqëruesit u përgjigjën: “Filanin dhe fistekun. O i Dërguari i Zotit, çfarë kishe për qëllim me këtë pyetje?” Profeti tha: “Njëri nga këta të dy nuk e pastronte veten nga urina dhe tjetri merrej me thashetheme.” Atë çast mori një degë nga pema e hurmës dhe e ndau në dy pjesë. Çdo pjesë e vendosi mbi secilin varr. I thanë: “O i Dërguari i Zotit, pse e bërë këtë veprim?” I Dërguari i Allahut u përgjigj: “Që t’u pakësohet dënimi.” Thanë: “O i Dërguari i Zotit, deri kur do të jenë duke vuajtur ata?” Tha: “Kjo është një çështje që i përket Gajbit (të fshehtës), të cilën e di vetëm Zoti. Nëse nuk do të ishin epushet e zemrës suaj dhe lllomotitjet tuaja të shumta, edhe ju do të dëgjonit atë që dëgjoj unë.”¹

Vetë kjo fjali e fundit tregon se Profeti (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dëgjoi gjëra që shokët e tij nuk mundën t’i dëgjonin. Kjo çështje është argument se, nëse njeriu ka mundësi ta pastrojë dhe ta kullojë zemrën nga mbeturinat dhe ndyrësitë e kësaj bote, nëse ndal së lllomotituri së koti, fiton fuqi, saqë dëgjon ato që nuk mund të dëgjohen në gjendje normale.

Po ashtu, në një hadith tjetër, ka ardhur se Handhaleh ibn Rebi’ El-Usejdi, njëri prej shkruesve të Profetit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i tha atij: “Kur ne jemi pranë teje, ti na e bën aq të gjallë kujtimin e Ferrit dhe të Parajsës, saqë na duket sikur i shikojmë. Por, kur largohemi prej teje, ne na mbyet mendimi për gruan, fëmijët dhe pasurinë e kësaj bote dhe harrojmë shumë nga ato çështje”. Profeti tha: “Pasha Atë, në dorën e të Cilit është shpirti im! Nëse do të vazhdonit jetën në të njëjtën gjendje që jeni pranë meje, duke bërë dhikër e duke kujtuar Zotin, engjëjt madje do t’ju vinin në shtrat dhe nëpër kryet

1. Përmendur nga Said Haa, Terbijetuna’r-Ruhijeh, bot. 2, Kajro, Mektebetu Uehbeh, 1979, f. 151.

e udhëve tuaja për t'ju takuar. Por, o Handhale, njeriu orë për orë ndryshon tri herë." Muslimi dhe Tirmidhiu e kanë transmetuar këtë hadith në kapitullin "Er-Rekaik"¹

Ky hadith na kallëzon këtë gjë: Nëse sahabët do të vazhdonin të kishin po atë gjendje paqeje të zemrës, pastërtie të shpirtit dhe kujtese ndaj Zotit, ashtu si në prani të Profetit, kishte mundësi të shikonin edhe engjëjt.

C- Gabimi i syrit

Defekti i syrit është një lloj perceptimi i gabuar i shikimit, i cili nuk përputhet me realitetin e sendit të shikuar. Disa prej gabimeve të syrit ekzistojnë te të gjithë njerëzit. Të gjithë i perceptojnë ato në mënyrë të ngjashme.²

Një nga shembujt e këtyre lloj gabimeve është shikimi i mirazhit ose i vegimit, që u ndodh nganjëherë njerëzve, domethënë, shikojnë së largu ndonjë vegim dhe pandehim se është ujë. Kur'ani e ka përmendur vegimin, aty ku ilustron kotësinë e punëve të mira të qafirëve dhe përkujton që këto punë në Ditën e Kiametit do të jenë të pafrytshme, sikurse pluhuri i shpërndarë në ajër, i njëjtë me mirazhin e njeriut të etur.

"Sa për ata që nuk besojnë, veprat e tyre janë si mirazhi në shkretëtirë, të cilin i etshmi e kujton për ujë, por, kur arrin tek ai vend, nuk gjen asgjë. Aty do të hasë në dënimin e Allahut, i Cili ia paguan llogarinë e tij të plotë, se Allahu është i shpejtë në llogari."³

Ç- Ndikimi i motiveve dhe i vlerave në vëmendjen dhe perceptimet shqisore

Motivet dhe vlerat e individit ndikojnë tek informimi dhe te perceptimet e tij. Rezultati i mjaft prej kërkimeve të reja eksperimentale e ka pranuar këtë çështje.⁴

1. *Terbijetuna'r-Ruhijeh*, f. 151.

2. Muhamed Uthman Nexhati, *Ilmu'n-nefs fi hajatina'l-jeumijeh*, f. 286-287.

3. Sure "En-Nur", ajeti 39.

4. Muhamed Uthman Nexhati, *Ilmu'n-nefs fi hajatina'l-jeumijeh*, f. 289, 293.

Kur'ani ka vënë theksin në disa raste për këtë realitet, duke na kujtuar se si besimi bëhet shkak që besimtarët, duke qenë të gatshëm dhe duke pasur vëmendjen ndaj ajeteve kur'anore, drejtohen nga ana e Zotit, i vënë veshin, i perceptojnë dhe i kuptojnë qartë mësimet që rrjedhin prej ajeteve.

Ndërkohë, që po këto ajete nuk kanë asnjë ndikim te politeistët dhe se ata janë të shkujdesur ndaj kuptimeve të tyre. Ne më poshtë do të përmendim shembuj prej ajeteve kur'anore, që flasin për mënyrën e perceptimit të këtyre ajeteve te politeistët. Këto ajete tregojnë se shkak i kësaj mosvëmendjeje është *shirku* (të përshkruarit shok Zotit) dhe mospasja e besimit, e cila është sharmi i paaftësisë të shqisave të politeistëve për kryerjen e detyrës.

“Ne kemi paracaktuar për Xhehenemin shumë xhinde dhe njerëz, sepse ata kanë zemra, por nuk kuptojnë, kanë sy, por nuk shohin dhe kanë veshë, por nuk dëgjojnë. Ata janë si bagëtitë, madje edhe më zi. Pikërisht këta janë të shkujdesurit.”¹

“Sikur ta kishim shpallur Kur'anin në një gjuhë tjetër, ata do të thoshin: “Ah, sikur vargjet e tij të ishin të kuptueshme! Vallë, pse të jetë në një gjuhë të huaj, ndërkohë që ai është arab?! Thuaj: “Ai është udhërrëfyes dhe shërim për besimtarët”. Por ata që nuk besojnë, janë të shurdhër dhe të verbër, njësoj si të thirreshin prej vendeve të largëta.”²

“Këta janë ata, të cilët Allahu i ka mallkuar, i ka bërë të shurdhër dhe ua ka verbuar shikimin.”³

“Vallë, a mos ti do të bësh të dëgjojë i shurdhëri dhe të udhëzosh të verbrin dhe atë që është në humbje të qartë?”⁴

“Rasti i tyre shëmbëllen me rastin e atyre që ndezin një zjarr dhe, kur ai ua ndriçon ç'kanë rreth vetes, Allahu ua

1. Sure “El-A'raf”, ajeti 179.

2. Sure “Fussilet”, ajeti 44. Ibn Kethiri, në komentimin e frazës **“thirreshin prej vendeve të largëta”**, thotë: Muxhahidi ka thënë: “Vend i largët, domethënë larg zemrave të tyre.” Edhe Ibn Xheriri thotë: “Kuptimi i vendit të largët është ky, që ngjan se ai që u drejtohet atyre, i thërret ata nga një vend i largët dhe nuk ia kuptojnë fjalët.” *Tefsiri Ibn Kethir*, vëll. 4, f. 103.

3. Sure “Muhamed”, ajeti 23.

4. Sure “Ez-Zuhruf”, ajeti 40.

merr dritën, i lë në errësirë dhe ata nuk shohin asgjë! Ata janë të shurdhër, memecë e të verbër, prandaj kthehen në rrugë të drejtë.”¹

“Ata që i mohojnë shpalljet Tona janë shurdhë e memecë, janë në errësirë. Allahu shpie në humbje kë të dojë dhe udhëzon në rrugë të drejtë kë të dojë.”²

“Mendo pak! Kush, përveç Allahut, mund ta udhëzojë atë njeri, që dëshirat e veta i ka bërë zot; atë njeri, të cilin Allahu, duke e njohur për të tillë, e ka shpënë në humbje, duke ia vulosur dëgjimin dhe zemrën e duke i vënë perde para syve të tij?! A nuk po merrni vesh?”³

“Ti nuk mundesh t’i nxjerrësh as të verbrit nga humbja e tyre! Ty të dëgjojnë vetëm ata që besojnë Shpalljet Tona dhe na nënshtrohen Ne (si myslimanë). Dhe, kur të përmbushet Fjala Jonë kundër tyre, Ne do të bëjmë që nga Toka të dalë një kafshë, e cila do t’u flasë atyre, se njerëzit nuk u janë bindur shpalljeve Tona.”⁴

Po ashtu, një nga mënyrat e ndikimit të motiveve te perceptimet është shtrembërimi dhe shndërrimi i realitetit të sendeve, që haset nganjëherë në perceptime. Në këtë këndvështrim, nganjëherë njeriu diçka të bukur e sheh të shëmtuar dhe diçka të shëmtuar e sheh të bukur.

Kur’ani ka vënë theksin mbi shtrembërimin që shkaktojnë motivet, dëshirat dhe epshet te perceptimet.

“A është ai, që veprat e veta të këqija i duken të mira (si ai që është i udhëzuar në rrugën e drejtë)? Me të vërtetë, Allahu shpie në humbje kë të dojë dhe udhëzon në rrugë të drejtë kë të dojë. Ti mos e shqetëso veten deri në shkatërrim për humbjen e tyre! Allahu është vërtet i Gjithëdijsëm për atë që bëjnë ata.”⁵

“Vallë, a është i njëjtë ai që i përmbahet udhëzimit të Zotit të tij me atë që i zbukurohen punët e veta të shëmtuara

1. Sure “El-Bekare”, ajetet 17-18.

2. Sure “El-En’am”, ajeti 39.

3. Sure “El-Xhathije”, ajeti 23.

4. Sure “En-Neml”, ajetet 80-81.

5. Sure “Fatir”, ajeti 8.

dhe lëshohet pas pasioneve të veta?"¹

Kërkimet e psikanalizës kanë vënë re se njeriut i pëlqen mosperceptimi i gjërave që e shqetësojnë apo që janë në konflikt me dëshirat e tij. Nuk ka ndonjë dyshim që idhujtarët e kurejshët dhe shumë nga çifutët dhe të krishterët nuk pajtoheshin me fenë e re, që kishte sjellë Profeti i Islamit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), pasi përhapja e tij shihej si rrezik për sundimin dhe ndikimin e tyre. Vetë kjo urrejtje për fenë e re u bë shkak që ata të mos jenë të përgatitur nga ana psikike për t'ua vënë veshin ajeteve kur'anore me meditim dhe përshtatje, ashtu sikurse pikërisht për këtë shkak, ata nuk ishin të gatshëm, nga pikëpamja logjike, të perceptonin domethëniet e Kur'anit dhe të miratojnë çështjet e vërteta që i ka sjellë ai.

1. Sure "Muhammed", ajeti 14.

KREU I KATËRT

Përsiatja (meditimi) nga pikëpamja e Kur'anit

Njeriu ka perceptime shqisore të përbashkëta me kafshën. Por në dallim nga kafsha, ai përdor arsyen, të cilën ia ka falur Zoti. Kjo gjë i jep atij mundësinë e vrojtimit dhe të verifikimit të sendeve, ngjarjeve dhe i jep fuqinë e nxjerrjes së konkluzioneve paraprake. Është vetë fuqia e të menduarit që e bën njeriun të denjë për t'u përqendruar në kryerjen e adhurimeve dhe në përballimin e përgjegjësisë së zgjedhjes.

Si rezultat i të gjitha këtyre, njeriu e ka merituar postin e zëvendësit të Zotit mbi tokë. Informacionet që foshnja fiton në fazën e parë të jetës, nëpërmjet perceptimeve, në të ardhmen, këtë informacion e rikthen në mendjen e vet dhe zë ta sistemojë me një mënyrë të re, që ta ndihmojë atë në zbulimin e informacioneve të reja. Këto informacione të freskëta, që njeriu shtie në dorë gjatë të menduarit dhe të përsiaturit, ia shton arkivit të informacioneve të tij të mëparshme. Njeriu sistemon gjithnjë informacionet e vjetra dhe zbulon informacione dhe realitete të reja.

Në të vërtetë, themeli i zhvillimit të verifikimeve shkencore përgjatë shekujve të ndryshëm të historisë, është arsyeja e një përparimi të qëndrueshëm, që del në pah në shkencat teorike dhe krahasimore. I madhi Zot e ka nxitur njeriun për të menduar mbi gjithësinë, për të soditur dukuritë e ndryshme të saj dhe për t'u kushtuar vëmendje çudive të krijimit dhe pafundësisë së universit.

Gjithashtu, studimin e diturisë dhe njohjen e ligjeve hyjnore, në të gjitha degët e ndryshme të shkencave dhe në këtë ftesë për soditje, meditim, verifikim dhe studim të shkencave, e vëmë re nëpër ajete të shumta të Kur'anit Fisnik.

Thuaj: “Udhëtoni nëpër Tokë dhe shikoni se si Ai e ka zënë fill krijimin. Pastaj do të jetë Allahu Ai që do të bëjë krijimin e dytë (ringjalljen). Me të vërtetë, Allahu është i

Fuqishëm për çdo gjë.”¹

“Vallë, a nuk kanë udhëtuar ata nëpër botë, që zemrat e tyre të mendojnë dhe veshët të dëgjojnë? Në të vërtetë, atyre nuk u janë verbuar sytë (në këto gjëra), por u janë verbuar zemrat e veta në krahavor.”²

“A nuk e shohin ata mbretërinë e qiejve e të Tokës dhe gjithçka që ka krijuar Allahu, duke menduar se mund t’u jetë afruar fundi?! Në çfarë Shpallje tjetër do të besojnë pas kësaj?”³

Thuaj: “Shikoni ç’ka në qiej dhe në Tokë!” Por shenjat dhe qortimet nuk u bëjnë kurrfarë dobie njerëzve që nuk besojnë.”⁴

“Vallë, a nuk i shohin devetë, se si janë krijuar?! Po qiellin, se si është ngritur?! Po malet, se si janë vënë të patundur?! Po Tokën, se si është shtrirë?! Prandaj këshilloji (njerëzit o Muhamed), se ti je vetëm këshillues.”⁵

“Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të Tokës, në këmbimin e natës dhe të ditës, në anijet që lundrojnë nëpër det për t’u sjellë dobi njerëzve, në ujin që Allahu zbret prej qiellit, duke ngjallur përmes tij tokën e vdekur dhe duke shpërndarë gjithfarë gjallesash, në lëvizjen e erërave dhe në retë që qëndrojnë midis qiellit e Tokës, pra, në të gjitha këto, sigurisht që ka shenja për njerëzit me intelekt.”⁶

“Është Ai që lëshon nga qielli ujë, nëpërmjet të cilit Ai nxjerr sythat e çdo bime. Prej kësaj Ne nxjerrim gjelbërim, kokrra gruri në kallinj, palma hurme të ngarkuara me kalaveshë të ulët, kopshte rrushi, ulliri dhe shege, që ngjajnë, por që janë të ndryshëm nga njëri-tjetri. Vështroni frytet e tyre kur formohen dhe piquen. Sigurisht që në këto ka shenja për njerëzit që besojnë.”⁷

1. Sure “El-Ankebut”, ajeti 20.

2. Sure “El-Haxhah”, ajeti 46.

3. Sure “El-A’raf”, ajeti 185.

4. Sure “Junus”, ajeti 101.

5. Sure “El-Gashije”, ajetet 17-21.

6. Sure “El-Bekare”, ajeti 164.

7. Sure “El-En’am”, ajeti 99.

“Le të mendojë njeriu për ushqimin e vet: “Jemi Ne që lëshojmë ujë me bollëk, pastaj e çajmë tokën në thellësi dhe nxjerrim prej saj drithërat, rrushin e perimet, ullirin e palmat, kopshtet e dendura, pemët dhe gjithë barërat, që t’i gëzoni ju dhe bagëtitë tuaja.”¹

Në ajetet e mësipërme dhe shembujt e tyre, njeriu është ftuar hapur që t’i përvishet soditjes, meditimit dhe eksplorimit shkencor të qiejve dhe tokës, të të gjitha krijesave dhe të gjitha dukurive të universit. Kur’ani nuk e fton njeriun vetëm në meditim dhe në kërkimet shkencore ndaj dukurive natyrore, por, gjithashtu, e nxit edhe për meditim rreth vetes, mistereve biologjike dhe psikike të krijesës së vet. Në këtë mënyrë e fton atë për t’u futur në fushat e shkencave të biologjisë, fiziologjisë, mjekësisë dhe psikikës (Psikiatrisë).

“Vallë, a nuk mendojnë ata në vetvete? Allahu ka krijuar qiejt dhe Tokën dhe ato që gjenden në mes tyre - vetëm me qëllim dhe afat të caktuar. E, me të vërtetë, shumica e njerëzve nuk besojnë në takimin me Zotin e tyre.”²

“Le të meditojë njeriu se prej çfarë është krijuar: është krijuar prej një lëngu që hidhet e që del ndërmjet shtyllës kurrizore dhe brinjëve.”³

“Ne do t’u tregojmë atyre shenjat Tona në hapësirat tokësore e qiellore, si dhe në vetvete, derisa t’u bëhet plotësisht e qartë se ai (Kur’ani) është e vërteta...”⁴

Këmbëngulja e Kur'anit Fisnik rreth ftimit të njerëzve për të medituar gjendet në ajete të shumta, në të cilat shihen shumë shprehje. Disa prej tyre po i japim më poshtë:

“Efela ja’kilun?” (A nuk po arsyetojnë?), ***“Efela jetefekkerun?”*** (A nuk po mendojnë?), ***“Leal’lekum ta’kilun”*** (Mbase arsyetoni), ***“Leal-lekum tetefekkerun”*** (Mbase zini të mendoni), ***“In kuntum ta’kilun”*** (Nëse do të arsyetonit), ***“Leal’lehum jetefekkerun”*** (Mbase ata arsyetojnë), ***“Efela jetedebberun?”*** (A nuk po mendojnë?), ***“Efela jetedhekkerun?”***

1. Sure “Abese”, ajetet 24-32.

2. Sure “Er-Rum”, ajeti 8.

3. Sure “Et-Tarik”, ajetet 5-7.

4. Sure “Fussilet”, ajeti 53.

(A nuk po kujtohen?), *“Li kaumin jetefekkerun”* (Për njerëzit që meditojnë), *“Li kaumin ja’kilun”* (Për atë grupin që arsyetojnë)...

Kur’ani e ka shpjeguar rëndësinë e të menduarit në jetën e njeriut dhe e ka ngritur vlerën e individit që vë në shërbim arsyen dhe të menduarin e vet.

“A mund të krahasohet ai që falet natën, duke bërë sexhde dhe duke qëndruar në këmbë e që ruhet prej jetës tjetër dhe shpreson në mëshirën e Zotit të tij (me jobesimtarin)?! Thuaj: “A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?! Vetëm mendarët i pranojnë këshillat!”¹

E ka ulur pozitën e atij që nuk e përdor arsyen dhe të menduarin e vet, më poshtë se kafsha.

“Krijesat më të këqija para Allahut janë ato që janë shurdhe dhe memece (ndaj së vërtetës) e që nuk hanë arsye.”²

“A mendon ti se shumica e tyre dëgjojnë dhe kuptojnë? Ata nuk janë tjetër, veçse si bagëti. Madje, ata janë edhe më të shmangur nga rruga e drejtë.”³

A- Fazat e mendimit në zgjidhjen e problemeve

Gjatë jetës, njeriu ndesh shumë vështirësi, për zgjidhjen e të cilave ndien nevojë që dikush ta ndihmojë. Parimisht, çdo pyetje që njeriu, e shqyrton me veten dhe nuk ia di përgjigjen, llogaritet vetë si një problem. Zakonisht, njeriu në jetë ballafaqohet me shumë situata, që i dalin problematike. Kjo është në kohën që ai ka një qëllim të caktuar dhe përpiqet për realizimin e tij, por nuk e njeh rrugën për të shkuar tek ai ose ekzistojnë pengesa që e ndalojnë për të arritur te qëllimi. Kur njeriu mendon rreth rrugëzgjidhjes së problemit që i del përpara, zakonisht hedh pas shpine vetë ato faza të caktuara, me studimin dhe analizimin e të cilave janë marrë psikologët. Ne mund të përmbledhim në temat e mëposhtme fazat e

1. Sure “Ez-Zumer”, ajeti 9.

2. Sure “En-Enfal”, ajeti 22.

3. Sure “El-Furkan”, ajeti 44.

mendimit në drejtim të zgjidhjes së problemeve.¹

1- Ndjenja e ekzistencës së problemit

Udhëtimi i mendimit nis me ekzistencën e një problemi, i cili ka rëndësi për njeriun. Njeriu në këtë fazë ndien një lloj motivi të fuqishëm, i cili e nxit për zgjidhjen e problemit, derisa t'ia arrijë qëllimit, për realizimin e të cilit përpiqet. Parimisht, ndjenja e ekzistencës së problemit përbën fazën e parë të udhëtimit të mendimit.

2- Grumbullimi i fakteve rreth e përqark problemit

Nëse njeriu ka një problem, zakonisht angazhohet me shqyrtimin e çështjes së tij në të gjitha aspektet, deri sa ta përcaktojë më së miri atë.

Pastaj merret me grumbullimin e të gjitha informacioneve dhe fakteve të lidhura me të dhe me kërkimin e tyre, me synim njohjen e shkallës së lidhjes së tyre me problemin dhe i ruan informacionet që janë të përshtatshme për zgjidhjen e tij. Ai i lë mënjanë ato që nuk janë të përshtatshme.

Grumbullimi i informacioneve dhe i dëshmive në përpjesëtim me çështjen e problemit, ndihmon në ndriçimin, kuptimin dhe përcaktimin e saktë të tij. Vetë kjo shtron udhën për dhënien e hipotezave të rrugëzgjidhjes.

3- Ngritja e hipotezës

Në procesin e grumbullimit të informacioneve dhe dëshmive, në lidhje me çështjen e problemit, disa nga rrugëzgjidhjet e mundshme të tij apo disa hipoteza futen në mendjen e njeriut. Hipoteza, në të vërtetë, është rrugëzgjidhja e propozuar e problemit.

1. Muhamed Uthman Nexhati, *Ilmu'n-nefs fi hayatina'l-jeumijeh*, f. 316-319.

4- Vlerësimi i hipotezave

Në kohën që kërkuesi ngre hipotezë për zgjidhjen e një problemi, zakonisht u futet hetimeve të thella dhe kërkimit përreth asaj hipoteze në kornizën e informacioneve dhe fakteve që ka, deri sa të sigurohet mbi lidhjen e tyre me problemin dhe për dobinë e tyre në zgjidhjen e tij. Nganjëherë, kërkuesi e sheh se hipoteza e parashtruar, nuk është në harmoni dhe nuk përputhet me disa nga informacionet që ka marrë. Në këtë drejtim, e hedh mënjane hipotezën e lartpërmendur, për shkak të mosmeritimit në zgjidhjen e problemit dhe zë të ngrejë një tjetër hipotezë, ashtu siç edhe ka vepruar me hipotezën e parë. Ai zë të shqetësohet me hetimin e thellë dhe me kërkimin për hipotezën e dytë. Nganjëherë, puna mbaron me hedhjen mënjane të hipotezës së dytë. Kjo punë përsëritet aq herë, deri sa të arrihet në paraqitjen e një hipoteze të pranuar, në përpjesëtim me informacionet dhe faktet për atë problem dhe të shquhet se kjo hipotezë e ka forcën e zgjidhjes së problemit të lartpërmendur.

5- Siguria në saktësinë e hipotezës

Mbas lënies mënjane të hipotezave të papërshtatshme dhe arritjes të një hipoteze të përshtatshme për zgjidhjen e problemit, kërkuesi, gjithashtu, merret edhe me grumbullimin e fakteve dhe të dëshmive të tjera. Ai arrin në pika të reja apo kryen eksperimente për t'u siguruar mbi saktësinë e kësaj hipoteze. Zakonisht, këto faza të të menduarit kalojnë gjatë procesit të zgjidhjes së problemeve. Ne, gjithashtu, i përshkojmë këto etapa për zgjidhjen e të gjitha problemeve që na shqetësojnë gjatë jetës së përditshme. Po ashtu, shkencëtarët që merren me kryerjen e eksperimenteve shkencore nëpër laboratorët e tyre, i përshkojnë këto faza, me dallimin e vetëm, se ata përdorin mjetet që kanë lidhje me çështjen dhe duan më shumë vëmendje, kontroll në kryerjen e kërkimeve dhe në grumbullimin e fakteve, në regjistrimin dhe në analizimin e tyre.

Kur'ani na paraqet shembuj për fazat e përshkrimit të të menduarit në procesin e zgjidhjes së problemeve. Këto shembuj i gjejmë në tregimin e Ibrahimit (*Paqja e Allahut qoftë mbi të!*) dhe metodës që ai zgjodhi, në përshkrimin e të menduarit për njohjen e të madhit Zot, të Plotfuqishmit, Gjithëkrijuesit.¹

“Trego për Ibrahimin, kur ai i tha të atit, Azerit: “A do t’i adhurosh idhujt si zotat e tu?! Unë vërtet po shoh se ti dhe populli yt jeni në humbje të madhe”.... Unë e kthej fytyrën time nga Ai që i ka krijuar qiejt dhe Tokën, duke qenë besimtar i vërtetë, dhe nuk jam nga idhujtarët!”²

Ibrahimi (*Paqja qoftë mbi të!*) kishte ndier parregullsi në adhurimin e idhujve nga populli i tij, sepse mendonte se njeriu është krijues i këtyre idhujve dhe, diçka që ndërtohet me dorë, si mund të adhurohet?

Ai u tha: “Vallë, ju adhuroni ato që i keni gdhendur vetë.”³

Nga ana tjetër, këta idhuj nuk kanë asnjë fuqi dhe mundësi, pra, nuk ka se si të përshkruhen me cilësi hyjnore. Zoti është i fuqishëm dhe ka mundësi. Ai është zotëruesi i gjithësisë, dhurues i begative dhe ndarës i rrëskut.

Ai u tha: “Mos vallë, ju adhuroni në vend të Allahut gjëra që nuk mund t’ju sjellin kurrfarë dobie e as dëmi?! Mjerë ju dhe mjerë ata që ju i adhuroni në vend të Allahut! A nuk arsyetoni?”⁴

Vetë kjo ndjesi e Ibrahimit (*Paqja qoftë mbi të!*) lidhur me parregullsinë e adhurimeve të idhujve dhe mosmeritimn e tyre për të qenë zota, i zgjoi atij një problem në vetvete, që e vinte nën presion atë dhe e shtynte të mendonte: “Kush është Zoti i kësaj gjithësie?”

Njëkohësisht, me praninë e këtij problemi, Ibrahimi (*Paqja qoftë mbi të!*) ndien një lloj motivi të fortë të vetja e tij, që të arrijë njohjen e Krijuesit të gjithësisë. Ky motiv, e nxiti atë për të menduar për këtë problem.

1. Ali Abdul Adhim, *Felsefetu'l-ma'rifeti fi'l-Kur'ani'l-Kerijm*, Kajro, Muxhemma'ul-Buhuthi'l-Islamijeh, 1973, f. 244-251.

2. Sure “El-En’am”, ajetet 74-79.

3. Sure “Es-Saffat”, ajeti 95.

4. Sure “El-Enbija”, ajetet 66-67.

Sigurisht që shkaktimin e këtij motivi, përveç udhëzimit dhe suksesit të dhënë prej Zotit, e ndihmoi edhe natyra e tij e lindur, e shëndoshë, shpirti i pastër dhe arsyeja. Pastaj Ibrahim (Paqja qoftë mbi të!) arriti në fazën e soditjes dhe të grumbullimit të informacioneve dhe të fakteve. Ai vrojtoi dukuritë e llojllojshme të gjithësisë në qiell e në tokë, se mos mbase, nëpërmjet tyre, arrinte njohjen e Zotit. Ai e hidhte vështrimin sa tek ylli, te hëna, te dielli dhe te dukuritë e tjera të gjithësisë, si në qiell, ashtu edhe në tokë. Këtë çështje mund ta kuptosh nga ky ajet: **“Dhe kështu, Ne ia treguam Ibrahimit mbretërinë e qiejve dhe të Tokës, që ai të bëhej nga ata që besojnë vendosmërisht”**¹

Në procesin e vrojtimit dhe të grumbullimit të informacioneve rreth dukurive të ndryshme të gjithësisë, Hazreti Ibrahim (Paqja qoftë mbi të!) ngriti hipoteza në mendjen e tij. Për shembull, në kohën që errësira e natës përfshin gjithçka dhe ai pa një yll që po ndriçonte në qiellin e errët, ngriti një hipotezë, rezultat i së cilës ishte besimi në të qenët e yllit Zot. Mirëpo, kur atij iu bë e ditur se ylli ka pësuar ndryshim, domethënë, perëndoi dhe nuk u duk më, e flaku mënjanë hipotezën e shtruar, sepse ishte një hipotezë e papërshtatshme për zgjidhjen e problemit. Zoti duhet të jetë i qëndrueshëm, i pandryshueshëm, gjithnjë i pranishëm dhe kurrë nuk duhet të mungojë. Kur pa hënë në qiell që ndriçonte në errësirë, ai ngriti një tjetër hipotezë: Hëna është Zoti. Mirëpo, kur vuri re se edhe Hëna u zhduk, e hodhi poshtë edhe këtë hipotezë, për shkak të mungesës së saj me cilësitë e Zotit. Kur pa Diellin që ndriçonte, mbushte botën plot dritë dhe e ngrohte atë, dhe se volumi i tij ishte gjithashtu më i madh sesa i yjeve të tjera, ai ngriti një hipotezë tjetër dhe tha se dielli është Zoti. Mirëpo, kur vuri re se edhe ai perëndoi, po ashtu e hodhi poshtë hipotezën, për shkak të mungesës së cilësive të Zotit.

Pasi Ibrahim i hodhi poshtë të gjitha këto hipoteza, si pasojë e mangësive në zgjidhjen e problemit, më në fund ngriti

1. Sure “El-En’am”, ajeti 75.

një hipotezë që e bëri të besojë atë në Zot,¹ në vetë atë Zot që krijoi të gjitha yjet, qiejt, Tokën dhe krijesat që gjenden mes qiellit dhe Tokës. Ai tha: **“Unë e kthej fytyrën time nga Ai që i ka krijuar qiejt dhe Tokën, duke qenë besimtar i vërtetë, dhe nuk jam nga idhujtarët”!**²

Pa dyshim që ai e ka menduar më përpara këtë hipotezë dhe kishte grumbulluar informacion të hollësishëm rreth dukurive të tjera të universit. Ai, jo vetëm që nuk kishte parë ndonjë gjë që t’ia hidhte poshtë hipotezën tek ato, por, përkundrazi, kishte zbuluar se çdo gjë që kishte soditur është prej mrekullive të krijimit të Zotit. Ky rregull i qëndrueshëm, i cili gjendet në sistemin e universit, tregon për ekzistencën e një Zoti të Plotfuqishëm e të Urtë. Ai ka krijuar këtë univers dhe të gjitha krijesat e gjendura në të, me një rregull të qëndrueshëm dhe të saktë.

Këto ajete na përkujtojnë tregimin se si e gjeti udhën Ibrahim (Paqja qoftë mbi të!) për tek Zoti i vetëm (Teuhidi). Shohim se si Kur’ani i ka përshkruar në mënyrë të saktë dhe të qartë fazat e rrugëtimit të mendimit për zgjidhjen e problemeve.

B- Gabimet e të menduarit

Të menduarit gjendet gjithnjë i ekspozuar ndaj gabimeve, sepse nganjëherë, disa elemente i qasen procesit të të menduarit dhe e largojnë atë nga rruga e drejtë. Gjithashtu, ngrenë pengesa midis të menduarit dhe bashkimit të njeriut me realitetin. Sa herë që pengesat e të menduarit i ushtrojnë presion njeriut, ai mpihet, sa nuk është në gjendje të pranojë ide dhe mendime të reja.

Kur njeriu arrin në këtë gjendje, të menduarit e humbet vlerën e tij të madhe në jetë dhe nuk e kryen detyrën e tij të natyrshme, në funksion të dallimit të së vërtetës nga e

1. Sipas mendimit tonë, Ibrahim ishte i bindur që më përpara dhe këto hipoteza i ngriti për të udhëzuar idhujtarët që të besonin në ekzistencën e Zotit dhe jo për veten.

2. Sure “El-En’am”, ajeti 79.

shtrembra, të së mirës dhe të së keqes, zbulimit të realiteteve, fitimit të dijes dhe çuarjes përpara të njeriut drejt zhvillimit dhe përsosjes. Kur forca menduese e njeriut ndal së funksionuari dhe zë të mpihet, në të vërtetë, njeriu e humbet avantazhin bazë të tij, i cili e dallon atë nga kafsha dhe do bëhet si kafsha, në mos edhe më rrugëhumbur se ajo.

“A mendon ti se shumica e tyre dëgjojnë dhe kuptojnë? Ata nuk janë tjetër, veçse si bagëti. Madje, ata janë edhe më të shmangur nga rruga e drejtë.”¹

Kur'ani, këtë gjendje të mpirjes së të menduarit e përshkruan si “vulosje zemrash”, apo “mbulim zemrash” apo “kyçje të tyre”.

“Këta janë ata që Allahu ua ka vulosur zemrat, të dëgjuarit dhe të parët; pikërisht këta janë të shkujdesurit.”²

“Ja, kështu, Allahu ua vulos zemrat atyre që nuk dinë.”³

“Allahu i ka vulosur zemrat e tyre, ndërsa në veshët dhe sytë e tyre kanë mbulesë; ata i pret një dënim i madh.”⁴

“A nuk e është e qartë për ata që trashëguan tokën e banorëve të mëparshëm të saj, se, nëse Ne dëshirojmë, i dënojmë për gjynahet e tyre dhe ua vulosim zemrat, që të mos dëgjojnë?! Ne të kemi treguar ty disa nga ngjarjet e atyre popujve. Të dërguarit e tyre u erdhën me prova të qarta, por sigurisht që ata nuk do të besonin diçka që edhe më parë e mohonin. Kështu ua vulos Allahu zemrat mohuesve.”⁵

“Ne kemi vënë mbulesa në zemrat e tyre, që të mos e kuptojnë atë (Kur'anin), dhe ua kemi shurdhuar veshët. Kur ti përmend në Kur'an vetëm Zotin tënd, ata kthejnë shpinën, duke ikur.”⁶

Ata thonë: “Ajo për të cilën ti na thërret, nuk i arrin

1. Sure “El-Furkan”, ajeti 44.

2. Sure “En-Nahl”, ajeti 108.

3. Sure “Er-Rum”, ajeti 59.

4. Sure “El-Bekare”, ajeti 7.

5. Sure “El-A'raf”, ajetet 100-101.

6. Sure “El-Isra”, ajeti 46. Një nga sëmundjet e zemrës që përmendet në Kur'an është “*kinnun*”, që vjen në formën e mbulimit. Në Kur'an është sjellë në numrin shumë “*ekinnnetun*” dhe ajo është një lloj mbulese, e cila i ndodh zemrës. Kjo fjalë ka ardhur edhe në ajetet e mëpasshme. (Përkthyesi)

zemrat tona, sepse ato janë të mbrojtura mirë. Veshët tanë janë të shurdhër e midis nesh e teje ka perde. Prandaj ti vepro si të duash, se edhe ne kështu do të veprojmë.”¹

“Disa prej tyre duket sikur të dëgjojnë, por Ne kemi vënë perde në zemrat e tyre dhe ua kemi rënduar dëgjimin, në mënyrë që ata të mos kuptojnë. Edhe nëse do të shihnin ndonjë prej shenjave Tona, ata sërish nuk do të besonin. Kur vijnë tek ti për të të kundërshtuar, jobesimtarët thonë: “Këto janë vetëm trillime të popujve të lashtë”!²

“Vërtet, ata që kthehen në mosbesim, pasi u është treguar rruga e drejtë, djalli i ka joshur dhe i ka ushqyer me shpresa të rreme.”³

Kur'ani ka përmendur faktorët më të rëndësishëm që bëhen pengesë për procesin e të menduarit dhe shkak i mpirjes mendore dhe, si rezultat, ngrenë pengesa midis të menduarit, njohjes së realitetit dhe shfaqjes së opinionit të drejtë për çështje të ndryshme. Këta faktorë përbëhen nga: qëndrimi i palëkundur ndaj mendimeve të hershme, mosekzistenca e mjaftueshme e fakteve dhe e dëshmive dhe pozicionimi.

1. Qëndrimi besnik ndaj mendimeve të vjetra

Qëndrimi besnik ndaj mendimeve dhe gjërave të vjetra, mbi bazën e të cilave qarkullojnë traditat dhe zakonet e popullit, është një nga faktorët e rëndësishëm, i cili bëhet shkak i mpirjes së të menduarit dhe i mospranimi të mendimeve të reja, që i qasen mendjes. Zakonisht, njeriu ka prirjen t'u qëndrojë besnik gjërave me të cilat është familjarizuar, që i ka bërë zakon dhe që është edukuar me to. Në mënyrë që lëshimi i rregullave dhe i mendimeve të hershme të bëhet një çështje për të përputhur dhe për të harmonizuar veten me to, ka nevojë për përpjekje, drejtim dhe vullnet, ashtu sikurse lyp fuqinë e njeriut për vështrim analitik dhe të paanshëm në lidhje me çështjet e ndryshme, të cilat i mundësojnë atij

1. Sure “Fussilet”, ajeti 5.

2. Sure “El-En'am”, ajeti 25.

3. Sure “Muhammed”, ajeti 25.

dallimin e të vërtetës nga e kota. Kjo punë, për shumë njerëz, nuk është e lehtë.

Kur'ani ka përshkruar këmbënguljen e shumë popujve në të tërë shekujt e shkuar të historisë, në besimet e baballarëve të tyre dhe në adhurimet e tyre. Ka kujtuar se ata nuk e kanë pasur fuqinë e vështirimit në besimin tek një Zot, për të cilin kanë ftuar të gjithë Profetët, si të dërguar me libër dhe si pa libër, me një mendim të lirë nga vargonjtë e zakoneve dhe të mendimeve të vjetra. Imitimi i etërve dhe qëndrimi besnik ndaj mendimeve dhe zakoneve të tyre ishte një nga faktorët e rëndësishëm të mpirjes mendore në shumë popuj. E në këtë drejtim, për ata nuk ishte e lehtë “larja e duarve” me këto lloj mendimesh dhe pranimi i fesë së besimit në një Zot, ku e kanë ftuar Profetët njerëzimin.

“Ndërsa ata thanë: “A mos ke ardhur të na kthesh nga ajo (rrugë), ku i kemi gjetur etërit tanë e, ju të dyve, t’ju takojë pushteti në Tokë? E pra, ne nuk duam t’ju besojmë ju të dyve!”¹

“Jo, por ata thonë: “Ne i kemi gjetur etërit tanë në këtë fe dhe ne po ndjekim gjurmët e tyre”. Po ashtu, në çdo vend që Ne kemi dërguar paralajmërues para teje, pasanikët e atij vendi thoshin: “Ne i kemi gjetur etërit tanë në këtë fe dhe po ndjekim gjurmët e tyre.””²

Kur u thuhet: “Ejani në atë që ka zbritur Allahu dhe ejani te i Dërguari!”, ata thonë: “Neve na mjafton rruga që kemi gjetur nga etërit tanë.” Edhe pse etërit e tyre nuk kanë ditur asgjë e as nuk kanë qenë në udhën e vërtetë?!³

“Kur atyre u thuhet: “Ndiqni atë që ka shpallur Allahu!”, ata përgjigjen “Jo! Ne do të ndjekim atë udhë në të cilën i kemi gjetur të parët tanë.” Vallë, edhe kur të parët e tyre nuk kuptonin gjë e nuk ishin të udhëzuar?!⁴

Ata thanë: “A mos na ke ardhur që të adhurojmë vetëm Allahun e t’i lëmë zotat që kanë adhuruar prindërit tanë?!”

1. Sure “Junus”, ajeti 78.

2. Sure “Ez-Zuhruf”, ajetet 22-23.

3. Sure “El-Maide”, ajeti 104.

4. Sure “El-Bekare”, ajeti 170.

Atëherë na sill atë me të cilën na kërcënon, nëse je i singërt!”¹

“Kur iu lexohen atyre shpalljet Tona të qarta, ata (paganët e Mekës) thonë: “Ky (Muhamedi a.s.) është vetëm njeri, që dëshiron t’ju largojë nga ajo që etërit tuaj kanë adhuruar”. Dhe ata thonë: “Ky (Kur’an) nuk është asgjë tjetër veçse një gënjeshtër e trilluar!” Dhe, kur u vjen e Vërteta, jobesimtarët thonë: “Kjo është vetëm magji e qartë!”²

Mpirja mendore është mjaft dëmprurëse për njeriun dhe e privon atë nga të përfituarit prej kësaj veçorie bazë, të cilën Zoti e ka dhënë posaçërisht për njeriun, duke e dalluar atë nga kafsha. Prandaj, Kur’ani i nxit vazhdimisht njerëzit për t’u çliruar nga vargonjtë që mbajnë të lidhur mendimin e tyre dhe që ndalin së funksionuari arsyen e tyre.

Kur’ani i ka kritikuar ashpër politeistët, të cilët imitonin etërit e tyre në mendime dhe bindje fetare, që arsyetonin dhe që e nxirrnin jashtë funksionit fuqinë e tyre mendore. Si rezultat, ata refuzonin çdo mendim të ri.

Ne edhe më parë e vumë theksin në ftesën që Kur’ani i bën njeriut për të shëtitur mbi tokë, për të soditur krijimet e universit dhe për t’u kushtuar vëmendje e për të medituar rreth dukurive të llojllojshme të gjithësisë. Kjo ftesë, në të vërtetë është vetë thirrja që Kur’ani bën për çlirimin e të menduarit nga vargonjtë me të cilët është lidhur dhe është një nxitje për udhëtim drejt horizonteve të njohjes dhe eksplorimit të dijes e shkencës.

Gjithashtu, Kur’ani këmbëngul mbi ftimin e njerëzimit për t’u çliruar nga iluzionet dhe besëtytnitë, të cilat ndalin së funksionuari procesin mendor dhe bëhen pengesë e njohjes së realitetit. Arabët, në periudhën e injorancës paraislame ishin besëtytë, për sa i përket llojit dhe numrit të të vegjëleve të devesë dhe deles. Nëse një deve apo dele pjell një numër të caktuar, vetëm femër, ose pjell së bashku mashkull e femër, ata e çlironin atë mbi po këtë bazë, ose i pengonin nga të pirit e qumështit të saj.

1. Sure “El-A’raf”, ajeti 70.

2. Sure “Sebe”, ajeti 43.

Kur'ani e ka ndaluar besimin në këto lloj besëtytnish.¹

“Allahu nuk e përlij as *Behirën*, as *Saibën*, as *Vesilën*, as *Hamin*. Por femohuesit trillojnë gënjeshtër për Allahun! Shumica syresh nuk kanë mend.”²

2. Pamjaftueshmëria e fakteve

Nuk është e lehtë për njeriun të mendojë drejt për një çështje, pa pasur fakte të mjaftueshme dhe informacione të domosdoshme për atë. Gjithashtu, pa grumbulluar argumente dhe prova të mjaftueshme, që të jenë të sakta, nuk mund të arrijë në një përfundim të drejtë në procesin e të menduarit.

Njerëzit dallojnë nga njëri-tjetri në masën e pasimit të ligjeve të drejta dhe logjike, në procesin e të menduarit, të argumentuarit, të deklarimit të opinioneve dhe gjykimeve mendore. Në parim, dijetarët, njerëzit e urtë dhe personat inteligjentë përmbahen nga shfaqja e opinioneve, e gjykimit dhe e lëshimit të urdhëresave, pa pasur në dorë argumente të qarta ku të mbështeten.

Mirëpo, shumë nga njerëzit nuk ndjekin ligjet e drejta logjike në procesin e të menduarit. Ata shpesh nxitohen në shfaqjen e mendimit për çështje të ndryshme, pa pasur fakte të mjaftueshme, duke nxjerrë rregulla, pa grumbulluar argumente të qarta. Kur'ani, për të arritur të vërtetën për një çështje, ka vënë theksin në rëndësinë e njohjes së saj dhe na ka ndaluar nga deklarimi i opinionit për gjërat që nuk i dimë dhe që nuk kemi argumente e fakte mbi saktësinë e tyre.

1. Muhamed El Behij, *El-Islam fi hajati'l-muslim*, botimi i dytë, Kajro: Mek-tebetu Uehbeh, 1973, f. 167-169.

2. Sure “El-Maide”, ajeti 103. Në Tefsirin e Ibn Kethirit thuhet: *Behijra* është një deve, mjelja e qumështit të së cilës ndalohej për shkak të idhujve dhe askush nuk e milte atë.

Saibeh: është një deve, të cilën e lironin për zotat e tyre dhe nuk i ngarkonin asgjë në kurriz.

Uesileh: është një deve e virgjër, që në pjelljen e parë, pjell mashkull, pastaj në fazën e dytë pjell femër. *Ham*: është një deve që lindte dy femra njëra pas tjetrës. Atë e lironin për idhujt, nuk i ngarkonin asaj në shpinë dhe e quanin *Hamij*. Tefsiri i Ibni Kethirit, vëll. 2, f. 107.

“Mos shko pas diçkaje për të cilën nuk ke dijeni. Vërtet, dëgjimi, shikimi dhe zemra, të gjithë këta do të merren në përgjegjësi.”¹

“Ka disa njerëz që diskutojnë për Allahun, pa kurrfarë dijenie dhe ndjekin rrugën e çdo djalli të ndërkryer.”²

“Disa njerëz diskutojnë për Allahun pa kurrfarë diturie, pa udhërrëfyes dhe pa Libër ndriçues.”

“Ata që i kundërshtojnë shpalljet e Allahut, pa pasur asnjë provë, janë të urryer në sytë e Allahut dhe në sytë e atyre që besojnë. Kështu, Allahu ia vulos zemrën çdo mendjemadhi e dhunuesi.”³

“Ata që polemizojnë për shpalljet e Allahut, pa pasur kurrfarë prove, kanë në zemrat e tyre vetëm mendjemadhësi, e cila nuk do t’i shpjerë në qëllimin e tyre. Prandaj kërko mbrojtje prej Allahut! Me të vërtetë, Ai i dëgjon të gjitha dhe i sheh të gjitha.”⁴

Ka raste kur njeriu, duke mos gjetur të gjitha faktet për një çështje që mendon, mbështetet në hamendësimin e rrugëzgjidhjeve që japin si mundësinë e të saktës, ashtu edhe të pasaktës, d.m.th që të dyja. Njeriu, në më të shumtën e kohës, i drejtohet hamendjes, për sa i përket gjykimit të tij lidhur me gjërat e ndryshme, ndërkohë që nuk ka ndonjë argument të qartë mbi saktësinë e hamendjes së vet. Nganjëherë, në të ardhmen, atij i bëhet e qartë pasaktësia e hamendjes.

Në këtë drejtim, hamendja nuk është rruga e drejtë për t’u pjekur me realitetin, por njeriu duhet të përpiqet që atë ta shndërrojë në bindje në rrezet e fakteve dhe të argumenteve të reja, me qëllim që të sigurohet mbi saktësinë, apo mossaktësinë e saj. Prandaj, hamendja përbëhet nga një hipotezë, e cila e përmban si mundshmërinë e saktësisë, ashtu edhe atë të pasaktësisë, d.m.th që të dyja.

1. Sure “El-Isra”, ajeti 36.

2. Sure “El-Haxh”, ajeti 3.

3. Sure “Gafir” (*Mu’min*), ajeti 35 *“bi gajri sultanin etahum”*, do të thotë “pa pasur asnjë argument dhe provë nga ana e Zotit”. Tefsiri i Ibn Kethirit, vëll. 4, f. 79.

4. Sure “Gafir” (*Mu’min*), ajeti 56.

“Shumica e tyre veprojnë vetëm sipas hamendjes. Në të vërtetë, hamendja nuk e zëvendëson aspak të vërtetën. Allahu, pa dyshim, e di mirë atë që punojnë ata.”¹

Dhe, kur juve ju thuhej: **“Premtimi i Allahut është i vërtetë: Ora (e Kiametit) pa dyshim që do të vijë!” - ju thoshit: “Ne nuk e dimë ç’është Ora (e Kiametit). Ne mendojmë se është vetëm një hamendje, prandaj nuk jemi të bindur.”²**

Për këtë arsye, njeriu nuk duhet të ndjekë hamendjen e vet në procesin e të menduarit, sepse hamendja shpesh rezulton e gabuar. Në parim, dyshimi dhe hamendja nuk janë një rrugë e sigurt për t’u pjekur me realitetin. Këtë e vërteton edhe domethënia e fjalës së të madhit Zot, që thotë: **“Ata nuk kanë asnjë njohuri për këtë, por ndjekin vetëm hamendjen, ndonëse hamendja nuk mund ta zëvendësojë aspak të vërtetën.”³**

1. Sure “Junus”, ajeti 36.

2. Sure “El-Xhathije”, ajeti 32.

3. Sure “En-Nexhm”, ajeti 28.

Fjala *dhannun* në Kur’an është thënë në tre kuptime: kuptimi i parë është vetëdija jo e sigurt, e cila nuk e rëndon peshoren kah e vërteta. Ajetet e mëposhtme janë shembuj të këtij kuptimi:

“Nëse u bindesh shumicës së njerëzve që gjenden në tokë, ata do të të shmangin nga rruga e Allahut. Ata ndjekin vetëm hamendjet. Ata vetëm gënjejnë.” (Sure “El-En’am”, ajeti 116)

“Vërtet, Allahut i përket çdokush që gjendet në qiej dhe në Tokë. E çfarë ndjekin ata që adhurojnë në vend të Allahut zota ortakë? Në të vërtetë, ata nuk ndjekin gjë tjetër, përveç hamendjes dhe vetëm gënjejnë.” (Sure “Junus”, ajeti 66.)

“Dhe për fjalët e tyre: “Ne e vramë Mesihun – Isain, të birin e Merjemes, të Dërguarin e Allahut.” Por, ata as e vranë, as e kryqëzuan, por ashtu u është dukur. Ata që nuk u pajtuan për çështjen e tij, me siguri që gjenden në dyshim për të. Ata nuk kanë ditur kurrëgjë për të, por vetëm kanë hamendësuar. Ata, në të vërtetë, nuk e kanë vranë.” (Sure “En-Nisa”, ajeti 157.)

“Në të vërtetë, Ne i dhamë Musait nëntë shenja të qarta. Pyeti bijtë e Izraelit, kur ai u erdhi të parëve të tyre dhe, kur Faraoni i tha atij: “O Musa, unë besoj se ti je i magjepsur.” (Sure “En-Nisa”, ajeti 157.)

“Dhe Faraoni tha: “O pari! Unë nuk di që për ju ka tjetër zot përveç meje! O Haman, më ndiz një zjarr për të pjekur qerpiçë dhe më ndërto një kullë të lartë që të ngjitem te Zoti i Musait. Jam i bindur se ai (Musai) gënjen!” (Sure “El-Kasas”, ajeti 38.)

Kuptimi i dytë i fjalës *dhannun* është po ajo dija jo e sigurt, e cila jep si

3. Anshmëria reaguese dhe emocionale

Për të pasur një mendim të shëndoshë për një çështje, njeriu duhet të merret me grumbullimin e fakteve dhe të dëshmive. Ky veprim merr formë nëpërmjet vërtetimit të përpiktë dhe eksplorimit sistematik shkencor.¹

mundësinë e të saktës, ashtu edhe të së pasaktës. *Dhann – hamendje*, në këtë kuptim është një lloj hipoteze, që, për ta pohuar ose për ta mohuar, ka nevojë për argument. *Dhann – hamendje*, në këtë kuptim është si një hipotezë shkencore, për të cilën ne folëm më parë përgjatë diskutimit, lidhur me fazat e udhëtimit mendor. Prej shembujve të *Dhen-n – hamendjes*, në këtë kuptim, mund të përmendim ajetet treshe, që i kemi cituar në tekstin e po këtij libri.

Kuptimi i tretë i fjalës *dhannun, hamendje*, është kur peshon kah të qenët e saj “e drejtë” apo “dije e saktë”.

“Kërkoni ndihmë (prej Allahut) me durim e me namaz! Kjo është njëmend e vështirë, përveçse për të devotshmit, që janë të bindur që do të takojnë Zotin e tyre dhe do të kthehen tek Ai.” (Sure “El-Bekare”, ajetet 45-46.)

“Kur Taluti u nis për luftë bashkë me ushtrinë, u tha atyre: “Allahu do t’ju provojë me një lumë. Kush pi ujë në të, nuk është ushtari im. Ndërsa, kush nuk do të pijë ujë në të ose kënaqet vetëm me një grusht ujë, është ushtari im.” Por më të shumtët pinë, përveç një pakice. Pasi ai me ata (ushtarë) që ishin besimtarë kaluan lumin, shumë prej tyre u thanë: “Ne sot nuk kemi fuqi të luftojmë me Xhalutin dhe ushtrinë e tij.” Por ata që ishin të bindur se do të takoheshin me Allahun, thanë: “Sa herë, me ndihmën e Allahut, një ushtri e vogël ka ngadhënjyer mbi një ushtri të madhe! Allahu është me të durueshmit.” (Sure “El-Bekare”, ajeti 249.)

“Të ligjtë do të shohin zjarrin dhe do të binden, se me të vërtetë, do të bien në të dhe nuk do të gjejnë largim prej atij.” (Sure “El-Kehf”, ajeti 53.)

“Idhujt, që ata i adhuronin më parë, do t’i zhgënjejnë dhe ata do ta dinë se nuk ka më shpëtim.” (Sure “Fussilet”, ajeti 48.)

1. Përpjekja e Kur'anit për nxitjen e njerëzve për vërtetimin, kushtimin e vëmendjes dhe nxjerrjen e konkluzionit dhe kërkimet shkencore ishte një nga faktorët më të rëndësishëm, që u dhanë shkas mendimtarëve myslimanë për të studiuar në mënyrë aktive dhe ripërtëritëse shkencën, me një mendje të hapur dhe për ta çliruar nga zinxhirët që, në atë kohë, kishin lidhur mendjet e mendimtarëve evropianë. Vetë kjo ndihmoi në përshpejtimin e zhvillimit shkencor në mesin e myslimanëve. Kjo lëvizje shkencore e myslimanëve, në të ardhmen ka pasur ndikimin më të madh në zgjimin e mendimit evropian gjatë periudhës së Rilindjes Europiane. Mendimtarët evropianë u ndihmuan nga kërkimet e myslimanëve dhe nga shkrimet e tyre shkencore në fusha të ndryshme të shkencave, ashtu sikurse edhe përfituan nga metodika e tyre në kërkim. Librat e dijetarëve myslimanë gjatë shekujve të mesjetës, madje edhe pak para Rilindjes Europiane, jepeshin mësim në universitetet e tyre.

Më përpara, ne theksuam se në ç'masë i jep rëndësi Kur'ani çështjes së nxitjes së njeriut për të vërtetuar, për të menduar dhe për të eksploruar në shkencë.

Dëshirat, motivet, reagimet dhe ndjenjat e njeriut ndikojnë në të menduarin e tij dhe bëhen shkak që ai të bjerë në grackën e gabimeve. Disa nga kërkimet e reja eksperimentale në psikologji, kanë vënë re manifestimin e gabimeve në të menduar, si rezultat i anshmërisë reaguese dhe ndjesore. Në njërin nga këto eksperimente, një grupi studentësh iu dha një numër provash të ngjashme. Atyre iu kërkua të vërtetonin nëse ishte logjik rezultati i përfituar nga dy parathëniet e marra në punë të njëjta. Vlen të përmendet se gjysma e këtyre provave të ngjashme, ishin të lidhura me çështje normale të jetës, ndërsa gjysma tjetër e tyre ishin të lidhura me çështje, që, për nga vetë natyra, ishin reagimndjellëse.

Nga rezultatet e këtij eksperimenti doli në pah se numri i studentëve që ranë pre e provave reagimndjellëse ishte me i madh se ai i atyre që përdorën provat e zakonshme, joreagimndjellëse. Rezultati i këtij eksperimenti tregon se gjendja jonë reaguese dhe ndjenjat ndikojnë në të menduarin tonë, duke e afruar në anën e bërjes së gabimeve.¹

Kur'ani vë theksin mbi ndikimin e pasionit te njeriu dhe largimin e të menduarit të tij nga prirja e drejtë. Si pasojë e kësaj, njeriu e humb rrugën e tij dhe bëhet i paafte për të bërë dallimin midis së vërtetës dhe së kotës (*hak*-ut dhe *batil*-it), së mirës dhe së keqes, udhëzimit e rrugëhumbjes.

“E nëse ata nuk të përgjigjen ty, dije se ata janë skllëvër të dëshirave të veta. E kush është në humbje më të madhe, se ata që udhëhiqen nga dëshirat e veta, pa udhëzim prej Allahut? Sigurisht, Allahu nuk i udhëzon njerëzit keqbërës.”²

“O Daud, Ne të kemi bërë mëkëmbës në Tokë, prandaj gjyko ndërmjet njerëzve me drejtësi dhe mos shko pas dëshirave dhe tekave, se ato të largojnë nga rruga e Allahut! Me të vërtetë, për ata që largohen nga rruga e Allahut, ka

1. Muhamed Uthman Nexhati *Ilmu'n-nefs fi hayatina'l-jeumije*.

2. Sure “El-Kasas”, ajeti 50.

dënim të ashpër, ngaqë e kanë harruar Ditën e Llogarisë.”¹

“...Dhe mos shkoni pas epsheve tuaja e të shtrembëroni drejtësinë!”²

“Mendo pak! Kush, përveç Allahut, mund ta udhëzojë atë njeri, që dëshirat e veta i ka bërë zot; atë njeri, të cilin Allahu, duke e njohur për të tillë, e ka shpënë në humbje, duke ia vulosur dëgjimin dhe zemrën e duke i vënë perde para syve të tij?! A nuk po merrni vesh?”³

“Këta janë vetëm emra që ua keni ngjitur (idhujve) ju dhe të parët tuaj, kurse Allahu nuk ju ka dërguar për ata asnjë provë. Ata ndjekin vetëm hamendjet dhe atë që ua ka qejfi, ndonëse u ka ardhur prej Zotit të tyre udhëzimi (për rrugën e drejtë).”⁴

“Por, keqbërësit, nga padituria ndjekin qejfet e veta.”⁵

1. Sure “Sad”, ajeti 26.

2. Sure “En-Nisa”, ajeti 135.

3. Sure “El-Xhathije”, ajetet 2-3.

4. Sure “En-Nexhm”, ajeti 23.

5. Sure “Er-Rum”, ajeti 25.

KREU I PESTË

Të mësuarit në Kur'an

Një nga dhuntitë e dhuruara njeriut nga i madhi Zot në Kur'an, përveç dhurimit të dhuntisë së perceptimit shqisor dhe të menduarit, është edhe talenti i lindur (*fetri*) për të mësuar dhe për të kapur njohuritë, dijet, mjeshtëritë dhe teknikat e ndryshme, që bëhen shkak i shtimit të aftësisë së njeriut në përballimin e barrës së përgjegjësisë së jetës në këtë botë.

Si përfundim, ky talent i lindur i jep njeriut mundësinë që të shtojë aftësitë dhe zhdërvjelltësinë e tij, derisa të arrijë në etapat e zhvillimit, bazuar në atë që Zoti i ka garantuar sipas dëshirës së vet.

A- Burimet e diturisë

Njeriu e mëson dijen apo njohurinë nga dy burime kryesore: burimi hyjnor (prej Zotit) dhe burimi njerëzor. Këto dy lloje dijesh janë plotësuese të njëra-tjetrës.

Në parim, kthimi i tyre është tek i madhi Zot, që e krijoi njeriun dhe i fali atij aparate dhe mjete për të perceptuar dhe për të nxënë dije.¹

Synimi ynë për dijen, e cila buron prej Zotit, është vetë ajo që arrin tek ne drejtpërsëdrejti nëpërmjet shpalljes hyjnore apo frymëzimit hyjnor. Kurse dija që buron nga zanafilla njerëzore, është dija që njeriu e mëson nëpërmjet shkathtësive personale dhe përpjekjes për të arritur diçka në jetë, ndërsa merr informacione dhe dëshmi, në sajë të përpjekjes që bën për zgjidhjen e problemeve të veta, nëpërmjet testimi dhe gabimit, nëpërmjet edukimit prindëror dhe institucioneve arsimore apo nëpërmjet kërkimit shkencor.

Në këtë kapitull, ne do të bëjmë objekt vëzhgimi diturinë

1. Abdul Fetah Xhelal, *Mine'l-usuli't-terbeuijati fil-Islam*, El-Merkezu'd-duelij li't-ta'limi'l-uedhifij lil-kibari fil-alemi'l-arabij, Republika Arabe e Egjiptit, 1977, f. 94.

që njeriu e fiton nga burimi njerëzor dhe do ta lëmë për kapitullin tjetër fjalën rreth diturisë që njeriu mëson nga Zoti, nëpërmjet shpalljes apo frymëzimit hyjnor.

B- Mësimi i gjuhës

Një nga mirësitë më të mëdha që Zoti i ka caktuar njeriut dhe për shkak të saj e ka ngritur atë mbi kafshën, është aftësia për të mësuar gjuhë. Në të vërtetë, gjuha është mjeti dhe instrumenti kryesor i njeriut për të menduar, për të marrë njohuri dhe për të studiuar dituri. Gjuha, duke qenë simbol i kuptimeve, i mundëson njeriut, që në procesin e të menduarit, t'i perceptojë të gjitha kuptimet në mënyrë simbolike. Kjo gjë e ndihmon atë të arrijë një përparim madh. Edhe gjitarët mund të ndërtojnë kuptime.

Kërkimet e reja në fushën e psikologjisë kanë arritur në përfundimin se gjitarët, nga të gjitha format gjeometrike, mund të dallojnë vetëm formën e trekëndëshit në mendjet e tyre. Mirëpo, ata nuk mund të mësojnë dot ndonjë fjalë që ta shprehin këtë formë. Edhe foshnjat, përpara se të mësojnë gjuhën, domethënë përpara se të mësojnë fraza që të jenë shprehëse të kuptimeve, munden, që njësoj si kafshët, të ndërtojnë kuptime në mendjet e tyre.¹

Ndërsa, kur foshnja zë të mësojë gjuhën, shumë shpejt formon një lloj “bagazhi gjuhësor”, që e mundëson të arrijë, jashtë kufirit kohor dhe vendor, procesin e të menduarit në kuptime të ndryshme.

Prandaj mund të mendojë për të shkuarën dhe të ardhmen dhe të mësojë gjëra të reja, si dhe të zbulojë lidhjet midis sendeve dhe të perceptojë parime dhe ligje, duke futur në punë aftësinë e saj sajuese dhe t'ia dalë mbanë në shpikjen e gjërave.

C- Hazreti Adem (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) dhe

1. Muhamed Uthman Nexhati, *Ilmu'n-nefs fi hajatina'l-jeumije*, f. 310-312.

mësimi i gjuhës

Gjuha ka një rëndësi të madhe në jetën e njeriut dhe e aftëson atë për të përparuar përherë në të mësuar e në të menduar. Gjëja e parë që i madhi Zot i mësoi Hazretit Adem (*Paqja e Allahut qoftë mbi të!*) ishin emrat e të gjitha gjërave:

Allahu ia mësoi Ademit emrat e çdo gjëje, pastaj ua paraqiti engjëjve dhe u tha: “Më tregoni emrat e tyre, nëse ajo që thoni është e vërtetë!” “Qofsh i lavdëruar! – thanë ata – Ne dimë vetëm atë që na ke mësuar Ti. Në të vërtetë, Ti je i Gjithëdituri, i Urti.” “O Adem, - tha Ai – ua trego atyre emrat e gjërave!” Kur ua tregoi emrat e tyre, Allahu tha: “A nuk ju kam thënë se Unë i di fshehtësitë e qiejve dhe të Tokës dhe vetëm unë e di çfarë tregoni haptazi dhe çfarë fshihni?!¹”

Mësimi i emrave të gjërave është në kuptimin e *frazave*, që janë simbol i kuptimeve dhe i domethënieve të përgjithshme, sepse kur, për shembull, emrin *kalë* e vendosim për një grup të caktuar kafshësh, na formohet një grup emëror që tregon për një kuptim apo domethënie të përgjithshme, që u përket të gjithë kuajve. Për këtë arsye, ne nga fjala e Zotit: “Ue al-leme Ademel esmae kul-leha”, kuptojmë se i madhi Zot i mësoi Ademit (*Paqja e Allahut qoftë mbi të!*) një gjuhë me të cilën të emërtonte të gjitha sendet, në të vërtetë, i mësoi atij emra që janë simbol i kuptimeve.

Mësimi i një *emri*, që vë theksin në një kuptim të caktuar, bëhet edhe përfshirës i njohjes së cilësive dhe veçorive të klasës që përfshin ky kuptim. Për shembull, kur mësojmë fjalën *kalë*, me anë të saj vëmë shenjë për të gjithë kuajt që shikojmë.

Kjo çështje njëkohësisht është vetëpërfshirëse e këtij supozimi, pasi ne, që më parë, e dimë se, të gjithë kuajt që vështrojmë, kanë cilësi të përbashkëta me njëri-tjetrin. Për këtë arsye, te fjala e Zotit të Madhëruar: “ue al-leme Ademel esmae kul-leha”, kuptojmë edhe këtë çështje, që i madhi Zot, përveç emrave, i ka mësuar Ademit (*Paqja e Allahut qoftë mbi të!*) cilësitë

1. Sure “El-Bekare”, ajetet 31-33.

dhe punët e këtyre sendeve.¹

Pas Hazretit Adem (*Paqja e Allahut qoftë mbi të!*), babait të njerëzimit, i cili e kaloi përvojën e mësimit të gjërave, edhe individët e gjenezës së tij do ta kalojnë këtë përvojë.

Njeriu që i vogël shquan se disa gjëra janë të ngjashme me njëra-tjetrën në disa veçori, ndërsa në një pjesë tjetër nuk përputhen me njëra-tjetrën. Njeriu nuk mund t'i perceptojë të gjitha gjërat që e rrethojnë dhe të ndikohet prej tyre, për shkak se cilado prej tyre është e pavarur dhe e ndarë nga tjetra, por dëshiron ta përgjithësojë punën e perceptimit të këtyre gjërave që gjenden përreth tij. Ky veprim merr formë nëpërmjet grumbullimit dhe vendosjes së gjërave të ngjashme me njëra-tjetrën në disa veçori, në një grupim apo në një lloj të përcaktuar, formimi i një kuptimi të përcaktuar për to, emërtimi i tyre dhe kryerja e një lloj reagimi përballë tyre.

Sipas këtij rendi, njeriu merret me klasifikimin e gjërave që të pakësojë shumësinë dhe vështirësinë e gjërave që e rrethojnë. Kjo punë kryhet me zgjerimin dhe përgjithësimin e tyre nëpërmjet ndërtimit të kuptimit, që përfshin raste të shumta.

Fuqia dhe aftësia për mësimin e gjuhës e ka ndihmuar njeriun të formojë më shpejt kuptimin e fjalëve dhe t'i përdorë ato në punën e të menduarit dhe të mësuarit të informacioneve të reja.² Sepse njeriu, në sajë të përfitimit prej kuptimeve në procesin e të menduarit dhe në sajë të përdorimit të frazave si simbole të këtyre kuptimeve, ka mundur që, në mënyrë simbolike, t'i arrijë të gjitha gjërat gjatë procesit të tij të të menduarit.

Gjithashtu, ka mundur që me ndihmën e të menduarit, të angazhohet në punën e analizimit, të përbërjes, të krahasimit, të dallimit dhe të zbulimit të raporteve, të perceptimit të parimeve.

Kur'ani Fisnik i jep rëndësi mësimit të gjuhës në jetën e njeriut. Për këtë arsye, në suren e parë që është zbritur, i ka nxitur njerëzit për të lexuar. Kjo sure vë theksin në dhurimin e të madhit Zot ndaj njeriut, sepse Zoti, në natyrën e njeriut

1. Ibn Kethiri, duke komentuar për këtë, thotë se ajeti "**Zoti i mësoi Adem-it emrat e të gjitha sendeve**", domethënë, i mësoi Adem-it natyrën e sendeve, cilësitë dhe aktet e tyre." Tefsiri ibn Kethir, vëll. 1, f. 72-75.

2. Muhamed Uthman Nexhati, *Ilmu'n-nefs fi hajatina'l-jeumije*, f. 310-312.

ka krijuar aftësinë e të mësuarit të gjuhës, të të lexuarit, të të shkruarit, të nxënies së dijes dhe mjeshtërive të ndryshme, të udhëzimit dhe të besimit.

Gjithashtu, tek ai ka krijuar gjëra që, përpara se ta udhëzonte Zoti, nuk kishte dijeni për to dhe nuk dinte gjë rreth tyre. I madhi Zot rreth kësaj, thotë:

“Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi (gjithçka), e krijoi njeriun nga një droçkë gjaku! Lexo! Zoti yt është Bujari më i madh, i Cili, me anë të penës ia mësoi, ia mësoi njeriut ato që nuk i dinte.”¹

“Lavdëro emrin e Zotit tënd, më të Lartit, që ka krijuar gjithçka dhe e ka përpjesëtuar drejt; që ka caktuar fatin e çdo gjëje dhe ia ka rrëfyer rrugën; që bën të rriten kullotat dhe pastaj të shndërrohen, të thahen e të vyshken.”²

Kur'an i ka përmendur dallimin e njeriut prej krijesave të tjera, aftësinë e tij në mësimin e gjuhës dhe vënien në funksion të saj, si shprehje e virtytit të ekzistencës së vet.

“Ua ka mësuar Kur'anin (robërve të Tij), ka krijuar njeriun.”³

Zoti ka dashur që prindërve tanë, Hazretit Adem dhe Havasë (*Paqja qoftë mbi ta!*), t’ju mësojë disa nga rregullat e dobishme të sjelljes, që përputhen me natyrën materiale dhe shpirtërore të formimit të tyre njerëzor, konfliktit që manifestohet midis dëshirave trupore dhe shpirtërore të tyre. Dëshira e Zotit është e atillë që t’ju mësojë atyre forcën e zgjidhjes, të vendimmarrjes dhe të përballimit të punëve që kryejnë dhe të vendimeve që marrin. Kjo ishte arsyeja se pse i ndaloi ata për t’ju afruar asaj “peme”.

Ne thamë: “O Adem, jeto ti dhe gruaja jote në Xhenet dhe aty hani sa të doni e kur të doni, por mos iu afroni kësaj peme, se ndryshe do bëhemi të padrejtë. Shejtani i shtyu të gabojnë e i nxori nga lumturia ku ishin. “Zbritni – u thamë Ne – do të jeni armiq të njëri-tjetrit. Në tokë do të qëndroni, do të keni furnizim e do të jetoni deri në një kohë të caktuar.”

1. Sure “El-Alak”, ajetet 1-5.

2. Sure “El-A’la”, ajetet 1-5.

3. Sure “Er-Rahman”, ajetet 2-3.

Ademi mësoi disa fjalë (se si të kërkonte falje) nga Zoti i tij, kështu që Ai ia pranoi pendimet, Ai është Mëshirëploti.”¹

Është më se e qartë që një mësimdhënie e tillë ishte e domosdoshme për prindërit tanë, Ademin dhe Havanë (*Paqja qoftë mbi ta!*), për t'i parapërgatitur ata për jetesën e tyre të ardhshme mbi sipërfaqen e tokës, e cila ishte përcaktuar nga Zoti për ta. Kjo ishte sepse ata mbi tokë do të përballeshin me çështje të shumta, për të cilat duhet të dinin të pozicionoheshin apo të nxirrnin rregullore për to dhe të zgjidhnin midis tyre. Gjithashtu, atyre do t'u duhej të merrnin përsipër përgjegjësinë e përzgjedhjes dhe vendimmarrjeve të tyre.

Ç- Udhët e mësimi në Kur'an

Njeriu angazhohet për të mësuar nëpër rrugë të ndryshme. Nganjëherë ai i mëson gjërat nëpërmjet imitimit. Për shembull, vogëlushi ose vogëlushja zakonisht imitojnë babanë dhe nënën e tyre dhe kapin shumë nga zakonet dhe sjelljet e tyre.

Gjithashtu, njeriu mëson shumë rrugëzgjidhje të dobishme për problemet e jetës së tij, nëpërmjet eksperimentimit shkencor apo prej mënyrës së testimit dhe gabimit. Kjo gjë është e dobishme për të përballuar jetën. Ndonjëherë njeriu mëson gjëra edhe nëpërmjet të menduarit dhe të arsyetuarit.

1- Imitimi

Shumë nga sjelljet dhe shprehjet e veta në fazën fillestare të jetës, njeriu i mëson nëpërmjet imitimit që u bën prindërve, vëllezërve dhe motrave të tij. Për shembull, ai përpiket që, duke imituar prindërit, vëllezërit dhe motrat e veta, të mësojë shqiptimin e disa prej ndërprerjeve zanore, që ata përsërisin shpeshherë përballë tij; ashtu sikurse përpiket të mësojë prej prindërve, vëllezërve e motrave të veta, ecjen, mbajtjen e ekuilibrit trupor dhe lëvizjen e këmbëve.

Në këtë mënyrë, nëpërmjet imitimit të individëve të

1. Sure "El-Bekare", ajetet 35-37.

familjes së vet, njeriu mëson shumë nga shprehjet dhe sjelljet. Kur'ani ka përmendur një shembull në të cilin sqaron rrethanat e mësimi të njeriut nëpërmjet imitimit, aty ku rrëfen historinë e Kabil, i cili vrau vëllanë e vet Habilin, por nuk dinte se ç'të bënte me trupin e tij. Këtu, Zoti dërgoi një sorrë, e cila zuri të gërmonte tokën, me qëllim që të groposte një sorrë të ngordhur. Kabil e mësoi prej sorrës se si ta fshihte trupin e të vëllait.

“Allahu dërgoi një sorrë që rrëmihte në tokë, për t'i treguar se si ta mbulonte kufomën e të vëllait. (Kabil) tha: “Mjeri unë, a nuk qenkam i zoti të bëhem si kjo sorrë e ta mbuloj trupin e tim vëllai?!” E u bë nga të penduarit.”¹

Njeriu natyrshëm priret kah imitimi dhe mëson nëpërmjet tij shumë prej sjelljeve të veta. Në të mësuar dhe në edukim ka rëndësi të madhe prania e një shembulli të mirë e të denjë. Profeti i Islamit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ishte vetë një shembull i dalluar për shokët e tij, duke u mësuar rrethanat dhe natyrën e kryerjes së adhurimeve. Për shembull, e shihnin atë gjatë marrjes së abdesit, faljes së namazit dhe kryerjes së riteve të Haxhit dhe i mësonin rrethanat e tyre, nëpërmjet imitimit dhe ndjekjes së atij shembulli madhështor. Transmetohet nga Ebi Hazimi se njëherë Profeti i Nderuar fali namaz mbi *minber* (podium). Kur e përfundoi, iu drejtua popullit dhe i tha: “O njerëz, unë e kreu këtë punë që, në sajë të saj, ju të më pasoni dhe të mësoni nga unë mënyrën e faljes së namazit.”²

Profeti i nderuar (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) shërben si një model i shkëlqyer për shokët (sahabët). Ata, jo vetëm që mësonin prej atij mënyrën e kryerjes së adhurimeve, por edhe sjelljen e mirë dhe moralin e pëlqyer dhe në përgjithësi, rregullat e ballafaqimit dhe sjelljen njerëzore. Kur'ani na ka këshilluar të pasojmë Profetin e nderuar (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe të mësojmë prej tij.

1. Sure “El-Maide”, ajeti 31.

2. Hadithi numër 408. Përmbledhja “Sahih Muslim” i Hafidh El-Mundhir-ijut.

“Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë, që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun.”¹

Kur'ani u ka kërkuar myslimanëve që, në përbuzje ndaj popullit të tyre politeist, të imitojnë Ibrahimin (*Paqja e Allahut qoftë mbi të!*). Besimtarët që ishin në krah të tij, i ka ftuar që të përmbahen nga dashuria për të afërmit politeistë, njësoj si Ibrahim (i *Paqja e Allahut qoftë mbi të!*).

“Shembull i mrekullueshëm për ju është Ibrahim dhe ata që kanë qenë me të, kur i thanë popullit të vet: “Ne shkëputemi nga ju dhe nga ato që ju i adhuronin në vend të Allahut; ne ju mohojmë dhe armiqësia e urrejtja midis nesh është e përhershme, deri sa të besoni tek Allahu Një dhe i Vetëm.” Përjashtim (nga ky shembull) bën fjala e Ibrahimit për të atin: “Unë do të kërkoj falje për ty, por nuk kam kurrfarë mundësie për të të mbrojtur para Allahut. O Zoti ynë, tek Ti mbështetemi, Ty të drejtohem dhe tek Ti do të kthehem.”²

“Vërtet, ata njerëz janë një shembull i mirë për ju e për këdo që shpreson në Allahun dhe në Ditën e Fundit. Kushdo që nuk ia vë veshin (këtij shembulli), ta dijë se Allahu është i Vetëmjaftueshëm, i Denji për çdo lavd!”³

Kur'ani i ka kërkuar Profetit të Islamit që të ndjekë shembullin e Profetëve të shkuar në besimin e njëshmërisë (në Akiden e Teuhidit) dhe punët e merituar për të cilat i ka udhëzuar Zoti.

“Këta janë ata, të cilët Allahu i ka udhëzuar në rrugën e drejtë, andaj edhe ti (o Muhamed) ndiq rrugën e tyre. Thuaj: “Unë nuk kërkoj nga ju kurrfarë shpërblimi për atë. Ai është vetëm këshillë për të gjithë botët (njerëzit dhe xhindet).”⁴

Njeriu i mëson shprehitë e mira dhe moralin e pëlqyer nëpërmjet një shembulli të mirë, ashtu sikurse i mëson zakonet e këqija dhe moralin e shëmtuar nëpërmjet shembullit të keq.

1. Sure “El-Ahzab”, ajeti 21.

2. Sure “El-Mumtehine”, ajeti 4.

3. Sure “El-Mumtehine”, ajeti 6.

4. Sure “El-En’am”, ajeti 90.

Gjatë diskutimit mbi mpirjen mendore, në kapitullin e katërt “Të menduarit në Kur'an”, ne mësuar se imitimi i baballarëve në adhurime dhe zbatimi i traditave të tyre ishte prej problemeve që i mundonin Profetët. Si Profetët me libër hyjnor, ashtu edhe ata pa libër, po këto probleme kanë pasur, pasi ishin pengesë e pranimit të ftesës për të besuar në një Zot nga ana e politeistëve.

2- Eksperimentimi shkencor, testimi dhe gabimi

Nëpërmjet eksperimentit shkencor, njeriu përpiqet të përballojë problemet e shumta të jetës dhe të gjejë zgjidhje të përshtatshme për to. Në jetë, ai ballafaqohet gjithnjë me çështje të reja, të cilat nuk i ka mësuar më parë dhe nuk di se si të reagojë dhe se si të sillet përballë tyre. Gjithnjë në të tilla raste, njeriu e përshtat veten në njëfarë mënyre që, në kushte të ndryshme, të sillet në forma të ndryshme. Ka raste që zgjedhjet i bën gabim, si dhe nganjëherë i kryen në rregull. Sipas kësaj mënyre, njeriu mëson përherë nëpërmjet asaj që psikologët e quajnë “Testim dhe gabim”, mënyra e ballafaqimit me çështjet e reja dhe rrugëzgjidhjet e problemeve që praktikisht hasen në jetë.

Kur'ani, në shumë ajete, e ka nxitur njerëzimin për të udhëtuar mbi tokë e për të soditur argumentet e Zotit në univers, si dhe për të medituar rreth tyre. Në kapitullin e kaluar, “Mendimi në Kur'an”, ne kemi përmendur shumë nga këto ajete. Nuk ka dyshim se përpjekja e Kur'anit në ftimin e njeriut për të soditur gjithësinë dhe për të medituar për të dhe për krijimet e saj, shpjegon fare qartë rëndësinë e madhe që ka ftimi i njeriut në procesin e të mësuarit.

Ky proces i të mësuarit realizohet nëpërmjet vështrimit të përpiktë të gjërave, eksperimentimit shkencor, testimit dhe gabimeve, si dhe nëpërmjet ndikimit mahnitës nga universi dhe nga krijesat e tjera.

Këtë mënyrë të të mësuarit do ta trajtojmë më pas. Kur'ani thekson këtë lloj të mësuarit, që merr formë nëpërmjet eksperimentit shkencor apo metodës së testimit dhe gabimit.

“Ata dinë vetëm anën e dukshme të kësaj jete, ndërsa për Jetën Tjetër janë të pakujdesshëm.”¹

Kurtubiu, në komentimin e ajetit *“Ja’lemune dhahiren mine’l-hajati’d-dunja”*, thotë kështu: “Ata i dinë punët e jetesës dhe të kësaj bote, për shembull dinë në ç’kohë të mbjellin e në ç’kohë të korrin, dinë se si të kultivojnë pemë dhe se si të ndërtojnë shtëpi.”²

Edhe Ibn Kethiri, në komentin e këtij ajeti, thotë: “Shumica e njerëzve janë të informuar dhe kanë dijeni vetëm për këtë botë, për interesat dhe çështjet e kësaj bote dhe gjërat e gjendura në të. Ata janë mjaft të shkathët dhe inteligjentë për të përfituar nga kjo botë.”³

3- Të menduarit

Njeriu mëson edhe nëpërmjet të menduarit, sepse, kur mendon rreth zgjidhjes së një problemi të caktuar, në të vërtetë, zë të bëjë një lloj testimi dhe gabimi mendor. Ai, në këtë punë, në mendjen e tij vlerëson rrugëzgjidhjet e shumta për atë problem dhe hedh poshtë rrugëzgjidhjet e gabuara dhe të papërshtatshme. Pastaj shqetësohet për zgjidhjen që ka shquar të përshtatshme dhe të rregullt. Prandaj, nëpërmjet të menduarit për zgjidhjen e problemeve të tij, njeriu mëson rrugëzgjidhje të reja dhe zbulon raportet midis gjërave dhe ngjarjeve, si dhe percepton parime dhe ide të reja dhe udhëhiqet drejt shpikjeve të reja. Për këtë shkak, psikologët bashkëkohorë, këtë lloj të mësuarit e quajnë “Procesi i shkëlqyer i të mësuarit.”

Shqyrtimi, diskutimi dhe konsultimi me ata që kanë mend, është ndër faktorët që ndihmon në ndriçimin e të menduarit. Vetë ky ndriçim i të menduarit është shkak i orientimit të njeriut drejt realitetit dhe rrugëzgjidhjeve të sakta të problemeve që dalin. Kur’ani i nxit njerëzit për konsultim dhe përkujton përparësinë e besimtarëve që, për të arritur te realiteti dhe për

1. Sure “Er-Rum”, ajeti 7.

2. *Tefsiru’l-Kurtubij*, vëll. 14, f. 7.

3. *Tefsir Ibn Kethir*, vëll. 3, f. 427.

të vendosur drejtësinë në shoqëri, konsultohen me njëri-tjetrin në punët e tyre.

“Për ata që i përgjigjen thirrjes së Zotit të tyre, e falin namazin rregullisht dhe këshillohen për punët e veta me njëri-tjetrin; për ata që ndajnë lëmoshë prej asaj që u kemi dhënë Ne.”¹

I madhi Zot i ka kërkuar Profetit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) që të këshillohet me shokët e tij të mençur.

“Në sajë të mëshirës së Allahut, u solle butësisht me ta (o Muhamed). Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje. Prandaj falua atyre gabimin, kërkoi falje Allahut për ata dhe këshillohu me ata për çështje të ndryshme. Kur të vendosësh për diçka, mbështetu tek Allahu. Vërtet, Allahu i do ata që mbështeten tek Ai.”²

Kur'ani ka futur në punë metodën e argumentimit dhe të diskutimit me politeistët dhe ka sjellë për ta argumente logjike, të cilat faktojnë kotësinë e idhujtarisë, me qëllim që të ngacmojë mendimin rreth Zotit të tyre dhe t'u mbushë mendjet atyre, për ultësinë dhe paaftësinë e idhujve, si dhe t'u bëhet e qartë se idhujt nuk meritojnë të jenë zota. Ajetet e mëposhtme janë shembuj të kësaj kategorie.

“A mos vallë ata i veshin Atij si ortakë idhuj që nuk mund të krijojnë asgjë, ndërkohë që vetë janë të krijuar?!... A kanë ata këmbë për të ecur ose duar për të kapur? A kanë sy për të parë ose veshë për të dëgjuar? Thuaj: “Thirrni zotat tuaj të rreme dhe kurdisni kurthe kundër meje, pa më lënë kohë!”³

D- Parimet e të mësuarit në Kur'an

Nëse do të këtë parime të caktuara, procesi i të mësuarit kryhet me lehtësi e me sukses. Mirëpo, në mungesë të këtyre parimeve, nganjëherë ky proces bëhet shumë problematik, e madje mund të rezultojë në disfatë.

1. Sure “Esh-Shura”, ajeti 38.

2. Sure “Ali Imran”, ajeti 159.

3. Sure “El-A'raf”, ajetet 191-195.

Nëse do të ekzaminojmë metodën që Kur'ani ka pasur parasysh për të ftuar në besimin në një Zot, për edukimin e besimtarëve dhe mbjelljen e parimeve dhe vlerave islame në shpirtrat e tyre, mundemi që prej saj të nxjerrim rezultatin e disa prej parimeve të rëndësishme të të mësuarit.

Së shpejti do të shohim që psikologët, në çështjen e të mësuarit, nuk e kishin zbuluar deri para pak kohësh, domethënë fillimet e shekullit të njëzetë, rëndësinë e parimeve që ka theksuar Kur'ani për edukimin shpirtëror të besimtarëve. Ne po përpiqemi që në rreshtat e ardhshëm të paraqesim dhe të analizojmë parimet e të mësuarit në Kur'an.

1- Motivi

Motivi ka rëndësi të madhe në çështjen e të mësuarit. Nëse për të arritur një objektiv të caktuar do të ekzistonte një motivim i fuqishëm, do të krijoheshin kushte të përshtatshme, që njeriu të ecë në rrugë të drejta për të mësuar dhe për të arritur atë objektiv. Nëse njeriu ballafaqohet me një problem dhe ndien se duhet gjetur një zgjidhje, zakonisht përfshihet në përpjekje të shumta për ta zgjidhur atë, derisa më në fund, të mësojë rrugëzgjidhjen e drejtë të tij. Shumë nga provat eksperimentale, që sapo janë kryer mbi kafshët dhe njeriun, kanë vënë re rëndësinë e motivacionit në vjeljen e të mësuarit.

Kur'ani, me qëllim edukimin shpirtëror të myslimanëve, ka përdorur metoda të shumta për ngacmimin e motiveve të tyre në drejtim të të mësuarit. Për shembull, ka përdorur metodën e nxitjes dhe të kërcënimit dhe metodën e rrëfimit. Me shpjegimin e ngjarjeve të rëndësishme, të cilat provokojnë motivet dhe reagimet e njerëzve, i ka nxitur ata të nxjerrin mësim prej këtyre ndodhjeve.

1.1- Motivimi nëpërmjet nxitjes dhe kërcënimit

Kur njeriu ka motiv të fortë për t'ia arritur një pikësynimi, ky pikësynim bëhet plotësim i motivacionit të tij. Ai llogaritet si një shpërblësë që bëhet shkak i ndjesisë së kënaqësisë

apo lumturi. Disfata në arritjen e pikësnyimit është një lloj ndëshkimi, i cili bëhet shkak i ndjesisë së vuajtjes apo pikëllimit. Njeriu, po ashtu edhe kafsha, natyrshëm priret nga gjëja që i fal kënaqësi dhe ngurron ndaj gjësë që i jep vuajtje e dhimbje. Për këtë arsye, njeriu, natyrshëm, priret drejt mësimit të sjelljeve dhe punëve që, në fund, përfundojnë me vjeljen e shpërblimit dhe largohet nga sjelljet dhe punët që përfundojnë me disfatë dhe ndëshkim. Këtë realitet e kanë studiuar psikologët bashkëkohorë.

Kur'ani, në vazhden e ftimit të njerëzimit për të adhuruar një Zot (ftimit të njerëzve në *Teuhid*), i ka kushtuar rëndësi çështjes së zgjimit të motiveve, pasi, nëpërmjet nxitjes së tyre, besimtarët shpërblehen me Parajsën e begatë; gjithashtu, indiferenca ndaj Zotit, i frikëson jobesimtarët për ndëshkimin apo dënimin që do i mbërthejë në zjarrin e skëterrës. Ajetet që përshkruajnë begatitë e Parajsës, zgjojnë te myslimanët shpresën e arritjes së këtyre begatëve. I nxisin ata për devotshmëri dhe sinqeritet në kryerjen e adhurimeve dhe punëve të mira, që bëhen shkak për të përfituar kënaqësinë e Zotit dhe të të Dërguarit të Tij, duke u shtuar shpresën për të hyrë në kategorinë e banorëve të Parajsës. Gjithashtu, i nxisin për luftë në rrugën e Zotit.

Ajetet që përshkruajnë ndëshkimin e skëterrës, zgjojnë tek ata frikën nga ky ndëshkim i dhembshëm, i cili është në pritje të mohuesve, hipokritëve dhe të rebeluarve nga urdhrat e të madhit Zot. Vetë kjo çështje i nxit ata për t'u ruajtur nga kryerja e mëkateve dhe çfarëdo qoftë që shkakton zemërimin e Zotit dhe të Dërguarit të Tij; i nxit me shpresën që Zoti t'i çlirojë ata nga dënimi i zjarrit të skëterrës. Sipas këtij rregulli, myslimanët janë nën ndikimin e dy motiveve të fuqishme: njëri i nxit për kryerjen e adhurimeve dhe detyrave dhe për çdo gjë që ka urdhëruar ligji i Zotit (*sheriati*), dhe tjetri i nxit të ruhen nga kryerja e mëkateve dhe të çdo gjëje tjetër që ka ndaluar Zoti.

Prania e këtyre dy motiveve të fuqishme, të cilat janë plotësuese të njëra-tjetrës dhe që janë në harmoni së bashku,

e mban njeriun në gatishmëri të plotë për nënshtrim të gjithanshëm ndaj të madhit Zot dhe Profetit, për t'u dhënë përgjigje pozitive të gjitha detyrave dhe përgjegjësive që i janë kërkuar atij. Gjithashtu, e përgatit plotësisht atë për rendin e ri në jetë, për tek i cili e udhëheq Islami dhe metodën e re në fushën e mendimit dhe të sjelljes, si dhe njëkohësisht për t'u larguar nga ajo që i madhi Zot dhe Profeti i nderuar (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) kanë ndaluar.

Nëse do t'u kushtojmë vëmendje ajeteve të Kur'anit në këtë fushë, do të vëmë re se, në çështjen e provokimit të motivit për pranimin e Islamit, Kur'ani jo vetëm që mbështet frikësimin e njerëzve nga dënimi i dhembshëm që vjen nga zjarri i skëterrës, por edhe çështjen e nxitjes së tyre për të përfituar nga mirësitë e Parajsës. Kjo ndodh sepse përdorimi i veçuar i frikësimit apo i nxitjes mund të mos sjellë ekuilibrimin e sjelljes. Për shembull, përdorimi vetëm i frikës, nganjëherë rezulton me mbizotërimin e gjendjes së frikës në shpirtin e njeriut. Si përfundim, do të shkaktojë dëshpërim dhe pesimizëm, lidhur me mëshirën e Zotit. Nga ana tjetër, përdorimi vetëm i nxitjes, ndonjëherë rezulton me mbizotërimin absolut të shpresës dhe optimizmit, lidhur me mëshirën e Zotit. Ka mundësi ta çojë atë drejt dembelizmit, dobësisë dhe neglizhencës dhe, si përfundim, të kërkojë prej Zotit atë që s'është e tij.¹

Rreth kësaj, Profeti i nderuar (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) thotë: *Besimi nuk është te dëshira, por ai ka zënë vend në zemrën e besimtarit dhe atë e faton puna e tij.*

Njerëzit që i mban peng shpresa për falje, deri aty sa të ikin prej kësaj bote, ndërkohë që nuk kanë kryer ndonjë punë të mirë dhe që thonë se kanë parandjenjë të mirë për Zotin, gënjejnë, sepse, po të kishin parandjenjë të mirë për Zotin, do të kryenin për hir të Tij, çdo punë të mirë.”²

Pra, për këtë arsye, Kur'ani nuk mbështetet vetëm te frikësimi apo nxitja, por te një përzierje të këtyre të dyjave,

1. Muhamed Said Ramadan El-Butij, *Menhexhun terbeuijun ferijduun fi'l-Kur'an*, botim i revistës “El-Ua'ju'l-Islamij”, Kuvajt, viti i shtatë, numri 81, tetor 1971, f. 74-75.

2. El-Behij El-Khaulij, *Adem (a.s.): Felsefetu takuimi'l-insan*, f. 185.

domethënë, e frikës nga ndëshkimi dhe e shpresës të mëshira dhe shpërblimi i Zotit. Kur'ani, në vazhden e përshkrimit të të zgjedhurve të Zotit (Profetëve dhe robërve të Tij punëmirë) e ka shpjeguar këtë temë dhe rreth tyre thotë:

“Ne iu përgjigjëm atij dhe i dhuruam Jahjain, duke ia bërë gruan të aftë (për lindje). Me të vërtetë, ata nxitonin për vepra të mira dhe Na luteshin, me shpresë e frikë dhe ishin të përlulur ndaj Nesh.”¹

“Ata ngrihen nga shtrati, i luten Zotit të tyre me frikë e shpresë dhe japin nga ajo që u kemi dhënë Ne.”²

Kjo përzierje e frikës me shpresën është garantues i zgjimit të një motivi të fuqishëm të myslimanët, që të mësojnë rendin e ri të jetës që ka ofruar Islami, si dhe metodat e reja të mendimit dhe të sjelljes që përfshin ky rend. Ajetet e mëposhtme janë prej ajeteve të nxitjes dhe kërcënimit, ku përmendet begatia që do të arrijnë besimtarët në Ditën e Kiametit, si dhe dënimi që do t'i kapë mohuesit.

“Nuk është kështu si thoni ju! Ata që bëjnë vepra të këqija dhe mbulohen nga fajet e veta, do të jenë banorë të Zjarrit (të Xhehenemit), ku do të qëndrojnë përgjithmonë. Kurse ata që besojnë e bëjnë vepra të mira, do të jenë banorët e Xhenetit, ku do të qëndrojnë përgjithmonë.”³

“Ti (o Muhamed) mos u mashtro nga bredhja e jobesimtarëve nëpër botë! Kjo mirëqenie është e shkurtër; pastaj, strehimi i tyre është Xhehenemi. Eh, sa shtrat i keq është ai vend! Por, ata që i frikësohen Zotit të tyre do të kenë kopshte nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe ku do të banojnë përjetësisht, si dhuratë prej Allahut. Dhe ajo që është tek Allahu, është dhurata më e mirë për besimtarët e vërtetë.”⁴

“Ata që s'besojnë në shenjat Tona, Ne padyshim, do t'i djegim në zjarr. Sapo t'u digjet lëkura, Ne do t'ua ndërrojmë atë me lëkurë tjetër, për të përjetuar dënimin. Me të vërtetë, Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë. Sa për ata

1. Sure “El-Enbija”, ajeti 90.

2. Sure “Es-Sexhde”, ajeti 16.

3. Sure “El-Bekare”, ajetet 81-82.

4. Sure “Ali Imran”, ajetet 196-198.

që besojnë dhe punojnë vepra të mira, Ne do t'i shpiem në kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe ku do të banojnë përgjithmonë. Ata do të kenë bashkëshorte të pastra dhe Ne do t'i shpiem në hije të dendura."¹

"Allahu u ka premtuar falje (të gjynaheve) dhe shpërblim të madh atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira. Sa për ata që nuk besojnë dhe mohojnë shpalljet Tona – ata do të jenë banorë të zjarrit."²

"Atë që i paraqitet Zotit të vet si keqbërës, sigurisht që e pret Xhehenemi, ku as nuk do të vdesë e as nuk do të jetojë. Ndërsa kush paraqitet tek Ai si besimtar e që ka bërë vepra të mira, do të ngrihet në shkallë të larta."³

"Për ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, ka falje dhe dhunti fisnike. Ndërsa ata që përpiqen t'i luftojnë shpalljet Tona, duke menduar se nuk do t'i dënojmë, (dije se) njerëz të tillë janë banorë të Xhehenemit."⁴

"I tërë pushteti atë ditë i përket Allahut. Ai do t'i gjykojë të gjithë: ata që kanë besuar dhe kanë bërë vepra të mira, do të gjenden në kopshtet e begative, ndërsa ata që nuk kanë besuar dhe i kanë përgënjeshtuar shpalljet Tona, do të kenë dënim poshtërues."⁵

"E, atë ditë kur të arrijë Ora, ata (besimtarët dhe jobesimtarët) do të ndahen. Ata që kanë besuar dhe kanë bërë vepra të mira, do të gëzojnë në kopshtin e Xhenetit, kurse ata që kanë mohuar dhe kanë përgënjeshtuar shenjat Tona dhe takimin në jetën tjetër, do të hidhen në zjarr."⁶

Ajetet e nxitjes dhe të kërcënimit në Kur'an nuk mjaftohen vetëm me përmendjen e begative që do të përfitojnë besimtarët apo dënimin që do t'i kapë jobesimtarët në Botën Tjetër. Madje përmend edhe mirësinë që u vjen besimtarëve në këtë botë (Dynja) dhe vuajtjen e dënimin që i kap jobesimtarët, po në

1. Sure "En-Nisa", ajetet 56-57.

2. Sure "El-Maide", ajetet 9-10.

3. Sure "Ta ha", ajetet 74-75.

4. Sure "El-Haxh", ajetet 50-51.

5. Sure "El-Haxh", ajetet 56-57.

6. Sure "Er-Rum", ajetet 14-16.

këtë botë. Ajetet e mëposhtme janë shembuj që përkujtojnë mirësinë dhe lumturinë që u vjen besimtarëve në këtë botë:

O populli im! Kërkoni falje nga Zoti juaj dhe kthehuni tek Ai të penduar, se Ai do t'ju sjellë shi të begatshëm dhe do t'ju shtojë fuqi mbi fuqinë tuaj. Mos u shmangni prej Atij duke qenë keqbërës!"¹

"E u thashë: "Kërkoni falje nga Zoti juaj, i Cili është Falës i madh, që Ai t'ju dërgojë shi të bollshëm, t'ju shtojë pasurinë dhe fëmijët tuaj dhe të bëjë për ju kopshte e lumenj!"²

Ajetet e mëposhtme janë shembuj të përkujtimit të dënimit, që u zbret jobesimtarëve në jetën e kësaj bote:

"(Idhujtarët e Mekës thonë:) Sikur të kishte një Kur'an, me të cilin të lëviznin malet ose të copëtohej toka, ose të flisnin të vdekurit (që të besojmë Muhamedin)? Jo, e gjithë çështja i takon (vetëm) Allahut. Vallë, a nuk e dinë ata që besojnë se sikur të donte Allahu, do t'i kishte udhëzuar të gjithë njerëzit (në besim)?! Kurse, jobesimtarët (e Mekës), për atë që kanë bërë, vazhdon t'i godasë shkatërrimi apo të bjerë pranë shtëpive të tyre, derisa të kryhet premtimi i Allahut. Nuk ka dyshim se Allahu e kryen premtimin e Tij."³

"Kur erdhi urdhri Ynë, Ne e shpëtuam me mëshirën Tonë Shuajbin dhe ata që i besuan atij, kurse mohuesit i kaploi një zë i tmerrshëm dhe në shtëpitë e tyre u gdhinë të vdekur e të palëvizshëm."⁴

Disa nga ajetet e tjera kanë përmendur fitimin e shpërblimit për besimtarët dhe realizimin e ndëshkimit për jobesimtarët në secilën jetë, si të kësaj bote (Dynjasë), ashtu edhe të Botës Tjetër (Ahiretit). Ajetet e mëposhtme janë shembuj për këtë:

"Dhe Allahu u dhuroi atyre shpërblimin e kësaj bote dhe shpërblimin më të mirë të Jetës Tjetër. Allahu i do punëmirët."⁵

1. Sure "Hud", ajeti 52.

2. Sure "Nuh", ajetet 10-12.

3. Sure "Er-Ra'd", ajeti 31.

4. Sure "Hud", ajeti 94.

5. Sure "Ali Imran", ajeti 148.

“Për ata ka dënim në këtë jetë, por dënimi në Jetën Tjetër, me siguri, është edhe më i ashpër; për ata s’ka mbrojtës nga dënimi i Allahut.”¹

1.2- Motivimi nëpërmjet tregimit

Një prej mjeteve të rëndësishme që Kur’ani ka përdorur për të nxitur të mësuarin, është tregimi, sepse në metodën e rrëfimit të ngjarjeve, zgjohet entuziazmi i dëgjuesve derisa të ndiqen me vëmendje të plotë rrjedhimet e ngjarjeve që thuhën në tregim. Kur’ani, gjatë tregimit, ofron dhe propagandon ato qëllime fetare që lidhen me besimet apo shembujt e mësimit dhe të urtësisë, që ka parasysh t’u mësojë njerëzve.

“Në tregimet e atyre (të dërguarve) ka këshilla për ata që janë me mend. Ky (Kur’an) nuk është tregim i trilluar, por ai është vërtetues i atyre (librave) që janë shpallur para tij, është shpjegues i çdo gjëje dhe udhërrëfyes e mëshirë për njerëzit besimtarë.”²

Përveç kësaj, në tregimet kur’anore janë të pranishme bukuritë artistike, që i dallojnë ato prej tregimeve të tjera, duke e bërë më të lehtë gjetjen e udhës drejt objektivave fetarë në shpirtin e njeriut dhe më të thellë ndikimin e tyre në ndërgjegje.³

Në një pjesë të tregimeve vihet re se Kur’ani, në fillim, rrëfen përmbledhjen e tregimit, e pastaj detajet e tij, nga fillimi në fund. Këtë mënyrë rrëfimi e hasim fare qartë te tregimi i *As’habi Kehf*-it (Banorët e Shpellës). Rrëfimi i ngjeshur i tregimit, përpara rrëfimit të detajeve të tij, bëhet shkak i nxitjes së dëgjuesve dhe tërheqjes së vëmendjes së tyre, për të ndjekur hollësitë e tregimit.⁴

Në një pjesë të tregimeve kur’anore vihet re se tregimi nis me përmbledhjen e përfundimit. Përmbajtja e tregimit është diktuese. Më pas rrëfen hollësitë e ngjarjes. Këtë e shohim

1. Sure “Er-Ra’d”, ajeti 34.

2. Sure “Jusuf”, ajeti 111.

3. Sejjid Kutub, *Et-Tasui’u’l-fennij fi’l-Kur’an*, botimi i tretë, Daru’l-Mearif, 1975, f. 148.

4. Sejjid Kutub, *Et-Tasui’u’l-fennij fi’l-Kur’an*, botimi i tretë, Daru’l-Mearif, 1975, f. 148-149.

në tregimin e Hazretit Musa (*Paqja e Allahut qoftë mbi të!*), që ka ardhur në suren "El-Kasas". Përmendja e përmbajtjes dhe ngarkesa e mësuesisë në fillim bëhet shkak i nxitjes së dëgjuesve dhe vëmendjes së tyre për të ndjekur ngjarjet e tregimit, me qëllim njohjen e rrjedhjes së ngjarjes, përfundimin e së cilës e ka lexuar në fillim të tregimit.¹

1.3- Ndhurma prej ngjarjeve të rëndësishme

Një nga faktorët që ndihmon në zgjimin e motivit dhe tërheqjen e vëmendjes së njeriut, janë zhvillimet e një pjese të ngjarjeve apo e problemeve të rëndësishme, të cilat tronditin ndërgjegjen e njerëzve, duke vënë në lëvizje mendimet e tyre. Zakonisht njerëzit, si pasojë e ngjarjeve të rëndësishme që u ndodhin, janë të gatshëm të mësojnë atë këshillë dhe mësim që ekziston në këto ngjarje. Kur'ani është ndihmuar prej ngjarjeve të rëndësishme që u kanë ndodhur myslimanëve, duke u mësuar të tjerëve shembuj të dobishëm në jetë. Është e natyrshme që myslimanët, në çastin e zhvillimit të këtyre lloj ngjarjeve që zgjojnë ndërgjegjen e tyre, kanë një gatishmëri më të madhe dhe një gjendje më pranuese, për të nxënë mësim e për të marrë shembull të gjithanshëm.²

Një nga shembujt e kësaj teme ishte ngjarja që ndodhi në Luftën e Hunejnit, aty ku myslimanët u mburrën për bollëkun dhe fuqinë e tyre dhe ishin të sigurt se do të fitonin mbi jobesimtarët. Ata harruan se fitorja bëhet e mundur vetëm me ndihmën dhe dëshirën e Zotit. I madhi Zot, gjithashtu, deshi që t'u mësojë myslimanëve se fuqia nuk rezulton domosdoshmërisht me fitore. Zoti ndihmon vetëm atë grupim myslimanësh, besimi dhe devotshmëria e të cilëve ndërton dhe lumturon zemrat e tyre, ndonëse numri i tyre mund të jetë i paktë.³

1. Sejjid Kutub, *Et-Tasuiru'l-fennij fi'l-Kur'an*, botimi i tretë, Darul Mearif, 1975, f. 149.

2. Muhamed Shedid, *Menhexhu'l-Kur'an fi't-terbijeh*, Bejrut, Muessesetu'r-Risaleh, 1979, f. 277.

3. Abdul Fettah Xhelal, *Mine'l-usuli't-terbeuijeti fi'l-Islam*, f. 119.

“Në të vërtetë, Allahu ju ka ndihmuar në shumë beteja, si dhe në ditën e (luftës së) Huneinit, kur juve ju mahniti numri juaj i madh. Por ai numër nuk ju solli dobi aspak, sepse toka ju duk juve e ngushtë, edhe pse është e gjerë dhe kthyet shpinën duke ia mbathur. Pastaj, Allahu zbriti qetësinë e Tij mbi të Dërguarin e Vet dhe mbi besimtarët, si dhe zbriti luftëtarë (engjëj), të cilët ju nuk i patë dot e i dënoi jobesimtarët. Kështu u “shpërblyen” mohuesit.”¹

2- Përsëritja

Çështja e përsëritjes në shfaqjen e mendimeve të caktuara te njerëzit, zakonisht përfundon me fiksimin dhe kohëzgjatjen e këtyre mendimeve në mendjen dhe kujtesën e tyre. Kërkimet e psikologëve bashkëkohorë kanë provuar rëndësinë e përsëritjes në procesin e të mësuarit. Madje edhe shoqëritë tregtare dhe industriale kanë gjurmuar rëndësinë e përsëritjes në qëndrueshmërinë dhe zëvendësimin e një ideje në mendjet e njerëzve. Për këtë arsye shpenzojnë para të shumta për propagandim biznesi, ku idetë dhe mendimet e caktuara ua paraqesin në mënyrë të përsëritur njerëzve, derisa të ndikojnë në prirjet dhe modelet e tyre të konsumit duke propaganduar për artikujt e tyre të biznesit.

Ne vëmë re se në Kur'an është futur në përdorim përsëritja, për sa i përket disa realiteteve të lidhura me besimin (*Akiden*) dhe çështjeve të fshehta (që i përkasin *Gajbit*). Kur'ani dëshiron t'u bëjë vend në mendjet e njerëzve, sikurse *Teuhidi* (të besuarit në një Zot), që vetëm Zoti është burimi i të gjitha feve, dhe besimin në Ringjalljen dhe në Ditën e Kiametit, në llogari, në shpërblim dhe në ndëshkim në jetën e Botës Tjetër. Shumë nga ajetet e Kur'anit i përsëritin ato, me qëllim që të fiksohen në mendjet e njerëzve. Një nga shembujt e përsëritjes rreth besimit në një Zot që vlen të adhurohet, është sjellë në suren “En-Neml” (sure mekase). Në këtë sure është përsëritur pesë herë thënia: **“e ilahun me’Allahi?”** (Vallë, a ka krahas Allahut

1. Sure “Et-Teube”, ajetet 25-26.

zot tjetër?!), me qëllim që të ngulisë te mendjet Teuhidin.

“A ka më të mirë se Ai që ka krijuar qiejt dhe Tokën dhe lëshon për ju nga qielli ujë, me të cilin krijon kopshte të mrekullueshme?! Ju nuk mund t’i bëni pemët të rriten (pa këtë ujë). Vallë, a ka krahas Allahut zot tjetër?! Jo, por ata janë njerëz që i veshin (Allahut) të barabartë me Atë!”¹

Në suren “Hud” (sure mekase) po ashtu është përsëritur katër herë ftesa për Teuhid e për të adhuruar Zotin një e të vetëm. Në këtë sure, Kur’ani ka përmendur fjalën e disa prej Profetëve pararendës, që ata ia kanë thënë popujve të tyre, teksa i ftonin drejt Teuhidit dhe besimit në një Zot. Për shembull, thotë kështu rreth asaj që Nuhu (*Paqja e Allahut qoftë mbi të!*) tha për popullin e tij:

“Shumë kohë më parë, Ne dërguam Nuhun te populli i tij. (Ai u tha): “Unë jam për ju paralajmërues i hapët; që të adhuron vetëm Allahun. (Përndryshe), unë kam frikë për ju dënimin e një Dite të dhembshme.”²

Pastaj Kur’ani, në po këtë sure, përmend fjalët e Hudit, Salihut dhe Shuajbit (*Paqja qoftë mbi ta!*) ndaj popujve të tyre. Këtë e përsërit tri herë me një shprehje:

“Fisit Ad (Ne i dërguam) vëllanë e tyre Hudin. Ai tha: “O populli im, adhuron Allahun! Ju nuk keni Zot tjetër përveç Tij; ju jeni vetëm trillues.”³

“Fisit Themud (Ne i dërguam) vëllanë e tij, Salihun. “O populli im”, - u tha ai - “adhuron vetëm Allahun. Ju s’keni zot tjetër përveç Atij! Ai ju krijoi nga toka dhe ju vuri të jetoni në të; andaj, kërkon falje nga Ai dhe kthehuni me pendim tek Ai! Pa dyshim, Zoti im është afër dhe u përgjigjet (lutjeve).”⁴

Gjithashtu, shprehja *“U’budull-llahe ma lekum min ilahin gajrih”* (Adhuron Allahun! Ju nuk keni zot tjetër, përveç Tij!) në ajetet 23 dhe 32 të sures “El-Mu’minun”, që është sure mekase, është përsëritur dy herë.

1. Sure “En-Neml”, ajetet 60-64.

2. Sure “Hud”, ajetet 25-26.

3. Sure “Hud”, ajeti 50.

4. Sure “Hud”, ajeti 61.

Edhe tregimet e Profetëve në Kur'an janë sjellë në mënyrë të përsëritur, me qëllim që të rrënjoset te mendjet realiteti se të gjitha fetë janë nga ana e Zotit,¹ sepse Zoti i madhëruar të gjithë Profetët i ka dërguar drejt njerëzimit nëpër etapa të ndryshme të historisë, me qëllim që t'i udhëheqin ata dhe t'i ftojnë në besimin në një Zot të vetëm e të pashoq dhe të mos i atribuojnë Atij partner.

Argument tjetër për përsëritjen e tregimeve të Profetëve është dëftimi i fatit të përgënjeshtresve të Profetëve të shkuar, t'i paralajmërojë jobesimtarët kurejshë për një fat të ngjashëm, i cili i pret kundrejt përgënjeshtimit të Profetit të Islamit.

“Popullit të Medjenit Ne i dërguam vëllanë e tyre, Shuajbin. Ai tha: “O populli im, adhuroni Allahun! Ju s’keni tjetër zot përveç Tij. Mos bëni hile as gjatë matjes, as në kandar. Unë po shoh se ju gjendeni në begati dhe kam frikë se do t’ju godasë dënimi i një dite, që ju përfshin të gjithëve.”²

Përveç kësaj, në suren “El-Kamer” (sure mekase), shohim se është përdorur përsëritja, lidhur me përmendjen e dënimit, që do t’i kapë jobesimtarët, si dhe paralajmërimi i Zotit ndaj këtij dënimi. Kjo përsëritje bëhet që t’u tërhiqet vëmendja atyre dhe përmend fatin e personave që kanë përgënjeshtuar Profetët e mëparshëm, duke i paralajmëruar ata se, për sa kohë vazhdojnë të përgënjeshtrojnë Profetin e Islamit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), të njëjtin fat do të kenë.³

Në këtë sure (El-Kamer), ajeti i mëposhtëm është përsëritur tri herë:

“Eh, sa i tmerrshëm qe dënimi Im pas paralajmërimeve të Mia! Vërtet, Ne e kemi bërë Kuranin të lehtë për t’u kuptuar dhe kujtuar, prandaj, a ka ndonjë që të marrë këshillë?!⁴

“Vërtet, Ne e kemi bërë Kur’anin të lehtë për t’u

1. Sejjid Kutub, *Et-Tasuiru'l-fennij fi'l-Kur'an*, f. 109.

2. Sure “Hud”, ajeti 84.

3. Referohu tek *El-Kur'an ue 'ilmu'n-nefs*, Abdul Uehhab Hamude, Kajro, Daru'l-Kalem, 1962, f. 95-96.

4. Sure “El-Kamer”, ajetet 16, 17; 21, 22; 30, 32 dhe 40.

kuptuar dhe për t'u kujtuar, prandaj, a ka ndonjë që të marrë këshillë?!¹

Në suren "El-Murselat" (sure mekase) shprehja "*Uejlun jeumeidhin lil makedh-dhibijn*" (Mjerë mohuesit në atë ditë!) është përsëritur dhjetë herë. Kjo sure përmend shumë nga begatitë që Zoti u ka dhënë njerëzve, si dhe shumë nga fatkeqësitë që kanë zbritur për ta. Shprehja e mësipërme ka ardhur pas çdo begatie që Zoti u kujton njerëzve dhe pas çdo fatkeqësie me të cilën i frikëson ata. Kjo bëhet që të tërheqë vëmendjen e tyre te këto begati dhe fatkeqësi, derisa me përkujtimin e tyre të përmbahen nga përgënjeshtrimi i Profetëve dhe vazhdimësia e mohimit. Përveç kësaj, parimisht, në përsëritjen e një fjalie, ekziston një lloj efekti oratorik, me të cilën arabët janë të njohur. Kjo mënyrë e të shprehurit është e zakonshme në mesin e arabëve gjatë mbajtjes së ligjëratave dhe recitimit të poezive.²

Në Kur'an ka ajete të shumta që flasin rreth ringjalljes, Ditës së Kiametit, ditës së marrjes në pyetje, të kërkimit të llogarisë, begative të Parajsës, ndëshkimeve të skëterrës, krijimit të Ademit dhe Havasë (*Paqja e Allahut qoftë mbi ta!*) dhe armiqësisë së shejtanit me ta. Synimi i Kur'anit, me përsëritjen e këtyre lloj çështjeve të fshehta, është qëndrueshmëria, rritja e besimit në shpirtat e njerëzve, faktimi i besimeve (parimeve) dhe i shembujve (mësimeve) e këshillave, të cilat trajtohen në vazhdimin e rrëfimit të tyre.

Duhet pasur vëmendje se përsëritja e tregimeve në Kur'an nuk është përsëritje e plotë dhe monotone. Kur'ani përmend vetëm ato ngjarje të tregimeve që kanë përputhje me procesin e kuptimeve të gjendura në sure. Për shembull, sa herë që Kur'ani përsërit ndonjë pjesë të një tregimi, zakonisht fut në të ndonjë kuptim të ri, të cilin nuk e ka përmendur më parë dhe, në fjalët e tregimit, në përpjesëtim me shembullin që është qëllimi i tregimit, krijon paksa modifikim dhe zhvendosje. Kur'ani nuk i ritregon tregimet e Profetëve si aventura

1. Sure "El-Kamer", ajetet 17, 22, 32, 40.

2. Abdul Uehhab Hamude, po ai burim, f. 96- 97.

historike në të cilat duhet të ruhet kronologjia e ngjarjeve, por i përcjell për hir të shembujve dhe këshillave që gjenden në ndodhitë e tyre. Prandaj, Kur'ani ritregon atë kategori të ngjarjeve që është në përshtatje me shembullin që kërkon ta përhapë ndërmjet njerëzve.¹

Në këtë çështje, po ashtu nuk ka dyshim se qasja e disa ngjarjeve dhe ideve ndaj problemeve dhe shembujve të ndryshme, bëhet shkak i tërheqjes së vëmendjes dhe parandalon lodhjen e njeriut, që mund t'i vijë si pasojë e shfaqjes së ideve të caktuara në mënyrë të vazhdueshme. Kërkimet e psikologëve bashkëkohorë dhe të specialistëve të propagandës, kanë faktuar se për mënjanimin e lodhjes dhe tërheqjen e vëmendjes së njerëzve, ka shumë rëndësi ndryshimi i formës së shembujve, që janë shpjegues të një ideje të caktuar. Në ditët e sotme, specialistët e propagandës tregtare e respektojnë plotësisht këtë temë.

Në parim, përsëritja vë në vend çështjen e të mësuarit, qoftë ky mësim i një zakoni të mirë apo të keq nga ana e njeriut. Për shembull, përsëritja e një mësimi të shëmtuar nga njerëzit, bëhet shkak i stabilizimit të tij dhe e shndërron atë në një huq, që çlirimi prej tij do të mund të arrihej vetëm në sajë të një përpjekjeje të madhe dhe me vullnet të fuqishëm. Pra, për këtë arsye, mund të thuhet se përsëritja e besimeve dhe e zakoneve të vjetra, që politeistët i kishin mësuar prej baballarëve të tyre, ishte një prej fakteve të rrënjës së këtyre besimtarëve. Manifestimi i tyre në sjelljen e politeistëve ishte në atë mënyrë, sa që çlirimi prej tyre nuk ishte i lehtë për ta. Kur'ani ka vënë theksin në shumë ajete, lidhur me problemet që kanë ndeshur Profetët në të gjitha ciklet e historisë, për t'u mbushur mendjen politeistëve që të besonin në një Zot. Arsyeja e ekzistencës së këtyre problemeve për Profetët ishte se politeistët u përmbaheshin po atyre adhurimeve të vjetra dhe kishin ecur bashkë me to gjatë jetës së tyre.

Më parë, në kreun e katërt, i cili lidhej me temën e të menduarit në Kur'an, e vumë theksin në temën e gabimeve dhe

1. Abdul Uehhab Hamude, po ai burim, f. 103-105.

mpirjes mendore. Kur'ani e vë theksin në ndikimin e përsëritjes së mëkatit, sepse bëhet shkak që njeriu të mos tregohet i gatshëm për pranimin e ftesës për adhurimin e një Zoti. Kjo është ajo, që në shumë ajete përmendet si "Vulosja e zemrave".

Gjithashtu, Kur'ani ka përmendur forcën e zakoneve të shëmtuara dhe mëkateve, të cilat përftohen nëpërmjet përsëritjes. Këto zakone forcohen aq shumë te njeriu, sa mund të thuhet se mbi arsyen e tij është varur një perde e ndryshkur, që ndalon fuqinë e të dalluarit të saj. Njeriu e ka të vështirë ta çlirojë veten prej mëkateve që i ka bërë zakon. Kjo çështje është sjellë në ajetin e mëposhtëm:

"Nuk është ashtu! Por veprat e tyre (të këqija) ua kanë mbuluar zemrat."¹

Profeti i nderuar (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), në lidhje me këtë, thotë: "Sa herë që dikush kryen një mëkat, në zemër i shkaktohet një pikë e zezë. Nëse kryen sërish mëkat, atij i shkaktohet një tjetër pikë dhe ky proces vazhdon, aq sa atij i errësohet zemra njësoj si ngjyra e deles së zezë."

Në një tjetër transmetim thuhet: "Kryerja e përsëritur e mëkateve, e nxin në mënyrë të atillë zemrën, sa që në të nuk mbetet më shpresë për pendim."²

3- Vëmendja

Çështja e vëmendjes llogaritet si një faktor i rëndësishëm në të mësuar. Për shembull, nëse nuk i kushton vëmendje një fjalimi, nuk mund të perceptosh informacionet e nevojshme e, si rezultat, nuk je i aftë të mësosh dhe nuk mund ta sjellësh ndërmend atë temë në të ardhmen. Për vetë këtë arsye, mësuesit dhe edukatorët këmbëngulin gjithnjë që nxënësit të

1. Sure "El-Mutaffifin", ajeti 14.

2. Fjala "*rane*" në ajetin e lartpërmendur është një lloj sëmundjeje, të cilën e përmend Kur'ani dhe është në kuptimin e oksidimit (ndryshkut), apo pluhurit, apo të një shtrese të pistë, që zë sendet e çmuara. Ky interpretim në Kur'an është përdorur për personat, zemrat e të cilëve, si pasojë e kryeneçësisë dhe mëkateve të shumta, janë bërë të pandikueshme. Me transmetim prej Tefsirit "Nemune", vëll. 1, f. 86. - (përkthyesi nga arabishtja në persisht).

jenë të vëmendshëm ndaj tyre, me qëllim që ata të mund ta thithin dhe ta mësojnë plotësisht mësimin.

Ashtu siç thamë më parë, përdorimi që Kur'ani u bën tregimeve, është një faktor i rëndësishëm në zgjimin e vëmendjes dhe përmbajtjes së këshillave, shembujve dhe ftimit në adhurimin e një Zoti (*Teuhid*). Kur'ani ka përmendur rëndësinë e vëmendjes në thithjen dhe në perceptimin e informacioneve dhe të të dhënave. Allahu në Kur'an thotë kështu:

“Vërtet, këtu ka këshillë për këdo që ka zemër, dëgjon me vëmendje dhe dëshmon.”¹

Ky ajet ka ardhur pas një ajeti tjetër, në të cilin Zoti ka kujtuar se përpara kurejshëve ka shkatërruar kombe të shumta mohuesish, që ishin më kokëfortë e më të fuqishëm se kurejshët. Në këtë ajet theksohet se në këtë ndodhi gjendet e fshehur një këshillë për ata që kanë mend në kokë apo për ata që i dëgjojnë, i kuptojnë me gatishmëri dhe prani mendore dhe vëmendje të plotë këto fjalë.

Gjithashtu, Kur'ani, në suren “El-Muzzemmil”, aty ku përmend se ngritja nga gjumi në mesnatë bëhet shkak i vëmendjes më të madhe të njeriut ndaj kuptimit kur'anor dhe, si rezultat, i perceptimit më të mirë të tij, në të vërtetë, do të theksojë rëndësinë e çështjes së vëmendjes. Kjo çështje, mbase, nga njëra anë, i kthehet pushimit mendor në kohën e gjumit dhe qetësimit dhe, nga ana tjetër, lidhet me atë qetësi që përfshin natën anakënd dhe në atë çast nuk e angazhon mendjen njerëzore në çështjet e përditshme të jetës, të cilat zakonisht e shqetësojnë atë gjatë ditës.²

Kur'ani në lidhje me këtë, thotë:

“Natyrisht, adhurimi natën vepron më fuqishëm dhe fjala është më shprehëse.”³

1. Sure “El-Kaf”, ajeti 37.

2. Me transmetim nga Ebu'l Kasim El-Hasan ibn Muhamed El-Mufaddal Er-Ragib El-Esfahani, libri *Tafsilu'n-nesh'atejn ue tahsilu's-se'adetejn*.

3. Sure “El-Muzzemmil”, ajeti 6. Ibn Kethiri, në komentin e këtij ajeti thotë: “Pikësynimi është që të qëndruarit zgjuar (adhurimi i bërë) natën shkakton lidhjen më të mirë midis zemrës dhe gjuhës dhe është koha më

Edhe në çështjen e "Perceptimit dhe të mësuarit", Kur'ani e vë theksin mbi rëndësinë e vëmendjes.

"Kur të lexohet Kur'ani, dëgjoni dhe heshtni, në mënyrë që të mëshiroheni."¹

Të dëgjuarit e Kur'anit në heshtje, në të vërtetë, është për të rritur vëmendjen ndaj ajeteve të tij. Kur këndohet, me qëllim që të meditohet për kuptimin e ajeteve dhe të mësohet besimi, urdhëresat, ndalesat, që gjenden në të, është më se e qartë që kjo temë është tregues i rëndësisë së vëmendjes në të perceptuar dhe në të mësuar.

Një nga gjërat që ndihmon në përqendrimin e vëmendjes dhe e bën të lehtë punën e të mësuarit, është ofrimi i kuptimeve abstrakte sa më thjeshtë dhe sa më qartë. Kjo gjë kryhet patjetër me shëmbëllimin dhe me përngjasimin e kuptimeve të përmendura në gjërat reale dhe të prekshme, me qëllim që të jetë i mundshëm perceptimi dhe kuptimi i tyre.

Për këtë arsye, në ditët e sotme, mësuesit, për shpjegimin e ligjeve dhe ideve shkencore, më së shumti, përdorin instrumentet e dëgjimit dhe të shikimit, eksperimentet shkencore. Kjo gjë bëhet shkak i tërheqjes së vëmendjes së nxënësve dhe i ndihmon ata që të perceptojnë idetë e përmendura.

Tregimet dhe shembujt që gjenden në Kur'an, në të vërtetë, janë metoda të cilat Kur'ani i ka përdorur, me qëllim që t'i bëjë të shikueshme kuptimet e besimit islam dhe t'i afrojë ato për mendjet. Prandaj, dëgjuesi i tregimeve kur'anore shndërrohet në një spektator të ndodhive, në të cilat kristalizohen kuptimet e tregimeve.²

Kjo çështje, pa dyshim, e tërheq vëmendjen e tij në peizazhe të ulëta që kalojnë njëri pas tjetrit në mendje.

e përshtatshme për recitimin e Kur'anit. Për këtë arsye, Zoti thotë: *"Hije esheddu uet'aen ue ekuamu kijlen"*, që do të thotë: Njeriu natën angazhohet në këndimin e Kur'anit dhe të kuptuarit e tij, duke qenë se është më i qetë se ditën, sepse dita është koha e ecejakëve të njerëzve, fjalosjeve dhe e fitimit të jetesës së tyre. (Tefsir Ibn Kethir, vëll. 4, f. 435.)

1. Sure "El-A'raf", ajeti 204.

2. Muhamed Ali Taskhiri, *Et-Teuazun fi'l-Islam*, f. 141- 142; Sejjid Kutub, f. 62-73.

Shembujt luajnë po të njëjtin rol në Kur'an, sepse krijojnë ngjashmëri midis kuptimeve dhe gjërave të ndjeshme, i sjellin kuptimet në mënyrë të shikueshme. Vetë ky është thelbi i afrimit sa më të madh të këtyre kuptimeve me të kuptuarit dhe të perceptuarit e njerëzve.¹

Një nga pasqyrimet e shembujve është shembulli që ka ardhur në suren "Ibrahim", kur i madhi Zot, në vazhden e saj, mospërfitimin e qafirëve prej punëve të tyre në këtë botë, për shkak se nuk janë mbështetur në besim, e krahason me hirin, që ditën me stuhi, era e fortë e ngre lart atë dhe njeriu nuk mund ta mbajë dot.

Një pasqyrim tjetër i përdorimit të shembullit në Kur'an, është se fjalën e pastër dhe të mirë, Zoti e krahason me një pemë të lulëzuar e frytdhënëse, nga frytet e së cilës njerëzit përfitojnë. Ajo vetë i ka rrënjët thellë në tokë, ndërsa trugu dhe degët e saj arrijnë në qiell. Kjo pemë jep fryte kurdo që Zoti e cakton dhe me lejen e Tij.

Edhe fjala e Teuhidit është e qëndrueshme dhe me rrënjë të thella në zemrën e besimtarëve; puna e pastër e tyre ngjitet lart te Zoti dhe besimtarët i arrin në çdo kohë begatia dhe shpërblimi i saj.

Gjithashtu, Zoti e ka krahasuar *fjalën e pistë* me një *pemë të tharë*, së cilës i janë shkukur rrënjët nga toka. Si rrjedhim, nuk ka qëndrueshmëri. Po ashtu, edhe besimi i kotë (*akideja batile*) është i paqëndrueshëm dhe i shkatërrueshëm.²

Një pasqyrim tjetër është shembulli i dhënë në suren "Er-Ra'd", përgjatë së cilës Zoti shpjegon se *haku* (e vërteta) është e qëndrueshme, ndërsa *batili* (e kota) është e zhdukshme.

"Vepra e atyre, që nuk besojnë Zotin e tyre, i shëmbëllen hirit, të cilin e shpërndan era në një ditë të stuhishme. Ata nuk do të kenë asnjë dobi nga veprat që kanë punuar. Kjo është humbja e madhe."³

"Vallë, a nuk e sheh se si Allahu e përqas fjalën e mirë

1. Muhamed Ali Taskhirij, *Et-Teuazun fi'l-Islam*, f. 141-142; Sejjid Kutub, f. 142-143.

2. *El-Muntekhab fi Tefsiri'l-Kur'ani'l-Kerijm*, f. 368.

3. Sure "Ibrahim", ajeti18.

me pemën e mirë, e cila rrënjën e ka të fortë në tokë, kurse degët nga qielli? Me lejen e Zotit të saj (pema) jep fruta në çdo kohë. Allahu u tregon shembuj njerëzve, që t'ua vënë veshin. Fjala e keqe është si pema e keqe me rrënjë të shkulura, e paqëndrueshme për ekzistencë.”¹

Qëndrueshmërinë e së vërtetës dhe zhdukjen e së kotës e ka shëmbëllyer me gjërat që i bartin përrenjtë gjatë rrjedhës së tyre. Në këtë lëvizje mbeten gjërat që janë të dobishme për njerëzit dhe, ajo si “shkumë” nuk ka dobi për ta, del në sipërfaqe të ujit dhe asgjësohet.

I madhi Zot, qëndrueshmërinë e së vërtetës dhe venitjen e së kotës e ka krahasuar me metalet në kohën që i fryhet zjarrit tek ta. Ajo kategori metalesh që ka dobi për njerëzit, duron, qëndron dhe nuk asgjësohet. Sikurse ari dhe argjendi, me të cilët bëhen stoli dhe gjëra të çmuara, apo hekuri dhe bakri, me të cilët bëhen mjete dhe vegla të dobishme. Ndërsa ajo, që nuk ka dobi për njerëzit, del në sipërfaqe teksa valon e mënjanohet e pastaj flaket jashtë.

“Ai e zbrit shiun nga qielli, prandaj rrjedhin lumenjtë me masë dhe rrjedha bart mbeturinat mbi sipërfaqen e ujit. Edhe zgjyra, kur e shkrijnë njerëzit në zjarr që të bëjnë stoli ose vegla, është mbeturinë, si ajo. Kështu, Allahu jep shembullin e së vërtetës dhe të së pavërtetës: Mbeturinat hidhen, ndërsa ajo që u shërben njerëzve mbetet në tokë. Kështu, Allahu i shpjegon shembujt.”²

Disa nga suret kur'anore nisin me germa, si: Elif Lam Mim, Elif Lam Ra, Elif Lam Mim Sad, Elif Lam Mim Ra, Kef He Je Ajn Sad, Ta Sin Mim.

Komentuesit e Kur'anit kanë bërë komente të ndryshme, lidhur me këto germa të ndërprera. Një nga thëniet rreth komentimit të shkronjave të lartpërmendura është: qëllimi për sjelljen e tyre është tërheqja e vëmendjes së politeistëve për ta dëgjuar Kur'anin. Politeistët, më parë, i patën rekomanduar njëri-tjetrit që të mos ia vënë veshin Kur'anit.

1. Sure “Ibrahim”, ajetet 24-26.

2. Sure “Er-Ra’d”, ajeti 17.

Mirëpo, nisja e Kur'anit me shkronjat e lartpërmendura, i ngacmon veshët e politeistëve për dëgjimin e ajeteve, duke u thënë se fjalët e tij janë shkruar nga këto shkronja.¹

Rast tjetër që të tërheq vëmendjen, është përdorimi i betimit në fillim të disa sureve mekase. Pesëmbëdhjetë sure kur'anore nisin me betim të llojit: *Ues-Saffat, uedh-Dharijat, uet-Tur, uen-Nexhm, ues-Sema'i dhati'l-buruxh, ues-Sema uet-Tarik, uel-Fexhr, uel-Asr*.

Arsyeja e përdorimit të betimit ka qenë tërheqja e vëmendjes, sepse, në veshin e lexuesit, arrin si një lloj frikësimi dhe alarmimi. Në këtë formë, për perceptimin e fjalëve në psikikën e njeriut krijohet një lloj përgatitjeje, sepse betimi është një gjë alarmuese dhe njeriu, në një situatë të tillë, përqendrohet më shumë ta dëgjojë, sesa kur, për shembull, e fillon me debat dhe diskutimin e fjalëve të veta.²

Përveç kësaj, stili kur'anor përmban veçorinë e mrekullisë së elokuencës dhe të melodisë së veçantë, që të drithëron ndërgjegjen dhe të tërheq vëmendjen. Metoda kur'anore e përmban këtë veçori që ka harmoninë më të lartë e më të bukur me kuptimet dhe domethëniet e saj.

Kjo falë dimensionit të veçantë, të ndryshëm nga e zakonshmja e frazave, pasi njeriu, kuptimin e fjalës e trupëzon në mendjen e tij, teksa dëgjon zërin dhe mënyrën e shqiptimit të saj.³

Kjo çështje, pa dyshim, bëhet shkak i tërheqjes së vëmendjes së tij dhe shkakton tek ai një gjendje, në mënyrë që ta ndiejë situatën që paraqet Kur'ani. Nga ana e vet, kjo rezulton me thithjen me kujdes të kuptimeve dhe perceptimit të gjithanshëm të tyre.

1. *Tefsir Ibn Kethir*, vëll. 1, f. 37; *Tefsiru'l-Menar*, vëll. 1, f. 122. Autori ka për qëllim që të krijojë një lloj paqeje midis politeistëve dhe Kur'anit, nëpërmjet dëgjimit të këtyre germave të ndërprera. Kur'ani, po ashtu, me të vërtetë është shkruar nga vetë këto germa të ndërprera, që bartin një melodi të veçantë dhe tërheqin vëmendjen e politeistëve. Prandaj nuk ekziton ndonjë argument, që ata të mos e dëgjojnë atë.

2. Abdul Uehhab Hamudeh, *El-Kur'an ue ilmu'n-nefs*, f. 16- 17.

3. Muhamed Ali Taskhirij, *Et-Teuazun fi'l-Islam*, f. 143-144.

4- Pjesëmarrja aktive

Për mësimin e zhdërvjelltësive lëvizëse është e nevojshme që njeriu të mësohet të angazhohet me kryerjen praktike të këtyre ushtrimeve, duke u ushtruar vazhdimisht. Ushtrimi praktik nuk është i nevojshëm vetëm në mësimin e zhdërvjelltësive lëvizëse, por ka rëndësi edhe në mësimin e shkencave të zbatuara dhe teorike, sjelljen morale, virtyteve, vlerave e rregullave të sjelljes shoqërore. Nëse njeriu e kryen vetë një punë që do të mësojë, kjo ndihmon në shpejtësinë dhe në vëmendjen e të mësuarit të tij.

Rezultatet e njërës prej kërkimeve shkencore e kanë zbardhur këtë çështje: individët që i lexonin vetë disa nga fjalët që i ishin vënë përballë, në mbajtjen mend të tyre ishin më të shpejtë dhe më të suksesshëm se personat që, po këto fjalë, ua lexonte vetëm mësuesi apo përgjegjësi i qendrës së eksperimenteve dhe ata vetëm dëgjonin. Gjithashtu, ata ishin më të suksesshëm se personat që, ndërsa mësuesi u lexonte fjalët, ua paraqiste mbi perde pamjet e atyre fjalëve.¹

Rezultati i këtij eksperimenti tregon rëndësinë e pjesëmarrjes aktive në procesin e të mësuarit. Në Kur'an shohim se është vepruar në thelbin e "pjesëmarrjes aktive". Kjo çështje del në pah prej metodës që Kur'ani ka pasur parasysh për të mësuarin e veçorive të pëlqyera psikike, moralit e shprehive të sjelljes së shkëlqyer. Kjo metodë, në të vërtetë, është mësimi i myslimanëve nëpërmjet ushtrimit praktik në kryerjen e adhurimeve të ndryshme, për zbatimin e të cilave Kur'ani i ka deleguar. Për shembull u mëson myslimanëve marrjen e abdesit dhe faljen e namazit në kohët e caktuara për çdo ditë, pastrimin, bindjen, rregullin, durimin, qëndrueshmërinë dhe agjërimin. U mëson moralin e bindjes dhe të qëndrësës në përballimin e vështirësive dhe mëshirimin ndaj të vobektëve.

Haxhi u mëson bindjen dhe durimin në përballimin e problemeve. Në kapitullin e dhjetë, "Psikoterapia në Kur'an", do t'i shpjegojmë më hollësisht dobritë e adhurimeve.

1. Muhamed Uthman Nexhati, *Ilmu'n-nefs fi hayatina'l-jeumijeh*, f. 196-197.

Kur'ani, krahas mësimit të besimit dhe parimeve fetare te myslimanët, i ka kushtuar një vëmendje të madhe nxitjes dhe udhëheqjes së tyre drejt kryerjes së punëve të mira. Besimi i vërtetë duhet të pasqyrohet në sjelljen dhe veprimin e besimtarit. Një besim i tillë është i mundshëm vetëm me stolisjen e besimtarit me moral të mirë dhe kërkimin e së mirës për të gjithë njerëzit dhe garimit në kryerjen e punëve që sjellin kënaqësinë e Zotit e të Profetit të Tij të nderuar (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Për këtë arsye, besimi në shumë prej ajeteve të Kur'anit ka ardhur përkrah punës së mirë. Ajetet e mëposhtme janë shembuj të kësaj kategorie:

“Ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, përgëzoji me kopshte të Xhenetit, nëpër të cilat rrjedhin lumenj. Sa herë që atyre do t’u jepet si ushqim ndonjë fryt i kopshteve, ata do të thonë: “Këtë e kemi ngrënë dhe më përpara.” Por atyre do t’u jepen vetëm fruta të ngjashme me ato të Tokës. Në Xhenet ato do të kenë bashkëshorte të pastra dhe atje do të jetojnë përgjithmonë.”¹

“Kurse ata që besojnë e bëjnë vepra të mira, do të jenë banorët e Xhenetit, ku do të qëndrojmë përgjithmonë.”²

“Ata që besojnë e kryejnë vepra të mira, falin namazin dhe japin zekatin, do të kenë shpërblim te Zoti i tyre dhe nuk do të kenë pse të frikësohen apo pikëllohen.”³

“Ndërsa atyre që besojnë dhe punojnë vepra të mira, Zoti do t’u japë shpërblimin e merituar. Allahu nuk i do punëmbropshtët.”⁴

“Allahu u ka premtuar falje (të gjynaheve) dhe shpërblim të madh atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira.”⁵

“Sa për atë që beson dhe bën vepra të mira, atij i takon shpërblimi më i mirë dhe do t’i premtojmë atij lehtësira.”⁶

1. Sure “El-Bekare”, ajeti 25.

2. Sure “El-Bekare”, ajeti 82.

3. Sure “El-Bekare”, ajeti 277.

4. Sure “Ali Imran”, ajeti 57.

5. Sure “El-Maide”, ajeti 9.

6. Sure “El-Kehf”, ajeti 88.

“Vërtet, Unë jam Falës për atë që pendohet, beson e bën vepra të mira dhe pastaj qëndron në rrugë të drejtë.”¹

5- Shpërndarja e të mësuarit

Kërkimet eksperimentale që kanë kryer psikologët bashkëkohorë, kanë vërtetuar se shpërndarja e të mësuarit ose të ushtruarit e tij në distanca kohore, larg njëra-tjetrës, duke u çlodhur për ca kohë, ndihmon në shpejtësinë e të mësuarit dhe në fiksimin e tij në kujtesë.

Gjithashtu, këto kërkime kanë nxjerrë në pah se të mësuarit, duke përdorur metodën e shpërndarjes, është shumë më efikas se të mësuarit nëpërmjet metodës së përqendrimit. Metoda e përqendrimit është një metodë, ku të mësuarit realizohet gjatë një periudhe kohore të pandërprerë dhe pa pushim.²

Edhe në Kur'an i është kushtuar vëmendje këtij thelbi, sepse Kur'ani është zbritur në distanca kohore larg njëra-tjetrës, përgjatë një periudhe 23-vjeçare, me qëllim që njerëzit të mund ta mësonin atë gradualisht dhe t'i përthithnin plotësisht kuptimet dhe domethëniet e tij. Kjo çështje ka ndihmuar në mësimin, në kuptimin dhe në memorizimin e Kur'anit. Nëse i tërë Kur'ani do të zbritet njëherazi e në një vend, të mësuarit dhe të kuptuarit e ajeteve dhe qëllimeve të tyre do të ishte i vështirë.

“Ky është një Kur'an, që Ne e kemi ndarë pjesë-pjesë, që ti t'ua mësosh njerëzve pak nga pak, duke e shpallur atë kohë pas kohe.”³

“Jobesimtarët thonë: “Përse Kur'ani nuk i është shpallur i tëri përnjëherë?!” Ne ta kemi shpallur kështu për të forcuar zemrën tënde dhe ta kemi zbuluar qartazi varg pas vargu.”⁴

1. Sure “Ta ha”, ajeti 82.

2. Muhamed Uthman Nexhati, *Ilmu'n-nefs fi hajatina'l-jeumijeh*, f. 190-194.

3. Sure “El-Isra”, ajeti 106. Në komentimin e këtij ajeti, në librin *El-Muntekhab fi tefsiri'l-Kur'ani'l-Kerijm* thuhet se fraza *“ue Kur'anen farak-nahu litekraehu ala'n-nasi ala mukth”* ka kuptimin, e zbritëm këtë Kur'an në mënyrë graduale për një periudhë të gjatë, që ta lexosh atë sipas rastit dhe për ta kuptuar njerëzit.

4. Sure “El-Furkan”, ajeti 32. *“kedhalike linuthebbite bihi fuadek”* do të thotë ne e zbritëm Kur'anin, në mënyrë të shpërndarë, që të forcojmë zemrën tënde nëpërmjet

6- Rregullimi i sjelljes në mënyrë graduale

Çlirimi prej disa zakoneve të forta e të shëmtuara, të cilat i kemi kryer për një periudhë të gjatë kohore, aq sa na janë shndërruar në një pjesë të patundur të sjelljes sonë, për shumë nga njerëzit nuk është një punë e lehtë, sepse duhet një vullnet i fortë, një përpjekje e madhe dhe ushtrim i vazhdueshëm për t'u shkëputur prej tyre. Prandaj, mënyra më e mirë për t'u larguar prej tyre është veprimi në mënyrë graduale. Për shembull, largimi i frikës bëhet gradualisht duke vënë një reagim kundërshtar të saj, si reagimi i gëzimit dhe i dashurisë, deri sa më në fund, të kemi sukses në çlirimin e plotë prej frikës. Disa nga eksperimentet e kryera nga psikologë bashkëkohorë kanë arritur në përfundimin se, me anë të kësaj metode, mund të çlirohet fëmija prej frikës (nga një kafshë e caktuar), duke i mësuar atij dashurinë për të.¹

Me këtë metodë mund ta çlirojmë veten prej shprehive të shëmtuara, duke vënë shprehitë kundërshtare të tyre. Disa nga psikologët bashkëkohorë e ndjekin vetë këtë metodë në psikoterapi.

Përpara shpalljes së Islamit, tek arabët ekzistonte një zinxhir shprehish e zakonesh të shëmtuara, që në etapën e parë të ftimit në Islam nuk ishte e lehtë t'u kërkohej që të hiqnin dorë prej tyre, sepse ishin mësuar me to prej kohësh. Për këtë arsye, Islami ka përdorur dy metoda për kurimin e këtyre zakoneve. Metoda e parë ishte shtyrja e kurimit të tyre deri në forcimin e besimit në zemrat e tyre, në mënyrë që të mund të merrnin ndihmë nga fuqia e besimit, si një motiv i fortë që t'u lehtësonte punën e çlirimit prej zakoneve të fiksuara dhe në vend të tyre u mësonin zakone të reja.

Për këtë arsye, shumica e ajeteve kur'anore, që në fillim të ftimit në Islam, janë zbritur në Mekë dhe janë të lidhura me ftimin e njerëzimit drejt besimit në një Zot (*Teuhid*). Profeti i

familjarizimit me të dhe memorizimit të tij. "*Rettelnahu tertila*": domethënë e bëmë atë pjesë, ose e lexuam atë me anë të gjuhës së Xhebrailit, gradualisht e me stepje dhe afat. Referohu tek *El-Muntekhab fi tefsiri'l-Kur'ani'l-Kerijm*.

1. Muhamed Uthman Nexhati, *Ilmu'n-nefs fi hajatina'l-jeumijeh*, f. 137-138.

Islamit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ndiente përgjegjësi për edukimin shpirtëror të njerëzve që i ishin bashkuar ftesës së tij.

Kjo gjë ishte aq e rëndësishme dhe e domosdoshme në parapërgatitjen e psikikës së myslimanëve, sa që ata parapërgatiteshin për një kohë të gjatë për ndryshimin e sjelljes, zakoneve dhe sistemin e tyre të jetës. Gjithashtu, u parapërgatitën për pranimin e ajeteve që zbritën më pas, në lidhje me ndalimin e atyre zakoneve qarkulluese, si: pirja e alkoolit, ngrënia e kamatës, kumari etj. Në fillim e kishin vështirë t'i braktisnin këto zakone, por, kur besimi u rrënjos thellë në zemrat e myslimanëve, ai u bë një motivacion i fortë që t'i binden të madhit Zot dhe Profetit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe të pranojnë vullnetarisht gjërat për të cilat ishin urdhëruar. Për shembull, kur u zbriti ajeti për ndalimin e pirjes së alkoolit, të gjithë myslimanët s' dëgjuan të pinin më në qytetin e Medinës.

Ndërsa metoda e dytë që Kur'ani përdori për shërimin e zakoneve të forta, të shëmtuara e të fiksuara te myslimanët, ishte parapërgatitja graduale e psikikës së tyre për t'u çliruar nga këto zakone. Kjo punë u realizua nëpërmjet shkaktimit të një lloj reagimi të kundërt përballë zakoneve prej të cilave duheshin çliruar.

Në lidhje me shërimin e "sëmundjes" së pirjes së alkoolit, Kur'ani ka përdorur po këtë metodë, domethënë, në fillim u mor me neveritjen e pijeve alkoolike, para se t'i ndalonte ato plotësisht. Atëherë i çoi myslimanët gradualisht drejt ndalimit të plotë. I pari ajet që zbriti në lidhje me alkoolin, vë theksin mbi këtë çështje: dëmet e alkoolit janë më të shumta se dobitë e tij. Kjo çështje u bë shkak që myslimanët të ndienin neveri për alkoolin dhe të nxiteshin që të mos e pinin atë, aq sa disa prej sahabëve, pas zbritjes së këtij ajeti, e lanë pirjen e alkoolit. Ndërkohë që për myslimanët që nuk e kishin lënë atë tërësisht, Zoti thotë:

"Të pyesin ty për verën dhe kumarin. Thuaju: "Ato sjellin dëme të mëdha (gjynahe), por edhe dobi për njerëzit.

Megjithatë, dëmi i tyre është më i madh se dobia.” Të pyesim se çfarë të japin si lëmoshë. Thuaju: “Tepricën!” ja, kështu jua shpjegon Allahu shpalljet e Tij, që mund të mendoni.”¹

Pas zbritjes së ajetit të mësipërm, Kur'ani zuri të merrej në mënyrë më të prerë me neveritjen e alkoolit, duke i nxitur myslimanët që të përmbahen dhe të mos e pinë atë. Kjo u realizua kur disa prej sahabëve falnin namaz në gjendje të dehur e, si rrjedhojë, ngatërroheshin teksa këndonin Kur'an (në namaz). Gjithashtu, Kur'ani e ndaloi dhe e bëri haram për ata faljen e namazit në gjendje të dehur. Sipas këtij rendi, në të vërtetë, u ndalua pirja e alkoolit në më të shumtën e kohës ditore.

“O besimtarë! Mos u falni kur jeni të dehur, prisni të kthjelloheni e të dini se ç'flisni; as kur jeni të papastër (xhunub) – përveçse nëse jeni duke udhëtuar, derisa të laheni. Dhe, nëse jeni të sëmurë ose gjendeni në rrugë, ose keni kryer nevojën natyrore, ose keni bërë marrëdhënie me gra dhe nuk gjeni ujë, atëherë fërkoni fytyrën dhe duart tuaja me dhë të pastër. Allahu, me të vërtetë, është Shlyes dhe Falës i gjynaheve.”²

Konkretisht, ndalimi i pirjes së alkoolit pesë herë në ditë përkon me shumicën e orëve ditore, llogaritet si një lloj ushtrimi dhe shkulje e të pirit për myslimanët. Po ky ushtrim, nga pikëpamja psikike, i parapërgatiti ata për kalimin në fazën e mëpasshme: ndalimin e plotë të pirjes së alkoolit. Kjo fazë u plotësua me zbritjen e një ajeti, i cili e ndalon plotësisht e në formë të prerë pirjen e alkoolit.

“O besimtarë! Me të vërtetë, pijet alkoolike, bixhozi, idhujt dhe shigjetat e fallit janë vepra të ndyta nga punët e djallit. Prandaj, largohuni nga këto, me qëllim që të shpëtoni! Vërtet, djalli, me pije alkoolike dhe me bixhoz, kërkon që të fusë midis jush armiqësi e urrejtje dhe t'ju shmangë nga të kujtuarit e Allahut dhe kryerja e namazit. Prandaj, a po hiqni dorë?”³

1. Sure “El-Bekare”, ajeti 219.

2. Sure “En-Nisa”, ajeti 43.

3. Sure “El-Maide”, ajetet 90-91.

Kjo metodë graduale, e cila u përdor për ndalimin e alkoolit, pak e nga pak e reduktoi interesin e myslimanëve për alkoolin dhe, në vend të tij, fiksoi një lloj reagimi të kundërt: neverinë. Pas këtyre aksioneve, kur zbriti ajeti i ndalimit të alkoolit, të gjithë myslimanët e Medinës i derdhën nëpër rrugët e qytetit të gjitha pijet alkoolike që gjendeshin në shtëpitë e tyre, duke u çliruar prej të ligës së tyre. Nëse ajeti i ndalimit të alkoolit do të zbriste në Mekë dhe gjatë fillimit të fazave të thirrjes në Islam, nuk do të pritej se do të ndikonte te myslimanët, siç ndodhi kur zbriti në Medinë. Pra, kur ajeti zbriti në Medinë, domethënë kur besimi ishte forcuar në zemrat e tyre, ndalimi gradual i alkoolit i kishte parapërgatitur ata që më parë nga pikëpamja psikike, që, sapo të zbriste ajeti i ndalimit të pirjes së alkoolit, të hiqnin merakun prej tij.

Transmetohet nga Aishja se ka thënë: “Surja e parë që u zbrit, ishte një sure e shkurtër, në të cilën është përmendur kujtimi i Parajsës dhe i Ferrit. Ky proces vijoi në po këtë mënyrë, derisa njerëzit u prirën kah Islami. Pastaj zbritën çështjet e hallallit dhe të haramit (lejimi dhe ndalimi). Nëse në fillim të Islamit do të zbriteshin diçka e tillë, si *“la teshrebu’l-khamr”* (Mos pini alkool!), do të thoshin: “Ne kurrë nuk do ta lëmë alkoolin!” Apo nëse do të zbriteshin rregulli i ndalimit të zinasë (marrëdhënieve të jashtëligjshme martesore) *“la teznu”*, do thoshin: “Ne kurrë nuk e lëmë zinanë!”¹

Vetë Kur’ani e ndoqi këtë metodë për ndalimin e kamatës, e cila ishte e përhapur mes arabëve të periudhës së injorancës dhe u mor me ndalimin gradual të saj. Në çështjen e ndalimit të kamatës, mund të vëmë theksin në katër faza.² Në fazën e parë, i madhi Zot, në ajetin e mëposhtëm, shfaq kundërshtimin e përdorimit të kamatës.

“Kur Ne u japim njerëzve ta shijojnë dhuntinë, ata gëzohen me të e, kur i godet fatkeqësia për atë që kanë bërë me duart e tyre, atëherë e humbin shpresën.”³

1. Fet’hul Barij bi sherhi Sahih’i’l-Bukhari, vëll. 19, f. 48.

2. Mustafa Er-Rafii, *El-Islam ue mushkilatu’l-asr*, Bejrut, Daru’l-Kitabi’l-Lubnanij, 1972, f. 200-201.

3. Sure “Er-Rum”, ajeti 39.

Në fazën e dytë u zbrit një ajet, në të cilin ishin kërcënuar çifutët për shkak të ngrënies së kamatës. Vetë kjo është një shenjë mbi ndalimin e kamatës, ndonëse nuk ka ndonjë theksim të qartë mbi ndalimin e saj:

“Ne ua ndaluar atyre disa ushqime të mira, të cilat ishin të lejuara për ta, për shkak të prapësive që bënë, për shkak se ata pengonin shumë njerëz nga udha e Allahut, për shkak se merrnin kamatë, megjithëse kjo ishte e ndaluar për ta dhe për shkak se përvetësonin padrejtësisht pasurinë e njerëzve. Jobesimtarëve midis tyre, Ne u kemi përgatitur një dënim të dhembshëm.”¹

Në fazën e tretë, i madhi Zot e ndaloi atë kamatë imorale me interesa disafish, që ishte normale tek arabët e periudhës së injorancës paraislame. Dhe thotë:

“O besimtarë! Mos pranoni kamatë të shumëfishtë mbi kamatë! Kijeni frikë Allahun, që të shpëtoni.”²

Në fazën e katërt, në ajetet e mëposhtme, i madhi Zot e ndaloi në formë të prerë kamatën:

“Allahu! Nuk ka Zot tjetër (që meriton adhurim) përveç Tij, të Gjallin, të Përvetshmin, Mbajtësit të gjithçkaje! Atë që nuk e kaplon as dremitja, as gjumi! Atij i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe gjithçka në Tokë. Kush mund të ndërhyjë tek Ai për ndokënd pa lejen e Tij? Ai di çdo gjë që ka ndodhur më para dhe çdo gjë që do të ndodhë pas njerëzve, kurse ata nuk dinë të përvetësojnë asgjë nga Dituria e Tij, përveçse aq sa dëshiron. Kursiu i Tij shtrihet në qiej dhe ai nuk e ka të rëndë t’i ruajë ato. Ai është i Larti, Madhështori! S’ka detyrim në fe, sepse tashmë është dalluar e drejta nga e shtrembra! Ai që mohon idhujt (dhe gjithçka që adhurohet në vend të Allahut) dhe beson në Allahun, e ka siguruar lidhjen më të fortë, e cila nuk këputet kurrë. Allahu dëgjon dhe di gjithçka.”³

“Allahu është Mbrotjtësi i atyre që besojnë. Ai i nxjerr nga errësira në dritë. Sa për ata që nuk besojnë, mbrotjtësi

1. Sure “En-Nisa”, ajetet 160-161.

2. Sure “Ali Imran”, ajeti 130.

3. Sure “El-Bekare”, ajetet 275-276.

i tyre është djalli, i cili i nxjerr nga drita dhe i shpie në errësirë. Këta janë banorët e Zjarrit (të Xhehenemit), ku do të qëndrojnë përgjithmonë. A nuk ke dëgjuar ti (Muhamed) për atë që bëri fjalë me Ibrahimin për Zotin e tij, sepse Allahu i kishte dhënë pushtet? Kur Ibrahim i tha: “Zoti im është ai që jep jetë dhe shkakton vdekje.”, - ai u përgjigj: “Edhe unë mund të jap jetë e të shkaktoj vdekje.” Ibrahim pastaj i tha: “Allahu e sjell Diellin nga lindja. Sille ti nga perëndimi!” Atëherë, ai (mohuesi) mbeti me gojën hapur. Allahu nuk i udhëzon ata që janë keqbërës.”¹

Ajeti i parë që është zbritur për kamatën, domethënë ajeti që thekson mospëlqimin e të madhit Zot ndaj ngrënies së kamatës, është mekas. Ndërsa ajetet e tjera që zbritën më pas, veçanërisht ajetet që e ndalojnë prerazi kamatën, janë medinase. Prej këtui del në pah se ndalimi i plotë i kamatës është realizuar fill pas forcimit të besimit në zemrat e myslimanëve.

Metoda që Kur’ani ka pasur parasysh për kurimin e “sëmundjes” së pirjes së alkoolit dhe ngrënies së kamatës është metoda e krijimit gradual të neveritjes së alkoolit dhe kamatës te myslimanët. Kjo neveritje duhej të bëhej aq e fuqishme, sa të mund të triumfoje mbi interesimin dhe prirjen e tyre kah pijeve alkoolike dhe kamatës. Sipas kësaj mënyre, Kur’ani mundi të kurojë me sukses këto dy zakone të forta, të fiksuara në sjelljen e arabëve, me një metodë të mirëlllogaritur me shumë kujdes, dhe me urtësi t’i asgjësojë ato.

Disa prej psikoterapistëve, me ndihmën e kërkimeve të B.F. Skinner, së fundi kanë në dorë një metodë psikoterapie që, në një masë të gjerë, i ngjason metodës që Kur’ani ka përdorur në çështjen e ndalimit të pijeve alkoolike dhe kamatës. Kjo metodë në terminologjinë e Psikoterapisë është e njohur me emrin “Formim”. Një prej shembujve të rregullimit të sjelljes nëpërmjet Formimit, ishte gjendja e një të sëmurit psikik, i cili ishte duke u kuruar në një klinikë psikiatrike. Ai hezitonte të shkonte në një dhomë të veçantë, e cila ishte bërë për kryerjen e disa eksperimenteve mbi të sëmurët dhe ndodhej në katin paralel të klinikës.

1. Sure “El-Bekare”, ajetet 278-279.

Metoda e përdorur me këtë të sëmure për ta nxitur që të futet në dhomën e lartpërmendur, ishte e këtillë që ai merrte shpërblim për kryerjen e punëve që e afronin atë gradualisht drejt objektivit të dëshiruar (hyrjes në dhomë). Për shembull, kur për herë të parë i sëmuri ktheu kokën në anën e derës, e cila hapej në ballkonin që përfundonte në katin paralel, mjeku i terapisë, menjëherë i dha të sëmurit një copë ëmbëlsire, siç ai e pëlqente. Kjo punë u bë shkak që i sëmuri të përsëriste me shpejtësi të shikuarin drejt derës në fjalë dhe, për çdo shikim, gjithashtu, të merrte si shpërblim një numër ëmbëlsirash.

Pas përsëritjes disa herë të kësaj metode, i sëmuri hodhi disa hapa dhe qëndroi përballë derës. Në fund të kësaj faze, mjeku i terapisë ia ndërpreu shpërblimin. Ai do të merrte ëmbëlsira, nëse do të hidhte ndonjë hap drejt derës. Edhe kjo fazë mbaroi pas marrjes së disa shpërblimeve nga ana e të sëmurit. Faza e mëpasshme, domethënë hedhja e hapit të të sëmurit drejt ballkonit, që përfundonte në katin paralel, nisi me po atë mënyrë, me dhënien e shpërblimit. Kurimi vazhdoi për disa ditë me po këtë mënyrë, derisa i sëmuri zbriti vetë, poshtë nga shkallët dhe u fut në dhomën e posaçme eksperimentale.¹

Po ashtu, nëse dëshironi që ndonjë fëmijë t'i mësoni ndonjë lloj reagimi problematik, mund të bëheni të suksesshëm nëpërmjet shkaktimit dhe formimit gradual të sjelljes së lartpërmendur tek fëmija. Për shembull, nëse një fëmijë nuk e ka mësuar shkuarjen në banjë në kohën e përshtatshme, veproni në mënyrë të tillë, që në fazën e parë, kur ai reagon pozitivisht me shkuarjen në banjë, e nxisni atë me dhënie shpërblimi (ëmbëlsirë). Pas përshkrimit të kësaj faze, nisni fazën e dytë të kurimit, domethënë i kërkoni atij që, në çastin e nevojës, të shkojë vetë në banjë dhe, kur ta kryejë këtë punë, i jepni atij më shumë shpërblim (një ëmbëlsirë më të madhe). T'i shprehni vlerësim gjithnjë e më të madh fëmijës, derisa ai, para se të shkojë në banjë, t'u thotë prindërve se ka nevoja personale dhe se do të shkojë në banjë.²

1. *Et-Te'al'lum* (Të mësuarit), përkthim i Imaduddijn Ismaili, redaktim i Muhamed Uthman Nexhatit, Bejrut, Daru'sh-Shuruk, 1981, f. 21- 22.

2. *Ilmu'n-nefsi'l-Ikliniki* (Psikologjia klinike), përkthim i Atije Mahmud

Kjo metodë psikoterapie është e mbështetur rrënjësisht në shkaktimin gradual të reagimit, ku synimi kryesor është mësimi hap pas hapi të disa lloje reagimesh të mesme. Këto reagime të mesme, gradualisht, shkojnë drejt qëllimit të dëshiruar.

Ky lloj kurimi është i ngjashëm me të njëjtën metodë që Kur'ani kishte zbatuar më parë për kurimin e sëmundjes së prirjes së alkoolit dhe ngrënies së kamatës. Edhe Josef Uof, për kurimin e gjendjes së frikës, e cila lidhet me sende të caktuara, ka përdorur metodën graduale. Ky lloj kurimi realizohet nëpërmjet shkaktimit të reagimit të kundërt me frikën, sikurse qetësimi përballë një zinxhiri gradual gjërash, që ashtu, sikurse objekti kryesor, provokojnë frikë.

Mirëpo ky rend duhet të nisë në një sistem gradual, nga gjëja më e vogël frikëshkaktuese e deri te më e madhja e tij, në mënyrë që gjëja kryesore e frikshme, kurimi i gjendjes së frikës së individit, të formojë hallkën e fundit të këtij zinxhiri. Në këtë metodë, kurimi nis sipas këtij rendi: të sëmurit i mësojnë që gjënë frikëndjellëse, të gjendur në hallkën e parë të këtij zinxhiri, ta trupëzojë në mendjen e tij, me nerva të qeta dhe në qetësi të plotë, derisa të zhduket frika e lidhur me të.

Pastaj kurimi transferohet në fazën e dytë. Edhe në këtë fazë, të sëmurit i thuhet që gjënë e dytë, të gjendur në zinxhirin e përmendur, që është më frikëndjellëse se e para, ta përfytyrojë në gjendje plotësisht qetësie. Edhe në këtë fazë, terapia vazhdon deri në asgjësimin e frikës për atë gjë. Sipas këtij rendi, terapia vazhdon me çlirimin gradual të frikës, që është e lidhur me këtë zinxhir gradual të gjërave frikëndjellëse.¹

Përdorimin e metodës hap pas hapi në mësimdhënien e reagimeve të vështira apo në psikoterapi, me qëllim çlirimin e njeriut prej disa zakoneve apo reagimeve të papëlqyeshme, që së fundi kanë arritur psikologët bashkëkohorë, Kur'ani e ka përdorur që para katërmëdhjetë shekujsh, për kurimin e sëmundjes së prirjes së alkoolit dhe ngrënies së kamatës.

Hanna, redaktim i Muhamed Uthman Nexhatit, botim i dytë, Bejrut, Daru'sh-Shuruk, 1984, f. 159-160.

1. Riçard M. Shuajn: *Ilmu'l-emradi'n-nefsijeti ue'l-'aklije*, përkthim i Abdul Aziz Selame, Kajro, Daru'n-Nahdati'l-Arabijeh, 1979, f. 846-854.

KREU I GJASHTË

Dituria që mësohet vetë, pa mësues, me frymëzimin e Zotit (*Ilmu Ledunni*) në Kur'an

Frymëzimi dhe ëndrra

Aftësia e arsyes njerëzore është e kufizuar në njohjen e realiteteve dhe të dijeve. Njeriu nuk mund të përfshijë me diturinë e tij të gjitha realitetet e gjithësisë, ashtu sikurse, me përpjekje individuale, është i pazoti të arrijë njohjen e realiteteve të fshehta (*Gajbin*).

“Do të të pyesin ty për shpirtin. Thuaj: “Shpirti është çështje që i përket vetëm Zotit tim, ndërsa juve nuk ju është dhënë veçse pak dijeni”.¹

Arsyeja e njeriut, përveç kufizimit, gjendet e ekspozuar edhe ndaj gabimeve mendore. Këtë çështje ne e trajtuam në kapitullin “Të menduarit në Kur'an”. Gjithashtu, gjendet e ekspozuar ndaj indiferencës dhe harresës. Për këtë arsye, njeriu, për të arritur të mirën e vet, është gjithnjë nevojtar ndaj udhëzimit të Zotit, si nëpërmjet Profetëve dhe të Dërguarve të Tij, ashtu edhe nëpërmjet frymëzimit dhe ëndrrës.

Në parim, detyra e të Dërguarve që Zoti ka ngarkuar me mision profetik përgjatë shekujve të ndryshëm të historisë, ka qenë vetëm udhëzimi i njerëzve, mësimi i rregullave fetare dhe i më së mirës për racën njerëzore.

“Dikur, të gjithë njerëzit përbënin një bashkësi të vetme. Prandaj Allahu u dërgoi profetët me lajme të mira dhe paralajmërime. Bashkë me ata, Ai zbriti Librin me të vërtetën, për t'i gjykuar njerëzit në çështjet për të cilat nuk pajtoheshin. Mirëpo, njerëzit u grindën midis tyre, pasi u erdhën shenjat e qarta, nga zilia që kishin për njëri-tjetrin. Atëherë, me vullnetin e Vet, Allahu i udhëzoi besimtarët që ta kuptonin të vërtetën, lidhur me çështjet që të tjerët nuk

1. Sure “El-Isra”, ajeti 85.

pajtoheshin. Allahu shpie në udhë të drejtë kë të dojë.”¹

“Çdo populli Ne i çuam një të dërguar (që u thoshte): “Adhuroni Allahun dhe shmangni idhujt!” Disa prej tyre Allahu i shpuri në rrugë të drejtë e disa e merituan të mbeten në humbje. Andaj, udhëtoni nëpër botë të shihni se si ishte fundi i përgënjeshtresve!”²

“Ne i çuam të dërguarit Tanë me prova të qarta dhe bashkë me ta zbritëm Librat (e shenjtë) dhe peshoren (e drejtësisë): që njerëzit të veprojnë drejt. Ne e zbritëm hekurin, në të cilin ka (material për) luftë të fuqishme dhe dobi (të tjera) për njerëzit, me qëllim që Allahu të njohë ata që e ndihmojnë Atë dhe të dërguarit e Tij, pa e parë Atë. Me të vërtetë, Allahu është i Fortë dhe i Plotfuqishëm.”³

Dituria hyjnore,⁴ e cila përfitohet nëpërmjet frymëzimit dhe ëndrrës, nuk është vetëm monopol i profetëve.

Mirëpo, përveç atyre, atë mund ta përfitojnë edhe individë të tjerë që kanë cilësi të veçanta (kualifikim, devotshmëri, pastërti zemre dhe shpirtërore). Frymëzimi është një lloj diturie dhe informacioni, me të cilën Zoti e begaton njeriun dhe ia çon atë në zemër, ku si rezultat, atij i zbulohet një pjesë e të fshehtave dhe një pjesë e realiteteve.

Në Kur'an gjenden ajete të shumta që vënë theksin te dituria hyjnore, me të cilën Zoti begatoi profetët dhe të dërguarit e Tij. Një prej shembujve të këtyre rasteve është ngjarja e gjykimit të Dautit dhe të Sulejmanit (*Paqja qoftë me ta!*), që Kur'ani e përcjell me suren *El-Enbija*: “Ata morën të gjykonin dy burra. Njëri prej tyre kishte një fermë dhe u ankua te Dauti (*Paqja e Allahut qoftë mbi të!*) se delet e burrit tjetër kishin kullotur te ferma e tij dhe e kishin prishur atë. Dauti (*Paqja e Allahut qoftë mbi të!*) gjykoi se delet duhej të kalonin në pronësi të pronarit të fermës, mirëpo Zoti i frymëzoi Sulejmanit (*Paqja e Allahut qoftë mbi të!*), se pronari i fermës duhej të përfitonte vetëm

1. Sure “El-Bekare”, ajeti 213.

2. Sure “En-Nahl”, ajeti 36.

3. Sure “El-Hadid”, ajeti 25.

4. *Ilmi Ledunni*, është vetë dituri hyjnore, e cila i jepet dikujt që e meriton nëpërmjet frymëzimit (referohu tek *El-Mu'xhemu'l-Uesijt*).

prej qumështit, qengjave dhe leshit të deleve, derisa pronari i deleve të ndreqte fermën e prishur dhe ta kthente atë në gjendjen e mëparshme dhe se delet do t'i ktheheshin atij vetëm në këtë formë. Edhe Dauti (*Paqja e Allahut qoftë mbi të!*), kur vuri re epërsinë e gjykit të Sulejmanit (*Paqja e Allahut qoftë mbi të!*), e pranoi atë. I madhi Zot, rreth kësaj, thotë: **“(Kujtoje) edhe Dautin dhe Sulejmanin, kur gjykuan mbi të lashtat në të cilat kishin kullotur natën bagëtitë e disa njerëzve. Ne ishim dëshmitarë të gjykit të tyre. Ne e bëmë Sulejmanin ta kuptonte drejt çështjen dhe, që të dyve u dhamë mençuri e dituri...”**¹

Shembull tjetër i frymëzimit në Kur'an është çështja e të mësuarit të mjeshtërisë së farkëtimit dhe armëpunimit Dautit (*Paqja e Allahut qoftë mbi të!*) nga ana e të madhit Zot. (Ndërkaq, vlen të përmendet se Dauti (*Paqja Allahut qoftë mbi të!*) ishte i pari armëpunues e farkëtar).

“Ne i mësuam atij (Dautit) punimin e parzmoreve prej hekuri për ju, për t’ju mbrojtur në luftë me armikun, andaj, a jeni mirënjohës?”²

Po ashtu, rreth Dautit, thotë:

“Me ndihmën e Allahut, ata i thyen armiqtë dhe Dauti vrau Xhalutin. Allahu i dha atij pushtetin dhe Profetësinë dhe i mësoi diturinë që dëshoi. Sikur Allahu të mos i ndihmonte njerëzit e mirë kundër të këqijve, bota do të ishte e shkatërruar. Por Allahu është më Bujar me krijesat e Veta.”³

Gjithashtu, nëpërmjet frymëzimit, i Madhi Zot i mësoi Jusufit (*Paqja e Allahut qoftë mbi të!*) dijen e interpretimit të ëndrrave.

“Dhe kështu, Zoti yt të ka zgjedhur ty dhe të mëson shpjegimin e ëndrrave dhe e plotëson dhuntinë e Vet ndaj teje dhe familjes së Jakubit, ashtu siç e ka plotësuar më parë ndaj të parëve të tu, Ibrahimit dhe Is’hakut. Pa dyshim, Zoti yt është i Urtë dhe i Gjithëdijsëm.”⁴

1. Sure “El-Enbija”, ajetet 78-79.

2. Sure “El-Enbija”, ajeti 80.

3. Sure “El-Bekare”, ajeti 251.

4. Sure “Jusuf”, ajeti 6.

“Një njeri nga Egjipti që e bleu, i tha gruas së vet: “Bëja të këndshëm qëndrimin këtu. Ndoshta do të na shërbejë, ose do ta birësojmë!” Dhe kështu, Ne e vendosëm Jusufin në atë tokë të bukur dhe i mësua shpjegimin e ëndrrave. Allahu ka kontroll dhe fuqi të plotë mbi çështjet e Tij, por shumica e njerëzve nuk e dinë. Kur Jusufi arriti moshën e pjekurisë, Ne i dhamë aftësinë e të gjykuarit dhe dituri. Kështu i shpërblejmë Ne punëmirët.”¹

Në kohën që Jusufi (*Paqja e Allahut qoftë mbi të!*) u kërkoi të vëllezërve që ta marrin këmbishën e tij dhe t’ia hedhin mbi fytyrë babait, me qëllim që t’i kthehet sërish shikimi, në të vërtetë, këtë e kishte zbuluar nëpërmjet frymëzimit hyjnor se, duke hedhur këmbishën mbi fytyrën e të atit, ai do të rifitonte shikimin e tij.

“Shkoni me këtë këmbishë timen dhe vëreni në fytyrën e atit tim e ai do të shohë, dhe m’i sillni tërë familjet tuaja!”²

Po ashtu edhe Jakubi (*Paqja e Allahut qoftë mbi të!*), nëpërmjet frymëzimit hyjnor dinte gjëra rreth Jusufit, për të cilat bijtë e tij nuk kishin dijeni.

“(Jakubi) tha: “Unë dhimbjen time dhe pikëllimin tim ia paraqes vetëm Allahut e nga Allahu di atë që nuk e dini ju.”³

“Kur erdhi sjellësi i lajmit të mirë dhe ia vuri këmbishën në fytyrë, atij iu kthye shikimi. Ai tha: “A nuk ju kam thënë se unë di nga Allahu atë që ju nuk e dini.”⁴

E sërish, përreth Jakubit (*Paqja e Allahut qoftë mbi të!*), thotë:

“Kur ata hynë (në qytet), ashtu siç i urdhëroi babai i tyre, dëshira e Jakubit u përmbush, por kjo nuk i ndihmoi aspak para caktimit të Allahut. Ai (Jakubi), në të vërtetë, ka qenë dijetar i madh, sepse Ne e kemi mësuar, por shumica e njerëzve nuk e di.”⁵

Në Kur’an gjenden ajete të shumta, të cilat vënë theksin mbi çështjen e frymëzimit të diturisë dhe urtësisë nga ana e të madhit Zot te të Dërguarit dhe Profetët e Tij.

1. Sure “Jusuf”, ajetet 21-22.

2. Sure “Jusuf”, ajeti 93.

3. Sure “Jusuf”, ajeti 86.

4. Sure “Jusuf”, ajeti 96.

5. Sure “Jusuf”, ajeti 68.

Një nga shembujt e qartë të trajtimit të diturisë hyjnore në Kur'an është historia e treguar në suren "El-Kehf" për robin punëmirë (*abdun salih*), domethënë historia e atij personi që Musai (*Paqja e Allahut qoftë mbi të!*) i kërkoi që ta pranonte në shoqërinë e tij, me qëllim që të mësonte.

"Dhe gjetën një prej robërve Tanë, të cilit i patëm dhuruar mëshirë prej Nesh dhe i kishim mësuar nga ana Jonë dije. Musai i tha atij: "A mund të të pasoj ty, që të më mësosh edhe mua diçka prej diturisë së drejtë që të është dhënë ty?"¹

Megjithëse Musai (*Paqja e Allahut qoftë mbi të!*) ishte Profet dhe i dërguar i Zotit, prapëseprapë ai nuk e dinte diturinë hyjnore, që Zoti e pati dhënë posaçërisht për atë rob punëmirë. Përmes asaj diturie u zbuluan sekrete nga më të thellat, të cilat madje nuk ishin të ditura për Profetin e Zotit, Musain (*Paqja e Allahut qoftë mbi të!*), por që njiheshin nga robi punëmirë.

Për shembull, ai rob punëmirë (Hazreti Hizri, *Paqja e Allahut qoftë mbi të!*) e dinte që ekzistonte një mbret, i cili i sekuestronte dhe i fuste në pronësi të tij anijet që ishin në gjendje të mirë. Për këtë arsye, ai shpoi një anije, e cila ishte në pronësi të disa fukarenjve dhe nevojtarëve, me qëllim që ta nxirrte atë jashtë funksionit dhe, si rezultat, të parandalonte sekuestrimin e anijes nga ana e mbretit zullumqar.

Gjithashtu, e dinte se fëmija që u vra nga dora e tij (nëse do të mbetej gjallë, në të ardhmen), do të ushtronte dhunë ndaj prindërve të tij punëmirë. Vullneti i Zotit ishte i tillë që, në vend të tij, t'u dhuronte një fëmijë më të mirë.

Po ashtu, ai e dinte se nën mur, i cili rrezikonte të shembej së shpejti, fshihej një thesar që u përkiste dy jetimëve të atij qyteti, të cilët kishin një baba punëmirë. Prandaj, me qëllim ruajtjen e thesarit për dy jetimët, e meremetoi dhe e ngriti sërish murin, derisa fëmijët të rriteshin dhe ta nxirrnin nga poshtë murit thesarin e tyre.

"Robi punëmirë", më pas i tha Musait (*Paqja e Allahut qoftë mbi të!*) se ajo çfarë ai kishte kryer, nuk ishte prej atij vetë, por me urdhër të të Madhit Zot.

1. Sure "El-Kehf", ajetet 65-66.

“E, sa i përket murit, ai u takonte dy djelmoshave jetimë në qytet dhe, nën të gjendej një thesar i tyre. Babai i tyre kishte qenë njeri i mirë, prandaj Zoti yt dëshiroi që ata të arrinin moshën e pjekurisë e ta nxirrnin thesarin e tyre, si mëshirë nga Zoti yt. Unë këtë nuk e kam bërë sipas gjykimit tim. Ky është shpjegimi i asaj, për të cilën ti s’munde të duroje!”¹

Në Kur’an janë sjellë ajete të shumta, të cilat tregojnë se frymëzimi prej Zotit është i mundur, edhe për ata që nuk janë Profetë dhe të dërguar të Zotit.

“Kur i frymëzuam nënës tënde atë që iu frymëzua: “Vëre atë (foshnjën) në një sënduk e hidhe në lumë! Lumi do ta nxjerrë në breg e atë do ta marrë një armiku Im dhe armiku i tij.” Unë kam hedhur në ty dashurinë Time, që të rritesh nën Syrin (kujdesin) Tim.”²

“Kështu, Ne e frymëzuam nënën e Musait: “Jepi gji atij dhe, kur të trembesh për sigurinë e tij, hidhe në lumë, pa pasur frikë dhe as dëshpërim. Me siguri që Ne do të ta kthejmë ty atë dhe do ta bëjmë të dërguar.”³

E gjithashtu i Madhi Zot i frymëzoi apostujt që të besojnë tek Isai (*Paqja qoftë mbi të!*)

“...dhe se si kur i urdhërova dishepujt: “Besomëni Mua dhe të Dërguarit Tim!” - ata u përgjigjën: “Ne besojmë, prandaj dëshmo se Ty të jemi dorëzuar!”⁴

Gjithashtu, Kur’ani e vendos theksin mbi këtë çështje: besimi, devotshmëria, sinqeriteti në adhurimin e Zotit, sigurimi i gjërave që janë shkak i pastërtisë së zemrës dhe i kullimit të shpirtit, e parapërgatit njeriun për fitimin e një vargu frymëzimesh nga ana e Zotit, me qëllim që ta udhëheqë atë drejt udhës së mirësisë, begatisë e udhëzimit.

“Sa për ata që ndjekin rrugën e drejtë, Ai ua shton udhëzimin dhe u jep devotshmëri e vetëpërmbajtje.”⁵

1. Sure “El-Kehf”, ajeti 82.

2. Sure “Ta ha”, ajetet 38-39.

3. Sure “El-Kasas”, ajeti 7.

4. Sure “El-Maide”, ajeti 111.

5. Sure “Muhamed”, ajeti 17.

“Ata që luftojnë për çështjen Tonë, sigurisht, Ne do t’i udhëzojmë drejt udhëve Tona. Vërtet, Allahu është me punëmirët!”¹

Nganjëherë, edhe nëpërmjet engjëjve jepet ky lloj frymëzimi. Këtë frymëzim, sufijtë e quajnë *mbresa hyjnore (khavotir melekutije)*. Në hadith është treguar se në zemër gjenden dy lloj komunikimesh: një *komunikim me engjëllin*, i cili urdhëron për mirë dhe për miratim të së vërtetës. Nëse kjo gjendje haset te një person, ai duhet ta dijë se është nga ana e Zotit dhe duhet ta falënderojë Atë; dhe tjetra *komunikimi me armikun (djallin)*, i cili urdhëron për prapësi, për përgënjeshttrim të së vërtetës dhe për ndalim nga punët e mira. Tek ai që gjendet kjo lloj gjendjeje, le të kërkojë mbrojtjen e Zotit prej djallit të mallkuar.²

Psikologët bashkëkohorë nuk merren me kërkime rreth çështjes së frymëzimit prej Zotit. Mirëpo, kur zënë të hetojnë çështjen e mendimit krijues (*tefekkur khal’lak*), lidhur me shfaqjen e mendimeve të reja, që në dukje u vijnë të papritura në procesin e të menduarit, për disa probleme shkencore, përdorin termin *ilham-frymëzim* dhe *shuhud-dëshmim*.

Ata e konsiderojnë këtë lloj frymëzimi rezultat të arsyes dhe të mendimit dhe jo të vërshuar nga një burim i huaj. Për shembull, kur njeriu, për një kohë të gjatë mendon për një problem dhe nuk ia del dot mbanë të gjejë rrugëzgjidhje për të, zakonisht e lë atë për njëfarë kohe, duke e qetësuar edhe mendjen e tij gjatë kësaj kohe. Mirëpo pas pushimit mendor, sërish ai angazhohet duke menduar rreth tij.

Psikologët thonë se në po këtë kohë pushimi, të cilin vetë e quajnë si cikël të kujdestarisë mendore, në funksionin e të menduarit ndodhin shndërrime të rëndësishme, sepse:

Së pari, mendimi çlirohet nga disa parregullsi që ishin pengesë për rrugëzgjidhjen e dëshiruar.

Së dyti, mendja qetësohet në kohën e pushimit prej lodhjes, që buron prej të menduarit të vazhdueshëm për

1. Sure “El-Ankebut”, ajeti 69.

2. Me transmetim nga Said Haua, *Terbijetuna’r-ruhijeh*, f. 155.

problemin. Më pas, kur pas çlodhjes zë të mendojë sërish rreth problemit të përmendur, do të jetë më i freskët, më i gatshëm për të zgjidhur problemin.

Së treti, shkaktohet një lloj organizimi dhe rregullimi në informacionet e njeriut për problemin e caktuar, që bëhet shkak i daljes në pah të disa raporteve që nuk shquheshin më parë dhe, po ashtu, bëhet motiv i lindjes së mendimeve të reja, duke gjetur rrugën për zgjidhjen e problemit. Madje, disa nga psikologët besojnë se vjen në ekzistencë një lloj i të menduarit të pavetëdijshtë në lidhje me problemin. Dhe po ashtu, dukshëm në njëfarë mënyre, vijojnë një pjesë e përpjekjeve të trurit.¹

Në të vërtetë, nuk ekziston ndonjë konflikt midis shpjegimit shkencor të frymëzimit, të cilin psikologët bashkëkohorë e paraqesin në rrjedhën e shpjegimit dhe komentimit të “mendimit krijues” dhe (midis) shpjegimit fetar të tij. Psikologët bashkëkohorë, në çështjen e shpjegimit të frymëzimit ndalen vetëm në kufizimin e operacioneve fiziologjike të kryera në tru dhe operacioneve psikologjike që e shoqërojnë atë.

Mirëpo individi besimtar, edhe pse i pranon pikëpamjet e psikologëve rreth operacioneve fiziologjike të trurit, shkon përtej nivelit të këtij komentimi. Ai beson se, nganjëherë, vullneti i të madhit Zot, që është zotëruesi dhe menaxhuesi i të gjitha gjërave në univers, e kërkon që të sistemojë në njëfarë mënyre operacionet mendore të disa njerëz, me qëllim që t’i udhëheqë ata drejt zbulimit dhe njohjes së një pjese të realiteteve, që Zoti do t’ua frymëzojë atyre.

Si përfundim, duket se realitetet në fjalë, befasisht e në mënyrë dëshmuese, gjejnë rrugë për në mendjen e tyre. Ndonjëherë, vullneti i Zotit e kërkon që, përveç kohëve të “mendimit krijues”, për disa individë të vijë gjendja frymëzuese, në mënyrë që, kurdoherë që Zoti dëshiron t’u frymëzojë Profetëve, të Dërguarve dhe robërve të tjerë të Tij.

Psikologët myslimanë e kanë komentuar frymëzimin, në përputhje me atë që ka ardhur në Kur’an. Për shembull, Ibn

1. Muhamed Uthman Nexhati, *Ilmu’n-nefs fi hayatina’l-jeumijeh*, f. 328, 330.

Sina (Avicena), frymëzimin që u vjen disave kur janë zgjuar apo në gjumë në formë ëndrre, e njeh si rrjedhojë të raporteve të shpirtit me botën qiellore.¹

Ashtu siç nganjëherë, vullneti i Zotit e kërkon që mendimin e disa njerëzve ta drejtojë nga koha e vërtetë nëpërmjet frymëzimit dhe Shpalljes (*Uahjit*). Po ashtu, vetë ky vullnet hyjnor, ndonjëherë kërkon ta mbajë larg nga e vërteta mendimin e disa njerëzve të tjerë, për shkak të arrogancës, kokëfortësisë dhe indiferencës së tyre.

“Do t’i largoj prej shenjave të Mia ata që sillen me arrogancë në Tokë, kështu që edhe kur të shohin çfarëdo shenje, nuk do ta besojnë atë. Kur të shohin rrugën e drejtë, ata nuk do ta ndjekin atë dhe, kur të shohin rrugën e gabuar, do ta marrin atë, sepse ata nuk i besuan shpalljet Tona dhe nuk u kushtonin vëmendje atyre.”²

B- Gjumi dhe ëndrrat

Çështja e të shikuarit të ëndrrave është një nga dukuritë psikike të zakonshme dhe të përhapura mes njerëzve. Në periudhat e ndryshme të historisë, mendimtarët janë përpjekur t’i komentojnë ato. Ata e kanë shpjeguar dhe e kanë komentuar në mënyra të ndryshme këtë çështje. Sipas mendimit të tyre, disa nga ëndrrat janë rezultat i ndjesive që njeriu i ndien gjatë gjumit, qofshin këto kur rrjedhin prej ndikimit të faktorëve të jashtëm të shqisat apo si rezultat i ndjesive që rrjedhin prej faktorëve të ndikimit të brendshëm, që krijohen brenda trupit. Pjesa tjetër e ëndrrave vjen si rezultat i vijimësisë së shqetësimit të mendjes me punë, që e kanë angazhuar individin kur ka qenë zgjuar. Një pjesë e tyre është e përbërë prej kujtimit të disa ngjarjeve të shkuara.

Në mesin e psikologëve, ideja më e përhapur rreth interpretimit të ëndrrave është ideja e Frojdit. Sipas kësaj ideje, ëndrra është mënyra simbolike e shpjegimit të motiveve të

1. Muhamed Uthman Nexhati, *El-Idraku'l-hissij 'inde Ibn Sina, Bahthun fi 'ilmi'n-nefs inde'l-arab*, botim i tretë, Bejrut, Daru'sh-Shuruk, 1980, f. 216.

2. Sure “El-A’raf”, ajeti 146.

pavetëdijshe të njeriut. Krijimet e psikologëve bashkëkohorë rreth ëndrrës përfshijnë vetëm llojet e ëndrrave, të cilat ne vumë theksin më sipër, e në veçanti ato ëndrra që, sipas idesë së Frojdit, janë shpjeguese të motiveve të pavetëdijshe.

Ata nuk ndërhyjnë tek ëndrrat e drejta e të vërteta, të cilat ngrenë perden ndaj punëve që do të ndodhin në të ardhmen. Kjo lloj ëndrre ndodh nganjëherë për disa njerëz, ashtu sikurse është përmendur dhe te fetë.

Kur'ani përmend termin *“edgathu ahlam”* (“ëndrra të palidhura, të ngatërruara”) dhe *“er-ru’ja”* (“ëndrra”). *“Edgathu ahlam”* janë ëndrra të koklavitura, të turbullta e jo të qarta¹. Kur'ani, kur përmend *“edgathu ahlam”*, ndoshta e vë theksin tek ato ëndrra, të cilat janë bërë objekt i diskutimit dhe i komentimit të psikologëve. Edhe ne e vumë theksin më parë tek ato.

Ndërsa *“er-ru’ja”* (“ëndrra”) në Kur'an është vetëm në kuptimin e ëndrrës së vërtetë, që Zoti, në rrjedhën e saj, i përçon një lloj zbulese dhe frymëzimi të caktuar jo vetëm Profetëve dhe të Dërguarve të Tij, por edhe njerëzve të tjerë apo i njofton ata për ngjarjet e së ardhmes. Një prej shembujve është ëndrra e Ibrahimit (*Paqja e Allahut qoftë mbi të!*). Ai sheh ëndërr sikur është duke sakrifikuar të birin, Ismailin (*Paqja e Allahut qoftë mbi të!*).

“Kur fëmija u rrit aq sa ta ndihmonte në punë, Ibrahim i tha: “O djali im, kam parë ëndërr se duhet të të flijoj. Çfarë mendon ti?” – I biri i tha: “O ati im, vepro ashtu siç je urdhëruar! Dashtë Allahu, unë do të jem i durueshëm!” Pasi iu nënshtruan që të dy urdhrit, (Ibrahimi) e vuri (Ismailin) me ballë pertokë. Ne e thirrëm: “O Ibrahim, ti e përmbushe ëndrrën.” Vërtet, Ne kështu i shpërblejmë punëmirët!”²

Një tjetër shembull i ëndrrës së vërtetë, që është treguar në Kur'an, është ëndrra e Hazretit Jusuf (*Paqja qoftë mbi të!*).

“Kur Jusufi i tha babait të vet: “O babai im! Unë pashë në ëndërr njëmbëdhjetë yje, Diellin dhe Hënë! I pashë të më përuleshin në sexhde”, ai i tha: “O biri im! Mos ua trego

1. Në *El-Mu’xhemu’l Uesijt* është treguar se *“edgathu ahlam”* u thuhet ëndrrave të ngatërruara e të turbullta, interpretimi i të cilave është i vështirë.

2. Sure *“Es-Saffat”*, ajetet 102-105.

ëndrrën tënde vëllezërve të tu, që të mos kurdisin ndonjë gjë kundër teje, sepse, vërtet, djalli është armik i hapët i njeriut.”¹

Kjo ëndërr e Jusufit (*Paqja e Allahut qoftë mbi të!*) u realizua në kohën që ai thirri pranë vetes vëllezërit dhe prindërit e tij dhe ata, kur hynë tek ai, ranë në sexhde si respekt dhe nderim për Zotin e tij.

“Ai i ngriti prindërit e vet në fron dhe ata të gjithë iu përulën atij. Ai tha: “O babai im, ky është shpjegimi i ëndrrës sime të dikurshme. Zoti im e përmbushi atë. Mua më bëri mirësi, kur më nxori nga burgu, kurse juve ju solli nga shkretëtira, pasi djalli pati futur ngatërresë midis meje dhe vëllezërve të mi. Vërtet, Zoti im është i Butë me kë të dojë; Ai është i Gjithëdijshmi dhe i Urti!”²

Zoti këtu ka përmendur rrjedhën e ëndrrës së Profetit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) atë vit kur shkoi në Hudejbije. Profeti (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) kishte parë në ëndërr sikur ishte futur në Mekë dhe po i binte rrotull shtëpisë së Zotit (Qabesë).

“Është Ai që e ka çuar të Dërguarin e Vet me Udhëzimin dhe fenë e vërtetë, për ta ngritur atë mbi të gjitha fetë. Allahu mjafton si dëshmitar!”³

Gjithashtu, Kur’ani ka përmendur rrjedhën e ëndrrës së parë nga dy të rinjtë, të cilët vuanin dënimin në të njëjtin burg me Jusufin (*Paqja e Allahut qoftë mbi të!*) dhe interpretimin e ëndrrës së tyre nga ana e Jusufit,⁴ si dhe ëndrrën e mbretit të Egjiptit. Mbreti i Egjiptit kishte parë në ëndërr sikur shtatë lopë të dobëta hëngrën shtatë lopë të majme dhe se shtatë kallinj të tharë shkatërruan shtatë kallinj të gjelbër.⁵ Jusufi (*Paqja e Allahut qoftë mbi të!*) e interpretoi këtë ëndërr për të.⁶

1. Sure “Jusuf”, ajeti 4-5.

2. Sure “Jusuf”, ajeti 100.

3. Sure “El-Fet’h”, ajeti 28.

4. Sure “Jusuf”, ajetet 36-41.

5. Sure “Jusuf”, ajeti 43.

6. Sure “Jusuf”, ajetet 48-49.

Në hadith është treguar se Profeti (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Ëndrra e vërtetë është nga ana e Zotit, ndërsa ëndrra e turbullt nga ana e djallit.” Po ashtu, ka thënë: “Ëndrra e vërtetë (e çiltër) e robit punëmirë është një pjesë prej 46 pjesëve të Profetësisë.”¹

Interpretimet e Kur'anit rreth “ëndrrës së vërtetë” kanë pasur ndikim të shumtë në formësimin e ideve të mendimtarëve myslimanë. Ata e komentojnë dhe e shpjegojnë ëndrrën me atë që është sjellë në Kur'an. Për shembull, Alusiu, në komentimin e vet, rrëfen: “Ebu Hatimi dhe Ibn Merdavejhi me zinxhir transmetimi nga Selim ibn Ammari, kanë transmetuar se Umer ibn Hatabi ka thënë: “Jam i mahnitur me ëndrrën e dikujt që fle dhe në ëndërr shikon diçka që nuk e kishte çuar kurrë ndërmend, ndërsa ëndrra e tij është njësoj si kopja apo prekja me dorë (ëndrra ndodh me përpikëri kur është zgjuar). Ndërsa nganjëherë njeriu sheh ëndërr dhe nuk ndodh asgjë.” Aliu (*Paqja e Allahut qoftë mbi të!*) i tha Umerit: “Dëshiron të ta tregoj misterin e saj?” Dhe këndoi këtë ajet:

“Allahu ua merr shpirtrat atyre që u ka ardhur çasti i vdekjes dhe atyre që nuk kanë vdekur, por që janë në gjumë. Pastaj Ai ndal shpirtin e atij që i është caktuar vdekja, ndërsa të tjerëve ua lë deri në një kohë të caktuar. Me të vërtetë, këto janë shenja për njerëzit që mendojnë.”²

Prandaj Zoti i merr pranë Vetes shpirtrat e të gjithëve. Ajo që shpirti sheh në qiell teksa është pranë Zotit, është ëndrra e çiltër dhe e vërtetë, ndërsa atë që e sheh teksa kthehet në trup, është ëndrra e gënjeshtërt.³

Ne e shohim mirë dhe qartë se në komentimin dhe interpretimin e ëndrrave, filozofia islame është nën ndikimin e Kur'anit. Për shembull, Ibni Sina (Avicena), ëndrrën e

1. Muhamed ibn Sirin, *Muntekhabu'l-kelam fi tefsiri'l-ahlam*, e botuar në anë të librit *Ta'tijru'l-enam fi ta'biri'l-menam* i autorit i Abdul Gani En-Nabulsij, Egjipt, 1347 hixhri, f. 2.

2. Sure “Ez-Zumer”, ajeti 42.

3. Ebu'l-Fadl Shihabuddijn Es-Sejjid Mahmud El-Alusi El-Bagdadi, *Ruhu'l-me'ani fi tefsiri'l-Kur'an*, Kajro, shtypshkronja Emirije Bulak, 1301, vëll. 2, f. 409.

çiltër e të vërtetë e njeh si rezultat të raporteve të shpirtit me botën qiellore në kohën e gjumit dhe të marrjes së shpalljes apo frymëzimit prej Zotit, ndërsa ëndrrat e ngatërruara dhe të gënjeshtra, i njeh si të prejardhura prej ndikimit të njësive trupore të shpirti.¹

Së fundi, disa studiues të sekreteve të forcës shpirtërore të njeriut besojnë se shpirti i njeriut, gjatë gjumit, ndahet prej trupit dhe zë të shëtisë nëpër vende të ndryshme.

Çdo gjë që njeriu sheh në ëndërr, ata e njohin si fundin e asaj që shpirti ka shquar teksa ka shëtitur. Kjo ide është e përbashkët me idenë e mendimtarëve myslimanë, që e transmetuam më parë, në pikën që shpirti, gjatë gjumit, ndahet nga trupi.

Mirëpo ka dallim me atë në një pikëpamje. Mendimtarët myslimanë besojnë se, kur shpirti ndahet nga trupi, ka mundësi që të arrijë në botën qiellore dhe prej atje të marrë shpallje dhe frymëzim në formën e ëndrrës së çiltër. Në të vërtetë, ka mundësi që të mos arrijë në botën qiellore dhe, meqë në këtë situatë gjendet nën ndikimin e ndjesive trupore, ajo çfarë ai sheh, janë vetëm ëndrra të ngatërruara. Ndërsa psikanalistët bashkëkohorë nuk i kushtojnë vëmendje, ashtu si mendimtarët myslimanë, dallimit midis ëndrrave të ngatërruara dhe ëndrrave të çiltra.

1. Abdur-Rezak Neufel, *El-Kur'an ue'l-ilmu'l-hadith*, Bejrut, Daru'l-Kitabi'l-Arabi, 1973, f. 96-99.

KREU I SHTATË

Kujtesa dhe harresa në Kur'an

Çështja e kujtesës ka rëndësi shumë të madhe në jetën e njeriut, sepse kujtesa enjohurive dhe emjeshtërive të mëhershme na aftëson për t'u përballur me problemet e së ardhmes; na ndihmon të ecim, me qëllim marrjen e informacioneve dhe zbulimin e realiteteve të reja. Kjo konsiderohet si një çështje e rëndësishme në përmirësimin e ecurisë shkencore dhe e zhvillimit njerëzor. Përveç rëndësisë që ka në jetën shkencore dhe praktike të njeriut, nga këndvështrimi fetar, kujtesa merr një rëndësi të madhe.

Ka rëndësi të madhe përmendja e vazhdueshme e Zotit, kujtimi i begative e mirësive të shumta që Ai ka falur, kujtimi i Botës Tjetër (Ahiretit), Ditës së Shpagimit, të Shpërblimit dhe të Ndëshkimit, që është në pritje të njeriut. Të gjitha këto e nxisin njeriun për t'u bërë i devotshëm, për të kryer punë të mbara e për t'u stolitur me virtyte. Prandaj, kujtesa dhe përmendja është e dobishme për njeriun dhe për realizimin e të mirës, si në këtë botë, ashtu edhe në Botën Tjetër (Ahiret). Kur'ani Fisnik, nëpër shumë ajete, i ka nxitur njerëzit ta përmendin Zotin, me shprehje të ngjashme, të cilat janë përsëritur shumë në Kur'an.

Efela tetedhekkerune? – E pra, a nuk po përkujtoni?

Kalilen ma tedhekkerune - A s'po përkujtoni pak?

Leal'lehum jetedhekkerune - Mbase përkujtojnë...

Efela jetedhekkerune? - Pra, a nuk po përkujtojnë?

Leal'lehum jetedhekkerune - Mbase përkujtojnë...

Ue li jetedhekere ulu'l-elbab - që të marrin shembull ata që kanë intelekt dhe mend...

Innema jetedhekkeru ulu'l-elbab - Përkujtojnë vetëm ata që kanë intelekt...

Ue ma jetedhekkeru il'la ulu'l-elbab - Nuk përkujtojnë askush veç atyre që kanë mend.

Në Kur'an gjenden ajete të shumta që tregojnë se Zoti e ka ngarkuar me mision profetik Profetin e Islamit dhe se ia ka zbritur atij Kur'anin, me qëllim që t'i kujtojë njerëzimit kujtimin e adhurimit të një Zoti, të Ditës së Ringjalljes dhe të Llogarisë në Botën Tjetër. Po ashtu, kujtimin e mësimave të Profetëve dhe Lajmëtarëve të shkuar, ndaj të cilave janë bërë të pavëmendshëm dhe i kishin harruar. Disa shembuj nga këto ajete:

"Ky Libër të është shpallur ty; le të mos ketë kurrfarë shtrëngimi në zemrën tënde për shkak të tij! Ai të është shpallur, që nëpërmjet tij të paralajmërosh jobesimtarët dhe të këshillosh besimtarët. Ndiqni atë që ju është zbritur nga Zoti juaj e mos ndiqni mbrojtës të tjerë, përveç Tij. Sa pak që i pranoni këshillat!"¹

"Ky (Kur'an) është shpallje e qartë për njerëzit, me qëllim që ata të marrin paralajmërim nëpërmjet tij, që ta dinë se Allahu është Një Zot i Vetëm dhe që të këshillohen njerëzit e mençur!"²

"Ti nuk ke qenë as pranë Turit, kur Ne thirrëm Musain. Por ti je dërguar si mëshirë nga Zoti yt për të paralajmëruar njerëzit, të cilëve nuk u kishte ardhur kurrfarë paralajmëruesi para teje, që ata të mund të marrin këshilla."³

"Ky (Kur'an) është një libër i bekuar, që Ne ta kemi zbritur ty (Muhamed), për të përsiatur mbi vargjet e tij dhe për t'u këshilluar me të mendarët."⁴

"Ne e kemi bërë të lehtë Kur'anin në gjuhën tënde, që ata të mund të marrin këshilla."⁵

"Jepu atyre shembullin e jetës së kësaj bote: ajo është si uji që Ne e lëshojmë nga qielli; bimësia në tokë përzihet me të, por pastaj bëhet si bar i thatë, të cilin e shpërndan era. Allahu është i Fuqishëm për çdo gjë!"⁶

1. Sure "El-A'raf", ajetet 2-3.

2. Sure "Ibrahim", ajeti 52.

3. Sure "El-Kasas", ajeti 46.

4. Sure "Sad", ajeti 29.

5. Sure "Ed-Duhan", ajeti 58.

6. Sure "El-Kehf", ajeti 45.

“Prandaj shmangu prej atyre; ti nuk do të qortohesh për këtë!”¹

“Prandaj këshilloji (njerëzit o Muhamed), se ti je vetëm këshillues.”²

A- Harresa

Një prej problemeve të njeriut është ekspozimi ndaj harresës dhe, natyrisht, që kjo është dëmprurëse për atë dhe, në shumë raste, e pengon për të triumfuar ndaj problemeve të jetës. Kur'an i ka cekur çështjen e harresës nëpër shumë ajete. Ne, nëse do t'u referohemi këtyre ajeteve dhe do të zëmë të ekzaminojmë domethëniet e tyre, do të shohim se çështja e harresës është sjellë në disa kuptime, të cilat mund t'i përmbledhim sipas rasteve të mëposhtme:³

1. Harresa që ndodh në mendje, lidhur me ngjarje, emra të personave dhe informacione të fituara më parë.

Kjo është harresa e zakonshme që u ndodh njerëzve, si pasojë e ndrydhjes së informacioneve. Psikologët e kanë ekzaminuar këtë lloj harrese dhe e kanë konsideruar atë si të prejardhur prej ndërhyrjeve të informacioneve. Ata kanë dhënë dallimin midis dy lloj ndërhyrjesh: ndërhyrje e mëparshme (*tedakhul sabik*) dhe ndërhyrje e mëpasshme (*tedakhul lahik*).

Ndërhyrja e mëparshme (*tedakhul sabik*)

Del në pah në kohën kur mësimi i lëndës së re rezulton me dobësimin e lëndës së mësuar më parë. Po ashtu, ndërhyrja e mëparshme (*tedakhul sabik*) merr formë si pasojë e ndikimit të zakoneve, aktiviteteve dhe njohurive të mëposhtme mbi të kujtuarin e lëndës, të cilën sapo e kemi mësuar. Sa më të pakta të jenë informacionet dhe aktivitetet tona të mëparshme, aq më e lehtë do të jetë kujtesa e lëndës së re.

1. Sure “Edh-Dharijat”, ajeti 55.

2. Sure “El-Gashije”, ajeti 21.

3. El-Behij El-Khaulij, *Adem (a.s) felsefetu takuimi'l-insan ue khilafetih*, f. 182, 184.

Pra, për këtë arsye ndodh që fuqia e kujtesës së të vegjëlve për detaje apo për ngjarje të mëparshme, është më e madhe se e të rriturve.¹

Kur'ani e vë theksin kështu mbi këtë lloj harrese:

“Prandaj këshilloji (njerëzit, o Muhamed), se ti je vetëm këshillues.”²

“Ne do të të bëjmë ty (Muhamed) të lexosh (Shpalljet Tona), kështu që nuk ke për të harruar.”³

2. Harresa në kontekstin e fshirjes

Kjo lloj harrese është kur njeriu harron diçka në ndonjë vend dhe e kujton pas njëfarë kohe; ose kur është duke biseduar me dikë rreth disa temave, harron se çfarë do të thoshte dhe i sjell ndërmend ato pas njëfarë kohe. Shembull për këtë është ndodhia që Kur'ani përcjell për djaloshin që ndihmonte Musain (*Paqja e Allahut qoftë mbi të!*).

Ai u përgjigj: “Shiko! Kur ndalua tek ai shkëmbi, unë e harrova peshkun. Vetëm djalli më bëri ta harroj e nuk ta thashë se peshku mori rrugën nga deti në mënyrë të habitshme!”⁴

Një shembull tjetër është fjala e Hazretit Musa (*Paqja e Allahut qoftë mbi të!*) ndaj robit punëmirë.

Ai u përgjigj: “Mos më qorto për atë që harrova dhe mos më ngarko me vështirësi në punët e mia!”⁵

Edhe këtë çështje mund ta konsiderojmë prej kategorisë së *tadakhul lahik*, ndërhyrjes së mëpasshme, të cilën e përmendëm më parë.

1. Sarenf A. Mednijk, Hauarder, Zhyle, Elizabet F., *Et-Ta'lijm*, përkthim i Muhamed Imaduddijn Ismail, redaktim i Muhamed Uthman Nexhati, Bejrut, Daru'sh-Shuruk, 1981, f. 152-157.

2. Sure “El-Gashije”, ajeti 21.

3. Sure “El-A'la”, ajeti 6.

4. Sure “El-Kehf”, ajeti 63.

5. Sure “El-Kehf”, ajeti 73.

3. Harresa në kontekstin e pavëmendjes ndaj temës

Një prej shembujve të kësaj lloj harrese është ajeti i mëposhtëm:

“Hipokritët dhe hipokritet janë të ngjashëm me njëri-tjetrin: kërkojnë që të bëhen vepra të këqija e pengojnë të mirat dhe janë dorështrenguar. Ata e kanë harruar Allahun, por edhe Ai i ka harruar ata. Me të vërtetë, hipokritët janë keqbërës.”¹

Kuptimi i fjalës *“nesullahe”* është se ata u rebeluan prej bindjes ndaj të madhit Zot, si pasojë e mosvëmendjes së urdhrave të Tij dhe *“nesijehum”* d.m.th. Zoti e ndali mirësinë e Tij ndaj tyre dhe ata e kishin veten në duart e tyre.

Po ashtu, një tjetër shembull për këtë lloj harrese është ajeti i mëposhtëm:

“Mos u bëni si ata që e harruan Allahun, kështu që Ai i bëri të harronin vetveten! Pikërisht ata janë të pabindurit (ndaj Allahut).”²

Harresa, që në ajetin e mëposhtëm i është atribuar Ademit (*Paqja e Allahut qoftë mbi të!*), po ashtu është prej kësaj lloj harrese:

“Ora (e Kiametit) do të vijë me siguri, por Unë e mbaj tepër të fshehur, që secili të shpërblehet për atë që ka bërë.”³

Kuptimi i këtij ajeti është ky: zemra e Ademit (*Paqja e Allahut qoftë mbi të!*) “për një çast” u plogështua, lidhur me ujdinë që kishte bërë me Zotin.⁴ Si përfundim, e harroi ndalimin e bërë nga Zoti dhe u mashtrua, si pasojë e vesveseve të djallit dhe ra në çarkun e gabimit.

1. Sure “Et-Teube”, ajeti 67.

2. Sure “El-Hashr”, ajeti 19. Kuptimi i frazës *ensahum enfusehum* është ky: Zoti i bëri ata të harrojnë se, me kryerjen e punëve të mira në këtë botë, që përpara duhet të depozitohen të mira për Botën Tjetër të tyre.

3. Sure “Ta ha”, ajeti 15.

4. El-Behij el-Khaulij, *Adem (a.s.) felsefetu takuimi'l-insan ue khilafetihi*, f. 183.

B- Lidhja e harresës me djallin

Disa nga ajetet e Kur'anit vënë në dukje çështjen që djalli ndikon te njeriu nëpërmjet harresës, duke e nxitur atë që, nganjëherë, të jetë indiferent ndaj disa punëve të rëndësishme, te të cilat gjendet dobi. Ashtu sikurse, ndonjëherë, bëhet shkak i indiferencës së njeriut ndaj kujtimit të të madhit Zot dhe të shkujdesjes së tij ndaj bindjes karshi urdhërësave të Zotit. Ne më parë, kur po diskutonim për një harresë të prejardhur nga gabimi, përmendëm një ajet që rrëfen fjalën e djaloshtit që bashkudhëtonte me Musain (*Paqja e Allahut qoftë mbi të!*) për harresën e peshkut. Ai tha: **“Vetëm djalli ma mori nga mendja kujtimin e atij peshku.”** Ajetet e mëposhtme ofrojnë shembuj të tjerë të ndërhyrjes së djallit në harresën e njeriut.

“Kur t’i shohësh ata të nënçmojnë shpalljet Tona, largohu prej tyre, derisa të kalojnë në bisedë tjetër! E, nëse djalli të bën të harrosh, sapo të përmendesh, mos rri me keqbërësit!”¹

“Ata i ka vënë poshtë djalli dhe i ka bërë që të harrojnë përmendjen e Allahut. Ata janë pala e djallit; në të vërtetë, pala e djallit janë humbësit.”²

“Jusufi i tha njërit prej këtyre të dyve, për të cilin e dinte se do të shpëtonte: “Përmendëm mua te pronari yt!” Por djalli bëri që ai të harronte ta përmendte te pronari i vet dhe kështu, Jusufi mbeti edhe disa vjet në burg.”³

Arma e djallit për t’i larguar nga rruga e drejtë dhe për t’i shtrënguar njerëzit që të harrojnë Zotin e në mënyrë të përgjithshme për të harruar të mirën dhe atë që është në interes të tyre, është ndikimi i tij tek ata nëpërmjet motivimit, epshit të tyre, duke qenë kjo një pikë e dobët e tyre.

Porta e hyrjes së djallit te shpirti i Ademit (*Paqja e Allahut qoftë mbi të!*) ishte nëpërmjet kësaj udhe,⁴ sepse djalli i kishte premtuar atijse, nëse do të hante prej fryteve të pemës së ndaluar,

1. Sure “El-En’am”, ajeti 68.

2. Sure “El-Muxhadile”, ajeti 19.

3. Sure “Jusuf”, ajeti 42.

4. El-Behij el-Khaulij, Adem (a.s.) felsefetu takuimi'l-insan ue khilafetihi, f. 184.

do t'i dhuronte atij përjetësi dhe pushtet të qëndrueshëm. Si pasojë e kësaj ngasjeje, Ademi e harroi ndalimin e bërë prej Zotit dhe ra në rrjetën e djallit. Parimisht, djalli te të gjithë njerëzit e arrin kontrollin nëpërmjet kësaj metode, domethënë fillimisht provokon tek ata pasione dhe dëshira të ndryshme, pastaj i zvarrit drejt tyre dhe, si përfundim, i ndalon nga të kujtuarit e Zotit.

“Tregoju atyre (hebrenjve) për njeriun, të cilit Ne i mësuam shpalljet Tona, por u largua prej tyre. Kështu, djalli e pushtoi atë dhe ai u bë nga të humburit. Sikur të donim, do ta ngrinim atë (me shpalljet Tona), por ai u mbërthye pas jetës tokësore dhe u dha pas dëshirave të veta. Shembulli i tij është si shembulli i qenit: nëse e ndjek, ai të nxjerr gjuhën, nëse largohesh, ai përsëri të nxjerr gjuhën. Ky është shembull i njerëzve, që mohojnë shpalljet Tona. Tregojua atyre këto ngjarje, në mënyrë që ata të mendojnë.”¹

C- Kur'ani dhe kurimi i harresës

Kurimi i harresës është i mundur me kujtimin e vazhdueshëm të Zotit, përmendjen e mirësive dhe begative të Tij, përsëritjen e ajeteve të Kur'anit për kujtimin e Botës Tjetër dhe të Ditës së Kiametit. Në ajetin e mëposhtëm, Kur'ani ka sqaruar rëndësinë e përmendjes së Zotit si kurim të kësaj lloj harrese.

“...Dhe, kur të harrosh, kujtoje Zotin ...”²

Kur'ani i lavdëron besimtarët që e mbajnë në mendje Zotin dhe i përshkruan ata si “të zotët e mendjes”.

“Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të Tokës dhe në ndërrimin e natës e të ditës, ka shenja për mendarët, për ata që e përmendin Allahun duke qëndruar në këmbë, ndenjur ose shtrirë dhe që meditojnë për krijimin e qiejve dhe të Tokës (duke thënë): “O Zoti Ynë! Ti nuk i ke krijuar kot këto - lartësuar qofsh (nga çdo e metë)! Prandaj na ruaj nga ndëshkimi i zjarrit.”³

1. Sure “El-A’raf”, ajetet 175-176.

2. Sure “El-Kehf”, ajeti 24.

3. Sure “Ali Imran”, ajetet 190-191.

Meqë kujtimi i të madhit Zot është kurues i harresës dhe i shkujdesjes së zemrës, Zoti na ka urdhëruar që natë e ditë, mëngjes e mbrëmje, gjithnjë ta mbajmë Atë në mendje.

“O besimtarë, përmendeni shpesh Allahun dhe lavdërojeni Atë në mëngjes dhe në mbrëmje!”¹

“Pasi të kryeni namazin, përmendeni Allahun duke qëndruar në këmbë, ulur dhe të shtrirë...”²

“Dhe, kur të përfundojë namazi, atëherë shpërndahuni nëpër tokë, kërkonin nga mirësitë e Allahut dhe përmendeni shumë Allahun, në mënyrë që të shpëtoni.”³

Duke e përmendur vazhdimisht Zotin, njeriu mund të kurojë harresën e Zotit dhe shkujdesjen ndaj Botës Tjetër (Ahiretit). Përmendja e Zotit është shkak i pronësisë së përhershme të të madhit Zot në zemër, në atë mënyrë, sa që njeriu nuk qëndron i shkujdesur, qoftë edhe një moment prej përmendjes së Zotit.

Kjo çështje na shpie te një prej parimeve të të mësuarit, domethënë te *përsëritja*, për të cilën diskutuam më parë. Përsëritja e përkujtimit të Zotit i bëhet zakon njeriut në atë mënyrë, sa që bëhet njësh në sjelljen e tij dhe, pa përpjekje e pa ndonjë mundim, del vetvetiu në çdo moment të jetës.

Si përfundim, kujtimi i Zotit bëhet i pranishëm në zemrën e njeriut dhe kjo është vetë gjendja të cilën e synojnë shumë nga sufistët nëpërmjet ushtrimeve dhe vetëdisiplinimit shpirtëror. Kur'ani, duke qenë një libër parimor, është e natyrshme që ta bëjë objekt trajtimi çështjen e harresës dhe të shkujdesjes së njeriut ndaj Botës Tjetër dhe të kujdeset për këtë lloj harrese, që ka rëndësi të madhe në sigurimin e lumturisë së kësaj bote e të Botës Tjetër të njeriut.

Nëse do të pranojmë që themeli i kësaj harrese është përkujtimi i Zotit, me qëllim fiksimit të këtij lloj zakoni dhe qëndrueshmërinë në sjelljen e njeriut, mund të nxirrnim si përfundim edhe këtë çështje: kurimi i harresës së zakonshme

1. Sure “El-Ahzab”, ajetet 41- 42.

2. Sure “En-Nisa”, ajeti 103.

3. Sure “El-Xhumu’a”, ajeti 10.

të informacioneve dhe njohurive, domethënë, harresa e llojit të parë dhe të dytë, për të cilën folëm më parë, me përsëritjen e informacioneve në fjalë herë pas here, është e mundur. Kjo është ajo gjë që psikologët bashkëkohorë kanë arritur në kërkimet e tyre.

Psikologët e kanë kufizuar vëmendjen e tyre në çështjen e harresës, shpesh të llojit të parë dhe të dytë dhe nuk kanë ndërhyrë në llojin e tretë të harresës, që është treguar në Kur'an, për të cilën folëm më parë.

KREU I TETË

Sistemi nervor në Kur'an

Kërkimet e reja fiziologjike kanë mundur të shquajnë zona të caktuara në indet e trurit, që kryejnë funksione të veçanta psikologjike. Njëra është qendra e lëvizjes, e cila kontrollon të gjitha lëvizjet e pjesëve të trupit. Tjetra është qendra e ndjeshmërisë, shqisa e të prekurit dhe disa nga faktorët e brendshëm. Ndjenja e ndryshimit të gradës së temperaturës dhe shqisa e shijimit mbaron tek ajo (në parim, çdo sektor nga pjesët e trupit ka përfaqësues në këto dy pjesë, domethënë në qendrën e lëvizjes dhe në qendrën e ndjeshmërisë.)¹

Qendër tjetër është qendra e të shikuarit, tek e cila mbarojnë fijet nervore të syrit dhe qendra e të dëgjuarit, tek e cila mbarojnë fijet nervore të veshit. Një tjetër prej këtyre qendrave është qendra e komunikimeve, e cila gjendet në pjesën më të madhe të sektorit ballor të dy anëve të trurit dhe është zona e grumbullimit të mesazheve me kuptim, të cilat hyjnë në tru prej pjesëve të ndryshme të trupit.

Gjithashtu, ajo është koordinuese e mesazheve të lëvizjes, të cilat lëshojnë impulse nga truri drejt pjesëve të ndryshme të trupit. Kjo qendër ndërhyr gjithashtu në të gjitha aktivitetet. Qendra e aktiviteteve të larta të mendjes janë: të mësuarit, të menduarit, të folurit, të shikuarit dhe të lexuarit.² Truri i njeriut ka kontroll mbi të gjitha aktivitetet e tij dhe çdo aktivitet që kryen njeriu ndikon te qelizat trunore.

Ky ndikim mbetet në qelizat e trurit në një formë, natyrën e së cilës shkenca nuk e ka zbuluar ende. Vetë këto ndikime të mbetura te qelizat e indeve të trurit formojnë bazën e

1. Rënditja e qendrave të lidhura me pjesët e trupit, me qendrat e lëvizjes dhe të ndjeshmërisë së trurit është e ndryshme. Për shembull, qendra që lidhet me këmbët dhe gjunjët gjendet në pjesën e sipërme të trurit dhe qendra që lidhet me duart, gojën dhe këmbët, gjendet në pjesën e poshtme të trurit.

2. Muhamed Uthman Nexhati, *Ilmu'n-nefs fi hayatina'l-jeumije*, f. 53-58.

aktiviteteve të larta të mendjes njerëzore, si: të mësuarin, kujtesën, imagjinatën dhe të menduarin. Nën rrezen e po kësaj intuïte, mbase mund të komentohen disa nga ajetet që kallëzojnë për dëshmimin e veshit, të syrit dhe të lëkurës kundër vetë njeriut në Ditën e Gjykimit. Sigurisht që, mënyrën e këtij dëshmimi e di vetëm Zoti. Mirëpo aty ku të gjitha aktivitetet e njeriut regjistrohen te qelizat trunore, ka mundësi që i madhi Zot t'i bëjë "të flasin" këto qeliza. Si rezultat, ato, njësoj si kasetat e regjistrimit të zërit, i përsërisin gjërat që janë regjistruar në to.

Shkencëtarët bashkëkohorë kanë bërë kërkime rreth enigmave të kujtesës dhe regjistruësve të zhdërvjelltësive të njeriut në qelizat e trurit. Në procesin e njërës prej këtyre eksperimenteve u ngacmua me rrymë elektrike një prej qendrave të trurit të një individi, që dëgjoi një melodi muzikore, të cilën e kishte dëgjuar më parë. Dhe, kur u ngacmua një pikë tjetër e trurit të tij, ai pa një panoramë të caktuar, që e kishte parë më parë.¹

Eksperimente të tilla vërtetojnë se informacionet e njeriut regjistrohen në qelizat e trurit të tij, në mënyrë që, nëse këto qeliza ngacmohen me ndonjë metodë të veçantë, njeriu mund të sjellë ndërmend informacionet e kaluara të tij. Prandaj mbetet mundësia (gjithsesi, Zoti e di më mirë) që i madhi Zot në Ditën e Kiametit, t'i bëjë të flasin qelizat e njeriut dhe t'i detyrojë ato që të përsërisin të gjitha aktet e kryera dhe fjalët e thëna që kanë regjistruar.

Si përfundim, njeriu i sjell ndërmend të gjitha veprat dhe fjalët e tij, thuajse i shikon dhe i dëgjon ato njësoj si pamje të gjalla e të drejtpërdrejta. Ndoshta ekzistojnë edhe mjete të tjera të cilat i madhi Zot ka regjistruar veprat dhe fjalët e njerëzve dhe qelizat trunore të jenë njëra prej tyre.

Gjithashtu, ka mundësi që regjistrimi i veprave dhe i fjalëve të njerëzve të realizohet nga qeliza të tjera të indeve të trupit, në ndonjë mënyrë, e cila është e panjohur për ne (Zoti e di më mirë).

1. Gazeta *Es-Sijase*, botimi i Kuvajtit, 12.03.1982, f. 13.

“Paralajmëroji ata për Ditën, kur do të tubohen armiqtë e Allahut për në zjarr e do të shtyhen me radhë. Kur të vijnë afër zjarrit, kundër tyre do të dëshmojnë veshët, sytë dhe lëkurët e tyre për atë që kanë bërë. Ata do t’u thonë lëkurëve të veta: “Pse dëshmuat kundër nesh?” e ato do të përgjigjen: “Allahu, i Cili ia jep aftësinë e të folurit gjithçkaje, na ka bërë që të flasim. Ai ju ka krijuar për herë të parë dhe tek Ai do të ktheheni.”¹

“Atë Ditë që do të dëshmojnë kundër tyre gjuhët, duart dhe këmbët e tyre për çfarë kanë bërë.”²

“Sot Ne do t’ua vulosim atyre gojët e do të Na flasin duart e tyre dhe do të dëshmojnë këmbët e tyre për atë që kanë bërë.”³

Indet e trurit janë të organizuara prej miliarda qelizash nervore që gjenden në një vend relativisht të ngushtë në kafkë. Për këtë arsye, këto inde janë të formuara prej hullish dhe lartësish të shumta. Në të vërtetë, sipërfaqja e indeve të trurit është aq e madhe, që, nëse do ta shihnim atë në plan të shtrirë, sipërfaqja e tyre arrin në 16 këmbë katrorë.

Vëllimi i madh i këtyre indeve, që është i formuar nga miliarda qeliza nervore, e bën atë të aftë që të regjistrojë të gjitha aktivitetet e njeriut. Indet e trurit të njeriut, në të vërtetë, janë raporti i madh dhe vëllimi i të gjitha aktiviteteve të njeriut. Ashtu siç e theksuam dhe më parë, mbase një prej mjeteve të regjistrimit të veprave të njeriut, sipas vullnetit të Zotit, do të jenë vetë qelizat e trurit, që në ditën e Kiametit do të hyjnë në punë kundër njeriut, si një argument i pamohueshëm.

“Çdo njeriu ia kemi varur në qafë llogarinë për punën e tij dhe Ne, do t’ia paraqesim Ditën e Kiametit librin, që do ta gjejë të hapur (e do t’i themi): “Lexoje librin tënd! Ti mjafton sot si llogaritar kundër vetvetes!”⁴

“Atë ditë, njeriu do të vihet në dijeni për veprat që ka bërë dhe për ato që ka lënë pa bërë. Po, vërtet që njeriu

1. Sure “Fussilet”, ajeti 19-21.

2. Sure “En-Nur”, ajeti 24.

3. Sure “Ja Sin”, ajeti 65.

4. Sure “El-Isra”, ajetet 13-14.

do të dëshmojë kundër vetvetes, edhe sikur të paraqesë shfajësimet e veta.”¹

Natyrisht që regjistrimi i veprave të njeriut në qelizat e trurit nuk e përjashton mundësinë e ekzistencës së një tjetër mjeti për regjistrimin e veprave të të gjithë njerëzve, në një dosje tjetër të përgjithshme. Ky mjet tjetër është vetë Libri, për të cilin është vënë theksi në disa ajete kur'anore.

“Dhe Toka do të shndrisë me dritën e Zotit të vet dhe do të vendoset Libri (i veprave). Pastaj do të sillen profetët dhe dëshmitarët e ata do të gjykohen me drejtësi, e nuk do t’u bëhet asnjë padrejtësi.”²

“Dhe Libri (i veprave të tyre) do t’u vihet përpara, e do t’i shohësh gjynahqarët se si do të tmerrohen nga ato që gjenden në të dhe do të thonë: “Të mjerët ne! Çfarë është ky libër që nuk paska lënë asnjë vepër të madhe apo të vogël pa e shënuar atë.” Aty do të gjejnë të shënuar gjithçka që kanë punuar. Zoti yt nuk i bën padrejtësi askujt.”³

“... te Ne është Libri që flet të vërtetën dhe askujt nuk do t’i bëhet padrejtësi.”⁴

Shqisat e njeriut, po ashtu, ndikohen nga paralajmërimet shqisore, të cilat përfitohen prej ndjesive të ndryshme. Në këtë mënyrë, shqisat në fjalë, nën ndikimin e atyre paralajmërimeve, bëhen motiv i një sërë ngacmimesh nervore. Këto ngacmime kalojnë nëpër damarë dhe nerva dhe, më në fund, arrijnë në qendrat e ndjesive në tru, ku ndodhin perceptimet shqisore.

Kur’ani, në shumë nga ajetet që ne i theksuam më parë në kreun e tretë, në të cilin bëhej fjalë për perceptimet shqisore, ka vënë shenjë në disa prej organeve të rëndësishme shqisore. Tani këtu po sjellim disa shembuj të tjerë të këtyre ajeteve:

“Allahu ju ka nxjerrë nga barku i nënave tuaja e ju nuk dinit asgjë dhe ju dha të dëgjuarit, të parët dhe zemrat, që të jeni falënderues.”⁵

1. Sure “El-Kijame”, ajetet 13-15.

2. Sure “Ez-Zumer”, ajeti 69.

3. Sure “El-Kehf”, ajeti 49.

4. Sure “El-Mu’minun”, ajeti 62.

5. Sure “En-Nahl”, ajeti 78.

“Është Ai që jua ka krijuar dëgjimin, shikimin dhe zemrën. Eh, sa pak që e falënderoni ju!”¹

Gjithashtu, në pjesën e tretë, teksa diskutonim përreth perceptimeve shqisore, sollëm ndërmend këtë pikë, që Kur'ani e ka vënë theksin në ekzistencën e ndjesisë së dhimbjes në lëkurën e njeriut. Gjithashtu, na ka sjellë ndërmend edhe ekzistencën e shqisës së prekjës në lëkurën e njeriut, në veçanti, në gishtat e dorës.

“Ata që s’besojnë në shenjat Tona, Ne padyshim, do t’i djegim në zjarr. Sapo t’u digjet lëkura, Ne do t’ua ndërrojmë atë me lëkurë tjetër, për të përjetuar dënimin. Me të vërtetë, Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë.”²

“Sikur Ne të të zbritnim ty një Libër të shkruar në letër e ata ta preknin me duart e tyre, jobesimtarët me siguri që do të thoshin: “Kjo s’është gjë tjetër, veçse një magji e hapur.”³

1. Sure “El-Mu’minun”, ajeti 78.

2. Sure “En-Nisa”, ajeti 56.

3. Sure “El-En’am”, ajeti 7.

KREU I NËNTË

Personaliteti në Kur'an

Zakonisht njerëzit shohin te personaliteti ndikimet që individi shkakton te të tjerët dhe anasjelltas. Me një fjalë, e konsiderojnë atë një person agresiv ose paqësor. Ndërsa psikologët, teksa kërkojnë rreth personalitetit, e shohin atë si një qendër të aktiviteteve të qëndrueshme psikike, që është organizuesja e zhdërvjelltësive të individit dhe shkak i aksionit dhe i reaksionit të tij në mjedisin ku jeton, që e dallon atë prej të tjerëve.

Me fjalë të tjera, personaliteti është një lloj organizimi dinamik i sistemeve trupore dhe psikike, që përcakton natyrën e veçantë të njeriut, në përputhje me mjedisin. Prandaj, kur psikologët zënë të studiojnë personalitetin, e shohin individin si një koleksion që përmban aksion dhe reaksion, ku të gjitha aparatet trupore dhe psikike të tij kanë ndikim të ndërsjellë te njëri-tjetri, duke i veçuar sjelljet dhe reagimet e individit, që e dallojnë atë nga të tjerët.

Në Kur'an është sjellë përshkrimi i personalitetit të njeriut dhe i tipareve të përgjithshme të tij, që është shkak i dallimit të njeriut prej krijesave të tjera të Zotit.¹

Gjithashtu është përshkruar një pjesë e shembujve të përgjithshëm të personalitetit të njeriut, duke dhënë disa prej veçorive të tyre. Këto modele janë aq të përhapura, saqë sot vërehen në shoqërinë tonë njerëzore. Në Kur'an, gjithashtu, është përshkruar personaliteti normal dhe jonormal, si dhe faktorët krijues të normalitetit dhe të jonormalitetit të personalitetit. Për kuptimin e drejtë të personalitetit të njeriut duhet të studiohen me kujdes elementet e ndryshme përcaktuese të personalitetit.

1. Për më shumë informacione rreth personalitetit, referohu tek *Esh-Shakhsije (Personaliteti)*, me autor Richard. S.Lazarus, përkthimi i Sejjid Muhamed Gunejm, redaktor krahasues Muhamed Uthman Nexhati, Bejrut, Daru'sh-Shuruk, 1981, f. 19-22. Muhamed Nexhati, *Ilmu'n-nefs fi hajatina'l-jeumije*, f. 296, 392.

Psikologët bashkëkohorë bëjnë kërkime rreth faktorëve që ndikojnë në formësimin e personalitetit krijues. Zakonisht, ata ekzaminojnë faktorët biologjikë, shoqërorë dhe kulturorë. Vlen të theksohet se ata u japin rëndësi kërkimeve biologjike, në çështjen e ndikimit të trashëgimisë, strukturës trupore dhe natyrës përbërëse të sistemit nervor dhe aparatit endokrin.

Për të parë se si ndikojnë elementet shoqërore mbi personalitetin, studiohen zhdërvjelltësitë e periudhës së fëmijërisë, në veçanti në familje, dhe mënyra e sjelljes së prindërve. Gjithashtu, studiohet ndikimi i kulturave anësore, klasave të ndryshme të njerëzve, institucioneve të larmishme shoqërore dhe grupacioneve. Prandaj, faktorët përcaktues të personalitetit mund të ndahen në dy grupe kryesore: *faktorët trashëgues*, ata që rezultojnë nga struktura natyrore e vetë individit dhe *faktorët mjedisorë*, ata që burojnë nga mjedisi shoqëror-kulturor jashtë familjes.

Teksa diskutojnë rreth veçorive të personalitetit, psikologët përqendrohen në studimin e natyrës strukturore të individit dhe faktorët biologjikë, duke e lënë në harresë aspektin psikik të tij. Kjo është metoda e punës së tyre në kërkimet shkencore, metodë që merr në shqyrtim vetëm çështjen ku është i mundshëm vërtetimi dhe studimi.

Psikologët bashkëkohorë nuk e shqyrtojnë aspektin shoqëror, shpirtëror dhe ndikimin e tij në personalitetin e njeriut.

Deri diku është i pranishëm justifikimi i psikologëve për mënyrën eksperimentale që ndjekin në studimet e tyre, që nuk ndërhyjnë në aspektin shpirtëror të njeriut, sepse nuk dinë si të arrijnë në psikikën e tij nëpërmjet kërkimit shkencor.

Mirëpo, paaftësia e tyre për të arritur në aspektin shpirtëror të njeriut përmes kërkimit shkencor nuk duhet bërë shkak që të lihet pas dore tërësisht, kur përpiqet për perceptimin e personalitetit dhe arsyeve të sjelljes së tij, qofshin normale apo jonormale, nga ky aspekt shpirtëror.

Kjo indiferencë e psikologëve në kërkim të drejtimit shpirtëror të personalitetit të njeriut ka rezultuar me mangësi në perceptimin e tyre për njeriun, shkujdesje ndaj njohjes

së veçorive të personalitetit normal dhe jonormal dhe në mosarritjen te metoda ideale në psikoterapinë e çrregullimeve të personalitetit.

Psikanalisti i famshëm Erik From ka vënë re mangësinë dhe paaftësinë e psikologjisë bashkëkohore në çështjen e njohjes së psikikës së njeriut. Ai thotë: "...Tradita që e quan psikologjinë si shkencën e kërkimit të shpirtit të njeriut, që metodë të saj ka studimin e virtyteve, tashmë është lënë tërësisht mënjanë. Psikologjia akademike, duke ndjekur shkencat eksperimentale dhe metodat laboratorike në paraqitjen e statistikave dhe të shifrave, është shndërruar në një shkencë që kërkon gjithçka, përveç psikikës së njeriut.

Ajo pretendon të njohë aspektet e njeriut, për të cilat ekziston mundësia e testimit në laborator, por arrin në përfundimin se ndjesia, kriteret e vlerës dhe njohjes të së mirës dhe të së keqes, janë thjesht përfytyrime metafizike, që nuk kanë ndonjë lidhje me çështjet e psikologjisë. Sot, psikologjia, në vend që të jetë krijuese e metodave të reja për ekzaminimin e çështjeve të rëndësishme të njeriut, shpesh e harxhon të gjithë përpjekjen e saj nëpër çështje që, sipas mendimeve të psikologëve, janë të ekzaminueshme me metodat shkencore.

Në këtë mënyrë, shkenca e psikologjisë ndjeu nevojën e studimit të çështjes kryesore të saj, domethënë shpirtit të njeriut. Më parë, ajo merrej me ekzaminimin e mekanizmave që shkaktojnë reagim, me instinktët, dhe qëndronte indiferente ndaj studimit të tipareve të tjera njerëzore, të cilat e dallonin plotësisht atë prej krijesave të tjera, sikurse dashuria, arsyeja, ndjenja dhe vlerat."¹

Pa njohjen e natyrës dhe realitetit të faktorëve përcaktues të personalitetit, qofshin faktorë materialë apo shpirtërorë, nuk është i mundshëm perceptimi i qartë dhe i plotë i personalitetit të njeriut. Parimisht, ekzaminimi vetëm i faktorëve truporë-biologjikë dhe mospërfillja e aspekteve psikike të njeriut, natyrshëm do të na sjellë në dorë një imazh të pakuptimtë e të pasaktë të personalitetit.

1. Erik From, *Ed-din ue't-tahlilu'n-nefsij*, përkthim i Fuad Kamilit, f. 11.

A- Krijimi i njeriut

Kur'ani e ka shpjeguar mënyrën e krijimit të njeriut prej substancës dhe shpirtit. Bazuar në shpjegimin e Kur'anit, Zoti fryu nga shpirti i Tij te dheu, pas përshkrimit të fazave të ndryshme të krijimit dhe shndërrimit të tij në baltë, baltë e zezë me erë të keqe dhe baltë poçarie.¹ Kështu krijoi Ademin (*Paqja e Allahut qoftë mbi të!*).

“Kur Zoti yt u tha engjëjve: “Unë do të krijoj një njeri prej balte. Kur t’i jap trajtë dhe t’i fryj prej shpirtit Tim, përuluni në sexhde atij!”²

“Kur Zoti yt u tha engjëjve: “Unë do të krijoj një njeri prej baltës së thatë, të marrë nga balta e zezë pa formë. Kur t’i jap formën dhe t’i fryj prej shpirtit Tim, ju t’i përuleni atij në sexhde.”³

Fjala *ruh* (shpirt), në Kur'an është sjellë në disa kuptime.⁴ *Ruh* (shpirti) që është sjellë në ajetet që lidhen me krijimin e Ademit (*Paqja e Allahut qoftë mbi të!*) është në kuptimin e “një shpirti prej Zotit, i cili e përgatit njeriun për të perceptuar cilësitë e larta dhe për të ushqyer dashuri për *hakun*-të vërtetën.”⁵

1. I madhi Zot, në disa vende të Kur'anit ka vënë theksin në lidhje me fazat e krijimit të Ademit. Diku, Ai thotë: “E krijova atë nga dheu...” **“turabun”**; diku tjetër, nga balta **“tijn”**, që është përzierje prej dheut dhe ujit. Në një vend tjetër, prej **“hamain mesnun”**, d.m.th., një baltë që, si pasojë e qëndrimit në mot të ngrohtë, ka ndryshuar trajtë dhe, në një vend tjetër, **“tij-nun lazib”**, d.m.th., baltë ngjitëse, së cilës i jepet formë. Gjithashtu, diku tjetër prej **“salsalin min hamain mesnun”**, d.m.th., një balte e përtharë, që, kur e godet si qyp, lëshon zë tingëllues (baltë poçarie); diku tjetër prej **“salsalin ke'l-fekhar”**, një baltë që është tërësisht e tharë, për shembull në kohën kur balta piqet në zjarr dhe shndërrohet në enë balte, qeramikë. Referohu tek *El-Mufredat* i Ebu'l Kasim el-Hasan ibn Muhamed El-Mufaddal er-Ragib El-Isfahanit, f. 17-18. Dhe Muhamed Muteueli Esh-Sha'raui te *Mu'xhizetul Kur'an*, f. 117.

2. Sure “Sad”, ajetet 71-72.

3. Sure “El-Hixhr”, ajetet 28-29.

4. *Ruh* (shpirti) në Kur'an ka ardhur në disa kuptime, të cilat i ka përshkruar Ibn Kajimi në librin e tij *Er-Ruh*. Po ashtu, El-Beha el-Khaulij i ka sjellë këto kuptime me transmetimin nga libri në fjalë, me ndryshime dhe transformime në librin e tij *Adem (a.s.)*, nga i cili ne përcollëm më parë tema, f. 21-24.

5. El-Beha el-Khaulij, po aty, f. 22.

Gjithashtu, është shpirt në kuptimin e *elementit sublim (unsurijen iluijun)*, i cili e përgatit njeriun për realizimin e çështjeve të larta dhe fitimin e cilësive të shenjta, duke e bërë të denjë për t'u ngjitur në një pozitë më të lartë se kafsha. E përcakton dhe krijon për të qëllimin, objektivin e lartë dhe linjat kryesore të jetës dhe të stilit të tij.

Veç kësaj, gjithashtu, shton mbi prirjen e tij drejt burimit të vlerave dhe njohurive, që realiteti i ekzistencës së njeriut është për realizimin e tyre.¹

Për arsye të vetë kësaj ngrehine strukturore ekzistenciale, njeriu dallon nga krijesat e tjera, sepse ai ngjason me kafshën në më të shumtën e veçorive trupore, motivet, reagimet e ruajtjes së qenies dhe mbijetesës së llojit (species), gjithashtu, në fuqinë perceptuese dhe në të mësuar, dhe ndryshon prej saj vetëm nga veçoritë shpirtërore, të cilat janë motiv i prirjes dhe i vëmendjes së njeriut drejt njohjes, adhurimit të të madhit Zot dhe nxitjes së tij drejt fitimit të virtyteve dhe moraleve të larta, që e çojnë atë drejt niveleve të larta të përsosmërisë, duke e bërë të denjë si mëkëmbës të Zotit mbi tokë.

Me pak fjalë mund të thuhet se pamja dalluese e njeriut nga kafsha, në të vërtetë është ekzistenca e vetë kësaj shkëndije të shpirtit të Zotit te njeriu, e cila e ka parapërgatitur vetëm atë (dhe jo ndonjë krijesë tjetër) për njohjen e Zotit, besimin tek Ai, adhurimin e Qenies më të qenësishme, dhe për fitimin e dijeve e nxjerrjes së dobisë prej tyre, me qëllim krijimin e qytetërimeve mbi sipërfaqen e tokës dhe ruajtjen ndaj vlerave dhe moraleve të larta në sjelljet individuale dhe shoqërore.

Duhet ditur se shpirti dhe materia te njeriu nuk janë dy gjëra të ndara dhe të pavarura nga njëra-tjetra, por janë të përziera me njëra-tjetrën në një tërësi të përkryer dhe të harmonishme. Personaliteti i njeriut formohet nga kjo përzierje e përkryer dhe e harmonishme. Parimisht, pa kushtimin e vëmendjes së gjithanshme ndaj këtij realiteti, që formimi i personalitetit është rezultat i përzierjes së materies dhe e shpirtit, nuk është e mundshme njohja e personalitetit të njeriut.

1. Po aty, f. 32-33.

B- Konflikti psikik

Nga pikëpamja e personalitetit, njeriu ka një seri karakteristikash kafshërore, të cilat kristalizohen në nevojat trupore dhe, se këto nevoja duhet të plotësohen për ruajtjen e qenies dhe të mbijetesës së llojit (species). Ai, gjithashtu, mbart edhe cilësi hyjnore, të cilat kristalizohen në përmallimin shpirtëror, lidhur me njohjen e të madhit Zot, besimin tek Ai, adhurimin, shenjtërimin dhe atribuimin e pacenueshmërisë ndaj Zotit të Madhëruar. Nganjëherë, midis këtyre dy lloj karakteristikash të personalitetit të njeriut, lind kundërshtimi, saqë herë nevojat dhe dëshirat trupore e herë nevojat dhe përmallimet shpirtërore, e tërheqin atë drejt vetes dhe vetë njeriu, po ashtu, e ndien këtë konflikt të brendshëm ndërmjet këtyre dy aspekteve të personalitetit.

Kur'ani e vë kështu theksin për sa i përket situatës konfliktuale ndërmjet aspekteve trupore dhe shpirtërore të njeriut:

“Atëherë, ai që ka shkelur gjithçka dhe ka parapëlqyer jetën e kësaj bote, sigurisht që do të ketë për strehë Xhehenemin. Kurse ai që i është frikësuar madhërisë së Zotit të tij dhe e ka frenuar veten nga dëshirat, pa dyshim që do të ketë për strehë Xhenetin.”¹

Gjithashtu, Kur'ani, aty ku përshkruan shfaqjen me bujë të Karunit, me eskortë e stoli, vë theksin mbi këtë konflikt të brendshëm trupor dhe shpirtëror, sepse një pjesë e popullit, duke parë gjendjen e tij, dëshiruan që edhe ata të mund të kishin qenë të pasur si ai. Mirëpo, disa të tjerë u thanë atyre se ajo që gjendet pranë Zotit, është më e mirë dhe më e qëndrueshme.

“Kur ai dilte para popullit të vet me stolitë e tij, ata që lakmonin jetën e kësaj bote thanë: “Ah! Sikur të na ishte dhënë edhe neve si Karunit! Vërtet që ai është njeri me fat.” Ndërsa njerëzit e dijshtëm thoshin: “Të mjerët ju! Shpërblimi i Allahut është më i mirë për atë që beson dhe bën vepra të mira. Ai do t’u jepet vetëm të duruarve.”²

1. Sure “En-Naziat”, ajetet 37-41.

2. Sure “El-Kasas”, ajetet 79-80.

Disa myslimanë, kur dëgjuan se në Medinë arriti karvani i ngarkuar përplot me të mira materiale, u hallakatën sa andej-kënde, duke e lënë vetëm Profetin (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Ndërsa rrëfen këtë ndodhi, Kur'ani e vë theksin te konflikti midis aspekteve materiale dhe shpirtërore të njeriut.

"Mirëpo, sa herë që ata shohin ndonjë tregti ose lojë, shkojnë tek ajo e të lënë ty në këmbë. Thuaj: "Ajo që është tek Allahu, është më e mirë nga argëtimi e nga tregtia." Allahu është Dhuruesi më bujar."¹

Mbase vullneti i të madhit Zot e ka kërkuar kështu, që njeriu të mundohet ndërmjet vështirësive të tjera të jetës, prej konfliktit të brendshëm të kërkesave trupore dhe atyre shpirtërore.

"Se, në të vërtetë, Ne e kemi krijuar njeriun për të luftuar në vështirësi!"²

Mirëpo, ndoshta vullneti i Zotit mund të ketë qenë në favor të kësaj, që stili i njeriut, në zgjidhjen e këtij problemi, të jetë po ai testim real dhe themelor që Zoti ka caktuar në këtë botë për njeriun. Personat që mund të mbledhin te vetja aspektet materiale dhe shpirtërore të personalitetit dhe arrijnë të vendosin harmoni dhe baraspeshë, do të dalin me sukses dhe kryelartë nga ky testim dhe do të jenë të denjë për marrjen e shpërblimit të kësaj bote e të Botës Tjetër.

"Pasuria dhe fëmijët tuaj janë vetëm provë për ju. Allahu ka shpërblim të madh."³

"Prandaj këshillo, nëse këshilla do të jetë e dobishme! Asaj do t'ia vërë veshin ai që (i) frikësohet (Allahut), e do t'i shmanget vetëm më i keqi, i cili do të digjet në zjarrin e madh, ku as nuk do të vdesë, as nuk do të jetojë. I shpëtuar është ai që pastrohet, që e përmend emrin e Zotit të vet dhe që fal namaz! Por ju, përkundrazi, më shumë po e parapëlqeni jetën e kësaj bote, ndonëse Jeta Tjetër është më e mirë dhe e amshuar."⁴

1. Sure "El-Xhumu'a", ajeti 11.

2. Sure "El-Beled", ajeti 4.

3. Sure "Et-Tegabun", ajeti 15.

4. Sure "El-A'la", ajetet 9-17.

“Ai i ka krijuar jetën dhe vdekjen, për t’ju provuar se kush prej jush do të veprojë më mirë; Ai është i Plotfuqishmi dhe Falësi i madh.”¹

Mbase kërkesa e urtësisë dhe e mëshirës së të madhit Zot është që ta ndihmojë me të gjitha mundësitë e nevojshme njeriun për zgjidhjen e këtij konflikti dhe kalimin e fazës së këtij testimi problematik. Prandaj edhe i ka dhuruar mendjen njeriut, për të shquar e për të dalluar të mirën dhe të keqen, *hakun* dhe *batilin* (të drejtën dhe të shtrembrën). Gjithashtu, i ka dhënë atij lirinë e vullnetit dhe të zgjedhjes, që të mund të marrë vendim në këtë konflikt, që të zgjedhë çdo rrugë që pëlqen për zgjidhjen e tij. Parimisht, bazën dhe infrastrukturën e përgjegjësisë dhe të kontrollimit të llogarisë së njeriut, e formon liria e vullnetit dhe e zgjedhjes së rrugës për zgjidhjen e këtij konflikti.

“Dhe ia kemi bërë të qarta të dyja rrugët?”²

“Natyrisht që Ne i treguam atij rrugën e drejtë, që ai të jetë ose mirënjohës, ose mosmirënjohës.”³

“Për shpirtin dhe për Atë që e ka përsosur, duke ia bërë të njohur atij të keqen e të mirën! Vërtet, kushdo që e pastron shpirtin, do të shpëtojë, ndërsa kushdo që e shtyp atë (me punë të këqija), do të dështojë.”⁴

“(Thuaju o Muhamed): “Tashmë ju kanë ardhur nga Zoti juaj prova të qarta. Ai që i sheh ato, i sjell dobi vetes, ndërsa ai që i mbyll sytë para tyre, i bën dëm vetes. Unë nuk jam rojtari juaj.”⁵

Dhe thuaj: “E vërteta është nga Zoti juaj. Kush të dojë, le të besojë e kush të dojë, le të mohojë.” Ne kemi përgatitur për mohuesit keqbërës një zjarr, që do t’i rrethojë nga të gjitha anët (si çadra). Nëse do të kërkojnë ndihmë, do t’u jepet një ujë si xehja e shkrirë, që do t’ua përcëllojë fytyrat. Sa pije e tmerrshme është ajo e sa strehim i keq është ai (zjarri)!”⁶

1. Sure “El-Mulk”, ajeti 2.

2. Sure “El-Beled”, ajeti 10.

3. Sure “El-Insan”, ajeti 3.

4. Sure “Esh-Shems”, ajetet 7-10.

5. Sure “El-En’am”, ajeti 104.

6. Sure “El-Kehf”, ajeti 29.

“Kush bën mirë, e bën për dobi të vet, e kush punon keq, punon në dëm të vet. Zoti yt nuk u bën padrejtësi robërve të Tij.”¹

Kurrsesi! Beto hem për Hënën, për natën që largohet e për agimin që zbardhëllon.....Ne lëshoheshim në biseda të kota me llafazanët dhe mohonim Ditën e Llogarisë, deri sa na erdhi vdekja.”²

Prandaj, ngrehina ekzistenciale e njeriut, natyrshëm, ka dhunti si kryerjen e punëve të shëmtuara, rendjen pas epshit, dëshirave trupore, mbytjen në kënaqësitë e prekshme dhe prirjet kah tokësorja, ashtu edhe gatishmërinë e ngritjes në kulmin e devotshmërisë, virtyteve të larta njerëzore, punën e mirë dhe rrjedhojat e saj, domethënë, arritjen te qetësia psikike dhe lumturia shpirtërore. Kjo është arsyeja se pse natyra e lindur e njeriut është përmbajtëse e konfliktit midis së mirës dhe së keqes, virtytit dhe poshtërimit, bindjes e mosbindjes ndaj Zotit. Trishtimi real i njeriut në këtë botë është vetë ky drejtim i prirjes së dëshirës dhe çështjes së zgjedhjes së tij.

Vallë, a do të zgjedhë rrugën e së mirës dhe të bindjes ndaj Zotit apo rrugën e së keqes e të mosbindjes? A do të rendë pas epsheve dhe dëshirave trupore dhe çështjeve tokësore dhe do të mbesë i shkujdesur, për sa i përket kujtimit të Zotit e do të harrojë Ditën e Kiametit, apo do t'i vërë nën kontroll epshet e do të krijojë ekuilibër midis dëshirave trupore dhe shpirtërore të veta? Nëse njeriu në jetë zgjedh kënaqësitë tokësore dhe rend pas epsheve dhe pasioneve trupore, duke harruar Zotin dhe Ditën e Shpagimit, bëhet njësoj si kafsha, madje edhe më keq, sepse nuk ka përfituar nga mendja dhe arsyeja e tij, që me anë të saj, Zoti i ka dhuruar përparësi mbi kafshën.

“A e ke parë ti atë që epshin e vet e ka marrë për zot? A do t'i bëhesh mbrojtës atij? A mendon ti se shumica e tyre dëgjojnë dhe kuptojnë? Ata nuk janë tjetër, veçse si bagëti. Madje, ata janë edhe më të shmangur nga rruga e drejtë.”³

1. Sure “Fussilet”, ajeti 46.

2. Sure “El-Muddeth’thir”, ajetet 32-47.

3. Sure “El-Furkan”, ajetet 43- 44.

Njeriu që bën këtë lloj jetese, nuk ka një personalitet të zhvilluar. Një person i tillë është si një fëmijë, që përveç nevojave dhe prirjeve të veta, për të nuk ka rëndësi asgjë tjetër. Në të vërtetë, ende nuk i është forcuar vullneti dhe nuk e ka mësuar cilësinë e zotërimit mbi epshin dhe dëshirën e zemrës. Prandaj, gjithnjë rend pas dëshirave dhe është i nënshtruar nga ngasjet e vesveseve të *nefsit emmare bis-su* (shpirtit urdhërues për gjëra të liga).

“Unë nuk e shfajësoj veten, sepse shpirti (i njeriut) është fort i prirur për të keqe, përveç atij që e mëshiron Zoti im. Me të vërtetë, Zoti im është Falës dhe Mëshirë-plotë.”¹

Edhe Profeti i nderuar, për këtë, ka thënë: “Armiku yt më i përbetuar është vetë epshi yt, i cili gjendet brenda teje. Kushdo që e edukon dhe e shtyp atë, do të mbetet i sigurt prej mizorisë së tij.”²

Kur njeriu arrin në një gradë të lartë zhvillimi, i zgjohet ndërgjegjja dhe e dënon brishtësinë e vullnetit dhe rendjen pas epsheve dhe kënaqësive të kësaj bote, që bëhen shkas për rrëshqitjen dhe mëkatimin e tij. Ndërsa ndien mëkatën, e qorton veten e vet për shkak të teprimit në mëkatim dhe shkon drejt Zotit, duke kërkuar ndjesë e duke u penduar. Në këtë situatë, ai është nën ndikimin e *nefsit levvame* (shpirtit qortues, brejtjes së ndërgjegjes).

“Betohem në Ditën e Kiametit! Betohem në shpirtin qortues!”³

“Atë Ditë, askush nuk do të dënojë siç dënon Ai, e askush nuk do të lidhë në pranga siç lidh Ai! O ti shpirt i qetësuar! Kthehu te Zoti yt, ti i kënaqur me Atë dhe Ai kënaqur me ty! Bashkohu me robërit e Mi dhe hyr në Xhenetin Tim!”⁴

Këto tri koncepte të *nefsit*, domethënë *nefsit emmare bi's-su* (shpirtit urdhërues për gjëra të liga, epshit për gjëra të liga), *nefsit levvame* (shpirtit qortues, brejtjes së ndërgjegjes) dhe *nefsit mutmainne* (shpirtit të qetë e të bindur), mund t'i

1. Sure “Jusuf”, ajeti 53.

2. Me transmetim nga Ebu'l Kasim Hasan ibn Muhamed el-Mafaddal Er-Ragib el-Isfahani: *El-Mufredat*, f. 88-89.

3. Sure “El-Kijame”, ajetet 1-2.

4. Sure “El-Fexhr”, ajetet 25-30.

imagjinosh si shkallë kualifikimi të personalitetit të njeriut. Në nivelet e ndryshme të zhvillimit, personaliteti i njeriut i hedh ato pas shpine, gjatë rrjedhës së konfliktit të brendshëm midis aspekteve materiale dhe shpirtërore. Në kohën që personaliteti i njeriut gjendet në nivelin më të ulët, kur atë e sundojnë epshet, pasionet dhe shijimet tokësore, në të vërtetë, është nën sundimin e *nefsit emmare* (shpirtit urdhërues, epshit).

Në kohën që arrin në rangun më të lartë të zhvillimit dhe të përsosjes njerëzore, deri aty sa të krijohet baraspeshë midis kërkesave të tij trupore dhe shpirtërore, atëherë ka arritur në fazën e *nefsit mutmainne* (nefsit të bindur). Kufiri i mesëm midis këtyre dy fazave është një fazë në të cilën njeriu i kërkon llogari vetes për fajet që ka kryer dhe ndalon seriozisht së kryeri punë, që bëhen shkak i zemërimit të Zotit dhe brejtjes së ndërgjegjes.

Mirëpo njeriu nuk korr gjithnjë sukses në këtë përpjekje. Nganjëherë gabon dhe bie në faj si pasojë e dobësisë. Në këtë gjendje, personaliteti i njeriut gjendet në nivelin e *nefsit levvame* (brejtjes së ndërgjegjes). Vlen të përmendet se pas katërmbëdhjetë shekujsh të zbritjes së Kur'anit, Zigmund Frojdi, themeluesi i Psikanalizës, në lidhje me personalitetin, paraqiti një ide, mbi bazën e së cilës e ndau *nefsin* (veten) në tri pjesë, të cilat ngjasojnë me konceptet e *nefsit emmare*, *nefsit levvame* dhe *nefsit mutmainne* në Kur'an.

Frojdi beson se vetja përbëhet nga tri pjesë: *idi*, *uni*, *mbiuni*.¹ (*essi*, *egoja* dhe *superegoja*). *Idi* (*essi*), sipas pikëpamjes së Frojdit është i përbërë nga instinkte me rrjedhojë trupore dhe se vetja në këtë fazë vepron mbi bazën e *Parimit të kënaqësisë*. Synimi i saj mbetet gjithnjë kënaqja e instinkteve trupore, pa respektuar logjikën, moralin dhe realitetin. *Idi* (*essi*), në njëfarë mase, është i ngjashëm me *nefsin emmare bi's-su* në Kur'an.

Mbiuni ose *superegoja* është ajo pjesë e vetes, e cila përbëhet prej mësimave që i janë ushqyer individit nëpërmjet prindërve dhe mësuesve; njëkohësisht prej vlerave kulturore

1. Zigmund Frojd, *El-Ena ue'l-hue* (*The Ego and the Id*), përkthim i Muhamed Uthman Nexhatit, botim i katërt, Bejrut: Daru'sh-Shuruk, 1982, f. 14-17; Zigmund Frojd, *Me'alimu't-tehlili'n-nefsij*, përkthim i Muhamed Uthman Nexhatit, botim i pestë, Daru'sh-Shuruk, Bejrut, 1983, f. 46-48.

të ambientit dhe që pak e nga pak shndërrohet në një energji të brendshme psikike, që angazhohet në të kërkuarit e llogarisë, të kritikimit të individit, që nganjëherë e kërcënon edhe me shpagim. Këtë *nefs* zakonisht e njohin me emrin ndërgjegje. Sipas besimit të Frojdit, *mbiuni* ose *superegoja* është treguese e natyrës zhvillimjetëse të njeriut.

Mbiuni ose superegoja, në këtë kuptim, deri diku, është e ngjashme me konceptin e *nefsit levvame* (brejtjes së ndërgjegjes).

E më në fund, *uni* ose *egoja* është ajo pjesë e vetes, e cila ka në dorë frerët e prirjeve instiktive që burojnë prej *idi-essit* dhe mbizotëron mbi ta. Si rrjedhojë, lejon kënaqjen për atë që do dhe lë për zëvendësim kryerjen e asaj që nuk dëshiron. Po ashtu, shtyp prirjet, asgjësimin e të cilave e sheh të domosdoshëm dhe në këto punë respekton dhe i përmbahet *Parimit të realitetit* apo vëmendjes në “botën jashtë vetes”, me të gjitha ligjet, vlerat, moralet dhe urdhëresat fetare të saj.

Sipas besimit të Frojdit, funksioni i *egos* është shkaktimi i harmonisë midis *essit* dhe *realitetit*, apo midis botës së jashtme dhe *superegos*, në mënyrë që e lejon kënaqjen e *esit* vetëm në kufirin e realitetit dhe, gjithashtu, parandalon teprimin e *Superegos* dhe bëhet pengesë e teprimit pa argument logjik.

Nëse *egoja* ia del me sukses në detyrën e harmonizimit midis *esit* dhe *superegos*, do të faktohet mundësia e ekuilibrit, e normalitetit dhe e shëndetit psikik të njeriut. Duke vënë re temat e mësipërme, ne mund të gjejmë ngjashmëri midis rezultatit, tek i cili përfundon sukcesi i *egos* në kryerjen e detyrës; po ashtu, faktimit të ekuilibrit të personalitetit dhe lumturisë së njeriut nga njëra anë dhe nga ana tjetër midis gjendjes së *nefsit mutmainne* (vetes së bindur), tek e cila njeriu arrin me mposhtjen e pasioneve dhe krijimin e ekuilibrit ndërmjet dëshirave trupore dhe shpirtërore të veta.

Sigurisht që në këtë mes, njeriu respekton *Parimin e realitetit*, të cilin ia orienton jetesa në një shoqëri islame, domethënë, ndjek rregullat morale islame, kryen adhurimet e detyruara dhe angazhohet në punë të mira, duke iu larguar punëve të këqija. Sigurisht që këtu duhet të theksojmë ekzistencën e

mosmarrëveshjes së gjendur midis tri koncepteve të *Nefsit* (të Vetes), ashtu siç kanë ardhur në Kur'an dhe tri llojeve të vetes nga pikëpamja e Frojdit.

Konceptet e *nefsit emmare bi's-su*, *nefsit levvame* dhe *nefsit mutmainne* janë gjendje të ndryshme që, në rrjedhën e konfliktit të brendshëm të hapësirës materiale dhe shpirtërore të personalitetit të njeriut, vetja e tij kualifikohet e klasifikohet sipas tyre. Prandaj ato nuk mund të njihen si pjesë të ndryshme të *Nefsit-Vetes*, sikurse nuk dalin në pah gjatë etapave të përcaktuara të zhvillimit, nëpër të cilat kalon njeriu.

Konceptet e *esit*, *egos* dhe *superegos*, nga pikëpamja e Frojdit, janë edhe lloje të ndryshme të vetes, por që dalin në pah edhe në etapat e ndryshme të zhvillimit të fëmijës. *Esi*, në të vërtetë është vetja e fëmijës, menjëherë pas lindjes së tij, sepse fëmija në këtë fazë gjendet nën ndikimin e dëshirave instinktive të tij. Pastaj gradualisht dhe nën ndikimin e botës së jashtme, del në pah pjesa e *egos* së fëmijës. Kjo është vetë ajo që, duke respektuar rrethanat dhe nevojat e *Realitetit* dhe botën e jashtme, qeveris e sundon mbi instinktet e dala prej *esit*.

Ndërsa *superegoja* e fëmijës, gjithashtu, ndërtohet nga urdhërimet dhe ndalimet, të cilat ai i përthith prej prindërve dhe kulturës së mjedisit që e rrethon. Kjo është vetë ndërgjegjja, e cila i kërkon llogari njeriut, e qorton dhe e fajëson për mëkatet dhe fajet që bën. Në pikëpamjen e Frojdit, midis këtyre tri pjesëve të vetes, pa dyshim, lindin konflikte, që në rrjedhën e tyre *egoja* përpiqet të vendosë harmoninë midis dëshirave të *esit* dhe të *superegos*, botës së jashtme. Nëse ia del mbanë në këtë punë, atëherë njeriu do të bëhet një njeri normal dhe përfitues i shëndetit psikik. Ndërkohë që, nga pikëpamja e Frojdit, ndodh konflikt psikik midis këtyre tri pjesëve të vetes.

Duke u bazuar në panoramën që na paraqet Kur'ani për natyrën dhe brumin e krijimit të njeriut, ky konflikt realizohet midis dimensionit material, shpirtëror e psikik të personalitetit të njeriut dhe, si rezultat i këtij konflikti, lindin tri gjendjet e *nefsit-vetes*: *nefsi emmare bi's-su*, *nefsi levvame* dhe *nefsi mutmainne*.

C- Ekuilibri i personalitetit

Më parë thamë se rrugëzgjdhja më e përshtatshme e problemit të konfliktit midis anëve trupore dhe psikike të njeriut është vendosja e harmonisë ndërmjet këtyre të dyjave, në kuptimin që njeriu të kënaqë nevojat trupore në masën e lejuar dhe, njëkohësisht, të merret edhe me plotësimin e nevojave psikike. Nëse njeriu zotohet të jetë i matur dhe i ekuilibruar, larg teprimit në plotësimin e motiveve trupore dhe psikike, është plotësisht i mundshëm krijimi i harmonisë midis nevojave trupore dhe shpirtërore.

Në Islam nuk ekziston ndonjë murgëri (*rahbanijet*), që të jetë kundër plotësimit të motiveve trupore dhe të veprjës në drejtim të shtypjes së tyre dhe as ndonjë lloj lirie absolute (*ibahe mutlaka*), që të plotësojë tërësisht motivet trupore. Islami është kërkues i harmonizimit të motiveve trupore dhe shpirtërore dhe i zgjidhjes së një rruge të mesme, e cila përfundon me krijimin e ekuilibrit ndërmjet anëve materiale dhe shpirtërore të njeriut.

Më parë, teksa diskutonim rreth përplasjes psikike, në kreun e parë të këtij libri (kreu për motivet në Kur'an), ne e kemi vënë theksin në këtë temë. Kur'ani e vë theksin kështu mbi domosdoshmërinë e realizimit të këtij ekuilibri në personalitetin e njeriut:

“Por përpiku me atë që të ka dhënë Allahu të fitosh jetën e botës së ardhshme, duke mos harruar pjesën tënde në këtë botë...”¹

Profeti Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*) ka thënë: “Më i miri ndër ju nuk është ai që punon për këtë botë (*dynjanë*), pa marrë parasysh Botën Tjetër (*Ahiretin*), as ai që punon vetëm për Botën Tjetër (*Ahiretin*) dhe që e braktis këtë botë (*dynjanë*). Por, më i miri ndër ju është ai që punon si për këtë botë, ashtu edhe për Botën Tjetër.”²

Me vendosjen e ekuilibrit ndërmjet trupit dhe shpirtit, merr formë në mënyrë reale e të plotë natyra (qenia) e njeriut.

1. Sure “El-Kasas”, ajeti 77.

2. Muhamed Xhevad Mugnijeh, *Felsufetu'l-akhlak fi'l-Islam*, Bejrut, Daru'l-Ilm lil-Melajin, 1977, f. 194-195.

Kjo natyrë (qenia) e plotësuar vihet re në personalitetin e Profetit të Islamit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), i cili i bart që të dyja, si energjinë gjallëruese e shpirtërore, ashtu edhe freskinë rritëse trupore. Ky Profet, ashtu si adhuronte Zotin me kënaqësi e përlulësi të plotë, ashtu vazhdonte jetën e tij njerëzore, njësoj si të tjerët dhe përfitonte nga kënaqësitë e kësaj bote, aq sa lejohej.

Për këtë arsye, ekzistenca e shenjtë e Profetit të Islamit, ishte përfaqësuese e një njeriu të kompletuar dhe një personaliteti shembullor, tek i cili ishin ekuilibruar të gjitha forcat trupore dhe psikike njerëzore.¹

Ekuilibri i trupit dhe i shpirtit në personalitetin e njeriut është tregues i baraspeshës së gjendur në të gjithë universin, sepse i madhi Zot e ka krijuar çdo gjë në një masë të caktuar. Ne, në kreun e parë, kur diskutuam rreth motiveve me natyrë të lindur (*fitri*), vumë theksin në idenë e ekuilibrit jetik në trup; gjithashtu, treguam detyrën e motiveve të lindura (*fitri*) në ruajtjen e trupit në një gjendje të qëndrueshme në ekuilibër, që është një gjë e domosdoshme për ruajtjen e qenies dhe mbijetesën e llojit. Mirëpo, duhet vënë re se çështja e ekuilibrit të njeriu nuk kufizohet vetëm me ekuilibrin biologjik, por përfshin të gjithë personalitetin e njeriut, si edhe ekuilibrin e trupit dhe të shpirtit.

Ç- Personaliteti normal

Nga temat e kërkuara del në pah çështja se personaliteti normal, në këndvështrimin e Islamit, është një personalitet, ku trupi dhe shpirti janë në baraspeshë dhe ku plotësohen nevojat e të dyve. Njeriu që gëzon personalitet normal, i kushton rëndësi trupit, shëndetit dhe fuqisë së tij dhe i plotëson nevojat e tij në masën që e lejon ligji i shenjtë, njëkohësisht beson edhe në Zot, zbaton adhurimet dhe punët për të cilat fiton kënaqësinë e Zotit dhe shmanget prej veprimeve që bëhen shkak i zemërimit të Tij.

1. Muhamed Kutub, *Fi'n-nefsi ue'l-muxhtema'*, botim i dytë, Kajro, Mekteb-etü Uehbe" 1962, f. 62-63.

Prandaj, nga pikëpamja e Islamit, individi që rend pas epshit, është një individ jonormal; e po ashtu, edhe ai person që shtyp nevojat e tij trupore dhe me murgëri bëhet shkak i dobësimit trupor të tij dhe merret vetëm me plotësimin e nevojave dhe prirjeve shpirtërore, është një person jonormal.

Këto lloj prirjesh ekstreme janë në kundërshtim e në mosmarrëveshje me natyrën burimore të njeriut (*fitrah*). Pra, për këtë arsye, asnjëra nga këto dy prirje nuk përfundon me formësimin dhe realizimin e natyrës (qenies) reale të njeriut, si dhe nuk e shpie atë drejt përsosjes së vërtetë të personalitetit.

D- Llojet e personalitetit në Kur'an

Mendimtarët përgjatë historisë dhe psikologët në shekullin e tanishëm janë përpjekur të studiojnë ngjashmëritë dhe ndryshimet e personaliteteve njerëzore. Nga pikëpamja e personalitetit, ata i kanë ndarë njerëzit në disa lloje. Secili lloj mbart një grup të caktuar karakteristikash apo shenjash dalluese. Disa, duke u bazuar te karakteristikat trupore, i kanë ndarë njerëzit në kategori të ndryshme dhe besojnë se ata persona që renditen në grupimin e ndonjëres prej tyre, ngjajnë me njëri-tjetrin në veçoritë psikike. Një grup tjetër, duke u bazuar në ngjasimet e tipareve psikike të njerëzve, i ka ndarë në kategori psikike.¹

Ndarja e njerëzve në kategori të ndryshme nga pikëpamja e personalitetit, ku secila kategori përfshin individë që kanë karakteristika të ngjashme, në të vërtetë, është një përpjekje për të përshkruar njerëzit e për të komentuar sjelljen e tyre. Për shembull, kur pohojmë lidhjen e X personi me Y personalitet, do të mund ta përshkruajmë vetë atë dhe të komentojmë sjelljen e tij, sikurse do të jetë i parashikueshëm lloji i sjelljes që mund të lindë prej tij në të ardhmen. Sipas Kur'anit, njerëzit ndahen në tri kategori: *mu'minë*-besimtarë, *kafirë*-mohues dhe *munafikë*-

1. Për më shumë informacion rreth ideve të paraqitura për llojet e personalitetit, referohu tek: *Esh-Shekhsije (Personaliteti)*, Ricard.S.Yazarus, f. 62-67 dhe *Ilmu'n-nefs fi hajatina'l-jeumijeh (Psikologjia në jetën tonë të përditshme)*, Muhamed Uthman Nexhati, f. 398-405.

hipokritë. Secila nga këto tri kategori ka veçoritë e saj.

Nga ana tjetër, ky klasifikim është tregues i rëndësisë së besimit (*akides*) në strukturimin e personalitetit të njeriut dhe në dallimin e karakteristikave dalluese të tij. Gjithashtu i jep drejtim sjelljes së njeriut në mënyrë të përcaktuar, që bëhet shkak i dallimit të tij nga të tjerët. Ky klasifikim tregon se faktori kryesor i vlerësimit të personalitetit në këndvështrimin kur'anor është besimi (*akideja*). Në shumë prej shembujve, Kur'ani vë theksin te njerëzit që bartin këto tre lloj personalitetesh, domethënë te besimtarët, mohuesit dhe hipokritët.

Për shembull, në fillim të sures "El-Bekare", i përmend besimtarët në katër ajete (2-5), mohuesit në dy ajete (6-7) dhe hipokritët në 13 ajete (8-20). Po ashtu, tregon për ta edhe në sure të tjera. Përveç kësaj, ka emërtuar nga një sure për secilën kategori: sure "El-Mu'minun", "El-Kafirun" dhe "El-Munafikun".¹

Kur'ani përmend karakteristika dhe shenja të veçanta për secilin nga këto tri personalitete, me anë të të cilave dallohen nga dy kategoritë e tjera. Në vijim, ne do të përpiqemi të përmendim treguesit më të rëndësishëm që dallojnë çdo kategori nga kategoritë e tjera, ashtu siç kanë ardhur në Kur'an.

1- Besimtarët:

I madhi Zot, në shumë ajete e në më të shumtën e sureve të Kur'anit, i ka përmendur besimtarët dhe sjelljet e tyre në fusha të ndryshme të jetës, siç janë: akideja - besimi, ibadeti - adhurimi, morali, raporti me të tjerët, marrëdhëniet familjare, dashuria për dijen, jeta praktike dhe përpjekja për fitimin e jetesës së përditshme dhe karakteristikat trupore. Nëse do të merremi me grumbullimin e karakteristikave të besimtarëve, të cilat janë cituar në Kur'an, mund t'i ndajmë në 9 fusha:

1. Për këtë temë referohu tek *El-Menakhu'l-islamijeh fi'l-Kur'ani'l-Kerijm* i Ahmed Muhamed Faris, Bejrut, Darul Fikr (pa datë), f. 61-85 dhe tek *El-Insan fi'l-Islam ue'l-insanu'l-muasir*, i Abdul Gani Abbud, Kajro: Daru'l-Fikri'l-Arabi, 1978, f. 152-158.

1. karakteristikat e besimit (akide);
2. karakteristikat e adhurimit ('ibade);
3. karakteristikat e lidhura me marrëdhëniet shoqërore;
4. karakteristikat e lidhura me marrëdhëniet familjare;
5. karakteristikat morale;
6. karakteristikat reaguese e të ndjeshmërisë (afeksionit) (*infiali dhe atifi*);
7. karakteristikat racionale (të arsyes) e të njohjes;
8. karakteristikat e lidhura me jetën praktike dhe mjeshtërore (profesionale);
9. karakteristikat trupore.

Secila nga këto fusha përbëhet nga një grup tjetër veçorish dytësore, ku secila është e lidhur me një anë të caktuar të sjelljes. Shembujt e mëposhtëm janë tregues të grupeve dytësore, të cilat gjenden në fushat e përgjithshme dhe kryesore të karakteristikave të besimtarëve.

1-1. Karakteristikat e besimit

Besimi në Zot, te Profetët, librat qiellorë, engjëjt, te Dita e Kiametit, Dita e Ringjalljes dhe e Llogarisë, Parajsa dhe Ferri, tek e fshehta (*gajbin*) dhe caktimi dhe vendimi hyjnor (*kada e kader*).

1-2. Karakteristikat e adhurimit

Adhurimi i Zotit dhe kryerja e farzeve, siç janë: namazi, agjërimi, zekati, Haxhi, xhihadi në rrugën e Zotit, përmendja e përhershme e Zotit (*dhikri*), kërkimi i faljes nga Zoti, mbështetja te Zoti dhe këndimi i Kur'anit.

1-3. Karakteristikat e lidhura me marrëdhëniet shoqërore

Sjellja e mirë me njerëzit bujarë dhe bamirësia, bashkëpunimi, uniteti dhe solidariteti, urdhërimi për punë të mira dhe ndalimi nga punët e këqija, falja, vetëmohimi dhe mënjanimi nga punët e kota.

1-4. Karakteristikat e lidhura me marrëdhëniet familjare

Mirësia ndaj prindërve dhe të afërmve, harmonia bashkëshortore, përkujdesja ndaj familjes dhe pagesa e *nafaka-s* (mjeteve për jetesë dhe bukës së përditshme).

1-5. Karakteristikat morale

Durimi, toleranca, ndershmëria, drejtësia, besueshmëria në ruajtjen e depozitës (ruajtja e amanetit), besnikëria ndaj paktit me Zotin dhe njerëzit, përkohësia (përmbajtje nga mëkatet), përlësia, stërmundimi në fitimin e të drejtës dhe në rrugën e Zotit, vetërespekti, forca e dëshirës apo vullnetit, kontrolli i epshit dhe iç pasioneve.

1-6. Karakteristikat reaguese dhe të ndjesisë

Dashuria ndaj Zotit, frika ndaj ndëshkimit të Zotit, shpresa për mëshirën e Zotit, dashja e njerëzve dhe mirëdashja në raport me ta, gëlltitja e zemërimit dhe e kontrollimit të reagimit të zemërimit, të moskryerit agresion ndaj të tjerëve, mospasja smirë ndaj të tjerëve, modestia, dhembshuria, qortimi i vetes dhe pendimi në rast mëkatimi.

1-7. Karakteristikat racionale (të arsyes) dhe njohjes

Meditimi për universin dhe krijimin e Zotit, kërkimi i njohjes dhe i diturisë, mospasimi i paragjykit, kërkimi i realitetit, liria e mendimit dhe e besimit.

1-8. Karakteristikat e lidhura me jetën praktike dhe profesionale

Sinqeriteti në veprim dhe bashkëpunim, përpjekja aktive dhe e zellshme për përfitimin e jetës së përditshme.

1-9. Karakteristikat trupore: fuqi, shëndet dhe pastërti

Nëse do të mendojnë për këto veçori, me të cilat Kur'ani ka përshkruar besimtarët, mund të përfytyrojmë një pamje të hareshme nga jeta e besimtarit. Besimtari, që e ka besuar singërisht Zotin e tij dhe që adhuron vetëm Atë dhe është i patundur në jetën private, familjare, shoqërore dhe profesionale të tij, është shembull në singëritet e në ruajtjen e amanetit (asaj që i besohet).

Panorama që Kur'ani paraqet për besimtarin është një pamje nga njeriu i përkryer (*Insan Kamil*) në kufirin e mundësive njerëzore. Ajo që Zoti kërkon nga ne, është përpjekja për ta arritur këtë përsosmëri. Profeti i nderuar (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), duke u bazuar te këto karakteristika, edukoi grupin e parë të myslimanëve. Si rezultat, e tjetërsoi personalitetin e tyre dhe nga ata nxori besimtarë që ndryshuan faqen e historisë me forcën e personalitetit, nderin e moralit, ambicien sublime, cilësitë e pëlqyera dhe vlerat e larta që kishin mësuar nga Kur'ani.

Pamja që Kur'ani krijon në imagjinatën tonë për besimtarët, në të vërtetë, është shembull i një njeriu besimtar, për realizimin e vërtetë të të cilit duhet të përpiqemi. Edukimi i fëmijëve duhet të bëhet mbi bazën e po këtyre karakteristikave, derisa të shndërrohen në veçori kryesore. Formimi i një shoqërie të shëndetshme islame mundësohet vetëm nëpërmjet kësaj rruge. Karakteristikat e lartpërmendura në personalitetin e besimtarit nuk janë të pavarura nga njëra-tjetra; ato ndikojnë e ndikohen nga njëra-tjetra dhe janë plotësuese të njëra-tjetrës. Gjithashtu, së bashku i japin drejtim sjelljes së besimtarit në të gjitha fushat e jetës. Për këtë arsye, sjellja e besimtarit është harmoni, si në lidhje me Zotin, ashtu edhe me njerëzit e po kështu edhe me veten.

Karakteristikat e besimtarit luajnë rol bazë dhe përcaktues në dhënien e drejtimit të sjelljes së njeriut në të gjitha fushat e jetës, në mënyrë që besimi në Teuhid, në Ditën e Ringjalljes dhe të Llogarisë, bëhen karakteristikat kryesore të personalitetit

të njeriut, që kanë efekt në të gjitha karakteristikat e tjera të personalitetit dhe i udhëheqin ato. Prandaj besimtari, në raport me Zotin, është besnik, si në punët e veta, ashtu edhe në punët e të tjerëve.

Po kështu, besimtari i frikësohet Zotit të vet dhe e adhuron atë me sinqeritet, edhe në përballjen me dëshirat e veta trupore, si dhe në marrëdhëniet me njerëzit, lyp kënaqësinë dhe shpërblimin e Zotit dhe i frikësohet zemërimit dhe ndëshkimit të Tij. Sipas kësaj mënyre, besimi në Zot dhe adhurimi i Tij bëhet motiv i vazhdimit të sjelljes së besimtarit në jetë.

Pra, në këtë këndvështrim, besimi në Zot është adhurim, udhëheqje e vetes në rrugën e drejtë, mirësjelljes me njerëzit, shfaqje e dashurisë dhe e sinqeritetit, si dhe kryerje e punëve të mira për ta. Është e qartë se të gjithë besimtarët nuk janë në një nivel nga pikëpamja e devotshmërisë dhe se ndryshojnë nga njëri-tjetri. Kur'ani ka përmendur tri grupe për besimtarët: besimtarët që i bëjnë padrejtësi vetes, ata që ecin në një rrugë të mesme dhe pararoja e punëve të mira.

“Pastaj, Ne ua dhamë Librin robërve Tanë të zgjedhur (nga ndjekësit e Muhamedit a.s). Disa prej tyre i bëjnë dëm vetes (duke bërë vepra të ndaluara), disa janë në rrugë të mesme (duke kryer detyrimet dhe duke shmangur të ndaluarat), ndërsa disa, me lejen e Allahut, shkojnë përpara me të mira (përtej detyrimeve); kjo është dhuntia e madhe.”¹

Ibn Kethiri, duke e komentuar këtë ajet, thotë: “*Dhalimun li nefsihi* - i padrejti ndaj vetes, është ai person që neglizhon në kryerjen e disa detyrave dhe që bën një pjesë prej gjërave të ndaluara. *Muktesid* - i paramenduar, është ai person që kryen detyrat dhe braktis veprat e ndaluara, mirëpo nuk e kryen një pjesë të veprave të lavdërueshme, apo kryen një pjesë të gjërave të papëlqyeshme. Ndërsa, *sabikun bi'l-khajrat* - pararojë në punët e mira, është ai person që i kryen si detyrat, ashtu edhe punët e pëlqyera dhe që i braktis të ndaluarat dhe punët e papëlqyera.”²

1. Sure “Fatir”, ajeti 32.

2. *Tefsir Ibn Kethir*, vëllimi 3, f. 554-555.

Ndërsa, në lidhje me këtë, Kurtubiu thotë: “I padrejtë ndaj vetes është ai person që kryen mëkate të vogla. *Muktesid* - i paramenduar, është ai person që i kryen aq sa nevojitet punët e kësaj bote (dynjasë) dhe të Botës Tjetër (Ahiretit). Ndërsa *sabikun bi'l-khajrat* - pararojë për punë të mira janë ata persona që qëndrojnë në krye të të gjithë njerëzve.”¹

Në “*Tefsiru'l-Xhelalejn*” është thënë se *i padrejtë ndaj vetes* është ai person që i bie shkurt në të vepruar; *kursimtar* është ai person që kryen detyrën e tij në më të shumtën e kohëve, ndërsa *pararojë në punët e mira* është ai që ia bashkëngjit veprimet mësimdhënies dhe udhëheqjes.²

2- Qafirët-mohuesit

Në shumë ajete, Kur'ani vë theksin te qafirët-mohuesit dhe përmend një pjesë të karakteristikave të tyre. Këto karakteristika mund t'i përmbledhim si më poshtë:

2-1. Karakteristika e besimit

Mosbesimi në njëshmërinë e Zotit, te Profetët, në Ditën e Kiametit, Ringjalljes dhe të Llogarisë.

2-2. Karakteristikat adhuruere

Adhurojnë gjëra të tjera, përveç Zotit, të cilat nuk u sjellin as dobi as dëm.

2-3. Karakteristikat lidhur me marrëdhëniet familjare

Padrejtësi: qafirët-mohuesit janë agresivë në sjelljen e tyre me besimtarët, i tallin ata dhe shkelin të drejtat e tyre. Gjithashtu, urdhërojnë për gjëra të ndaluara dhe ndalojnë për punë të mira.

1. *Tefsiru'l-Kurtubij*, vëllimi 4, f. 346, Kurtubiu thotë: “Ky ajet është i ngjashëm me ajetin ‘*ue kuntum ezuaxhen thelathen*’, që ndodhet në suren El-Uakia. Të padrejtët ndaj vetes këtu janë ‘as’habët meshe’ meh’, fatkeqët. ‘As’habët mejmene’, të djathtët dhe, pararojat në punë të mira, janë vetë “sabikun”, garuesit.”

2. *Tefsiru'l-Xhelalejn*, f. 367.

2-4. Karakteristikat lidhur me marrëdhëniet shoqërore

Prerja e marrëdhënieve me njerëzit e tyre të afërm, kushërinjtë.

2-5. Karakteristikat morale

Shkelje e premtimit, shthurje, rendje pas epshit, pasioneve dhe mendjemadhësi.

2-6. Karakteristika reaguese dhe të tërheqjes

Urrejtje dhe mëri për besimtarët. Ushqejnë smirë për besimtarët, përse u përket begative me të cilat i ka begatuar Zoti ata.

2-7. Karakteristika racionale (të logjikës dhe të njohjes)

Mpirje mendore dhe pamundësi në të perceptuar e në të arsyetuar, mbyllje dhe vulosje e zemrave të tyre, imitim qorrazi i besimtarëve dhe i zakoneve të baballarëve dhe mashtrimi i vetes.

Panorama që na paraqet Kur'ani mbi personalitetin e qafirëve, është se ata nuk besojnë në *Teuhid* (Njëshmërinë e Zotit), te Profetët, librat qiellorë, në Ditën e Kiametit, të Ringjalljes dhe të Llogarisë, Parajsës dhe Ferrit. Ata, duke i imituar baballarët e tyre, zënë dhe adhurojnë idhujt, nga të cilët s'kanë as dobi, as dëm, as nuk dëgjojnë, as nuk flasin e as arsyetojnë. Ata janë të pushtuar nga një mpirje mendore dhe janë të paaftë në perceptimin e realitetit të *Teuhidit* (Njëshmërisë së Zotit), për tek i cili Islami fton njerëzit. Për këtë arsye, Kur'ani i përshkruan kështu ata:

“Allahu i ka vulosur zemrat e tyre, ndërsa në veshët dhe sytë e tyre kanë mbulesë; ata i pret një dënim i madh.”¹

Ata i urrejnë e i mbajnë mëri. I tallin dhe i mendojnë, shpenzojnë para për të penguar përparimin e Islamit e në veçanti për të nxitur urrejtjen dhe mundimin e myslimanëve, madje nuk respektojnë as lidhjet me kushërinjtë dhe rrethin e afërt.

1. Sure “El-Bekare”, ajeti 7.

Ata janë premtimshkelës, mendjemëdhenj dhe prepotentë, njerëz materialistë dhe interesaxhinj, që mendojnë vetëm për të mirat dhe kënaqësitë e kësaj bote. Prandaj, jeta e tyre shoqërohet me shthurje, degjenerime dhe janë të mbytur pas kënaqësisë së epsheve.

Më parë, kur folëm për besimtarët, thamë se besimi në Njeshmërinë e Zotit (*Teuhid*), në Ditën e Ringjalljes dhe të Llogarisë, që është prej karakteristikave kryesore të personalitetit të besimtarëve, ndikon në të gjitha karakteristikat e tjera. Besimi në kategoritë e mësipërme, në të vërtetë, është një energji nxitëse dhe udhërrëfyese e besimtarëve, në një proces të caktuar të sjelljes, që i ndan ata nga të tjerët.

Mosbesimi i qafirëve-mohuesve në Njeshmërinë e Zotit dhe në Ditën e Kiametit, bëhet shkak që atyre t'u ikë nga duart kjo energji harmonizuese e karakteristikave të personalitetit. Kjo energji, karakteristikat e personalitetit i udhëheq drejt një qëllimi të përcaktuar e të qartë, që është adhurimi i Zotit. Njeriu i kryen të gjitha punët e tij duke pasur parasysh shpresën e faljes dhe të kënaqësisë së Zotit, fitimin e shpërblimit të kësaj bote dhe të Botës Tjetër.

Mungesa e këtij qëllimi nxitës dhe udhëheqës të sjelljes, e hiqte ekuilibrin nga personaliteti i qafirëve dhe e çonte në rrugëtimin e kënaqësisë së epsheve dhe të dëshirave trupore të kësaj bote. Gjithashtu, e trazonte në atë mënyrë ekuilibrin reagues të tyre, sa që ata i urrenin myslimanët, ushqenin armiqësi, smirë ndaj tyre dhe silleshin me agresivitet me ta. Vetë ky çekuilibrim në personalitetin e qafirëve ishte shkaku i mpirjes së tyre mendore dhe i ngurrimit për pranimin e ftesës së Zotit.

3- Hipokritët (*munafikët*)

Munafikët ishin njerëz me personalitet të dobët e të lëkundur, të cilët nuk mund të merrnin një pozicion të qartë përballë besimit. Kur'ani ka përmendur karakteristikat dalluese të tyre dhe i ka kërcënuar ata me dënim më të rreptë.

“Pa dyshim që hipokritët do të jenë në thellësinë më të madhe të Xhehenemit dhe ti kurrësi nuk do t’u gjesh atyre ndihmës.”¹

3.1. Karakteristikat e besimit

Mosmarrja e një pozicioni të caktuar përballë *Teuhidit*, deklarimi i besimit në mes të myslimanëve dhe deklarimi i *shirkut* (politeizmit) në mes të *mushrikëve* (politeistëve).

3.2. Karakteristikat e adhurimit

E kryejnë adhurimin nga hipokrizia dhe pa besim. Falen me përtaci dhe pa qejf.

3.3. Karakteristikat që lidhen me marrëdhëniet shoqërore

Urdhërojnë për punë të liga, ndalojnë për punë të paqta dhe mbjellin përçarje në mesin e myslimanëve nëpërmjet thashethemeve; kanë prirjen të mashtrojnë njerëzit; flasin bukur për të vënë nën ndikim dëgjuesit dhe, gjithashtu, betohen shumë për t’i bërë të besueshme fjalët e tyre. Ata e mbajnë veten dhe stolisen në mesin e popullit, me qëllim që të tërheqin vëmendje dhe, si rezultat, t’i vënë ata nën ndikimin e atyre.

3.4. Karakteristikat morale

Karakteristika morale të tyre janë mosbesimi te njerëzit, shkelja e premtimit, hipokrizia, frika, gënjeshtria, koprracia, të qenët interesaxhinj, oportunizmi dhe rendja pas epsheve.

3.5. Karakteristikat reaguese e të tërheqjes

Munafikët kanë tmerr si nga *muminët*-besimtarët, ashtu edhe nga *mushrikët*-politeistët, e po ashtu edhe nga vdekja. Kjo gjë bëhet shkak i kundërshtimit të tyre për të shkuar në luftë, së bashku me myslimanët e tjerë. Nuk i duan myslimanët dhe ushqejnë urrejtje ndaj tyre.

1. Sure “En-Nisa”, ajeti 145.

3.6. Karakteristikat racionale (të arsyes) dhe të njohjes

Hezitimi, dyshimi dhe pamundësia në gjykim, vendimmarrje dhe përsiatje. Për këtë arsye, Kur'ani i ka përshkruar munafikët si persona, zemrat e të cilëve janë të vulosura. Munafikët përpiqen të mbrohen duke justifikuar punët e tyre. Kjo mori karakteristikash, me të cilat Kur'ani përshkruan munafikët, jep një panoramë të qartë të personalitetit të tyre.

Parimisht, karakteristika kryesore e personalitetit të munafikut është ngurrimi në zgjedhjen e besimit (*Imanit*), mohimit (*kufrit*) dhe paaftësia për të marrë një pozicion të qartë përballë *Teuhidit*. Kjo cilësi mbase rrjedh nga të qenët hipokrit, frikacak dhe mosbesimit që ka te vetja, sepse ai frikësohet si nga besimtarët, ashtu edhe nga politeistët. Prandaj, marrin pozicion të ndërmjetëm dhe nuk mund të marrin një vendim të qartë, për sa i përket grupimit tek i cili realisht anojnë.

Marrja e një pozicionimi të këtillë e shtrëngon hipokritin që të gënjejë, të mashtrojë dhe të fshehë ndjenjat e tij të vërteta, të cilat janë: urrejtja, mëria dhe smira ndaj myslimanëve. Ky veprim bëhet shkak që ai, fshehur, duke përdorur armën e thashethemeve, të bëjë fitime e të mbjellë përçarje ndërmjet tyre. Parimisht, hipokriti është interesaxhi dhe oportunist. Nëse munafikëve u vjen ndonjë mirësi, ata shtiren dhe shkojnë nga të fryjë era, sipas interesave të tyre.

Po ashtu, edhe me politeistët zgjedhin të njëjtën sjellje. Janë frikacakë dhe, kur thirren për të bashkëpunuar në luftë, ata i pushton frika dhe me mënyra nga më të ndryshmet, rebelohen nga të shkuarit në luftë. Hipokritët përherë përpiqen të bëjnë demagogji, për të mashtruar njerëzit dhe mundohen që, me anë të fjalëve magjepsëse e të bukura në dukje, t'i fusin njerëzit në ndikimin e tyre. Thellë në veten e tyre ndiejnë pafuqi e prandaj përpiqen të justifikojnë punët e tyre.

Pamja që na paraqet Kur'ani për personalitetin e munafikut, është një pamje e gjallë, e cila përputhet me kategori të veçanta njerëzish, të cilët gjenden në të gjitha

shoqëritë njerëzore. Nëpërmjet këtyre karakteristikave, ne mund të identifikojmë qartë hipokritët.

E- Kur'ani dhe mekanizmat mbrojtës mendorë

Mekanizmat mendorë përbëhen nga një seri sjelljesh mbrojtëse, të cilat njeriu strehohet për të ruajtur veten nga ndjesia e trishtimit dhe e ankthit që e pushton dhe njohjes së motiveve reale të fshehura të vetja. Domethënë, përpiqet që t'i fshehë këto lloj motivesh, duke iu drejtuar mekanizmave mendorë. Veçoritë e personalitetit të hipokritëve, ashtu siç e shpjegojmë më parë, ishin: dyshimi, frika, mosbesimi të vetja dhe frika nga zbulimi i identitetit të vërtetë të tyre. Ata trembeshin se mos zbuloheshin nga myslimanët dhe sulmoheshin prej tyre.

Ekzistenca e një natyre të këtillë në personalitetin e hipokritëve i detyronte ata që të gjenin strehë të një serie dredhish mendore, të quajtura mekanizma mbrojtës. Kur'ani ka vënë theksin mbi tre lloj mekanizmash të sjelljes mendore, të cilat i përdorin hipokritët: projektimi, racionalizmi dhe formacioni reaktiv.

1. Projektimi

Projektimi është një lloj dredhie mendore, nga e cila individ i përfiton duke i atribuuar gjendjet psikike, motivet, gabimet e tij njerëzore të tjerët, domethënë në vend që t'i dallojë të vetja, i ndien këto veçori të tjerët. Për shembull, një person që brenda vetes ushqen armiqësi për një person tjetër, ia atribuon atij këtë armiqësi dhe e ndien armiqësinë e tij. Hipokritët, në mënyrë të fshehtë, ishin armiq me myslimanët, por e fshihnin urrejtnë dhe mërinë e tyre. Mirëpo ndjesinë e kësaj armiqësie ia atribuonin myslimanëve dhe mendonin se këta kishin si qëllim shfarosjen e tyre. Kur'ani, aty ku përshkruan hipokritët, e ka paraqitur këtë temë në mënyrën më të qartë dhe thotë se ata, çdo zë që dëgjojnë nga myslimanët, e pandehin kundër tyre.

“Kur i shihni ata, pamja e tyre e bukur ju mahnit e, nëse flasin, ju i dëgjoni fjalët e tyre. E megjithatë, ata janë si trungje të mbështetura. Ata kujtojnë se çdo thirrje që dëgjojnë është kundër tyre. Ata janë armiq të vërtetë, andaj ruajuni prej tyre! Allahu i vraftë! Sa shumë që janë larguar (nga e vërteta)?!”¹

Për çdo gjë që thuhet, hipokritët kujtojnë se bëhet fjalë për ta dhe pandehin se myslimanët kanë për qëllim t'i sulmojnë ata. Kjo gjë vjen si rrjedhojë e ndjesisë armiqësore që ata kanë për myslimanët.

Vini re, pas shprehjes **“Ata kujtojnë se çdo thirrje që dëgjojnë është kundër tyre”**, ajeti menjëherë thotë: **“Ata janë armiq të vërtetë, andaj ruajuni prej tyre!”**.

Kjo gjë tregon se hipokritët janë armiq me myslimanët. Zërat që dëgjojnë e që i marrin sikur janë kundër tyre, nuk është gjë tjetër veç imagjinatë e tyre, e cila buron nga tipari i projektimit.

2. Racionalizmi

Justifikimi dhe racionalizmi janë një lloj sjelljeje mbrojtëse mendore, me përdorimin e së cilës njeriu përpiqet të justifikojë motivet dhe veprimet e tij të papëlqyeshme, domethënë jep një komentim të pranueshëm të tyre. Si hipokritët, ashtu edhe qafirët, shumë herë justifikonin sjelljet e tyre. Për shembull, megjithëse përhapnin korrupsion dhe degjenerim, thoshin se synimi i tyre është reformimi dhe, sipas këtij rendi, thoshin justifikime “të arsyeshme e të pranueshme” për punët e tyre.

Kur'ani e përshkruan kështu racionalizmin e hipokritëve:

“Kur u thuhet: “Mos bëni çrregullime në tokë!”-ata thonë: “Ne bëjmë vetëm përmirësime në tokë!” Por jo! Në të vërtetë, pikërisht ata janë shkaktarët e çrregullimeve, ndonëse nuk e ndiejnë.”²

“Po kur u thuhet atyre: “Ejani tek ajo që ka shpallur Allahu dhe tek i Dërguari”, i sheh hipokritët se si largohen

1. Sure “El-Munafikun”, ajeti 4.

2. Sure “El-Bekare”, ajetet 11-12.

prej teje me neveri. Si do të jetë gjendja e tyre kur t'i godasë fatkeqësia, për shkak të asaj që vetë kanë punuar e të vijnë te ti, duke u betuar në Allahun e duke thënë: "Ne kemi dashur vetëm të bëjmë mirësi dhe pajtim."?! Këta janë ata për të cilët Allahu e di se ç'kanë në zemrat e tyre. Largohu prej tyre, këshilloji dhe thuaju fjalë që i prekin në zemër."¹

Dredhitë mendore janë sjellje që njeriu i bën në mënyrë të pandërgjegjshme, kur ia atribuon tjetrit ndjesinë e vet armiqësore. Në të vërtetë beson se personi është fshehtazi armik me të, pa qenë vetë i informuar, ka vënë në funksion aktin e *Projektimit*.

Gjithashtu, kur individi justifikon punët e veta, nuk e di se është angazhuar në *Racionalizim*. Përkundrazi, praktikisht beson se puna e tij e shëmtuar është e dobishme dhe e mirë, apo së paku qëllimi tij ka qenë mirëbërja dhe reformimi.

Kur'an, në ajetet e mësipërme, me thënie: "**Në të vërtetë, pikërisht ata janë shkaktarët e çrregullimeve, ndonëse nuk e ndiejnë.**", ka vënë theksin në aspektin e pavetëdijshëm të dredhive mendore. Shprehja: "**Ata nuk ndiejnë**", tregon pavetëdijen e tyre për këtë temë, që punët e tyre janë të aspektit degjenerues e joreformues.

3. Formacioni reaktiv

Formacioni reaktiv është një lloj sjelljeje mbrojtëse mendore, në rrjedhën e së cilës, individi zgjedh një sjellje të kundërt me sjelljen që ka për qëllim ta fshehë. Për shembull, nganjëherë njeriu, teksa përballet me një individ të caktuar, sillet me shumë respekt, edukatë dhe duke e lavdëruar. Kjo sjellje është një mjet mbrojtës, që fsheh prej tij urrejtjen dhe ndjenjën e vet armiqësore. Edhe hipokritët e përdornin këtë dredhi mendore për të fshehur ndjenjën e urrejtjes dhe të armiqësisë për myslimanët. Për këtë arsye, kur flisnin me ta, flisnin mirë dhe, duke mbuluar urrejtjen dhe armiqësinë e tyre, u shfaqnin dashamirësi myslimanëve, duke i lavdëruar dhe duke çmuar punët e tyre.

1. Sure "En-Nisa", ajetet 61-63.

“Ka ndonjë njeri (hipokrit), fjalët e të cilit në jetën e kësaj bote ta bëjnë qejfin dhe që betohet në Allahun për atë që mban në zemër, por që, në të vërtetë është kundërshtari (yt) më i betuar. E, kur largohet, përpiket të bëjë të këqija në Tokë, duke shkatërruar të mbjellat e bagëtinë. Por Allahu nuk e do shkatërrimin.”¹

“Kur i shihni ata, pamja e tyre e bukur ju mahnit e, nëse flasin, ju i dëgjoni fjalët e tyre. E megjithatë, ata janë si trungje të mbështetura. Ata kujtojnë se çdo thirrje që dëgjojnë është kundër tyre. Ata janë armiq të vërtetë, andaj ruajuni prej tyre! Allahu i vraftë! Sa shumë që janë larguar (nga e vërteta)?!”²

Sipas këtij rendi, vëmë re se Kur'ani, teksa përshkruan sjelljen e hipokritëve të kohës së Profetit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ka vënë theksin mbi disa prej mekanizmave mbrojtës mendorë që ata përdornin. Kjo gjë daton 14 shekuj përpara se Zigmund Frojdi të zbulonte me sukses këto dredhi mendore në sjelljen e të sëmurëve, me kurimin e të cilëve merrej.

F- Dallimet individuale në Kur'an

Nga pikëpamja e talentit dhe e aftësive fizike e mendore, njerëzit kanë dallime të shumta me njëri-tjetrin. Burimi i tyre i referohet ndikimit dhe prekjes nga faktorët trashëgimorë dhe të mjedisit ku jetojnë. Kur'ani ka vënë theksin në shumë raste, për dallimet që ekzistojnë midis njerëzve.

“Ai ju ka bërë pasardhës të njëri-tjetrit në Tokë dhe ka ngritur në shkallë disa nga ju mbi të tjerët, për t'ju provuar në atë që ju ka dhënë. Sigurisht që Zoti yt është i shpejtë në dënim, por, në të vërtetë, Ai është edhe Falës e

1. Sure “El-Bekare”, ajetet 204-205. Ajetet flasin për Akhnes ibn Sherikun. Ai ishte një hipokrit, gojëmbël me Profetin (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), betohej se besonte te Profeti dhe se ishte mik i tij. Në këtë mënyrë afrohej me Profetin. Mirëpo Zoti e përgënjeshtroi atë *Tefsiru'l-Xhelalejn*, f. 28.

2. Sure “El-Munafikun”, ajeti 4.

Mëshirëplotë.”¹

“Vallë, a mos janë ata që e ndajnë mëshirën e Zotit tënd? Jemi Ne ata që ua ndajmë njerëzve mjetet e jetesës në këtë botë, duke i ngritur në shkallë disa më lart mbi të tjerët, me qëllim që disa t’u shërbejnë të tjerëve. Mëshira e Zotit tënd është më e mirë nga ajo që grumbullojnë ata.”²

“Ndërmjet shenjave të Tij janë krijimi i qiejve e i Tokës dhe shumëllojshmëria e gjuhëve dhe e ngjyrave (racave) tuaja. Pa dyshim, në këtë ka shenja për ata që dinë.”³

“Shiko, si Ne i parapëlqejmë disa ndaj të tjerëve. Kurse Bota Tjetër, në të vërtetë, do të ketë shkallëzime më të mëdha dhe parapëlqime më të theksuara.”⁴

“Njerëzit, kafshët dhe bagëtitë janë lloje të ndryshme gjithashtu. Në të vërtetë, nga robërit e Tij, Allahut i frikësohen vetëm dijetarët, (që e dinë se) Allahu është vërtet i Plotfuqishëm dhe Falës.”⁵

Në këtë ajet ka tregues të qartë mbi ekzistencën e dallimeve individuale te njerëzit.

Ajetet e mësipërme janë pjesë e kësaj çështjeje, që dallimet individuale rrjedhin nga faktorët trashëgimorë dhe të mjedisit. Kjo pjesë prej fjalëve të Zotit: *“Disave prej jush u ka dhënë grada më të larta se disa të tjerë...”* bëhet përfshirëse e të gjitha dallimeve individuale, qofshin të trashëguara, të fituara, fizike, mendore e po ashtu edhe të dallimeve në zotërim e pasuri, pronave dhe ndikimit në shoqëri. Ajo pjesë prej fjalëve të Zotit që thotë: *“Që të komandojnë njëri-tjetrin e të bashkëpunojnë”*, në të vërtetë vendos theksin në dallimet e njerëzve nga pikëpamja e pasurisë, e diturisë dhe e profesionit.

Për shembull, i varfëri punon tek i pasuri për të marrë rrogë. Gjithashtu, disa prej mjeshtëurve e profesionistëve të veçantë punojnë për të tjerët për të marrë rrogë. Sipas këtij rendi realizohet bashkëpunimi dhe ndarja e punës ndërmjet

1. Sure “El-En’am”, ajeti 165.

2. Sure “Ez-Zuhruf”, ajeti 32.

3. Sure “Er-Rum”, ajeti 22.

4. Sure “El-Isra”, ajeti 21.

5. Sure “Fatir”, ajeti 28.

individëve të shoqërisë, duke plotësuar nevojat e njerëzve dhe garantimin e të gjitha shërbimeve të nevojshme për vazhdimësinë e jetës. Fjala e të madhit Zot, që mosmarrëveshja e gjuhëve dhe e ngjyrës së njerëzve është një prej argumenteve të Zotit, tregon ndikimin e gjithsecilit prej faktorëve trashëgimorë dhe mjedisorë në dallimet individuale.

Është e dukshme se mospërputhja e ngjyrës lidhet me faktorët trashëgimorë, ndërsa dallimi në gjuhë e në të folur, rrjedh prej faktorëve mjedisorë, shoqërorë dhe kulturorë. Gjithashtu, njerëzit kanë dallime me njëri-tjetrin edhe nga pikëpamja e diturisë dhe e urtësisë. Kjo përfshin dallimet në aftësitë mendore dhe të inteligjencës së tyre. Kjo temë kuptohet nga konteksti i ajeteve (citimeve) të mëparshme dhe të ajeteve të mëposhtme:

“Dhe nisi të kontrollojë barrët e tyre para barrës së vëllait të Jusufit. Pastaj nxori gotën nga barra e vëllait të tij. Kështu, Ne e mësuam Jusufin, që ta bënte këtë dredhi. Ai, sipas ligjit të mbretit nuk mund ta merrte (për skllav) vëllanë e vet, përveç se me vullnetin e Allahut. Ne e ngremë lart atë që duam, e mbi çdo të ditur është një i Gjithëdijsëm.”¹

Ibn Kethiri, duke e komentuar këtë ajet, thotë: “Hasan Basriu thotë kështu: *Çdo dijetar ka një dijetar më të madh mbi veten e tij. Ky zinxhir vazhdon në mënyrë të atillë, derisa përfundon te Zoti.*

Nga Said Ibn Xhubejri është përcjellë: *Ishim pranë Ibni Abasit dhe ai tha një fjalë interesante. Një burrë u çudit nga kjo fjalë dhe tha: El-Hamdulil-lah – Zot shqyrr, është shumë dora përmbi dorë.*

Ibn Abasi tha: *Fole gabim, Zoti është më lart se të gjithë dijetarët. Ndonjëherë një person është më i ditur se një tjetër dhe filani është më i ditur se fisteku, por Zoti është më lart se të gjithë dijetarët.”²*

Si e thamë edhe më lart, njerëzit kanë dallime me njëri-tjetrin, nga pikëpamja e talenteve, e aftësive, e kushteve sociale dhe kulturore dhe mjeshtërive personale.

Thuaj: “Çdokush sillet sipas mënyrës së vet, por Zoti juaj e di më së miri, se kush është në rrugën më të drejtë.”³

1. Sure “Jusuf”, ajeti 76.

2. Mukhtesaru Tefsiri Ibn Kethir, vëllimi 2, f. 257-258.

3. Sure “El-Isra”, ajeti 84. Referohu te Tefsir Ibn Kethir dhe Tefsiru'l -Xhela-lejn.

Dallimet e njerëzve në dhuntitë dhe aftësitë fizike e mendore, natyrshëm do të rezultojnë me dallime në punë, fitim, studim.

“Allahu nuk e ngarkon askënd përtej fuqisë që ka: në dobi të tij është e mira që bën, kurse në dëm të tij është e keqja që punon. Zoti ynë, mos na ndëshko për ata që harrojmë ose veprojmë pa qëllim! Zoti ynë, mos na ngarko barrë të rëndë, ashtu si i ngarkove ata para nesh! Zoti ynë, mos na ngarko me diçka që nuk mund ta bartim! Na i shlyej gjynahet tona, na i fal ato dhe na mëshiro! Ti je Zoti ynë! Prandaj na jep fitore kundër atyre që nuk besojnë!”¹

“Ne nuk ngarkojmë askënd përtej mundësive të tij; te Ne është Libri që flet të vërtetën dhe askujt nuk do t’i bëhet padrejtësi.”²

“Pasaniku le të shpenzojë sipas pasurisë që ka, ndërsa i varfri le të shpenzojë sipas asaj që i ka dhënë Allahu; Allahu nuk e ngarkon askënd mbi sa i ka dhënë. Pas vështirësisë, Ai sjell lehtësimin.”³

Është i qartë theksi që Kur’ani i vë ekzistencës së dallimeve individuale. Nisur nga kjo, detyra e individit është kryerja vetëm e punëve, për të cilat ai ka mundësi. Kjo është ideja kryesore e temës që ka trajtuar neopsikologjia (psikologjia e re), kriteret e dallimeve individuale në dhuntitë dhe aftësitë e njeriut për sistemimin e çështjeve mësimore, në mënyrë që çdo individ të orientohej dhe të udhëhiqet në llojin e mësimin që përputhet me dhuntinë dhe aftësinë e tij. Parimisht, po ky është qëllimi i udhëheqjeve mësimore në instruktimin dhe në edukimin e ri.

Neopsikologët, gjithashtu, përfitojnë nga kriteret e dallimeve individuale, për të bërë përmirësimin në zgjedhjet e profesionit dhe të zanatit, në mënyrë që, me kryerjen e këtij veprimi, do të jetë i pranueshëm emërimi i çdo individi, në përputhje me talentin dhe aftësinë e tij.

1. Sure “El-Bekare”, ajeti 286.

2. Sure “El-Mu’minun”, ajeti 62.

3. Sure “Et-Talak”, ajeti 7.

Në hadithet profetike vihet theksi te faktorët trashëgimorë në dallimet individuale, ku thuhet: *Gruan merreni nga një familje e mirë, sepse fisëria (soji) ndikon shumë te fëmijët.*

Dhe: *Për farën tuaj zgjidhni gra të denja, sepse gratë lindin fëmijë që u ngjajnë dajallarëve, tezeve, vëllezërve dhe motrave të tyre.*¹

Gjithashtu në hadithet profetike është vënë theksi edhe mbi ndikimin e faktorëve mjedisorë. Thotë: *Nuk lind askush vetëm se me natyrë të pastër (fitret) dhe janë prindërit ata që e bëjnë atë jehudi apo të krishterë, apo mexhuesi.*²

G- Kur'ani në çështjen e zhvillimit të njeriut

Psikologjia i kushton vëmendje studimit të fazave të ndryshme të zhvillimit të fëmijës, elementeve të përgjithshme që i ndajnë ato nga njëra-tjetra dhe faktorëve të ndryshëm ndikues. Kjo sigurisht bëhet shkak i njohjes sonë me personalitetin e fëmijës, i aftësimit më të madh për udhëheqjen dhe edukimin e tij.

Psikologjia nuk bën objekt vëzhgimi vetëm etapat e zhvillimit të fëmijës që nga çasti i lindjes, por ka në vëmendje edhe etapat që kalohen para lindjes, në periudhën embrionale, faktorët e ndryshëm trashëgimorë dhe mjedisorë, që ndikojnë në formimin e fetusit dhe në zhvillimin e tij. Sigurisht që psikologjia ka përfituar shumë nga rezultatet e kërkimeve të shkencës së embrionologjisë në studimin e fazës së zhvillimit të paralindjes.

1- Zhvillimi përpara lindjes

Me një mënyrë të mrekullueshme, përmbledhëse e treguese, Kur'ani Famëlartë ka vënë theksin në etapat e zhvillimit të embrionit, që nga fillimi i shtatzënisë e deri në lindjen e tij. Kushtojini vëmendje ajeteve të mëposhtme:

1. Marrë nga: *Et-Tufuletu fi'l-Islam*, Ibrahim Ed-Desukij Mer'ij; Kajro, Daru'l-I'tisam, 1979, f. 20.

2. Po aty, f. 39-40.

“Me të vërtetë, Ne e kemi krijuar njeriun prej palcës së baltës, e pastaj, e bëmë atë pikë fare dhe e vumë në një vend të sigurt (mitër). E mandej, pikën e farës e bëmë droçkë gjaku, e pastaj e bëmë copëz mishi pa formë; mandej, me atë mish bëmë eshtrat, pastaj i veshëm eshtrat me mish dhe pastaj e bëmë atë (njeriun) krijesë tjetër (duke i futur shpirtin). Qoftë lartësuar Allahu, Krijuesi më i përsosur!”¹

Këto ajete vënë theksin tek etapat e zhvillimit të fetusit në mitër, që nga fillimi i shtatzënisë, domethënë që nga koha që njëri prej spermatozoideve të babait fekondon (inseminon) vezën e nënës e në këtë mënyrë formohet zigota,² të cilën Kur'an i përmend me emrin *nutfe*:

“O njerëz, nëse ju dyshoni në ringjalljen, mendoni si Ne ju kemi krijuar prej dheut, pastaj prej pikës së farës, pastaj prej droçkave të gjakut, pastaj prej një cope mishi me trajtë të plotë ose jo të plotë, për t’jua bërë të qartë! Dhe Ne e mbajmë në mitër atë që duam deri në kohën e caktuar. Pastaj ju nxjerrim si fëmijë e pas kësaj do të arrini moshën e pjekurisë. Disa nga ju vdesin e disa ngelin deri në pleqëri të thellë, që të mos dinë asgjë nga ajo që kanë ditur më parë. Dhe ti e sheh tokën të tharë, por, kur Ne lëshojmë ujë mbi të, ajo trazohet dhe gufon dhe prej saj mbijnë gjithfarë lloj bimësh të mrekullueshme në çift.”³

“Ai ju krijoi prej një njeriu të vetëm; pastaj, prej tij krijoi shoqen e tij. Ai ka krijuar për ju tetë çifte bagëtish. Ai ju krijon në barqet e nënave tuaja, fazë pas faze në një errësirë të trefishtë. Ky është Allahu - Zoti juaj; Atij i përket i tërë pushteti; nuk ka zot tjetër të vërtetë përveç Tij. Atëherë, si është e mundur që largoheni prej Tij?!”⁴

1. Sure “El-Mu’minun”, ajetet 12-14.

2. *Ue nukirru fil erhami ma neshau* d.m.th., ato embrione që Ne duam, i vendosim në mitër, derisa të plotësohet zhvillimi i tyre dhe të lindin të gjallë. Gjithash-tu, një pjesë e tyre nuk e arrijnë zhvillimin e plotë dhe dështojnë.

3. Sure “El-Haxh”, ajeti 5.

4. Sure “Ez-Zumer”, ajeti 6.

KREU I DHJETË

Psikoterapia në Kur'an

Parimisht, Kur'ani Fisnik është zbritur për udhëzimin dhe ftimin e njerëzimit në adhurimin e Zotit Një e të Pashembullt, për mësimin e vlerave dhe metodave të reja të mendimit dhe të jetës, për udhëheqjen e sjelljeve normale, të cilat qëndron e mira e individit dhe e shoqërisë; gjithashtu, udhëheqjen e tyre në udhët e drejta të edukimit të vetvetes, në mënyrë që të rezultojë në përsosmërinë njerëzore, e cila garanton lumturinë e njeriut në këtë botë e në Botën Tjetër.

“Në të vërtetë, ky Kur'an udhëzon drejt asaj që është më e mira dhe u jep lajmin e gëzuar besimtarëve, që bëjnë vepra të mira, se ata do të kenë shpërblim të madh.”¹

“O njerëz, ju ka ardhur këshillë (Kur'ani) nga Zoti juaj, shërim për zemrat tuaja, udhëzim dhe mëshirë për besimtarët.”²

“Ne shpallim nga Kur'ani atë që është shërim dhe mëshirë për besimtarët e që mohuesve keqbërës u shton vetëm humbje.”³

“Sikur ta kishim shpallur Kur'anin në një gjuhë tjetër, ata do të thoshin: “Ah, sikur vargjet e tij të ishin të kuptueshme! Vallë, pse të jetë në një gjuhë të huaj, ndërkohë që ai është arab?!” Thuaj: “Ai është udhërrëfyes dhe shërim për besimtarët.” Por ata që nuk besojnë, janë të shurdhër dhe të verbër, njësoj si të thirreshin prej vendeve të largëta.”⁴

“Ky Kur'an është tregues i qartë, udhërrëfyes dhe mëshirë për njerëzit që kanë besim të patundur.”⁵

Kur'ani Fisnik la gjurmë të pashlyeshme te popullata arabe dhe ndryshoi rrënjësisht personalitetin, moralin, sjelljen

1. Sure “El-Isra”, ajeti 9.

2. Sure “Junus”, ajeti 57.

3. Sure “El-Isra”, ajeti 82.

4. Sure “Fussilet”, ajeti 44.

5. Sure “El-Xhathije”, ajeti 20.

dhe mënyrën e tyre të jetesës; edukoi individë me besim, që mbartnin vlera të fisshme njerëzore; solli një shoqëri të bashkuar e të disiplinuar, aq sa mundën të thyejnë Romën dhe Persinë, të cilat ishin qeveritë më të mëdha të botës së asaj kohe dhe të shpërndahen në më të shumtën e territoreve të globit e të angazhohen me përhapjen e Islamit. Këtë ndryshim rrënjësor që Kur'ani solli te popullata arabe dhe besimtarët e kombeve të ndryshëm, nuk e gjen tek asnjë prej institucioneve të besimit, të cilat u shfaqën në shekujt e ndryshëm të historisë.

Padyshim që në Kur'an gjendet një fuqi e madhe shpirtërore, e cila ndikon mahnitshëm në shpirtin e njeriut. Kjo fuqi bëhet shkak i zgjimit të ndërgjegjes, prehjes së ndjenjës dhe shqisave, shkëlqimit të shpirtit të njeriut, zgjon perceptimin e tij mendor dhe intuitën.

Pasi njeriu vihet nën ndikimin e ajeteve kur'anore, shndërrohet menjëherë, sa duket se sapo është krijuar. Personat që kanë studiuar historinë islame dhe kanë ndjekur etapat e ndryshme të ftimit në Islam, që në ditët e para, shohin cilësinë e ndryshimit të personalitetit të individit që ka mësuar në shkollën e Profetit rregullat e Islamit, si dhe mund të shquajë fare qartë ndikimin e madh të Kur'anit.

Përpjekje të shumta bëjnë shoqëritë e reja në fushat e mësimdhënies, edukimit dhe udhëheqjes së rinisë, që të formojnë individë të denjë e të dobishëm. Por, prapëseprapë, këto përpjekje nuk sjellin frytet e dëshiruara. Këto probleme, që gjithnjë e më shumë po ekzistojnë në të gjitha shoqëritë, janë një argument i qartë për disfatën e metodave të reja të edukimit dhe paaftësisë së tyre në formimin e individëve të denjë për t'i shërbyer vendit e shoqërisë. Janë kryer studime të shumta në fushën e psikoterapisë së individëve, të cilët janë të sëmurë nga çrregullime personaliteti dhe sëmundje psikike. Në këtë fushë janë përdorur metoda të ndryshme për psikoterapi, mirëpo asnjëra nuk ka sjellë suksesin e pritur për zhdukjen apo për parandalimin e sëmundjeve psikike.

Disa prej kërkimeve tregojnë se mesatarja e të sëmurëve, që kurohen me metoda psikanalitike, luhatet nga 60-64%.

Nëse do të vëmë re se mesatarja e të sëmurëve që shërohen, pa iu drejtuar psikoterapisë, luhetet rreth 44-66%, do të kuptojmë se mesatarja e mësipërme nuk jep përqindjen e kënaqshme. Përveç kësaj, është përkeqësuar gjendja e një numri të sëmurësh pas kurimeve të psikoterapistëve.

Në një kërkim tjetër ka dalë në pah se numri i të sëmurëve të kuruar pa ndonjë terapi të psikoterapistëve ishte i barabartë me numrin e të sëmurëve që u kuruan me terapi. Ky kërkim ka treguar se gjendja e disa prej këtyre të sëmurëve të kuruar nëpërmjet psikoterapive është rënduar edhe më shumë.¹ Këto lloj kërkimesh tregojnë se mesatarja e shërimit që buron nga psikoterapia, ende nuk ka arritur në një nivel të kënaqshëm. Përveç kësaj, nuk është kaq i rëndësishëm shërimi i të sëmurëve psikikë, por parandalimi i kësaj sëmundjeje.

Janë kryer studime të shumta për çështjen e sjelljeve të devijuara dhe, duke u munduar t'i parandalojnë këto sjellje, janë përpjekur të ndërhyjnë në problematikat që lindin në shoqëritë e ndryshme njerëzore. Pikësynimi i tyre është gjetja e rrugëzgjdhjeve për parandalimin e sjelljeve të devijuara. Mirëpo këto përpjekje janë të pakta dhe kryhen në fusha tepër të kufizuara, sikurse ndërhyrja e policisë në problemet familjare, të cilat ndodhin në disa prej lagjeve të qyteteve të mëdha në shoqërinë amerikane.²

Në parim, çështja e parandalimit të sjelljeve të devijuara, është një prej çështjeve të rëndësishme me të cilën ndeshen psikologët dhe sociologët, ndonëse janë shumë të pakta e të kufizuara përpjekjet e tyre në këtë fushë. Për më tepër, sot ekzistojnë kontradikta të shumta midis shkollave të psikoterapisë, se si e shikojnë ato natyrën e motiveve bazë nxitëse të sjelljes dhe natyrën e kërcënimeve, si dhe anasjellas.

Secila nga këto shkolla e shikon njeriun nga një kënd i caktuar dhe i kufizuar.

1. Richard M. Swain: *Ilmu'l-emradi'n-nefsije ue'l-aklijeh*, përkthim i Ahmed Abdul Aziz Selame, f. 864.

2. Sheldon Cashdan: *Ilmu nefsi'sh-sheuadh (Psikologjia e të devijuarve)*, përkthim i Ahmed Abdul Aziz Selame dhe me korrigjim të Muhamed Uthman Nexhatit. Bejrut: Daru'sh-Shuruk, 1984, f. 221-226.

Prandaj nuk munden ta shikojnë atë me një vështrim tërësor dhe të gjithanshëm. Vetë kjo gjë është motiv i mundësisë së këtyre shkallëve për ta konceptuar drejt dhe saktë njeriun. Mirëpo, me sa duket, së fundi, ka dalë një prirje e re midis psikologëve dhe psikoterapistëve, sipas së cilës mjedisi shoqëror dhe kulturor ndikon te personaliteti dhe natyra shoqërore, si dhe rrit nevojën e njeriut për varësi.

Kjo prirje u bë shkak që ata t'i kushtojnë më shumë rëndësi marrëdhënieve njerëzore në harmoninë apo disharmoninë e personalitetit të njeriut. Sheldon Kashdan (Cashdan), për këtë, thotë: *"Ndonjëherë modeli i ri thekson besimin e njerëzve te njëri-tjetri, gjë që është motiv i marrëdhënies së tyre. Për këtë shkak themi se disa nga konceptet, si: marrëdhënia e fortë, shkëmbimi i mendimeve dhe ndjenja e përgjegjësisë, i zëvendësojnë koncepte të tilla, si: superegoja, dogmatizmi, neuroza dhe çrregullimi mendor. Modeli i ri, nganjëherë, përmban koncepte të reja, si konceptin e dashurisë."*¹

Këto prirje i kanë drejtuar psikologët dhe psikoterapistët në pranimin dhe futjen në funksion të pikëpamjeve të fesë. Madje, ata i kanë kushtuar një vëmendje të madhe besimit fetar, duke e bërë pjesë të terapisë së tyre. Ata besojnë se te besimi në Zot ekziston një energji e jashtëzakonshme, e cila i fal një lloj fuqie shpirtërore njeriut besimtar dhe e ndihmon atë në përballimin e vështirësive të jetës; e mban larg shqetësimit dhe ankthit, në kllapat e të cilit gjenden shumë nga njerëzit e shekullit tonë, një shekull ku mbizotëron shumë vëmendja për jetën materiale.

Njerëzit janë të përfshirë në një realitet të fortë, për të shtënë në dorë materialen, ndërkohë që, në këtë kohë, është shumë më e ndjeshme nevoja për ushqim shpirtëror.

Kjo prirje drejt materiales është bërë shkak i trysnisë shpirtërore mbi njeriun bashkëkohor dhe hutimit të tij, duke e vënë atë në shënjestër të sulmeve ankthsjellëse dhe të sëmundjeve të ndryshme psikike.

Uilliam Xhejms (William James), filozofi dhe psikologu

1. Burimi i mëparshëm, f. 266.

amerikan, ishte ndër të parët, që e trajtoi këtë çështje. Ai thotë: *"Besimi është pa dyshim shërimi më efektiv i ankthit. Besimi është një energji që duhet të ekzistojë për ta ndihmuar njeriun në jetë, kurse humbja e tij është alarm rreziku, që lajmëron pamundësinë e njeriut përballë vështirësive të jetës."*

Diku tjetër thotë: *"Midis nesh dhe Zotit ekziston një lidhje e pandashme. Nëse ne do ta vëmë veten në mbikëqyrjen e të madhit Zot dhe t'i dorëzohemi Atij, do të realizohen të gjitha dëshirat tona."*

Në një vend tjetër sqaron: *"Ashtu sikurse dallgët gjëmuese të oqeanit nuk mund ta trazojnë qetësinë e thellësisë së tij dhe të cenojnë sigurinë e tij, as shndërrimet sipërfaqësore dhe të përkohshme të jetës, nuk mund ta trazojnë qetësinë e brendshme të njeriut. Njeriu i vërtetë besimtar nuk dorëzohet përpara ankthit, e ruan ekuilibrin e personalitetit të vet dhe gjithnjë është i gatshëm për t'u përballur me çështje të pakëndshme, të cilat mund t'ia sjellë koha."*¹

Karl Jungu (Carl G.Jung), psikanalist, thotë:

*"Gjatë 30 viteve të kaluara janë konsultuar me mua individë të shumtë nga vende të ndryshme të botës së qytetëruar. Unë kam kuruar e kam shëruar qindra të sëmurë, mirëpo nuk kam parë asnjë të sëmurë, nga mosha 35 vjeç e sipër, që të mos ketë nevojë për një prirje fitoreje në jetë. Me guxim mund të them se ata kishin rënë një e nga një viktimë të sëmundjes psikike, sepse u mungonte ajo gjë që fetë u japin në çdo kohë pasardhësve të tyre. Ata u shëruan plotësisht vetëm kur u rikthyen te feja, me pikëpamjet fetare."*²

Një psikanalist tjetër, Abraham A. Brill, mendon se besimtari i vërtetë nuk do të sëmuret kurrë mendërisht.³

Henri C. Link, një psikolog amerikan, në librin *Return to Religion* (Rikthim te feja), thotë:

"Në përfundim të përvojës sime të gjatë në kryerjen e eksperimentimeve psikike mbi punëtorët rreth zgjedhjeve dhe prirjeve profesionale, kuptova se individët besimtarë dhe personat që hyjnë e

1. Dale Carnegie, *Da'i'l-kalak uebde'il-hajat* (Lëri mënjatë shqetësimet dhe fillo jetën!), përkthim i Abdul Mun'im Ez-Zijadit, botimi i pestë, Kajro. Bibliote-ka "Khanxhi", 1956, f. 282, 292, 298, 301.

2. Carl. G. Jung, *Modern Man in Search of a Soul*, London: Routledge & Kegan Paul, Ltd, 1966, f. 264.

3. Dale Carnegie: i njëjti burim, f. 286.

dalën në faltore, zotërojnë një personalitet më të fortë e më të mirë sesa të pafetë apo personat që nuk i falen kurrë Zotit.”¹

Përveç psikologëve dhe psikanalistëve, shumë nga mendimtarët perëndimorë po flasin rreth problemit të njeriut bashkëkohor, që në thelb i kthehet nevojës së tij për fe dhe vlera shpirtërore. Për shembull, historiani i mirënjohur Arnold Toynbee thotë: *“Krizë që ka përfshirë europianët në shekullin që po jetojmë, në thelb, ka të bëjë me varfërinë e tyre shpirtërore.”* Ai beson se rruga e vetme e shërimit nga ky kolaps moral, prej të cilit po vuan Perëndimi, është rikthimi te feja.²

Në të vërtetë, besimi lë një përshtypje të thellë në shpirtin e njeriut, sepse shton tek ai vetëbesimin dhe fuqinë për të përballuar vështirësitë e jetës, si dhe ushqen ndjenjën e sigurisë dhe të qetësisë, e bën atë që ta mbledhë mendjen e të “notojë” në ndjenjën e lumturisë. Tani lind pyetja: “Si e çon besimi njeriun në këtë fazë qetësimi psikik?”

A- Lidhja e besimit me ndjenjën e sigurisë

Të gjitha shkollat e psikoterapisë janë të një mendimi se shkak kryesor i shfaqjes së sëmundjeve psikike është ankthi. Mirëpo kanë mosmarrëveshje me njëri-tjetrin në përcaktimin e faktorëve ankthsjellës. Të gjitha këto shkolla njohin si qëllim kryesor të psikoterapisë, çlirimin nga ankthi dhe sjelljen e ndjesisë së sigurisë në shpirtin e njeriut. Mirëpo, për realizimin e këtij qëllimi, ndjekin metoda të ndryshme terapie. Më parë përmendëm se këto metoda nuk kanë qenë të suksesshme në shërimin e plotë të sëmundjeve psikike.

Studimi i historisë së feve, në veçanti të fesë islame, tregon se besimi në Zot ka qenë plotësisht i suksesshëm në shërimin e këtyre lloj sëmundjeve dhe në rritjen e sigurisë, të qetësisë në parandalimin e ankthit dhe të sëmundjeve që burojnë prej tij. Vlen të përmendet se shërimi zakonisht nis pas sëmurjes

1. Jusuf Kardaui, *El-Iman ue'l-hajat*, botimi 6, Kajro: Biblioteka Uehbe, 1978, f. 342.

2. Enuer El-Xhundi, *Mefahimu'l-ulumi'l-ixhtimaijeh ue'n-nefs ue'l-akhlak fi dau'l-Islam*, Kajro: Daru'l-I'tisam, 1977, f. 195.

së personit me sëmundje psikike. Ndërsa, nëse besimi në Zot zë vend në shpirtin e njeriut që në vegjëli, i fal personit një lloj imuniteti dhe fuqie parandaluese ndaj dëmit të sëmundjeve psikike. Kur'ani e përshkruan kështu sigurinë dhe qetësinë që krijon besimi në shpirtin e njeriut:

“Sa për ata që besojnë dhe nuk e molepsin besimin e tyre me padrejtësi (idhujtari), pikërisht atyre u takon siguria dhe ata janë të udhëzuar.”¹

“Ata që besojnë dhe zemrat e të cilëve, kur përmendet Allahu, qetësohen. Vërtet, zemrat qetësohen me përmendjen e Allahut!”²

“Çdo fatkeqësi që i bie njeriut, ndodh me vullnetin e Allahut. Ai ia udhëzon zemrën kujt do që i beson Atij. Allahu di mirë çdo gjë.”³

Parimisht, realizohet për besimtarin qetësia dhe siguria e shpirtit, sepse besimi i tij i vërtetë në Zot e bën atë të ketë shpresë në ndihmën, përkrahjen dhe shikimin mëshirues të Zotit. Besimtari, në adhurimin dhe punët që kryen për kënaqësi të Zotit, e ka mendjen gjithnjë tek Ai dhe, për këtë arsye, ndien se Zoti është përherë me të dhe e ndihmon atë. Pra, kjo ndjesi e besimtarit, që Zoti është ndihmëtar i tij, jep siguri dhe qetësi në shpirtin e tij.⁴

Besimtari që beson në Zot, nuk trembet nga asgjë në këtë botë, sepse e di që, po të mos dojë Zoti, atij nuk i vjen dot

1. Sure “El-En’am”, ajeti 82: *Vetëm ata që kanë besuar Zotin dhe nuk e kanë ngatërruar atë me adhurimin e ndonjë tjetri veç Tij (shirk - politeizëm), meritojnë qetësi dhe dinjitet. Vetëm ata janë të udhëzuar në rrugën e vërtetë e të mirësisë. “El-Muntekhab fi Tefsiri’l-Kur’ani’l-Kerijm”, f. 185.*

2. Sure “Er-Ra’d”, ajeti 28.

3. Sure “Et-Tegabun”, ajeti 11: Thënia **“...Ai ia udhëzon zemrën kujt do që i beson Atij. Allahu di mirë çdo gjë”**, do të thotë: *fatkeqësia që i vjen dikujt, e njeh si caktim të Zotit dhe përballë saj bën durim. Zoti llogarit udhëzimin e zemrës dhe bindjes së vërtetë, në vend të gjërave që humbasin në këtë botë. Ibni Abasi thotë: Ajeti i mësipërm do të thotë se Zoti e udhëzon drejt bindjes zemrën e besimtarit. Si rezultat, ai e di se çdo sprovë, fatkeqësi që i vjen si caktim i Zotit, duhet patjetër të ndodhë, andaj është dakort dhe i përulur. “Mukhtesar Tefsir Ibn Kethir”, vëll. 3, f. 51.*

4. Jusuf El-Kardavi, *El-Iman ue’l-hajat*, botimi i 6: Kajro: Biblioteka “Ue-hbe”, 1978, f. 113-115.

asnjë e keqe dhe dëm. Po t mos dojë Zoti, asnjë njeri apo fuqi në këtë botë nuk do të jetë në gjendje t'i sjellë atij dëm apo t'i ndalojë atij ndonjë të mirë a dobi. Pra, për këtë arsye, besimtar i vërtetë është një njeri, tek i cili nuk mund të mbizotërojë frika apo ankthi.

"Kudo që gjenden, ata janë të kapluar nga poshtërimi, vetëm nëse kanë ndonjë mbrojtje prej Allahut apo prej njerëzve. Ata merituan zemërimin e Allahut dhe do t'i kaplojë mjerimi. Kjo ishte për shkak se mohuan Shpalljet e Tij dhe pa kurrfarë të drejte, i vrisnin profetët. Kjo ishte për shkak se ata nuk u bindën dhe i kaluan kufijtë (në të këqija)."¹

"Me të vërtetë, atyre që thonë: "Zoti ynë është Allahu", e pastaj vazhdojnë të vendosur në rrugën e drejtë, do t'u zbresin engjëjt (para vdekjes) e do t'u thonë: "Mos u frikësoni dhe mos u pikëlloni! Dhe gëzojuni Xhenetit që ju është premtuar. Ne jemi mbrojtësit tuaj në jetën e kësaj bote dhe në Botën Tjetër. Atje do të keni çfarë t'ju dëshirojë zemra dhe çfarë të kërkonit."²

"Pa dyshim, ata që thonë: "Zoti ynë është Allahu!" dhe pastaj qëndrojnë në rrugën e drejtë, nuk do të kenë arsye për t'u frikësuar e as për t'u dëshpëruar (kur t'u vijë vdekja)."³

Besimtari i vërtetë e di që e përditshmja dhe furnizimi i tij është në dorën e Zotit dhe është Ai (Zoti) që e ndan në sasi midis njerëzve furnizimin. Prandaj nuk frikësohet nga varfëria e mospasjes. Nëse caktimi i Zotit është që furnizimi i tij të jetë i paktë, ai është i kënaqur me vullnetin e Zotit. Ai e falënderon Zotin për hir të shumë mirësive të tjera që ka, si për mirësinë e jetës, të besimit, të shëndetit trupor e qetësinë shpirtërore. Besimtari i vërtetë nuk njeh kurrë frikë për furnizimin ushqimor, sepse ka besim që vetëm i madhi Zot është Furnizuesi me ushqim dhe Zotëruesi i fuqisë dhe i pushtetit.

1. Sure "El-Bekare", ajeti 112.

2. Sure "Fussilet", ajetet 30-31.

3. Sure "El-Ahkaf", ajeti 13.

“Vërtet, Allahu është Furnizuesi i vetëm, i Fuqishmi, i Plotpushtetshmi.”¹

“Në qiell është furnizimi juaj dhe gjithçka që ju është premtuar.”²

“S’ka asnjë gjallesë në Tokë që të mos i ketë mjetet e jetesës prej Tij. Ai di vendbanimin e saj dhe vendin e vdekjes. Të gjitha këto janë (të shënuara) në Librin e qartë.”³

“Sa krijesa ka që nuk e mbajnë dot veten me ushqim! Allahu u jep atyre dhe juve! Ai dëgjon dhe di gjithçka.”⁴

“Allahu ia shton furnizimin kujt të dojë dhe ia pakëson kujt të dojë. Jobsimtarët i gëzohen jetës së kësaj bote, por jeta e kësaj bote në krahasim me Botën Tjetër është vetëm kënaqësi kalimtare.”⁵

Besimtari i vërtetë nuk frikësohet nga vdekja dhe e sheh atë me një sy realist, sepse e di që s’ka nga t’ia mbathë prej saj dhe se çdo njeri e ka të shkruar se kur do vdesë dhe se, kur i arrin çasti i vdekjes, nuk ka fuqi që ta shtyjë a ta vonojë atë.

“Çdo shpirt do ta shijojë vdekjen. Shpërblimet do t’u plotësohen vetëm në Ditën e Kiametit; kushdo që shpëton nga zjarri i Xhehenemit dhe hyn në Xhenet, ai ka fituar (gjithçka që mund të dëshirohet). Ndërsa jeta e kësaj bote është vetëm kënaqësi mashtruese.”⁶

“Kudo që të gjendeni, do t’ju arrijë vdekja, madje, qofshi edhe në kështjellat më të forta!” Sa herë që u vjen ndonjë e mirë, ata thonë: “Kjo është nga ana e Allahut.” Por, nëse i godet ndonjë e ligë, ata thonë: “Kjo është prej teje (o Muhamed)!” Thua ju: “Të gjitha janë prej Allahut.” Ç’është kështu me këtë popull, që nuk kupton asgjë?”⁷

“Sigurisht që ti (o Muhamed) do të vdesësh një ditë e, sigurisht që edhe ata do të vdesin.”⁸

1. Sure “Edh-Dharijat”, ajeti 58.

2. Sure “Edh-Dharijat”, ajeti 22.

3. Sure “Hud”, ajeti 6.

4. Sure “El-Ankebut”, ajeti 60.

5. Sure “Er-Ra’d”, ajeti 26.

6. Sure “Ali Imran”, ajeti 185.

7. Sure “En-Nisa”, ajeti 78.

8. Sure “Ez-Zumer”, ajeti 30.

“Çdo popull ka afatin e vet. Kur t’i vijë koha e fundit, ata nuk mund ta shtyjnë, qoftë edhe për një çast dhe as nuk mund ta shpejtojnë.”¹

“Por Allahu nuk ia shtyn afatin asnjë shpirti, që i vjen koha (e vdekjes); Allahu e di mirë gjithçka që bëni ju.”²

“Allahu ju ka krijuar së pari prej dheut (Ademin), pastaj (pasardhësit e tij i ka krijuar) nga pika e farës dhe më në fund ju ka bërë çifte. Dhe asnjë femër nuk mbetet shtatzënë e as nuk lind pa dijeninë e Tij. Jeta e askujt nuk zgjatet e as nuk shkurtohet pa qenë e shënuar në Libër. Me të vërtetë, kjo për Allahun është e lehtë!”³

“Sikur armiku t’i pushtonte ata nga të gjitha anët e t’u kërkonte që të bëheshin idhujtarë, ata do të bëheshin duke ngurrUAR fare pak.”⁴

“Ai do ta dërgojë atë edhe tek të tjerë (myslimanë) nga ata, të cilët ende nuk u janë bashkuar. Ai është i Plotfuqishmi dhe i Urti.”⁵

Besimtari i vërtetë e di mirë se në këtë botë është veç një kalimtar, i cili transferohet me shpejtësi për në Botën Tjetër. Prandaj, në këtë botë i kryen punët e veta mbi këtë bazë që, me besimin te Zoti, adhURim dhe vepra të denja, të përgatitet për atë botë. Besimtari i vërtetë nuk frikësohet nga vdekja, ashtu siç i frikësohet asaj pjesa dërrmuese e njerëzve. Besimtari e di se vdekja do ta transferojë drejt afrimit hyjnor, atje ku do të begatohet me kënaqësi hyjnore, do të lumturohet me takimet e Profetëve dhe atyre që qenë të drejtë dhe që ecën mbarë në rrugën e Zotit, si dhe do të përfitojë prej begative të Parajsës, të cilat Zoti ia ka premtuar.

Besimtari i vërtetë nuk trembet prej fatkeqësive që i sjell koha dhe të papriturave që i sjell fati. Ai nuk bie në panik përballë sëmundjeve që mund ta prekin apo të papriturave të pakëndshme dhe të rënit në ndonjë tragjedi, sepse beson

1. Sure “El-A’raf”, ajeti 34.

2. Sure “El-Munafikun”, ajeti 11.

3. Sure “Fatir”, ajeti 11.

4. Sure “El-Ahzab”, ajeti 14.

5. Sure “El-Xhumu’a”, ajeti 3.

që ngjarjet e këndshme apo të hidhura, të cilat u ndodhin njerëzve, janë sprova nga ana e Zotit që të dalë në pah se cilët persona falënderojnë në kohë gëzimi dhe çlirimi, apo bëjnë durim në kohë vështirësie. Kur besimtari kaplohet nga ndonjë e keqe a fatkeqësi, nuk ankohet e nuk i ngelet hatri, mirëpo zgjedh rrugën e durimit dhe e falënderon Zotin, i lutet Atij që t'ia largojë të keqen dhe mundimin.

“Çdo njeri do ta shijojë vdekjen! Ne ju vëmë në provë me të keqe dhe me të mirë dhe te Ne do të ktheheni.”¹

Besimtari i vërtetë nuk e tregon mërzinë, pikëllimin e vet, nuk jeton me kujtimet e hidhura të së kaluarës e nuk ndien keqardhje për gjërat që ka humbur. Për këtë arsye, shumë njerëz vazhdojnë të mbajnë mbi shpatulla pikëllimin e ardhur prej mërzitjes dhe dhimbjes së ditëve të kaluara, ndërsa besimtari nuk ndien kurrfarë pikëllimi.²

Edhe kur i vijnë të mirat, nuk zgjedh rrugën e degjenerimit dhe të prishjes, nuk bëhet arrogant e i pabindur, por e falënderon Zotin për begatinë që i ka dhuruar.

“S’ka fatkeqësi që godet tokën dhe ju, që të mos jetë e shënuar në Libër (Leuhi Mahfûdh) më parë se ta krijojmë atë. Kjo për Allahun është vërtet e lehtë! (Këtë paracaktim e kemi bërë) që ju të mos dëshpëroheni për atë që ju ka kaluar, por edhe për të mos u gëzuar së tepërmi për atë që Ai ju ka dhënë. Allahu nuk i do kryelartët mburravecë.”³

“O besimtarë! Mos bëni si ata jobesimtarë (hipokritët) që u thoshin vëllezërve, kur këta niseshin në udhëtim ose në luftim: “Sikur të rrinit me ne, as nuk do të vdisnit, as nuk do të vriteshit” që këtë Allahu ta kthejë si pikëllim në zemrat e tyre. Allahu është Ai që jep jetën dhe sjell vdekjen; Allahu i sheh të gjitha punët që bëni ju.”⁴

Besimtari i vërtetë kurrë nuk pushtohet nga ankthi që buron prej ndjenjës së pavetëdijshme të mëkatit, prej së cilës vuan pjesa dërrmuese e të sëmurëve psikikë.

1. Sure “El-Enbija”, ajeti 35.

2. Jusuf El-Kardavi, *El-Iman ue'l-hajat*, f. 119, 121.

3. Sure “El-Hadid”, ajetet 22-23.

4. Sure “Ali Imran”, ajeti 156.

Mospasja e ankthit të shpirti i besimtarit vjen prej disa arsyeve:

1. Besimtari, që në fëmijëri është rritur, është mbështetur në edukimin e drejtë islam, nuk bie lehtë pre e mashtrimit dhe nuk kryen faje e mëkate, të cilat sjellin vrarjen e ndërgjegjes e ndjenjën e poshtërimit të shpirtit;

2. Është e qartë se çdo njeri gjendet në skemën e kryerjes së gabimeve, e po ashtu edhe besimtari nuk përjashtohet nga ky ligj. Mirëpo ai, kur bën faj, i lejon vetes ta kujtojë, ta pranojë atë, të kërkojë falje e të pendohet para Zotit, sepse e di që Zoti i Madhëruar është Pranues i pendimeve dhe i faljes.

“Kush punon vepër të keqe ose e ngarkon veten me gjynahe, pastaj kërkon falje prej Allahut, do të gjejë se Allahu është Falës e Mëshirëplotë.”¹

“Vërtet, Unë jam Falës për atë që pendohet, beson e bën vepra të mira dhe pastaj qëndron në rrugë të drejtë.”²

Thuaj: “O robërit e Mi, që i keni bërë keq vetes me gjynahe, mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut! Allahu, me siguri, i fal të gjitha gjynahet. Vërtet, Ai është Falësi i madh dhe Mëshirëploti.”³

Pranimi që besimtari i bën mëkatit dhe pendimi para Zotit, e pengon atë nga mendimi i mëkatit dhe nga shqetësimi psikik që buron nga kjo ndjenjë. Si përfundim, rezulton me mundjen e pavetëdijshme të tij. Duhet të kuptojmë se nuk do të thotë që njëkohësisht me mundjen e mendimit të mëkatit, të asgjësohet ajo fuqi reaguese e ndjenjës së poshtërimit, e cila ka ekzistuar përkrah mendimit të mëkatit. Prandaj, fuqia e përmendur reaguese manifestohet në trajtën e një ankthi të paqartë e të kultivuar te njeriu, gjë që i shkakton atij vuajtje dhe tension psikik.

Psikanalisti përpiqet ta detyrojë pacientin që t'i sjellë sërish ndërmend ato punë dhe të përballet me to dhe, në vend që të arratiset nga ballafaqimi me to, të gjejë një lloj gjykimi të arsyeshëm për to, domethënë të marrë vendim për to.

1. Sure “En-Nisa”, ajeti 110.

2. Sure “Ta ha”, ajeti 82.

3. Sure “Ez-Zumer”, ajeti 53.

Ndodh për këtë arsye që përmendja e mëkateve, nga ana e besimtarit, pranimi që i bën atyre, kërkimi i faljes dhe pendimi bëhen shkak i parandalimit të mposhtjes së ndjenjës së mëkatit. Kjo lloj mposhtjeje bëhet shkak i krijimit të ankthit dhe shfaqjes së ndërlikimeve psikike. Nga temat e mësipërme del në dritë se besimtari i vërtetë nuk trembet nga gjërat që u trembet shumica e njerëzve, si: vdekja, varfëria dhe mundimet që i sjell koha. Besimtari ato i quan sprova të Zotit, fatkeqësi që sjell koha dhe beson se, duke duruar përballë tyre, zotëron fuqi të konsiderueshme në përballimin e fatkeqësive. Ai nuk e mposht ndjenjën e mëkatit të tij, por e pohon atë dhe i kërkon falje Zotit.

Duke u kushtuar vëmendje këtyre çështjeve, nuk është për t'u çuditur se si një besimtar i vërtetë gjithnjë zotëron sigurinë mendore e psikike dhe qetësinë e zemrës dhe qenia e tij është e mbushur me kënaqësi, pajtim dhe qetësi mendore.

“Cilindo mashkull apo femër që kryen vepra të mira, duke qenë besimtar, Ne do ta bëjmë që të kalojë jetë të bukur dhe do ta shpërblejmë sipas veprave më të mira, që ka bërë.”¹

Mungesa e besimit në Zot e zbraz jetën prej koncepteve të larta dhe vlerave të fisshme humane dhe bëhet shkak që njeriu ta humbasë ndjenjën e misionit të tij të madh në jetë, si mëkëmbës i Zotit në tokë dhe të mos ketë intuitë të mprehtë rreth qëllimeve të mëdha të jetës së tij, domethënë adhurimit të Zotit dhe afrimit me Të, luftën me vetveten (*xhihadu'n-nefs*) për të arritur përkryerjen njerëzore, e cila sjell lumturinë e tij në këtë botë e në Botën Tjetër. Gjendjen e konfliktit dhe ankthit, sorollatjes dhe humbjen e vetvetes, e cila prek njeriun që i mungon besimi, Kur'ani e krahason me gjendjen e një njeriu që ndien se ka rënë nga qielli dhe shpendët e rrëmbejnë atë midis qiellit dhe tokës apo era e fortë e flak diku larg.

“Përluni plotësisht para Allahut me sinqeritet, duke mos i shoqëruar asgjë Atij (në adhurim). Kush i shoqëron Allahut diçka (në adhurim), i ngjan atij që bie nga qielli e që

1. Sure “En-Nahl”, ajeti 97.

e rrëmben zogu ose i ngjan atij që stuhia e erës e ka hedhur në një vend të largët e të humbur.”¹

“Për kohën! Me të vërtetë, njeriu është në humbje, përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, i këshillojnë njëri-tjetrit të vërtetën e i këshillojnë njëri-tjetrit durimin.”²

Besimi në Zotin e Madhëruar, pasimi i stilit që është dhënë në Kur'an dhe ndjekja e traditës dhe jetëshkrimit të Profetit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) është e vetmja rrugë e çlirimit të njeriut prej trishtimit dhe ankthit,³ që përfundon me sigurinë dhe lumturinë e tij. Ashtu sikurse mungesa e besimit dhe mosecja në udhën e Zotit, në fund do të dhurojë trishtim, ankth dhe fatkeqësi.

Dhe tha: “Zbritni prej Xhenetit që të dy (Ademi dhe djalli)! Do të jeni armiq të njëri-tjetrit. Kur t’ju vijë udhëzim nga ana Ime, kush do ta pasojë udhëzimin Tim, as nuk do të humbë, as nuk do të bjerë në mjerim. Kushdo që i kthen shpinën Këshillës Sime, do të ketë jetë të mjeruar dhe Ne, në Ditën e Kiametit, do ta ringjallim të verbër.”⁴

B- Besimi dhe ndjesia e atashimit në grup

Kur'ani e nxit besimtarin që t'i dojë vëllezërit e tij të besimit e t'i ndihmojë ata:

“Në të vërtetë, besimtarët janë vëllezër, andaj pajtojini vëllezërit tuaj midis tyre dhe kijeni frikë Allahun, në mënyrë që ju të mëshiroheni.”⁵

“Ndërsa ata që banojnë në Medinë dhe që e kanë pranuar besimin që më parë, i duan mërgimtarët që vijnë në Medinë dhe në zemrat e tyre nuk ndiejnë kurrfarë rëndimi, për atë, që u është dhënë atyre, por duan t'u bëjnë më mirë mërgimtarëve se sa vetes, edhe pse vetë janë nevojtare.

1. Sure “El-Haxh”, ajeti 31.

2. Sure “El-Asr”, e plotë.

3. *El-Akhlaq ue's-sejr fi mudavati'n-nufus*, Abu Muhamed Ali ibn Said ibn Hazm ibn Galib, Bejrut: Daru'l-Afaki'l-Xhedide, 1978, f. 15-16.

4. Sure “Ta ha”, ajetet 123-124.

5. Sure “El-Huxhurat”, ajeti 10.

Kushdo që ruhet nga lakmia e vetvetes, me siguri që do të jetë fitues.”¹

“Mjerë për ata, të cilët kur falen, janë të pakujdesshëm për namazet, të cilët duan vetëm që të duken dhe nuk u japin ndihmë nevojtarëve.”²

Kur’ani i nxit besimtarët për bashkëpunim dhe për krijimin e një shoqërie të bashkuar, ku besimtari ta ndiejë veten si pjesë të ndërtësës së lartë e të përsosur të saj.

“...Ndihmojeni njëri-tjetrin në punë të mira dhe në të ruajturit nga të këqijat dhe jo në gjynahe dhe armiqësi!...”³

Kur’ani e thekson rëndësinë e namazit me xhemat (në grup) në ditën e xhuma. Në këtë ditë, myslimanët e organizojnë namazin në xhami të ndryshme, për t’u njohur me njëri-tjetrin. Profeti Muhamed (*paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*), përveçse i inkurajonte myslimanët për të organizuar namazin me xhemat, i këshillonte ata gjithashtu, duke u thënë se është më mirë që namazi të organizohet me xhemat sesa të falet vetëm, pra i ndarë nga grupi. Namazi në grup (me xhemat) ka më shumë mirësi.

Theksi që vë Kur’ani në pasqyrimin e dashurisë midis myslimanëve dhe për bashkimin në rreshtat (*safet*) ku falin namazin, është shkak për përhapjen e dashurisë. Kjo gjë zhvillon respektin e të drejtave të njerëzve në përgjithësi në shoqërinë që na rrethon. Një mirësi tjetër që ka organizimi i namazit me xhemat, është largimi i mendjes nga gjendja pasive, urretja, smira, dhuna, egoizmi etj.

Nuk ka dyshim që organizimi i faljes së namazit me xhemat është shumë i vlefshëm për vetë faktin, se jo vetëm që i bashkon njerëzit me njëri-tjetrin, por sepse është urë lidhëse për forcimin e kurimit e ndjenjave vartëse. Ai bën që ndjenja e izolimit të largohet. Në parim, ndjenja e varësisë së një personi te grupi dhe vëmendja te roli i tij aktiv në shoqëri, ka një rëndësi shumë të madhe për shëndetin psikologjik.

1. Sure “El-Hashr”, ajeti 9.

2. Sure “El-Maun”, ajetet 4-7.

3. Sure “El-Maide”, ajeti 2.

Shumica e psikologëve u kushtojnë shumë vëmendje marrëdhënieve të personit që ata kurojnë me familjarët apo me persona të tjerë. Kjo gjë bëhet që të sigurohet shëndeti i të sëmurit. Për shembull, Alfred Adler besonte se sëmundja psikologjike është e kurueshme në kohën kur i sëmuri aktivizohet, duke qëndruar me shoqërinë dhe në marrëdhënie me njerëzit. Adler, për këtë gjë, shkruan: *"Përpjekjet e mia për të gjithë këtë mundim nuk janë për të tërhequr vëmendjen e të sëmurit te të tjerët, por në kohën kur ai zë vend në një grup dhe bashkëpunon në mënyrë të barabartë, në të vërtetë, ai ka gjetur vetoeten. Sipas mendimit tim, çështja më e rëndësishme është dashuria për të afërmit dhe dhënia e ndihmës. Personat që nuk janë bashkëpunues dhe që nuk e përfillin ndihmën, është e sigurt që do të kenë shumë probleme. Ajo çka jeta kërkon nga njeriu është që ai të riprodhojë, të punojë, si dhe të jetë dashamirës i njerëzve."*¹

Adler besonte se njeriu, me forcimin e lidhjeve të tij me njerëzit dhe me shoqërinë, duke bërë vepra të dobishme shoqërore, duke treguar (falur) dashuri dhe miqësi, mund të largohet nga ndjenjat shqetësuese. Thënë ndryshe, shqetësimi (ankthi) i njeriut përfundon atëherë kur ai e lidh veten me njerëzit.²

Lidhja e një personi me grupin, lidhja njerëzore mes tyre, si dhe, miqësia e grupit në raport me të, është nga shkaqet kryesore që ndihmon për të krijuar një personalitet të fortë, të sigurt dhe të qetë.

C- Metoda e Kur'anit në psikoterapi

Për të bërë rregullime apo ndryshime në sjelljen e një personi është e domosdoshme që në fillim të veprohet me rregullimin ose ndryshimin e prirjeve të tij. Njeriu është nën ndikimin e mendjes dhe të prirjeve.

1. Marrë nga: Dale Carnegie, *Da'i'l-kalak uebde'il-hajat (Lëri mënjane shqetësimet dhe fillo jetën!)*, përkthim i Abdul Mun'im Ez-Zijadit, botimi i pestë, Kajro. Biblioteka "Khanxhi", 1956, f. 262-264.

2. Alfred Adler: *Understanding Human Nature*. New York: Greenberg Publishers, inc., 1927, f. 239; Rollo May: *The Meaning of Anxiety*. New York: The Ronaldpress Co., 1950, ff. 128-130.

Për këtë arsye, qëllimi kryesor i psikoterapistëve është ndryshimi i llojeve të ndryshme të mendimeve, që kanë të sëmurët psikikë për veten e tyre, për njerëzit dhe për jetën. I sëmuri psikik, me ndryshimet e mendimeve që ndodhin nën efektin e trajtimit, bëhet i fuqishëm për të përballuar problemet. Shpeshherë, pas shërimit, e kupton se problemet e shkuara bëheshin shkak i shqetësimeve dhe i sëmundjeve të tij.

Në thelb, mësimi është praktikë që në rrjedhë të tij rregullon dhe ndryshon mendjen, prirjet, zakonet dhe sjelljet e njerëzve. Puna e psikoterapisë, në të vërtetë, është korrigjim i mësimave të gabuara të shkuara. I sëmuri, si rrjedhojë e mendimeve të gabuara rreth vetes, rreth të tjerëve dhe rreth jetës, është përballur me ankthe.

Psikologu përpiqet që t'i korrigjojë mendimet e pacientit dhe atë e detyron që të përballlet me realitetin e tij dhe të njerëzve të tjerë. Në vend të arratisjes nga problemet, ai duhet të përballlet me to. Gjithashtu, në vend që të vazhdojë të jetë i lidhur me gjendjen e ngatërruar psikike – që është pengesë e zgjidhjeve të problemeve - të përpiqet që t'i zgjidhë ato. Ky ndryshim qëndrimi e bën pacientin të fuqishëm përballë vetes dhe njerëzve dhe e bën atë më të fuqishëm për zgjidhjen e problemeve. Përfshirja psikike dhe ankthi largohen prej tij. Zakonisht, kjo bëhet shkak i lumturisë së pacientit dhe një fillimi aktiv të ri në jetën e tij. Njeriu e ndien shijen e jetës, kënaqësinë e shpirtit, qetësinë dhe lumturinë.

“... Allahu nuk e ndryshon të ardhmen e asnjë populli, derisa ai të ndryshojë veten e tij...”¹

Kur'ani ka zbritur për ndryshimin e mendjeve, të prirjeve dhe të sjelljeve të njerëzve, për udhëzimin e tyre në të drejtë dhe në të mirë, për shpëtimin nga humbja e rrugës së drejtë dhe injoranca, për të gjetur mendime të reja rreth karakterit dhe qëllimit të njeriut, për të treguar vlerat e moralit dhe shembujt e lartë. Kur'ani bëri ndryshime të mëdha në përgjithësi, që në themelimin e një sistemi të ri shoqëror, të jetës personale të njeriut, si dhe ndikimin e pakundërshtueshëm që pati në

1. Sure “Er-Ra’d”, ajeti 11.

shoqëri. Shkurtimisht, mund të thuhet se në mes të gjithë Librave të Zotit që janë zbritur gjatë historisë, Kur'ani është i pranueshëm dhe i pazëvendësueshëm. Në një kohë të shkurtër, Kur'ani arriti të nxirrte personalitete mjaft të larta, të plota, të drejta, të qeta dhe të sigurt në vetvete. Ata mundën që të ndryshonin në mënyrë të jashtëzakonshme, të tundnin botën dhe të linin gjurmë të thella në histori.

Lind pyetja: Si mundi Kur'ani ta ndryshonte psikologjinë dhe personalitetin e arabëve? Përgjigjen do ta marrim më poshtë:

1. Besimi se Zoti është Një

Gjëja e parë që Kur'ani donte të ndryshonte tek arabët ishte besimi i tyre. Duke u nisur nga kjo, qëllimi i ajeteve që u shpallën në fazën e parë të ftesës islame në Mekë, ishte besimi në një Zot. Metoda më e mirë e Kur'anit është në gjuhësinë e tij. Arabët nuk e kanë parë më parë shembullin e tij. Njëkohësisht, ai është sjellë edhe për faktet logjike e bindëse të tij, në trajtimin e temave e të dispozitave, në përmendjen e historive dhe në përdorimin e fjalëve të urta për shpjegimin dhe zbërthimin e kuptimeve. Për të krijuar interes në të mësuar janë përdorur metoda nxitëse (inkurajimi) dhe kërcënimi. Është përdorur përsëritja e disa kuptimeve për përforsimin e tyre në mendje.

Të gjitha këto, duke i përmbledhur, kanë pasur ndikim të madh në fe dhe në besimin në një Zot. Besimi në një Zot është hapi i parë për të krijuar ndryshime të mëdha në personalitet. Besimi sjell një forcë të madhe shpirtërore te njeriut, që ai e kupton në brendësi të tij. Besimi në një Zot i ndryshon njerëzit, jetën dhe gjithë universin. Ai i jep një kuptim të ri jetës dhe e bën njeriun që të mbajë përgjegjësi për të. Njëkohësisht bën që zemra e tij të mbushet me dashuri për Allahun, të Dërguarin e nderuar (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*), për njerëzit që e rrethojnë dhe për të gjithë njerëzimin.

2. Devotshmëria

Devotshmëria është ndjekëse e besimit. *Devotshmëri* do të thotë që njeriu ta largojë veten nga gjynahet dhe ta detyrojë atë që të jetojë sipas udhëzimeve, për të cilat Allahu dhe i Dërguari i nderuar (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*) na këshillojnë në Kur'an dhe hadith. Zbatimi i urdhrave të Zotit dhe largimi nga të ndaluarat e Tij, do të thotë *devotshmëri*.

Kuptimi i devotshmërisë mund të përmblihet në faktin se njeriu është sundues i dëshirave, i pasioneve dhe i kënaqësive të tij. Ai i përdor këto, vetëm aq sa e ka lejuar dispozita islame dhe duke mos i kaluar kufijtë. Devotshmëri nuk do të thotë që njeriu të shtypë (apo të shuajë) dëshirat e lindura (natyrore), por vetëm që të dijë se si t'i kontrollojë ato (dëshira), të mos e kalojë cakun e sheriatit (dispozitës). Në punët e tij, njeriu, njëkohësisht, duhet të jetë në kërkim të së vërtetës, të drejtësisë dhe të kryerjes së amanetit, të sillet mirë me njerëzit dhe të ketë kujdes që të mos i sulmojë apo t'i dhunojë ata. Devotshmëri do të thotë që njeriu t'i zbatojë në mënyrën më të mirë të gjitha punët që i janë caktuar. Veprat e tij ai i kryen për të marrë kënaqësinë e Zotit dhe për të marrë shpërblim prej Tij. Ai përpiket të përmirësojë sjelljen e tij e të marrë sa më shumë njohuri.

Devotshmëria është një forcë, e cila bën që njeriu të drejtohet drejt veprave të mira, të rrisë moralin e tij shpirtëror, të largohet nga sjelljet e papëlqyeshme dhe të devijuar. Që të arrihet kjo, njeriu duhet të luftojë me egon e tij dhe të mos u bindet dëshirave të kota. Devotshmëria është një nga shkaqet më kryesore për rritjen dhe plotësimin e një personaliteti. Ajo bën që njeriu të ngrihet dhe të arrijë në majat më të larta të tij.

“O ju (ithtarë të Librit) që besuat (në Musain dhe Isain), ruajuni Allahut dhe besoni në të Dërguarin e Tij (Muhamedin), se Ai do t’ju dhurojë pjesë të dyfishtë nga mëshira e Vet, do t’ju japë dritë, me ndihmën e së cilës do të ecni dhe do t’ju falë; Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë.”¹

1. Sure “El-Hadid”, ajeti 28.

“O besimtarë! Nëse i frikësoheni Allahut, Ai do t’ju japë aftësinë e të gjykuarit drejt, do t’ju lirojë nga gjynahet tuaja dhe do t’ju falë. Allahu zotëron mirësi të madhe.”¹

“O besimtarë, frikësojuni Allahut dhe thoni vetëm të vërtetën. Ai do t’jua bekojë veprat tuaja dhe do t’jua falë gjynahet.”²

“...Ai që i frikësohet Allahut, Ai do t’ia lehtësojë çështjen.”³

3. Adhurimet

Edhe pse ndryshimi i mendjes është hapi i parë dhe më i rëndësishëm për ndryshimin e personalitetit të një personi, mësimi i sjelljeve të reja dhe praktika e gjatë janë të detyrueshme. Pra, që njeriu të forcojë gjendjen e tij shpirtërore, është e nevojshme që të praktikohet sa më shumë. Personat, të cilët mësojnë fjalë dhe i përsërisin ato duke i shqiptuar, i mësojnë më shpejt sesa ata të cilët nuk i shqiptojnë, por vetëm i dëgjojnë dhe shikojnë figurën e fjalëve (me anë të filmave). Një njeri nuk mund të mësojë pa u praktikuar dhe pa u aktivizuar.

Në psikoterapi është e nevojshme që pacientit t’i tregohen aftësitë e tij, që ai të mendojë ndryshe për veten dhe njerëzit. Kështu, ai vëren se sjellja e tij e re është shkak i sukseseve të tij në lidhje me komunikimin me njerëzit, vëren qartë ndryshimin e sjelljes së personave që e rrethojnë. Pacienti e ndien që njerëzit ia shprehin haptas ndjenjat pozitive të tyre, si ndershmërinë, dashurinë dhe vlerësimin ndaj tij. Në këtë mënyrë, pacienti bën ushtrime praktike, duke filluar që nga ndryshimi i mendimeve. Duke qenë i kënaqur nga ky ushtrim, ai ndihmohet që të ketë një ndryshim të madh në personalitetin e tij. Ky ushtrim e bën atë që të hedhë hapa më të shpejtë drejt shërimit. Kur’ani ka sjellë mënyra të shumta për formimin e personalitetit të njeriut, si dhe për krijimin e ndryshimeve në sjelljet e tyre. Për këtë arsye, Allahu i Madhëruar i ka bërë

1. Sure “El-Enfal”, ajeti 29.

2. Sure “El-Ahzab”, ajeti 70-71.

3. Sure “Et-Talak”, ajeti 4.

të detyrueshme disa nga adhurimet, si: namazin, agjërimin, zekatin dhe haxhin. Zbatimi me rregull dhe me përpikëri i këtyre adhurimeve në kohën e tyre të caktuar, është bindje ndaj Allahut.

Gjithashtu, kjo bindje bën që ai të mësojë të këtë durim ndaj gjërave të vështira, të tolerojë, të luftojë me vetveten, si dhe, të kontrollojë dëshirat e lutjet (kërkesat) e veta. Ai mëson të tregojë dashuri dhe mirësi për njerëzit e shoqërinë. Këto janë virtyte që e dallojnë nga të tjerët. Nuk ka dyshim se zbatimi me sinqeritet dhe rregull i këtyre adhurimeve, bëhet shkak që besimtari të përfitojë cilësi të tilla. Këto cilësi kanë rrënjë të forta dhe shëndeti i pacientit është i sigurt (i ruajtur) nga problemet psikike. Shpjegimet e mëposhtme janë sqaruese të ndikimit të adhurimit të myslimanët.

3-1. Namazi

Fjala *namaz* tregon lidhjen mes njeriut dhe Zotit.¹ Në namaz njeriu qëndron dhe përulet përpara Zotit, Krijuesit të gjithçkaje. Ai, me trupin e tij të hollë e të dobët, qëndron para Zotit të Fuqishëm, Sunduesit të Botëve, Drejtuesit të punëve në Qiej e në Tokë. Qëndrimi i njeriut në namaz në gjendje nënshtrimi dhe turpërimi para Zotit të tij, bën që ai të gjejë forcë shpirtërore.²

Aty, ai ndien bukurinë shpirtërore, qetësinë e zemrës dhe ndien siguri psikike. Kjo ndodh sepse njeriu në namaz u kthen shpinën të gjitha problemeve të tij në këtë botë. Ai nuk mendon për asgjë, përveç Zotit të tij dhe përveç ajeteve kur'anore, të cilat i lexon në namaz. Kjo gjendje lehtësuese dhe qetësi mendore nga namazi, ka rëndësi të madhe në uljen e nervozizmit, në uljen e tensionit të jetës së përditshme, si dhe në uljen e stresit.

1. Namaz (arab. *Salat*). Rrënja (*uesele*) e kësaj fjale vjen nga *sile* – d.m.th. lidhje e marrëdhënie.

2. Xhemal Madi Ebu'l Azaim, *El-Kur'an ue ilmu'n-nefs*; Usama Muhamed Er-Radi, *El-Islam ue emradu'l-asr* (Konferenca "Ilmu'n-nefs ue'l-Islam"), Fakulteti i Shkencave të Edukimit në Universitetin e Rijadit, vëll. I, 1978.

Dr. Tomas Hayslip (Thomas Hayslip) thotë: *Gjëja më e rëndësishme që kam ndeshur gjatë eksperiencave të mia, e cila fal qetësi në çështjet psikike, është namazi. Unë, si mjek, them se gjëja më e rëndësishme që kam njohur ndonjëherë në krijimin e qetësisë në psikologjinë dhe nervozizmin e njeriut, është namazi.*¹

“Lehtësimi, qetësimi” është një nga mjetet e përdorura nga disa psikoterapistë të rinj, për të shëruar të sëmurët psikikë. Falja e namazit pesë herë në ditë është programi më i mirë për të gjetur qetësinë. Kur njeriu i mëson teknikat e qetësimit, ai mund t’u shmanget krizave nervore, që vijnë nga shtypjet dhe problemet e jetës. Profeti Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*), kur afronte koha e namazit, thoshte: *O Bilal! Na qetëso me thirrjen për në namaz.* Në një thënie tjetër thuhet se, sa herë që Profeti i vinte ndonjë detyrë e vështirë, ai falte namaz.² Profeti i nderuar (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*), ka thënë: “Ndriçimi i syve të mi është në namaz.”³

Namazi krijon gjendje qetësuese. Përsëritja e ndodhive të kësaj natyre ose kujtesa e tyre në gjendje relaksuese dhe qetësia shpirtërore pas namazit, bëhet shkak i shuarjes së stresit te njeriu në mënyrë graduale. Thelbi i këtyre çështjeve të debatueshme të stresit kthehet në gjendje qetësie pas lidhjes me namazin. Në këtë mënyrë, pacienti largohet prej stresit dhe shqetësimit. Ky efekt i rëndësishëm që jep namazi në shërimin e stresit, është i ngjashëm me trajtimin psikologjik që po përdorin disa nga psikoterapistët për shërimin e të sëmurëve psikikë kohët e fundit. Këta psikoterapistë, ku veçojmë Xhozef Volpe (Joseph Volpe), ndjekin mënyrën “Ndalimi i ndërsjellë”⁴ ose ndryshe “Shërimi me rrugë relaksuese” ose “Trajtimi duke ulur ndjeshmërinë pasive”. Në fillim të këtij trajtimi, terapeuti e ushtron pacientin që të ndiejë një çlodhje të thellë. Ndërkohë që pacienti ndodhet në gjendje relaksuese, psikoterapisti kërkon prej tij që të përfytyrojë një

1. Dale Carnegie, *Da'i'l-kalak uebde'il-hajat*, f. 359-360.

2. *Mukhtesar Tefsir Ibn Kethir*, vëll. I, f. 142.

3. Këtë hadith e transmeton Taberaniu në “*El-Eusat*”. Marrë nga Said Haua, *Terbijetuna'r-Ruhije*, f. 231.

4. *Reciprocal Inhibition*.

nga gjërat që e nervozojnë. Sigurisht që psikoterapisti këtë gjë e bën me qëllim të caktuar. Pra, e fillon nga gjërat më të lehta të acarimit nervor të pacientit, për të arritur tek ato më të mëdhatë. Ndërkohë që pacienti përfytyron atë që e nervozon dhe nervozizmi ndodh, psikoterapisti i kërkon që ta largojë nga mendja atë që e nervozonte dhe të përfytyrojë diçka që e relakson. Pasi pacienti qetësohet dhe kthehet në gjendje relaksi (qetësie), sërish atij i kërkohet që të përfytyrojë po atë gjë që e nervozon.

Kështu, në këtë mënyrë vazhdon shërimi, derisa pacienti kur të jetë i qetë, të mundet që ta përfytyrojë pa i bërë më përshtypje atë gjë nervozuese (pra, pa u nervozuar). Pas këtij hapi, pacienti mund të përfytyrojë gjëra më të rënda nervozuese, duke qenë i qetë. Kështu, ai përmirësohet hap pas hapi. Metoda e Volpésë dhe e psikoterapistëve dhe trajtuesve të tjerë, është e përmbajtur rrënjësisht nga parimet e kushtëzimit.¹ Në këtë metodë, psikoterapisti përpiqet që të krijojë një lidhje në mes nervozizmit, reagimeve nervore dhe qetësisë.

Vëmë re që ngjashmëria e metodës së psikoterapistëve dhe ndikimi shërues që jep rezultati i faljes së namazit, është mjaft i dukshëm. Ndërthurja e gjendjes relaksuese dhe qetësia psikike vjen nga namazi (zakonisht kjo gjendje vazhdon për një kohë edhe pas namazit). Namazi bëhet shkas i krijimit të një lidhjeje të re, e cila i dallon faktorët nervozues me ato qetësues. Ne e dimë që reagimi i gjendjes relaksuese pas namazit është në kundërshtim me nervozizmin. Për këtë arsye, njeriu largohet nga stresi e kjo është po ajo metodë, të cilën e përdorin edhe psikoterapistët për të shëruar nervozizmin, ashtu siç e përmendëm edhe më lart.

Njeriu, pas namazit, menjëherë fillon të lutet, të adhurojë e të lartësojë Krijuesin e tij. Kjo ndihmon që të vazhdojë gjendja relaksuese edhe për një kohë pas namazit. Në thelb, njeriu në lutje i përgjërohet Zotit të tij dhe i kërkon ndihmë Atij për problemet dhe hallet që ka gjatë jetës. Ai i kërkon mbështetje dhe ndihmë Zotit, që ta nxjerrë dhe ta çlirojë nga problemet

1. *Conditioning*.

dhe hallet që e kanë mbuluar. Po kjo kujtesë e problemeve nervozuese në një gjendje të tillë (ndërkohë që është i qetë) bëhet shkak i largimit të stresit, siç e përmendëm edhe më lart tek metoda që ndiqnin psikoterapistët, duke krijuar një lidhje në mes nervozizmit dhe relaksimit. Kështu, pacienti e mënjanon stresin dhe bie në qetësi, që është e kundërta e gjendjes nervozuese. Nga ana tjetër, kur njeriu ia shpreh dikujt problemet dhe hallet e tij, gjen edhe një lehtësim në vetvete. Kjo është e njohur edhe te psikoterapistët, të cilët u kërkojnë pacientëve të tyre që të shprehin problemet dhe hallet që kanë. Tani, përfytyroni se si do të ishte gjendja, kur njeriu këto halle e probleme t'ia shprehte Zotit të tij, t'i përgjërohej, t'i lutej e t'i kërkonte mbështetje? Sa do të përmirësohej gjendja e tij?

Duhet të kemi parasysh se lutja e Allahut ul stresin. Besimtari e di që Zoti i Madhëruar ka thënë në Kur'an: **“Dhe Zotit juaj tha: Lutmuni, që t’ju përgjigjem...”**¹

“Kur robërit e Mi të pyesin për Mua, (thuaje se) Unë jam afër, i përgjigjem lutjeve të lutësit, kur ai më lutet Mua...”²

Për këtë arsye, lutja drejtuar Allahut është shkak i uljes së stresit te njeriu. Besimtari shpreson që Zoti t'ia pranojë lutjet dhe përgjërimet dhe t'ia zgjidhë problemet e tij. Pavarësisht se, a e pranon Allahu lutjen e njeriut apo jo, vetëm duke menduar se ka një mundësi pranimi nga ana e Allahut, bëhet shkak që stresi i njeriut të pësojë rënie.

Është e dukshme që stresi e bën të pamundur zgjidhjen e konflikteve mendore (psikike) te njeriu. Në parim, ai merr një pjesë të madhe nga fuqia e njeriut për ta zgjidhur këtë konflikt psikik. Për këtë arsye, të sëmurët psikikë nuk mund t'i përditësojnë në mënyrë të rregullt mundësitë dhe fuqitë e tyre. Konfliktet psikike u harxhojnë shumë energji, e kjo bëhet shkak i pafuqisë së forcave mendore dhe mundësive të tyre. Por, po këta të sëmurë psikikë, pasi shërohen dhe marrin fuqi shpirtërore, lirohen nga konfliktet psikike dhe zakonisht, shprehin energji dhe gëzim. Fuqia e tyre për të punuar dhe

1. Sure “Gafir”, ajeti 60.

2. Sure “El-Bekare”, ajeti 186.

për të vepruar shtohet më shumë. Është konstatuar se, po ai rezultat që nxirret nga një psikoterapist i suksesshëm, nxirret dhe nga namazi. Ajo ndjenjë sigurie dhe lirimi nga stresi që krijohet në namaz te njeriu, bëhet shkas i pafuqisë së forcave mendore (psikike). Këto forca më parë ishin të burgosura e të lidhura në zinxhirët e stresit dhe të shqetësimit. Si përfundim, njeriu ndien lumturi dhe freski në të gjithë qënien e tij.

Sigurisht, duhet të kemi parasysh se ndikimi i namazit është shumë më i madh sesa ndikimi i psikoterapistit. Përveç çlirimit të forcave psikike nga zinxhirët stresues, njeriu në namaz krijon edhe një lidhje shpirtërore me Zotin. Namazi i fal njeriut aq shumë forcë shpirtërore, saqë ripërtërin shpresat, forcon vullnetin etj. Këto forca e bëjnë atë që të durojë vështirësitë dhe të bëjë punë shumë të mëdha. Në të vërtetë, janë mundësi dhe fuqi madhështore, të cilat fshihen në qënien e njeriut. Njeriu, zakonisht, përdor vetëm një pjesë shumë të vogël të tyre.

Uilliam Xhejms thotë: *Nëse krahasohemi me atë që duhet të jemi, do të kuptojmë se jemi krijesa gjysmë të gjalla. E thënë ndryshe, secili nga ne, në brendësi të kufijve të vërtetë, bën jetën e tij. Njeriu ka fuqi të shumta, mirëpo zakonisht, nuk i vëren ato ose ndodh që nuk mund t'i përdorë ato.*

Po kjo lidhje shpirtërore e njeriut me Zotin, gjatë namazit, bëhet shkak i forcimit të besimit dhe të vullnetit te njeriu. Ai bëhet më i gatshëm për të pranuar dije dhe njohuri, bëhet edhe më i fuqishëm për të kryer punë më të mëdha. Mjeku francez, Aleksis Karl ka vërtetuar se namazi është shkaku i lumturisë së vërtetë shpirtërore te njeriu, është shkaku i shërimit të shpejtë të disa të sëmurë.¹

Cyril Burt, një psikolog anglez, e ka vërtetuar mendimin e Uilliam Xhejmsit (William James) rreth namazit dhe ka thënë: *Nëpërmjet namazit, ne mund të hyjmë në depon e madhe të lumturisë, me kushtet më normale.*²

1. Alexis Carrel, *El-Insan, dhalike'l-mexhhul* (Man, The Unknoën - Njeriu, kjo qenie e panjohur), botimi 3, Bejrut, 1980, f. 170-171.

2. Cyril Burt, *Ilmu'n-nefsi'd-diniy*, përkthyer nga Samir Abduh, Damask: Dar Dimashk li't-tiba'a ue'n-neshr, f. 21.

Namazi i xhumasë (i të premtës) ka një ndikim të rëndësishëm te njeriu. Vajtja dhe ardhja e tij në xhami i jep mundësi që të njihet me fqinjët dhe me banorët e tjerë të lagjes së tij. Ai krijon lidhje të reja shoqërore dhe njihet me shokë të rinj. Këto lloj lidhjesh shoqërore, jo vetëm që e ndihmojnë njeriun në zhvillimin e personalitetit, por e bëjnë atë që të jetë më aktiv edhe në gjëra të tjera. Kjo gjë e pengon stresin. Disa njerëz vuajnë për shkak të vetmisë dhe të ndarjes nga grupi. Ata ndiejnë sikur grupi (shoqëria) nuk do t'i pranojë.

Po kështu, edhe namazi i xhumasë luan një rol të rëndësishëm shërues. Falësit e namazit të ditës së premte (*xhumu'a*) dëgjojnë *hytben* (fjalimin) e namazit. Zakonisht, imami i namazit i prek disa nga problemet shoqërore. Njëkohësisht, ai mundohet që t'i shtjellojë dhe të japë rrugëdalje për to. Imami diskuton gjithashtu, edhe disa nga sjelljet e papëlqyera dhe jep rrugëdalje ose mënyra përmirësuese për njerëzit. Nuk ka dyshim se namazfalësit i ndihmon dëgjimi i këtyre hytbeve, ku përmenden problemet dhe zgjidhjet e tyre. Ata mësojnë sjellje të mira, të cilat bëhen shkak i sigurisë psikike dhe asaj shpirtërore.

Namazi i xhumasë ka ndikime parapritëse dhe shëruese. Ndikimet parapritëse të namazit të xhumasë janë: Njeriun pjesëmarrës që frekuenton xhaminë, e ndihmon që të marrë njohuri fetare. Ai i vë në praktikë këto njohuri, të cilat e drejtojnë sjelljen e tij gjatë jetës; ai fillon të sillet në mënyrë më të saktë dhe forcat i shumëfishon për përballimin e problemeve. Ndikimi i shërimit te pacienti është i lidhur me fjalimin që mbahet.

Fjalimi duhet të jetë i një niveli të lartë dhe bindës për dëgjuesin. Pacienti, nga fjalimi duhet të marrë forca dhe t'i shtohet vullneti, që t'i sundojë problemet që e mendojnë atë. Ka njerëz, të cilët pas namazit flasin me imamin rreth problemeve të tyre. Ata këshillohen edhe me udhëzimet që imami u jep. Namazi me xhemat, e veçanërisht, namazi i xhumasë, ndikojnë mjaftueshëm në krijimin e personalitetit të njeriut. Ai njëkohësisht është një shërues i suksesshëm.

Klapmani dhe psikologë të tjerë i janë futur një metode, e cila quhet "Trajtimi psikologjik në grup"¹, për të ngritur pikëpamjet e problemeve dhe kundërshtimet psikike të të sëmurëve. Mekanizmat, informacionet dhe fjalimet e tjera, që i përdorën te të sëmurët psikikë, i ndihmuan ata që ta realizojnë këtë metodë. Është mëse e qartë se ky lloj trajtimi psikoterapeutik në grup, në thelb është i ngjashëm me unikimin e fjalimit (*hytbes*) të namazit të ditës së xhuma. Kjo hytbe është shërim ose parapritë e disa problemeve psikike. Namazi i ditës së xhuma, në të shumtën e rasteve, ndikon në ndalimin e stresit te njerëzit.²

Është edhe një pikë tjetër e rëndësishme. Trajtimi i sëmundjeve psikologjike zakonisht bëhet pasi të shkaktohen ato sëmundje, ndërsa namazi, veçanërisht namazi i xhumasë, i mbron njerëzit nga të qenët të sëmurë psikikë. Pa dyshim, mbrojtja është më e mirë se ilaçi. Për këtë, namazi nuk krahasohet me trajtimin psikik. Në ditët tona, disa psikologë orientohen kah mbrojtja nga sëmundjet, ashtu siç e përmenda më sipër.

Një tjetër çështje, e cila i ndihmon njerëzit për largimin e stresit është abdesi. Abdesi, duke qenë si parahyrës për në namaz, jo vetëm që bëhet shkak i pastrimit të trupit nga papastërtitë, por ai njëkohësisht pastron edhe shpirtin. Me marrjen e abdesit (me kusht që ai të kryhet në rregull), besimtari ndien se trupi dhe shpirti i tij janë pastruar nga papastërtitë, nga gjynahet dhe nga tundimet. Kjo ndjesi pastërtie trupore dhe shpirtërore e përgatit njeriun në namaz, për një lidhje shpirtërore me Zotin. Abdesi ka edhe ndikim fiziologjik. Disa shkrimtarë dhe mjekë e kanë përmendur një gjë të tillë.³

1. Robert Harber, *Et-Tehlilu'n-nefsij ue'l-ilaxhu'n-nefsij*, përkthyer nga Said Xhelal, f. 209-210.

2. Por, kohët e fundit, kjo gjë po rrallohet. Shkaku është se imamët e namazit nuk janë shumë të përgatitur. Është e nevojshme që imamët e namazit të xhumasë të përgatiten, që të mund t'i udhëheqin njerëzit jo vetëm nga ana fetare, por edhe nga anë të tjera, si: shoqërore, ekonomike dhe kulturore.

3. Xhemal Madi Ebu'l Azaim, *El-Kur'an ue ilmu'n-nefs*, (Konferenca "Ilmu'n-nefs ue'l-Islam"), Fakulteti i Shkencave të Edukimit në Universitetin e Rijadit, vëll. I, 1978.

Është vërtetuar se larja e disa pjesëve të trupit çdo ditë, nga pesë herë dhe me hapësirë kohore të caktuar, bëhet shkak i qetësimit dhe i çlodhjes së muskujve, i normalizimit të tensionit trupor dhe psikik të njeriut. Shohim se në një hadith, Profeti Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*) ka porositur që njeriu në kohën kur është i nxehur, të marrë abdes, duke thënë: “Kur të nxehesh merr abdes!”¹

3-2. Agjërimi

Nga pikëpamja psikologjike, agjërimi ka shumë efekte pozitive të njeriut. Ai bëhet shkak i edukimit dhe i kontrollit të egos (vetes). Gjithashtu, është shërues i shumë sëmundjeve shpirtërore dhe trupore. Mosngrënia dhe mospirja për një kohë të caktuar (nga syfyri deri në iftar) është një lloj ushtrimi dhe një lloj përmbajtjeje nga dëshirat. Agjërimi bën që njeriu të dijë të kontrollojë dhe të sundojë dëshirat e egos së tij. Duke u treguar i matur në dëshirat e egos, fryma e devotshmërisë hyn tek njeriu.

“O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm.”²

Kjo do të thotë se kështu do të kujdeseni që të mos bëni gjynahe. Agjërimi i thyen epshet, të cilat janë burim i gjynaheve.³

Në një hadith të Profetit Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*) thuhet: “Agjërimi është si mbrojtës. Sa herë që ndonjëri prej jush të jetë agjërueshëm, duhet që t’i agjërojë edhe goja, edhe sytë, edhe trupi. Nëse dikush kërkon të grindet me të, le të thotë: ‘Unë agjëroj’. Betohe në Atë, në dorën e Fuqisë së të Cilit është shpirti i Muhamedit (*paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*), se aroma e agjëruarit është me e këndshme tek Allahu, sesa

1. Usama Muhamed Er-Radi, *El-Islam ue emradu’l-asr* (Konferenca “Ilmu’n-nefs ue’l-Islam”), Fakulteti i Shkencave të Edukimit në Universitetin e Rijadit, vëll. I, 1978.

2. Sure “El-Bekare”, 183.

3. *Tefsiru’l-Xhelalejn*, f.25.

aroma e miskut. Agjëruesi që e lë të ngrënët, të pirët dhe epshin e tij për Mua, Unë ia jap Vetë shpërblimin e tij. Çdo vepër e mirë shpërblehet dhjetëfish.”¹

Vazhdimësia e ushtrimeve gjatë një muaji, për të kontrolluar epshin dhe për t’u bërë sundues i tij, bëhet shkak i forcimit të vullnetit të njeriut. Ai mund të mësojë sjellje të tjera të drejta. Ai merr edhe përgjegjësi të reja e i kryen ato në formën më të mirë.

Agjërimi e bën njeriun që të jetë i përmbajtur dhe i duruar përpara urisë, etjes dhe epsheve. Durimin, të cilin e mëson në agjërim, e përdor edhe në anë të tjera të jetës së tij. Në parim, durimi është nga virtytet e shumëpëlqyera. Allahu urdhëron që njeriu ta stolisë veten e tij me këtë cilësi të bukur. Durimi është miku më i mirë i njeriut në kapërcimin e vështirësive të jetës. Lufta me *nefsin* (egon), përmbajtja ndaj dëshirave dhe epsheve janë rezultat i durimit.

Një nga mirësitë psikike që ka agjërimi, është se njeriu ndien edhe mëshirë për të tjerët. Ai, duke qenë agjërueshëm, e ndien urinë dhe provon se çfarë ndiejnë të varfrit dhe nevojtarët. Kështu, ai hedh hapin për të bërë mirë te nevojtarët. Kjo gjë e forcon shpirtin e njeriut.

Agjërimi ka edhe shumë mirësi trupore. Është e njohur se shëndeti trupor i njeriut ndikon edhe në shëndetin e tij psikik.

3-3. Zekati

Në fenë islame, një nga detyrat (kushtet) është edhe *zekati*. Ai është i detyrueshëm për myslimanët. Çdo vit, një pjesë të caktuar të pasurisë tyre, ata ia japin të varfërve dhe nevojtarëve. Zekati i forcon lidhjet me të varfrit dhe nevojtarët. Njeriu përballet me përgjegjësi dhe ua kthen lumturinë të tjerëve. Detyrimi i zekatit u mëson myslimanëve llojin e shoqërisë dhe njeriun e shpëton nga koprracia dhe egoizmi. Njeriu i gjen forcat të dashuria, të bërit mirë ndaj njerëzve dhe të përpjekjet që ai bën për lumturinë e të tjerëve.

1. Es-Sejjid Sabik, *Fik’hu’s-Sunneh*, vëll.1, Bejrut, Daru’l-kitabi’l-arabij, pa datë, f. 431.

Kështu forcohen ndjenjat ndaj shoqërisë, gjë që e kënaq njeriun. Ndjenja të tilla kanë shumë rëndësi për shëndetin. Kur'ani thotë për dhënien e sadakasë, se është shkak i pastrimit dhe i kontrollit të *nefsit* (egos).

“Merr nga pasuria e tyre lëmoshë me të cilën t’i pastrosh ata dhe t’ua rrisësh veprat e mira! Lutu për ta, sepse lutja jote është vërtet qetësim për ata. Allahu dëgjon dhe di gjithçka.”¹

Prandaj, zekati e pastron shpirtin e njeriut nga të gjitha papastërtitë, koprracia dhe egoizmi. Zekati zhvillon shpirtin e njeriut. Ai i jep atij mirësi dhe begati. Në praktikë, zekati bën që njeriu të përparojë. Të gjitha këto mirësi, që i marrim prej dhënies së zekatit, janë e ardhmja e lumturisë në këtë botë dhe në Ahiret.²

Profetin e nderuar (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*), e pyeti një burrë nga fisi Temim, për mënyrën e harxhimit të parave. Ai (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*), tha: “Jepe zekatin e pasurisë tënde. Zekati është shkak i pastërtisë tënde dhe bëhet shkak që të afërmit e tu të krijojnë lidhje me ty. Gjithashtu, zekati bëhet shkak që ti të njohësh nevojën e nevojtarit dhe të të varfrit.”³

3-4. Haxhi

Haxhi ka shumë mirësi sa i përket anës psikologjike. Vizita në Shtëpinë e Zotit, në Mekën e Shenjtë, në xhaminë dhe në varrin e Profetit të nderuar (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*), në Medinë, vende, në të cilat është zbritur Shpallja, si dhe kujtimet e punëmirëve në fillimet e Islamit, u fal forcë të madhe myslimanëve. Kjo forcë i ndihmon ata që të përballojnë mundimet në jetën e tyre.

Kryerja e *haxhit* është një mënyrë ushtruese për të duruar vështirësitë. Haxhiu i heq të gjitha rrobat e mburrjes nga trupi i tij dhe vesh rrobat e thjeshtësisë (*Ihramin*).

Këtë rit e kryejnë në mënyrë të njëjtë, si të pasurit, ashtu

1. Sure “Et-Teube”, 103.

2. Es-Sejjid Sabik, *Fik’hu’s-Sunneh*, f. 328.

3. I njëjti burim.

edhe të varfrit. Kështu forcohen marrëdhëniet midis të gjithë vëllezërve myslimanë, të cilët mund të jenë nga raca, popuj dhe shtresa të ndryshme shoqërore. Të gjithë haxhinjtë mbledhen në të njëjtin vend. Ata, në këtë vend adhurojnë dhe i luten Zotit të Madhëruar. Ky takim i madh i myslimanëve nga vende të ndryshme është një mundësi që ata të familjarizohen e të krijojnë marrëdhënie miqësore me njëri-tjetrin. Kryerja e haxhit është një lloj ushtrimi për të forcuar shpirtin dhe për të qenë sundues i epsheve dhe i dëshirave egoiste. Personi që vesh *ihramin* e ka të ndaluar kryerjen e disa veprave, si: kryerjen e marrëdhënieve intime, të tregojë armiqësi ndaj dikujt, të shajë e të fyejë të tjerët etj. Shkurtimisht, janë të ndaluara të gjitha veprat, të cilat e çojnë njeriun në gjynah.

Kryerja e haxhit e mëson njeriun që të ketë një komunikim të mirë me të tjerët dhe e ndihmon të jetë i suksesshëm.

“Koha e haxhillëkut është në muaj të caktuar. Kush vendos të kryejë haxhillëkun, le të largohet nga marrëdhëniet (me gruan), grindjet dhe sharjet. Ndërkaq, çdo vepër të mirë që bëni, Allahu e di. Pajisuni me gjërat që ju nevojiten për rrugë dhe dijeni se pajisja më e mirë është devotshmëria. Prandaj, kini frikë prej Meje, o njerëz të mençur”¹

Sipas ajetit, haxhi është luftë me egon. Lufta me egon bën që njeriu të jetë i pastruar. Kryerja e haxhit bën që njeriu të jetë indiferent përballë kërkesave dhe dëshirave egoiste.

Është transmetuar se pranë Profetit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*) erdhi një njeri dhe i tha: *Unë jam një njeri frikacak dhe i dobët*. Profeti (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*) i tha: *“Shko në një luftë, e cila nuk ka asnjë vështirësi. Ai është haxhi.”²*

Thuhet se një person që kryen haxhin dhe nuk bën korrupsion morali, në kohën kur kthehet nga haxhi, është njëlloj sikur të ketë lindur sërish. Profeti (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*), ka thënë:

“Haxhin dhe urren kryejini njëra pas tjetrës. Ato bëjnë që

1. Sure “El-Bekare”, 197.

2. Es-Sejjid Sabik, *Fik’hu’s-Sunneh*, f. 626.

njeriu të pastrohet nga gjynahet. E, shpërblimi i haxhit nuk është vetëm Xheneti.”¹

Pa dyshim, Haxhi është shkak i faljes së gjynaheve. Haxhiu kthehet me zemër të gëzuar, i buzëqeshur, si dhe, duke u ndier i sigurt. Ai nuk ndien asnjë lloj problemi dhe vështirësie në jetën e tij dhe kthehet pa pasur stres, nervozizëm a shqetësime të tjera.

4. Durimi

Kur'ani i fton njerëzit në durim. Durimi ka shumë mirësi. Për të forcuar shpirtin, duhet të bësh durim. Durimi ndikon në personalitetin e njeriut. Ai i shton mundësitë dhe fuqitë e njeriut përpara vështirësive që has gjatë jetës.

“Kërkoni ndihmën e Allahut me durim e me namaz! Kjo është njëmend e vështirë, përveçse për të devotshmit”²

“O besimtarë! Kërkoni ndihmë për veten nëpërmjet durimit dhe namazit! Në të vërtetë, Allahu është me të duruarit.”³

“O besimtarë! Bëhuni të durueshëm dhe nxiteni njëri-tjetrin të jeni të tillë; bëhuni të vendosur dhe vigjilentë (në vepra të mira dhe në ruajtjen e kufijve) dhe kijeni frikë Allahun, që të shpëtoni!”⁴

Parimisht, besimtari durimtar nuk shfaq pamundësi përpara problemeve apo mundimeve, të cilat i ndodhin gjatë fatkeqësive. Zoti e ka urdhëruar njeriun për durim, sepse kjo botë është një sprovë për të njohur besimtarët durimtarë.

“Ne do t’ju vëmë në provë ju, derisa t’i njohim ata midis jush, që luftojnë (në rrugën e drejtë) dhe durojnë, e derisa të provojmë ato që thuhet për veprat tuaja.”⁵

“Sigurisht që Ne do t’ju provojmë me frikë dhe uri, me dëmtim të pasurisë, të njerëzve dhe të të lashtave! Prandaj, përgëzoji të duruarit, të cilët, kur i godet ndonjë fatkeqësi

1. I njëjti burim, f. 626-627.

2. Sure “El-Bekare”, 45.

3. Sure “El-Bekare”, 153.

4. Sure “Ali Imran”, 200.

5. Sure “Muhamed”, 31.

thonë: "Të Allahut jemi dhe vetëm tek Ai do të kthehemi!" Ata do të shpërblehen me bekim dhe mëshirë nga Zoti i tyre; ata janë në rrugën e drejtë!"¹

"Ju, me siguri, do të sprovoheni në pasurinë e në jetën tuaj dhe do të dëgjoni shumë fyerje nga popujt që i u është dhënë Libri para jush, si dhe nga paganët. Por, nëse ju duroni dhe ruheni (nga të këqijat), atëherë kjo është vërtet përcaktuese e çështjeve."²

Përgjithësisht, durimi është një virtutet i pëlqyer te besimtarët. Zoti e ka përmendur shumë herë në Kur'an, në çështje të ndryshme.

"E kush mund të ta shpjegojë ty se ç'është rruga e vështirë? Ajo është të lirosh një skllav, ose të ushqesh në një ditë zie jetimin e afërm; Ose të varfrin e mjerë. Veç kësaj, (njeriu duhet) të jetë nga ata që besojnë, që e këshillojnë njëri-tjetrit për durim dhe e këshillojnë për mëshirë. Këta janë njerëzit e krahut të djathtë."³

"Me emrin e Allahut të Gjithmëshirshmit, Mëshirëplotit. Pasha kohën! Me të vërtetë, njeriu është në humbje: "Përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, i këshillojnë njëri-tjetrit të vërtetën e i këshillojnë njëri-tjetrit durimin."⁴

"Mirësia nuk është të kthyerit e fytyrës suaj nga lindja dhe perëndimi, por mirësia është (cilësi) e atij që beson Allahun, Ditën e Fundit, engjëjt, Librin dhe profetët; e atij që me vullnet jep nga pasuria e vet për të afërmit, jetimët, të varfrit, udhëtarët e mbetur rrugës, lypësit dhe për lirim të robëruarve; e atij që fal namazin dhe e jep zeqatin; dhe e atyre që i plotësojnë premtimet, kur marrin përsipër diçka; e atyre që durojnë në kohë skamjeje, sëmundjeje dhe lufte. Këta janë besimtarët e vërtetë dhe këta janë ata që e kanë frikë Allahun."⁵

Të duruarit i mëson njeriut që të dijë si t'i kapërcejë punët

1. Sure "El-Bekare", 155-157.

2. Sure "Ali Imran", 186.

3. Sure "El-Beled", 12-18.

4. Sure "El-Asr".

5. Sure "El-Bekare", 177.

e vështira, qofshin praktike apo teorike, dhe të arrijë qëllimet e veta. Njeriut, për të arritur qëllimet e tij, qofshin ato shoqërore, ekonomike, politike etj., i nevojitet kohë dhe përpjekje e madhe. Për këtë arsye duhet të tregojë durim. Durimi, me të vërtetë, ka lidhje edhe me vullnetin e njeriut. Kështu, njeriu i duruar është edhe një person me vullnet të fuqishëm. Sa herë që përplasat me vështirësi dhe pengesa, ai nuk dorëzohet e as nuk i heq shpresat. Njeriu me vullnet mund të kryejë punë të mëdha. Ai mund t'i arrijë qëllimet e tij të larta, duke pasur durim dhe vullnet.

“O Profet! Jepu zemër e nxiti besimtarët për luftë! Nëse mes jush gjenden njëzet të qëndrueshëm, ata do të mundin dyqind (mohues) e, nëse nga ju janë njëqind të qëndrueshëm, ata do të mundin një mijë mohues, sepse ata janë njerëz që nuk kuptojnë”¹

Njeriu i duruar, i cili i mbështetet Allahut e i bindet Atij, ka fuqi që t'i kapërcejë pa pasur vështirësi problemet dhe armiqësitë, të cilat mund t'i hasë gjatë jetës. Me durim, ai i arrin qëllimet e tij, bëhet njeri që di ta kontrollojë egon e tij.

5. Përmendja

Përmendja e Allahut nga besimtarët në *tesbih* (*Subhanallah, Elhamdulillah, La ilahe il'Allah*, dhe *All'illahu Ekber*), kërkimi i faljes, lutja dhe leximi i Kur'anit bëjnë që në të vërtetë, njeriu ta pastrojë shpirtin e tij. Ai ndien siguri në vetvete dhe qetësi psikologjike.

“Ata që besojnë dhe zemrat e të cilëve, kur përmendet Allahu, qetësohen. Vërtet, zemrat qetësohen me përmendjen e Allahut!”²

“Prandaj duroje (o Muhamed) atë që thonë ata dhe lavdëroje me falënderim Zotin tënd para lindjes së Diellit dhe para perëndimit të tij! Lavdëroje Atë edhe në orët e natës, edhe në skajet e ditës, që të mund të kënaqesh.”³

“Ne shpallim nga Kur'ani atë që është shërim dhe

1. Sure “El-Enfal”, 65.

2. Sure “Er-Ra’d”, 28.

3. Sure “Ta ha”, 130.

mëshirë për besimtarët e që mohuesve keqbërës u shton vetëm humbje.”¹

Profeti Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*) ka thënë: “Përmendja e Allahut bëhet shkak i shërimit të zemrave.”²

Gjithashtu, ka thënë: “Nuk mblidhet një grup e të mos përmendet Allahu në bisedat e tyre. Melekët zbresin në mesin e tyre dhe dërgojnë mëshirë e qetësi në zemrat e tyre. Allahu, gjithmonë i kujton ata.”³

Kur njeriu e përmend Zotin, ndien se është më pranë Tij. Ai në ato momente ndien se i Vetmi Mbështetës dhe Kujdestar është vetëm Allahu. Allahu në Kur'an thotë: **“Prandaj, më kujtoni Mua (me namaz e lutje) që Unë t’ju kujtoj (me shpërblime) dhe falënderomëni Mua (duke M’u bindur) e mos i mohoni dhuntitë e Mia (me mosbindje)!”⁴**

Profeti i nderuar (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*) ka thënë: “Zoti ka thënë se kur robi Im lëviz buzët për të më përmendur Mua, Unë jam me të.”⁵

Profeti (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*) ka thënë: “Kujtojeni Allahun dhe lexojeni Kur'anin. Këto janë për ty forcë në tokë dhe kujtim në qiell.”⁶

Përmendja e Allahut largon çdo lloj stresi dhe mundimi shpirtëror. Njeriu largohet nga vetmia dhe nuk i ndien vështirësitë, pasi një tjetër forcë e sundon atë.

“Kushdo që i kthen shpinën Këshillës Sime, do të ketë jetë të mjeruar dhe Ne, në Ditën e Kiametit, do ta ringjallim të verbër.”⁷

“Lexo (o Muhamed) atë që të është zbritur ty prej Librit

1. Sure “El-Isra”, 82.

2. Këtë transmetim e transmeton Dejlëmiu nga Enesi. Marrë nga: Hasan Muhamed Esh-Sharkaui, *Nahue ilmi nefsini islamijjin*, Aleksandri, El-Hej’etu’l-Misrije li’l-Kitab, f. 300.

3. Këtë transmetim e transmeton Ibn Maxheh nga Ibn Saidi. Marrë nga: Hasan Muhamed Esh-Sharkaui, i njëjti burim, f. 299.

4. Sure “El-Bekare”, 152.

5. Këtë transmetim e transmeton Imam Sha’rani në *Keshfu’l-Ghummeh*. Marrë nga: Hasan Muhamed Esh-Sharkaui, i njëjti burim, f. 299.

6. Këtë transmetim e transmeton Ebu Ja’la nga Ebu Saidi. Marrë nga: Hasan Muhamed Esh-Sharkaui, i njëjti burim, f. 33.

7. Sure “Ta ha”, 124.

(Kur'anit) dhe fale namazin! Vërtet që namazi të ruan nga shthurja dhe nga çdo vepër e shëmtuar dhe vërtet që përmendja e Allahut është më e madhe! Allahu di gjithçka që ju bëni."¹

Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), gjithmonë e përmendte Allahun. Ai (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) porosiste për përmendjen e Tij. Pas çdo namazi, ai kërkonte falje dhe bënte tesbih, e falënderonte dhe e madhëronte Allahun gjithnjë. Rreth namazit, Allahu thotë: **"Me të vërtetë, Unë jam Allahu, s'ka zot tjetër përveç Meje, prandaj, vetëm Mua më adhuro dhe kryej faljen për të më kujtuar Mua."**²

Në të vërtetë, edhe agjërimi është bindje ndaj Allahut, largim nga zemërimi i Tij, madhërim i Tij dhe falënderim për udhëzimin e njeriut. Të gjitha këto janë përmendje (*dhikr*). Allahu i lartësuar thotë rreth agjëritit:

"...Ai dëshiron që të plotësoni numrin e ditëve të agjëritit dhe që ta madhëroni Allahun (në fund të agjëritit), për shkak se ju ka drejtuar në rrugë të drejtë e që ta falënderoni Atë."³

Gjithashtu, edhe në *haxh* muslimani ia përkushton veten namazit, lutjes dhe përgjëritit ndaj Allahut duke bërë ritualet e *haxhit*. Edhe kjo është nga kuptimet e përmendjes (*dhikr*). Allahu i lartësuar thotë rreth Haxhit:

"Thirri njerëzit për haxhillëk: ata do të vijnë në këmbë dhe me deve prej të gjitha viseve të largëta, që të dëshmojnë dobitë e tyre dhe të përmendin Emrin e Allahut në ditët e caktuara mbi kafshët (për kurban), të cilat ua ka dhuruar Ai..."⁴

Edhe për hedhjen e guralecëve (*remju'l-xhemerat*) thotë:

"Dhe madhëroni Allahun në (tre) ditët e caktuara (të Teshrikut)..."⁵

Besimtari që dëshiron të afrohet sa më pranë Allahut, nuk mjaftohet me përmendjen e Tij vetëm në kohët e namazit. Ai e

1. Sure "El-Ankebut", 45.

2. Sure "Ta ha", 14.

3. Sure "El-Bekare", 185.

4. Sure "El-Haxh", 27-28.

5. Sure "El-Bekare", 203.

përmend Allahun në çdo moment, duke u lutur apo duke bërë tesbih. Edhe pse është duke bërë ndonjë vepër tjetër, ai nuk harron që ta përkujtojë Krijuesin e vet. Duke u lutur a duke lexuar Kur'an, ai gjen sigurinë dhe qetësinë e tij shpirtërore.

6. Pendimi

Ndjenja e gjynahut, është shkak që njeriu të ndiejë mangësi dhe stres. Kjo ndjenjë shndërrohet gradualisht në sëmundje psikike. Psikoterapisti, në raste të tilla, kujdeset që të ndryshojë temat, të cilat kanë të bëjnë me të kaluarën e tij. Kështu, ai bën që pacienti i tij t'i kushtojë vëmendje më shumë gjërave të reja, të cilat nuk kanë lidhje me gjynahet e tij, që ai të mos ndihet fajtor dhe të mos ndiejë mangësi në vetvete. Pacienti fillon ta pranojë veten e tij dhe bëhet gati që t'i eliminojë stresin dhe shkaqet e sëmundjeve psikike.

Kur'aninaetregonmësëmirimetodënpazëvendësueshme dhe të suksesshme të pendimit, për shërimin e ndjenjës së fajit. Pendimi ose kthimi tek Allahu i Madhëruar, është shkak i faljes së gjynaheve dhe i forcimit të shpresës te njeriu. Për këtë arsye, ulet edhe stresi te njeriu. Zakonisht, pendimi te njeriu ndikon në përmirësimin e personalitetit. Pendimi e përgatit atë që të mos përzihet në kryerjen e gjynaheve herë tjetër. Kjo bën që ai t'ia dijë vlerën vetes, ta njohë dhe t'i besojë vetvetes.

"Thuaj: "O robtë e Mi, që i keni bërë keq vetes me gjynahe, mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut! Allahu, me siguri, i fal të gjitha gjynahet. Vërtet, Ai është Falësi i madh dhe Mëshirëploti.""¹

"Kush punon vepër të keqe ose e ngarkon veten me gjynahe, pastaj kërkon falje prej Allahut, do të gjejë se Allahu është Falës e Mëshirëplotë.""²

"Vërtet, Allahu nuk fal që të adhurohet dikush apo diçka tjetër veç Atij, por gjynahet e tjera më të vogla ia fal kujt të dojë..."³

"Allahu është pranues i pendimit vetëm për ata që

1. Sure "Ez-Zumer", 53

2. Sure "En-Nisa", 110.

3. Sure "En-Nisa", 48.

bëjnë ndonjë të keqe nga padituria dhe pendohen shpejt. Pra, këtyre Allahu ua pranon pendimin. Allahu është i Gjithëdijshtëm dhe i Urtë.”¹

“Ndërsa atij që pendohet pas të këqijave të tij dhe përmirësohet, Allahu ia pranon pendimin, sepse Ai është vërtet Falës dhe Mëshirëplotë.”²

“Kur të vijnë te ti ata që besojnë në shpalljet Tona, thuaj: “Paqja qoftë mbi ju!” Zoti juaj ia ka bërë detyrim Vetes mëshirën. Nëse dikush nga ju bën ndonjë vepër të keqe pa e ditur, e pastaj pendohet e përmirësohet, ai do ta gjejë Allahun Falës dhe Mëshirues.”³

“Vërtet, Unë jam Falës për atë që pendohet, beson e bën vepra të mira dhe pastaj qëndron në rrugë të drejtë.”⁴

“Ndërsa ata që kryejnë vepra të këqija e pastaj pendohen dhe bëhen besimtarë, ta dinë se pas kësaj, Zoti yt është vërtet Falës e Mëshirëplotë.”⁵

Ne besojmë se Allahu i Madhëruar është Pendimpranues dhe Falës gjynahesh. Ai kurrë nuk vepron në kundërshtim me atë që premt. Ai i fton myslimanët që të pendohen dhe të kërkojnë falje për gjynahet e tyre, duke u dhënë atyre myzhde për falje dhe kënaqësi. Në kohën kur një mysliman pendohet me pastërti, kur i bindet dhe e adhuron Allahun, kur fillon të bëjë vepra të mira, shpirti i tij qetësohet. Përfundimisht, ndjenja e fajtorit, e cila ishte shkak i stresit dhe e shqetësimeve, zhduket prej tij.

Për këtë arsye edhe Kur'ani ka përdorur metoda të ndryshme për të shëruar sëmundjet psikike. Disa nga metodat e tij janë:

1- ngulitja e besimit në shpirt dhe mbjellja e devotshmërisë në zemër. Ne e dimë se sa rëndësi ka kjo gjë dhe se çfarë përfundimi të rëndësishëm ka në personalitetin e njeriut;

2- bërja detyrim e adhurimeve të ndryshme. Këto

1. Sure “En-Nisa”, 17.

2. Sure “El-Maide”, 39.

3. Sure “El-En’am”, 54.

4. Sure “Ta ha”, 82.

5. Sure “El-A’raf”, 153.

adhurime janë shkak i largimit të njeriut nga shumë vese të këqija. Ato e zbukurojnë njeriun me virtyte të mira, që e ndihmojnë në rritjen e personalitetit;

3- inkurajimi i njeriut në durim. Njeriu ndihmohet duke duruar që të kapërcejë vështirësitë e jetës;

4- inkurajimi në vazhdimësinë e përmendjes së Allahut. Kjo gjë bën që njeriu të ndihet më pranë Zotit. Ai e lë veten e tij në mbrojtjen dhe në përkujdesjen e Allahut. Përfundimi është ndjesia e sigurisë dhe e qetësisë shpirtërore;

5- inkurajimi i myslimanëve për t'u penduar dhe për të kërkuar falje.

Kur'ani, duke përdorur këto metoda, pati sukses. Ai i shëroi dobësitë e njerëzve dhe u fali atyre virtyte të pëlqyera, të cilat i kanë dhënë personalitetit të njeriut sukses të lartë.

Në fund themi se ndikimin më të madh në të gjitha drejtimet e jetës së shoqërisë sonë, e ka **KUR'ANI**.

Burime bibliografike

Literaturë arabe:

1. Kur'ani famëlartë.
2. Ibrahim Desuki Mer'ij, *Et-Tufuleh fi'l-Islam*, Kajro, Daru'l-I'tisam, 1979.
3. Ebu'l-Hasen Muslim ibn Haxhaxh ibn Muslim El-Kushejri, *Sahihu Muslim bi Sherhi'n-Nevevij*, Kajro, El-Matba'atu'l-Misrijeh ue Mektebetuha, pa datë.
4. Ebu'l-Fadl Shihabuddin Es-Sejjid Mahmud El-Alusij El-Bagdadij, *Ruhu'l-Me'anih fi Tefsiri'l-Kur'an*, Kajro, El-Matbaatu'l-Emirijeh bi Bulak, 1301 h.
5. Ebu'l-Kasim El-Hasen ibn Muhammed El-Mufaddal Er-Ragib El-Isfahanij, *Tefsijlu'n-Nesh'atejn ue Tahsijlu's-Se'adetejn*, Bejrut, 1319 h, pa emër botuesi.
6. Ebu Hamid Muhammed ibn Muhammed El-Gazalij, *Me'arixhu'l-Kuds fi Medarixhi Ma'rifeti'n-Nefs*, botimi i dytë, Bejrut, Daru'l-Afaki'l-Xhedideh, 1975.
7. Ebu Hamid Muhammed ibn Muhammed El-Gazalij, *Ihjau 'Ulumi'd-Dijn*, Kajro, Daru'sh-Sha'b, pa datë.
8. Ebu Abdil'lah Muhammed ibn Ahmed El-Ensarij el-Kurtubij, *El-Xhami'u li Ahkami'l-Kur'an*, Kajro, Daru'l-Katibi'l-Arabij li't-Tiba'ati ue'n-Neshr, 1967.
9. Ebu Muhammed Ali bin Ahmed bin Sa'id bin Hazm bin Galib, *El-Akhlak ue's-Sejr fi Mudauati'n-Nufus*, Bejrut, Daru'l-Afaki'l-Xhedideh, 1978.
10. Ahmed Muhammed Xhemal, *Nahue terbijetin islamijeh*, Xheddah, Tuhama, 1980.
11. Ahmed Muhammed Faris, *En-Nemadhixhu'l-insanijeh fi'l-Kur'ani'l-Kerijm*, Bejrut, Daru'l-Fikr, pa datë.
12. Erich Fromm, *Ed-dijnu ue't-tahlilu'n-nefsij*, përkthim i Fuad

Kamilit, Kajro, Mektebetu Garijb, 1977.

13. Usama Muhammed Er-Radi, *El-Islam ue emradu'l-asr* (Konferenca "Ilmu'n-nefs ue'l-Islam"), Fakulteti i Edukimit në Universitetin e Rijadit (botim i daktilografuar), vëll. I, 1978.

14. Enuer El-Xhundi, *Mefahimu'l-ulumi'l-ixhtimaijeh ue'n-nefs ue'l-akhlak fi dau'i'l-Islam*, Kajro: Daru'l-I'tisam, 1977.

15. El-Behij el-Khaulij, *Adem (a.s.) felsefetu takuimi'l-insan ue khilafetihi*, botimi i tretë, Kajro: Daru'l-I'tisam, 1977.

16. El-Hafidh Ebu'l-Fadl Shihabuddin Ahmed bin Ali bin Muhammed El-Askalanij Esh-Shafi'ij, *Fet'hu'l-Barij bi sherhi Sahihi'l-Buharij*, Kajro: Mektebetu'l-kulijjati'l-ez'herije, 1978.

17. El-Hafidh El-Mundhirij, *Mukhtesaru Sahihi Muslim*, me recensën e Muhammed Nasiruddin El-Albanit, botimi i tretë, Bejrut: EL-Mektebu'l-Islamij, 1977.

18. El-Hafidh 'Imaduddin Ebu'l-Fida Ismail ibn Kethir El-Kureshij Ed-Dimeshkij, *Tefsiru'l-Kur'ani'l-Adhijm*, Kajro: Daru Ihjai'l-Kutubi'l-Arabijje i Isa El-Babij El-Halebij dhe ortakëve të tij, pa datë; gjithashtu, Bejrut: Daru'l-Ma'rifeh, 1980.

19. Es-Sejjid Sabik, *Fik'hu's-Sunneh*, vëll.1, Bejrut, Daru'l-Kitabi'l-Arabij, pa datë.

20. Alexis Carrel, *El-Insan, dhalike'l-mexhhul (Man, The Unknown)*, përkthyer në arabisht nga Shefik Es'ad Ferid, Bejrut: Daru'l-Me'arif, 1980.

21. Xhelaluddin Muhammed ibn Ahmed El-Mahal'li dhe Xhelaluddin Abdurrahman bin Ebi Bekr Es-Sujutij, *El-Kur'anul-Kerijm Tefsiru'l-Xhelalejn*, Bejrut: Daru'l-Kutubi'd-Dinijeh, pa datë.

22. *El-Muntekheb fi Tefsiri'l-Kur'ani'l-Kerim*, Këshilli i Lartë për Çështjet Islame në Ministrinë e Vakëfeve në Republikën Arabe të Egjiptit, botimi i shtatë, 1979.

23. Xhemal Madi Ebu'l-Azaim, *El-Kur'an ue ilmu'n-nefs*, (Konferenca "Ilmu'n-nefs ue'l-Islam"), Fakulteti i Shkencave të Edukimit në Universitetin e Rijadit (botim i daktilografuar), vëll. I, 1978.

24. Zhuljen Ruter, *Ilmu'n-nefsi'l-ikliniki* (Psikologjia klinike),

përkthim i Atije Mahmud Hanna, redaktim i Muhamed Uthman Nexhatit, Kuvajt: Daru'l-KAlem, 1977.

25. Mustafa Er-Rafi'ij, *El-Islam ue mushkilatu'l-asr*, Bejrut, Daru'l-Kitabi'l-Lubnanij, 1972.

26. Hamid Abdulaziz El-Fakij, *Dirasatun fi sejkuluxhijeti'n-numuw*, Kuvajt, 1977.

27. Hasan Muhamed Esh-Sharkaui, *Nahue ilmi nefsin islamijjin*, Aleksandri: El-Hej'etu'l-Misrijetu'l-Ammeh li'l-Kitab, pa datë.

28. Dale Carnegie, *Da'i'l-kalak uebde'il-hajat (Lëri mënjanë shqetësime dhe fillo jetën!)*, përkthim i Abdul Mun'im Ez-Zijadit, botimi i pestë, Kajro: Mektebetu'l-Khanegi, 1956.

29. Robert Harber, *Et-Tehlilu'n-nefsij ue'l-ilaxhu'n-nefsij*, përkthyer nga Sa'd Xhelal, Kajro: El-Hej'etu'l-Misrijetu'l-Ammeh li'l-Kitab, 1974.

30. Richard. S.Lazarus, *Esh-Shekhsije (Personaliteti)*, përkthimi i Sejjid Muhamed Gunejm, redaktor krahasues Muhamed Uthman Nexhati, Bejrut, Daru'sh-Shuruk, 1981.

31. Richard M. Swain: *Ilmu'l-emradi'n-nefsije ue'l-aklije*, përkthim i Ahmed Abdul Azijz Selame, Kajro: Daru'n-Nahdati'l-Arabijeh, 1979.

32. Sarnoff A. Mednick, Howard R. Pollio, Elizabeth F. Loftus, *Et-Te'al'lum (Learning)*, përkthim i Imaduddin Ismailit, redaktim i Muhamed Uthman Nexhatit, Bejrut, Daru'sh-Shuruk, 1981.

33. Said Haula, *Terbijetuna'r-Ruhijeh*, botimi i dytë, Kajro, Mektebetu Uehbeh, 1979.

34. Zigmund Frojd, *Me'alimu't-tehlili'n-nefsij*, përkthim i Muhamed Uthman Nexhatit, botimi i katërt, Kajro: Daru'n-Nahdati'l-Arabijeh, 1966.

35. Zigmund Frojd, *Edh-Dhat ue'l-Gharaiz*, përkthim i Muhamed Uthman Nexhatit, botimi i tretë, Kajro: Daru'n-Nahdati'l-Arabijeh, 1961.

36. Sejjid Kutub, *Et-Tasuiru'l-fennij fi'l-Kur'an*, botimi i tretë,

Kajro: Daru'l-Mearif, 1975.

37. Cyril Burt, *Ilmu'n-nefsi'd-dinij*, përkthyer nga Samir Abduh, Damask: Dar Dimashk li't-Tiba'ati ue'n-Neshr, pa datë.

38. Sheldon Cashdan: *Ilmu nefsi'sh-sheuadh (Psikologjia e të devijuarve)*, përkthim i Ahmed Abdul Azijz Selame dhe me korrigjim të Muhamed Uthman Nexhatit, El-Kuvejt: Daru'l-Kalem, 1977.

39. Abbas Mahmud El-Akkad, *'Abkarijetu 'Umer*, Bejrut: Daru'l-Kitabi'l-Arabij, 1969.

40. Abdur-Rezzak Neufel, *El-Kur'an ue'l-ilmu'l-hadith*, Bejrut, Daru'l-Kitabi'l-Arabij, 1973.

41. Abdul Gani Abbud, *El-Insan fi'l-Islam ue'l-insanu'l-muasir*, Kajro: Daru'l-Fikri'l-Arabij, 1978.

42. Abdul Fettah Xhelal, *Mine'l-usuli't-terbeuijeti fil-Islam*, El-Merkezu'd-Duelij li't-Ta'limi'l-Uedhifij lil-Kibari fil-'Alemi'l-Arabij, Republika Arabe e Egjiptit, 1977.

43. Abdul Uehhab Hamude, *El-Kur'an ue 'ilmu'n-nefs*, Kajro: Daru'l-Kalem, 1962.

44. Ali Es-Sabunij, *Mukhtesaru Tefsiri Ibn Kethir*, Bejrut: Daru'l-Kur'an, 1977.

45. Ali Abdul Adhim, *Felsefetu'l-ma'rifeti fi'l-Kur'ani'l-Kerijm*, Kajro: Mexhma'ul-Buhuthi'l-Islamijeh, 1973.

46. Fakhruddin Muhammed bin Umer Er-Rrazij: *En-nefsu ue'r-ruh ue sherhu kiuahuma* sipas studimit të Muhammed Sagijr El-Hasan El-Ma'sumij, nga publikimet e Ma'hadu'l-Ebhatti'l-Islamije, Karaçi, pa datë.

47. Fuad El-Behij Es-Sejjid, *El-Ususu'n-Nefsijeh li'n-Numuw*, botimi i katërt, Kajro: Daru'l-Fikri'l-Arabij, 1975.

48. Muhammed Ismail Ibrahim, *El-Kur'an ue I'xhazuhu'l-'Ilmij*, Kajro: Daru'l-Kitabi'l-Arabij, 1977.

49. Muhamed El-Behij, *El-Islam fi hajati'l-muslim*, botimi i dytë, Kajro: Mektebetu Uehbeh, 1973.

50. Muhammed El-Gazali, *El-Xhanibu'l-'atijfij mine'l-Islam*

(*Bahthun fi'l-khuluki ue's-suluki ue't-tesavuf*), Kajro, Daru'l-Kutubi'l-Hadithe, aditheHadithe (pa datë).

51. Muhamed ibn Sirin, *Muntekhabu'l-kelam fi tefsiri'l-ahlam*, e botuar në anë të librit *Ta'tijru'l-enam fi ta'biri'l-menam* i autorit i Abdul Gani En-Nabulsij, Egjipt, 1347 hixhri.

52. Muhamed Xheuad Mugnijeh, *Felsefetu'l-akhlak fi'l-Islam*, Bejrut, Daru'l-Ilm lil-Melajin, 1977.

53. Muhammed Reshid Rida, *Tefsiru'l-Kur'ani'l-Hakijm* i njohur si *Tefsiru'l-Menar*, Kajro: Daru'l-Menar, 1373 h.

54. Muhamed Said Ramadan El-Butij, *Menhexhun terbeuujun ferijdun fi'l-Kur'an*, botim i revistës "El-Ua'ju'l-Islamij", Kuvajt, viti i shtatë, numri 81, tetor 1971.

55. Muhamed Shedijd, *Menhexhu'l-Kur'an fi't-terbijeh*, Bejrut: Muessesetu'r-Risaleh, 1979.

56. Muhamed Kutub, *Fi'n-nefsi ue'l-muxhtema'*, botim i dytë, Kajro: Mektebetu Uehbe, 1962.

57. Muhamed Kutub, *El-Insan bejne'l-Maddijeti ue'l-Islam*, botimi i tretë, Kajro: Isa El-Babij El-Halebij dhe bashkëpuntorët e tij, 1960.

58. Muhamed Kutub, *Dirasat fi'n-nefsi'l-insaniye*, Bejrut: Daru'sh-Shuruk, 1979.

59. Muhamed Kutub, *Menhexhu't-terbijeti'l-islamijeh*, botimi i dytë, Bejrut: Daru'sh-Shuruk (pa datë).

60. Muhamed Uthman Nexhati, *El-Idraku'l-hissij 'inde Ibn Sina, Bahthun fi 'ilmi'n-nefs inde'l-arab*, botim i tretë, Bejrut, Daru'sh-Shuruk, 1980.

61. *Ilmu'n-nefs fi hajatina'l-jeumiye* të Muhamed Uthman Nexhati, botimi 8, Kuvajt, Daru'l-Kalem, 1980.

62. Muhamed Ali Taskhirij, *Et-Teuazun fi'l-Islam*, Bejrut, Ed-Daru'l-Islamije, 1979.

63. Muhamed Muteuel'li Esh-Sha'raui, *Mu'xhizetu'l-Kur'an*, vëll. 1, Kajro: "Kitabu'l-Jeum", 1980.

64. Mahmud Shelebi, *Hajatu Adem*, botimi i dytë, Bejrut:

Daru'l-Xhijl, (pa datë).

65. Jusuf El-Kardaui, *El-Iman ue'l-Hajat*, botimi 6, Kajro, Mektebetu Uehbeh, 1978.

Literaturë e huaj:

1. Adler Alfred: *Understanding Human Nature*, New York: Greenberg Publishers, Inc., 1927.
2. Cannon W.B.: *The Wisdom of the Body*, New York: Norton, 1932.
3. Jung, Carl. G.: *Modern Man in Search of a Soul*, London: Routledge & Kegan Paul, Ltd, 1966.
4. Lindsey, G. Hall, C. Sand and Thompson, R.F., *Psychology*, New York: Worth Publishers, Inc., 1967.
5. May, Rollo: *The Meaning of Anxiety*. New York: The Ronald Press Co., 1950.
6. Morris, Charles, G. *Psychology, An Introduction*, 3rd ed., Englewood Cliffs, New Jersey: Prentice - Hall, Inc., 1979.

Pasqyra e lëndës

<i>Parathënia e përkthyesit.....</i>	<i>3</i>
<i>Parathënia e autorit për botimin e dytë në arabisht.....</i>	<i>5</i>
<i>Hyrja.....</i>	<i>7</i>
<i>Parathënie.....</i>	<i>9</i>
KREU I PARË	
<i>Motivet e sjelljes në Kur'an.....</i>	<i>19</i>
KREU I DYTË	
<i>Reagimet në Kur'an.....</i>	<i>67</i>
KREU I TRETË	
<i>Perceptimet shqisore në Kur'an.....</i>	<i>123</i>
KREU I KATËRT	
<i>Përsiatja (meditimi) nga pikëpamja e Kur'anit.....</i>	<i>139</i>
KREU I PESTË	
<i>Të mësuarit në Kur'an.....</i>	<i>161</i>
KREU I GJASHTË	
<i>Dituria që mësohet vetë, pa mësues, me frymëzimin e Zotit (Ilmu Ledunni) në Kur'an.....</i>	<i>205</i>
KREU I SHTATË	
<i>Kujtesa dhe harresa në Kur'an.....</i>	<i>221</i>
KREU I TETË	
<i>Sistemi nervor në Kur'an.....</i>	<i>233</i>
KREU I NËNTË	
<i>Personaliteti në Kur'an.....</i>	<i>241</i>
KREU I DHJETË	
<i>Psikoterapia në Kur'an.....</i>	<i>279</i>
<i>Burime bibliografike.....</i>	<i>319</i>

القرآن و علم النفس

مؤلف: محمد عثمان نجاتي

مترجم: رديس شكو

تيرانا: 2013

نام کتاب: القرآن و علم النفس
نویسنده: محمد عثمان نجاتی
مترجم: ردیس شکو
تایپ: سونیلا چازیمی
ویرایش ادبی: یریدا کولا
ویرایش لغوی: کلودیانا اسماعیلای و دورینا باشا
مقابله: یتمیر چلا
صحافی: فاتمیر شوتینا
ناشر: مؤسسه قرآن کریم - آلبانی